

Riku Korhonen

ROMAN DOKTORI

Përkthet: Xhemile Zyka

SHTËPIA BOTUESE “FAN NOLI”
TIRANË, 2018

RIKU KORHONEN
Lääkäriromaani

© Riku Korhonen

First published in Finnish by Sammakko in 2008 with the original title Lääkäriromaani.

Published by arrangement with Bonnier Rights Finland, Helsinki, Finland

© i botimit shqip “Fan Noli”



Co-funded by the
Creative Europe Programme
of the European Union

“This project has been funded with support from the European Commission. This publication reflects the views only of the author, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.”

Ky projekt u mundësua me mbështetjen e Komisionit Europian. Ky publikim reflekton vetëm pikëpamjet e autorit dhe Komisioni nuk mban përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit që përmban publikimi.

Redaktor Rexhep Hida

Art grafik Aida Kumi

ISBN 978-9928-251-43-5

PJESA E PARË

FËMIJËT E FAMILJES DARLING

-Intelekti i gruas perëndimore e stimulon seksualitetin e saj. Mos qaj, Rejçëll, këto janë budallallëqe.

Atë të shtunë tetori psikoterapistja Rejçëll Fejërçalld qëndronte para pasqyrës së lartë dhe mendonte që e kaluara na shoqëron gjithmonë. Ishte njëzet e gjashtë vjeçe. E dinte që dukej e bukur me fustanin e kuq të shkurtër prej sateni, në të cilin ishin aplikuar figura lulësh orkideje të kadifenjta. Ktheu kokën. Jashtë dëgjoheshin tingujt e pasdites, të zakonshëm për Kensingtonin, të cilët vinin nga lëvizja në rrugën Holland Strit. Dhimbja iu kthye përsëri.

Ndodhte gjithnjë në të njëjtën mënyrë.

Zakonisht e qetë dhe e kënaqur, papritur, ndiente në ndërgjegjen e saj murmuritjen sarkastike, angulluese të Riçard Këkbërn që vinte nga bilardoja. Zëri i tij kritik e fyes, vajtonte madje edhe pas disa vitesh, gjatë të cilave e kishte pritur.

Sot ajo përgatitej për një ngjarje të rëndësishme. Lëmoi me dorë satenin e kuq. E kishte blerë atë fustan në Brikston Stejshën Arkad nga një shitëse xhamaikane, e cila, teksa shërbente, tundte kofshët e saj të rumbullakëta në ritmin e kërcimit.

Përpiquej ta përzinte nga ndërgjegjja figurën dhe zërin e Riçardit.

Këtë mbrëmje do të takonte Nikolas Strongun dhe do t'i qëndronte pranë si asistentja e tij.

Rejçëll rregulloi supin e fustanit të saj të festës dhe lëmoi me gisht vetullën e djathtë.

Pa dashur i krahasoi të dy burrat.

Riçardi ishte metalurg, njeri fisnik dhe merrte vesh nga makinat. E kishte takuar, kur ishte nëntëmbëdhjetë vjeçe. Ishte admirues i rrobave të ngushta të Pol Smitit, për të cilat, në të vërtetë, nuk i mjaftonin paratë. Luante bilardo në The Elephant & Castle dhe i pëlqente shumë uiski. E quanin bombë ujëshumë dhe kur e tepronin me të – zemërohej keqas.

Vazhdimisht përpiquej të ndikonte negativisht në zhvillimin profesional të saj.

Po Nikolas? Ai ishte krejt ndryshe.

Nikolas Strong ishte arsimuar në universitetin e mjekësisë në Kaliforni. Ishte dyzet e pesë vjeç dhe kishte ardhur në Londër para më shumë se dhjetë vjetësh, i tejnngopur nga materializmi i tepërt kalifornian. Flokët kishin filluar t'i thinjeshin. Ishte vegjetarian, njeri i matur dhe jashtëzakonisht i bukur! Duke shkuar që në mëngjes në qendrën e rehabilitimit burri syjeshil dukej tejet hijerëndë, i paprekshëm dhe i kujdesshëm.

Në vjeshtë, në Londër, mbante këmishë pambuku, xhaketë kadifeje dhe shall gri. Kishte një energji të pashtershme. Megjithatë Rejçëll e dinte se ai kishte përjetuar një tragjedi të tmerrshme.

Para njëzet vitesh, në periferi të San Diegos, një cisternë bëri aksident dhe shpërtheu në autostradë. Gruaja e tij, Sindi, udhëtonte për të marrë pjesë në një kongres të endokrinologjisë. Makina e saj u përplas në cisternën e përfshirë nga flakët.

Që atëherë, Nikolas nuk u martua më.

Rejçëll dinte diçka më shumë për të. Në një mëngjes ngrice, një ditë të zakonshme, Rejçëll kishte hyrë në laboratorin e protezave të qendrës të rehabilitimit. Në varëse në korridor, ishte një shall gri. Ajo e kishte këqyrur me vëmendje dhe e kishte ngjeshur pas fytyrës së vet. Mbante erë koteleje të vogël! Në vetëdijen e saj pati ndjesinë e pritshmërisë për diçka emocionuese.

Qëkur ishte student, Rejçëll ia kishte dëgjuar emrin dhe

kishte lexuar me interes intervistat e tij. Nikolas ishte ortoped dhe, ndoshta, protezisti më i mirë në botë.

Ndihma e pakursyer që u kishte dhënë fëmijëve në zonat e krizës, e kishte bërë atë të njohur. Përveç kësaj, ai merrte pjesë aktivisht në punën e organizatës “Mjekët pa kufi”, e cila kishte dhënë ndihmë mjekësore vetëmohuese për nevojtarët e vendeve në zhvillim.

Tashmë, Rejçëll e njihte atë personalisht.

Tani ajo ishte kolegia e tij.

Kolege.

Asgjë më shumë se kolege.

Ajo vuri pëllëmbët në faqe. Në krizë zemërimi, doli dhe ndjeu dëshirë t’i bërtiste imazhit të vet:

“Je një mjerane, Rejçëll! Jeta jote është një rrëmujë e vërtetë!”

Rregulloi flokët dhe u përpoq të qetësohej.

Viti fluturoi jashtëzakonisht shpejt. Vjeshtën e kaluar, kur fitoi një vend në qendrën e rehabilitimit, në Rouhempton, për njëfarë kohe ndihej e lumtur. Priste një rritje të qetë profesionale. S’kishte nga ta dinte se, shumë shpejt, një jetim i gjymtuar, më i njohuri në planet, do të bëhej pacienti i tyre. Vështroi thellë në sytë e vet. U drodh dhe, prapë, u inatos. Si mund të jetë kaq sipërfaqësore? Për çfarë ëndërron ajo, në të vërtetë? Guxonte të tërhiqte me etje vëmendjen e syjeshilit Nikolas Strong dhe t’i prekte atij duart, ndërsa Ali kishte humbur duart dhe familjen e vet, ishte i pafuqishëm dhe kishte nevojë për përkrahje si gjithë populli irakian.

Ajo vuri edhe pak pudër. U mundua të përfytyronte si do të dukej me pelerinë apo me kokën e mbështjellë me shall. Jetesa midis larmisë londineze me vite, ia kishte pasuruar njohuritë për gratë e lindjes. Kishte parë në Eduard Strit, në Sout’ holl pakistaneze dhe indiane me veshje shumë të bukura, kurse në Uajtçipëll Roud - vajza zeshkane nga Bangladeshi me veshje shumëngjyrëshe dhe me byzylykë të rëndë.

Nganjëherë habitej, kur mendonte se jeta e atyre femrave të reja

zeshkane, në njëfarë mënyre, mund të ishte më e lehtë se e saja. A nuk ishin më të çliruara nga barra, që rëndonte dhe mundonte një grua moderne perëndimore si ajo?

Vendosi që sot të mos e vriste mendjen për këtë.

Sot do të festojnë. Sot do të kërcejnë e do të gëzojnë. Sot djaloshit irakian me proteza bionike do t'i akordohet dekorata e Shpresës nga shoqata e amputimit. I gjymtuari nga lufta, Ali, do të ngjitej në skenë, në qendër të fokusit të mediave. Protezat e tij bioelektronike do të lëvizin para publikut dhe ai do të thoshte ca fjalë të pakuptueshme, të cilat dikush do t'i përkthente në një gjuhë të kuptueshme. Ali optimist do të fliste për Irakun, për atdheun e tij të vuajtur, i çliruar, tashmë, nga hija e diktatorit. Atje bën nxehtë, atje ka naftë, atje jetojnë sunët dhe shiitët, të cilët bëjnë luftë midis tyre. Tani atje ka edhe amerikanë edhe anglezë, të cilët me çmimin e jetës, i japin mundësi vendit të ecë përpara.

Nikolas duhej të mbante një fjalim. Rejçëll ishte e sigurt se fjala e tij do të ishte e madhërishme, plot mençuri dhe keqardhje ndaj dhimbjeve të gjymtyrëve të humbura të fëmijës shiit, në sulmin me raketa.

Këtë mbrëmje, Rejçëll do të harronte dëshirat e saj qesharake dhe do të qëndronte pranë Nikolasit dhe Alit. Mbrëmja galà, ishte e rëndësishme, gjithashtu, edhe për qendrën e rehabilitimit. Do të ishin të pranishëm autoritete dhe personalitete me influencë.

Pavarësisht nga kjo, nuk mund të mos mendonte për Nikolasin.

Do ta shikonte të veshur me kostum të zi.

Ishte e sigurt se këmisha e tij e bardhë do të ishte e përsosur. Por në shikimin e tij do të dallohej trishtimi, i cili kishte zënë vend tek ai për një kohë të gjatë. Ndoshta ngaqë kishte parë jashtëzakonisht shumë vuajtje feminare që e kishin përmbytur si deti dhe kishin ngrirë në sytë e tij.

Rejçëll nuk e nënvleftësonte, madje e ndiente edhe vetë forcën e feminitetit të saj. Kishte dy duar femre, të buta e të ndjeshme, me të cilat mund të qetësonte çdo mashkull, derisa ai të mos mendonte për asnjë tjetër.

Por vetëm, nëse ky burrë e donte atë.

Për një moment u ndje e pasigurt. Po sikur Nikolasi të jetë homo? Jo, kjo është e pamundur. Burrëria e tij ishte aq e qartë dhe e dukshme, saqë përjashtoj çdo lloj devijimi.

Në një fundjavë Rejçëll ishte ndier e vetmuar. Ia kishte lënë apartamentin e marrë me qira tezes së saj Marigold, kishte dalë nga stacioni Kuisaun dhe kishte hyrë në Hajd Park. Ishte ulur e mërzitur në një stol dhe u hidhte pëllumbave fara luledielli. I ushqente zogjtë që të mos mendonte të bënte gjë tjetër. Në moshën njëzet e gjashtë vjeçe, tashmë, e njihte veten deri diku. E njihte gjoksin e saj, gjatësinë, peshën dhe vlerat e presionit të gjakut. Duke zgjatur dorën nga zogjtë, ndiente se si brenda saj ngrihej diçka e madhe, e panjohur, përmasa e së cilës nuk mund të përcaktohej.

Në ëndërr Rejçëll e dinte çfarë ishte kjo.

Ishte dashuria e saj e papërmbajtshme.

Ishte ndjeshmëria e çmendur femërore ndaj një burri, ishte një ndjenjë që herë shpërthente, herë paqëtohej. Një natë gjysmë në ëndërr buzët e saj të vetmuara pëshpëritën: “Nikolas”.

Rejçëll Fejërçajlld ishte rehabilitologe, vajza e një postieri nga qyteti Hejurds Hijt. Tani atë e priste taksia në Holland Strit. E priste Nikolas Strong, e priste Ali, mediat, gjithashtu, e prisnin.

Para se të nisej, Rejçëll iu drejtua edhe një herë imazhit të vet: “Kjo është vetëm punë. Kjo është vetëm punë dhe asgjë më shumë”.

Pastaj i ktheu shpinën pasqyrës, veshi xhaketën, mori çantën dhe doli.

Argumenti i artikullit m'u duk i thjeshtë:

Pas çlirimit të Irakut nuk është e drejtë që SHBA-të të quhen polic botëror. Më shumë duhet folur për kryemjekun global.

Argumenti ishte i thjeshtë, por ngatërrohej në arsyetim. E ndieja që po shkruaja për veten, që po zhvishem. Në vetëdije më shfaqej figura e Inës.

Kisha një tavolinë pune të re. Temperatura në dhomë që në mëngjes ishte afër tridhjetë gradë. Ventilatori i tavolinës zhurmonte. Monitori shkëlqente në sytë e mi. Korridori pas shpinës sime ishte bosh. Përmes grilave shikoja një brez bari të thatë dhe një makinë të zezë në parking. Dukej se ndonjë idiot përpiqej të punonte në atë ferr.

U shkëputa dhe mbusha një gotë ujë.

Lexova në internet në gazetën "Independent", se në Europë kanë vdekur nga vapa qindra të moshuar. Në korrik masat e ajrit rrotulloheshin mbi detin Mesdhe. Avujt vdekjeprurës që vinin nga Saharaja nxehnin Romën, Lisbonën dhe Madridin. Në Paris i mblidhnin kufomat në hali të vjetra. Në Londër vdisnin në parqe dhe në pabe. Vapa lundronte e lundronte mbi fytyrat e rrudhura dhe vazhdonte në veri, duke mbartur përzierjen erëkeqe të dioksitit gri dhe shpirtrat fluturues europianë.

Kontrollova postën elektronike. S'kishte asgjë interesante, përveç një linku që më kishte dërguar një aspirant nga Tamperi. Ai më tërhiqte vëmendjen tek një faqe internet mbi një bërthamë nacionalsocialiste. Ajo ishte krijuar para disa muajsh dhe ishte formuluar bukur.

Në programin e tyre parimor gërshetohej racizmi dhe plot budallallëqe të tjera. U habita që pashë emrat si të drejtuesve të grupit, ashtu dhe të dy shokëve të tij. Njëri mbante mbiemrin Taberman, tjetri – Janson. Hapa kutinë e tij postare. Përdora nofkën e re – Jusi Korpinen. Dërgues : Jusi Korpinen<s.berluskoni et

hotmail.com> Marrësi : esa.taberman et vs-sisu.org, pekkajanson et vs-sissu.org referuar : Shoumen Suedez Përshëndetje, Hyra në faqen tënde.

Dhe lindi pyetja: për çfarë dreqi ju, shoumen suedez, merreni me mbrojtjen e një fisi finlandez? Nuk ka arsye që ju, plehra të ndyra suedeze të shqetësoheni për lulëzimin e Finlandës. Marsh, kthehuni mbrapsht në Suedi. Jusi Korpinen është finlandez autokton.

E nisa letrën dhe e mbylla postën. U qetësova. Hapa programin e përpunimit të tekstit, - Kështu pra- thashë me zë. Këtë artikull e planifikova sonte, teksa vërtitesha gjithë djersë me Inën në mendje dhe thërrimet e çipseve më gudulisnin shpinën.

Nën ulërimën e makinave të ambulancës dhe britmave të pijanecëve nga rruga arsyejoja dhe analizoja mendimet e mia. Tani orët rridhnin, ndërsa unë përpiqesha të sajoja fjali të sakta dhe ironike.

Dhe për çfarë dreq, o zot. Shtyva prapa mbështetësen e karriges, pastaj e ngrita, ngrita dhe ndenjësen, e shtyva prapë mbrapa, drejtova mbështetësen e krahut të djathtë dhe ula të majtën.

Hapa pak dritaren e vogël dhe nxora kokën jashtë. Dielli më verboi. Era e nxehtë ma mbuloi fytyrën. Prej diku vinte e qeshura e një femre dhe binte erë duhani. Kisha dëshirë të pija, por diku larg nga qyteti im. Imagjinoj veten duke shikuar në sy godinën përballë – gëlltis ajrin, shef kabineti i punës në katin e dytë të godinës së fakultetit.

I pafuqishëm dhe i paaftë për kontakte njerëzore. Puna më kishte mësuar si kalojnë ditët në mungesën e frymëzimit krijues. Por nuk isha i vetmi. Të tillë si unë, në vendin tonë, kishte me mijëra dhe ishim akoma të rinj dhe minj kureshtarë librash.

Në bibliotekën time kisha dhjetëra fotokopje. Vallë a kishte kuptim puna jonë? Dhomat tona ishin të vogla dhe pa horizont. Duhej ta shikoja të vërtetën në sy. Nganjëherë ndieja kënaqësi nga të menduarit e nga të shkruarit, por kjo ishte e dyshimtë.

Në dymbëdhjetë bëra një pushim. U nisa për nga bregu i lumit

për të ngrënë. I pjekur nga vapa, qyteti rrezatonte lodhje. Lëvizja rrugore gjemonte nëpër Kirkosilta.

Prapa muzeut të Sibeliusit, disa vajza me rroba banje dhe me syze dielli, të modelit Killer Loop, ishin ulur mbi një batanije nën një lis të madh. Ishin prej atyre që bënin xhiro në grupe të zhurmshme në brigjet e lumit, nëpër qendrat tregtare dhe klubet e natës, me pamjen e jashtme të modelit të viteve 82-83, me vithet e shtrënguara në mënyrë joshëse, skllave të konsumit, të cilat ushqehen me energji nga drita e diellit, fitnesi, kohë pas kohe me ndonjë tabletë droge – ekstazi dhe gllënjka sperme të ndyrësirave në hijet e parkut Vartiovuori.

Nëse njeriu ngjitej në lis, nga lart përmes gjetheve do të shikonte pirsingët që shkëlqenin në barkun e tyre. Në kohën që flisnin për luftën, për qetësinë shpirtërore dhe interfejsat e tyre MP – 3, zërat e tyre tingëllonin dhimbshëm ose butë. U ula në lëndinë dhe hëngra sallatën. S’kisha kohë fare, isha tmerrësisht mbrapa.

Ishte korrik. Nxënësit, tashmë, kishin filluar të interesoheshin, megjithëse ishte akoma atmosferë pushimesh. Në kabinetin e punës mbretëronte qetësia dhe era e letrave të printuara.

Lëkura ime, nën rroba, ishte e zbehtë. Ndërsa Ina, gjatë kësaj vere, ishte nxirë nga dielli si asnjëherë më parë. Kur u zhveshëm në mbrëmje – sikur ishin përfaqësues të dy racave të ndryshme.

Godina pesëkatëshe e kooperativës sonë ishte në bregun tjetër të lumit. Mund t’i telefonoja e t’i thosha që jam ulur në vapë dhe po shikoj andej, që ajo është, me të vërtetë e bukur. Dhe që po mendoj për gjinjte e saj. I njihja ata dhe çdo mbrëmje kënaqesha në ngrohtësinë e tyre.

Por isha i pafuqishëm për të bërë diçka, kur ajo, e shtrirë pranë meje, papritur bëhej e huaj, mbushte mushkëritë me ajër, fytyra e saj prishej nga trishtimi dhe trupi i saj lëkundej si një varkë e hedhur në breg.

Kurrë s’kisha parë diçka të tillë më parë. Vështrova pulëbardhat që fluturonin mbi lumë. Ndoshta duhej t’i tregoja Inës se faqja e internetit e racistëve nga Turku është bërë me mjeshtëri.

Në të vërtetë ishte prekëse që në mëngën Orion të Rrugës së Qumështit, rreth yllit të verdhë nga klasa spektrale G2 ecën planeti, në sipërfaqen e të cilit primatë të vegjël shkëmbejnë lajme kontradiktore në internet.

Prandaj ishin të nevojshëm evolucionin dhe mijëra vjet progres teknik. Njëqelizorët, dyqelizorët, peshku, majmuni, njeriu. Zjarri, maja e shigjetës, rrota, busulla, Gutenbergu, makina me avull, $E=mc^2$, makina enëlarëse, mikroprocesori, PDF fajll-i nazist. E mbarova sallatën. E futa kutinë plastike në çantën time të shpinës.

Vështrova vajzat dhe u ktheva tek puna ime. Në rrugën “Piispakatu” kalova pranë një panje të madhe. M’u kujtua se si dimrin e kaluar, në një mëngjes, rrugës për në fakultet, nga degët e zhveshura të po asaj panje dëgjova zhurmë. Vështrova lart me sytë e pulitur.

Nga qielli me ré binte vesa e shiut mbi ata që shkonin në punë, u lagte supet e përkulura dhe i detyronte të nxitonin. Midis degëve pashë një ketër të palëvizshëm me bishtin e ngritur. Ai kërcente, kur mbi të hidhej një ketër tjetër.

Ata ndiqnin njëri-tjetrin rreth trupit të pemës dhe duke e gërvishtur me thonj, hidheshin herë lart, herë poshtë, por, papritur ndaluan. Atëherë se nga ku kërcëu një ketër tjetër, i cili ndoqi atë të fundit. I vëzhgoja, i ngrysur, kërcimet e tyre nga një degë në tjetrën. Shpejtësia e tyre ishte e habitshme. Po të kisha një pushkë do t’i kisha qëlluar, që ata të ndalonin.

Qëndrova nën pemë, derisa acarimi im u qetësua, qielli u kthjellua dhe, papritur, pata një ndjesi sikur po ndiqja një triptik të madh: në gjysmën e majtë të tij, rridhte lumi i errët Aura, në të djathtën ngrihej kolona e gurtë e katedrales, ndërsa në mes skërmitej panja me ketrat e çmendur, të cilët ndiqnin njëri-tjetrin si të tërbuar, ndërkohë që në rrugën “Yudenmmakatu” gjëmonin makinat dhe autobusët e mbushur plot.

Por këto duhen parë me qetësi, sepse, po të mund t’i pyesja ketrat përse bëjnë ashtu, nuk do të më përgjigjeshin. Njerëzit gjithashtu. Veprojnë kështu, sepse veprojnë kështu. Të kapluar nga

dëshira e verbër, njerëzit krijojnë nga myku i tokës kisha, shkolla, dyqane dhe diktatura ushtarake.

2

Kam lindur në vitin 1972 në një familje të shtresës së mesme. Kisha një motër. Prindërit e mi ishin apolitikë të thellë. Babai im ishte me origjinë nga komuna Laaka dhe ishte djali më i madh i fermerëve. Në moshën nëntëmbëdhjetë vjeç erdhi në Turku për të studiuar dhe në vitin 1968 u diplomua si mjek.

Në mes të vitit shtatëdhjetë mori specialitetin e pediatri. Ai ishte i pari me shkollë të lartë nga fisi dhe krenohej me arsimimin e vet.

Për çfarë rebelohej rinia? Në cilën anë qëndronte? Ekonomia dhe politika ishin të huaja për të dhe aspak interesante, problemet e shoqërisë, gjithashtu. Trashëgimia e tij përbëhej nga toka, pylli dhe qielli, të cilët nuk i krijonin atij probleme.

Nga rrëfimet e babait, unë kam kuptuar se idealizmi i brishtë në shtëpinë e tij, ishte i përzier me frikën nga Zoti, pak patriotizëm për vendin, simpati për idetë e Alkios, të cilat zhdukeshin shpejt si tymi i ftohtë, kur hapnin shishen e vodkës, fillonin të flisnin për gjëra serioze, për punën, për mbjelljet, për luftën ose për gjahun.

Duke shëtitur nëpër rrugët e Turkut babai e kuptonte se është lidhur përjetë me arat dh bujqësinë. Revolucionet ishin të huaja për të dhe e ndiente se ky mishërim i dijeve është varianti më i sigurt në rrugën drejt një bote më të mirë dhe më interesante.

Nëna ime kishte lindur në Turku. Ishte bijë e një kasapi të pastër, vajzë me karakter – emocionet e saj të dashurisë i shqetësonin prindërit. Në kohën e Krishtlindjes, në vitin 1966 babai im e kishte parë në dyqan, teksa i jepte një klienti një pako mishi të tymosur. Prindi im i varfër, filloi të kursejë. Në fund të dimrit e ftoi në kafene.

U ulën në Asçani në rrugën “Humalistokatu”. Nëna ime kishte

frikë se ky burrë i këndshëm ishte tepër i zgjuar për të. Duke buzëqeshur, babai i tregonte asaj se si, në fillim të studimeve, gjatë netëve në vetmi, e mbante frymën dhe e maste kohën me matës sekondash. Një herë e humbi mendjen me orën në dorë. Nëna e shikonte dhe mendonte që ai kishte një çmenduri gazmore delikate, të domosdoshme. Brenda vetes ishte e qetë.

Ndoshta dashuria e saj për të ishte shprehje e revoltës kundër materializmit të familjes provinciale – borgjezi e vogël – dhe shpirtit të saj romantik. Ajo ndihej mirë me të. Ata e adhuronin njëri-tjetrin dhe midis botës së zhurmshme ishin bardhë e zi, trup e shpirt.

E donin shumë njëri-tjetrin, u martuan dhe në vitin 1970 u shfaq motra ime Johana, e cila trashëgonte inatin e nënës. Johana thoshte se martesë e prindërve tanë ishte mbajtur fort ndër vite – kjo për një arsye të thjeshtë: kur babai kthehej nga udhëtimi – puna e parë ishte të përqafoje mamanë, pastaj na jepte dhuratat neve dhe na nxirrte në oborr.

Nëse gjatë martesës dhjetëvjeçare midis prindërve të mi zienin pasione të papërmbajtshme, unë dhe motra ishim të lirë prej tyre. Rriteshim, teksa shikonim si babai ynë zbavitet duke zënë peshk, kurse nëna, në kopsht, ulej në gjunjë, me një shprehje të ëmbël në fytyrë.

Qëndrimi i babait ndaj meje më bënte të ndihesha i padrejtë. E di që, shpesh, në shoqërinë e klubeve thosha: “Babai im është njeri i mirë”. Afër figurës së tij flokëgjatë ndihesha mirë. Do të mund ta akuzoja vetëm se, për arsye profesionale, gjatë viteve të fëmijërisë sime, shfaqte interes të madh për zhvillimin e testikujve të mi. Ose do të mund të thosha se, në marrëdhëniet me mua, ishte aq i ndërlikuar, sa që unë nuk e kuptoja. Në moshën tetëvjeçare unë ëndërroja të më dhuronin për Krishtlindje miniski.

Para pesë vjetësh, ishim transferuar nga një apartament me dy dhoma në qendër të qytetit – në një me trekatësh, të veshur me tulla të kuqe me një oborr me gurë në periferinë jugore të qytetit. Nga qendra nuk kam kujtime. Atëherë imagjinoja që të gjitha familjet

me fëmijë, në botë, jetojnë si ne, në banesa prej njëqind metrash katrorë, të cilat përbëheshin nga katër dhoma dhe kuzhina dhe nën ballkonin e tyre fëshfërinin përgjumshëm mështeknat.

Dhoma e ndenjes ishte me parket ahu dhe me panele pishe. Kishim televizor me ngjyra dhe stereosistem Panasonic. Fqinjët tanë ishin, kryesisht, nga shtresa e mesme. Në barakën e barbekysë mbledheshin një drejtor banke, një montues makinash, një punonjës social, një oficer, një mjek dhe një punëtor i industrisë ushqimore.

Të gjithë mbanin veshje sportive, atlete nga Karhu, derisa kujtoheshin për teknikën e vrapimit të Lase Viren, vështronin se si fëmijët e tyre ngjiteshin në pishat e ulëta dhe flisnin për telefonat-lodër me jashtëtokësorët nga kozmosi i pakufishëm, të prodhuar në Tajvan. E gjithë bota do të shikonte se si djemtë nga oborri presin rripat e miniskive të tyre, zbresin poshtë nga shkëmbi i lartë dhe hidhen nga trampolina e ndërtuar me gurë.

Babai më kishte përvëlur ëndrrën time me shprehjen që miniskitë janë të padobishëm dhe të rrezikshëm. Më përshkruante pasojat nga thyerja e lidhëses në formë kryqi në kyçe.

Mbrëmjen e Krishtlindjes mora një pako, përmbajtjen e së cilës e mora me mend nga formati i saj. Murmurita – faleminderit – dhe e mbështeta pakon me lapsa tek muri. Babai më premtoi se do të bëjmë një ekspeditë në luginën Katarina, do të marrim ushqim me vete, kakao të ngrohtë dhe do të kënaqemi me detin e ngrirë dhe natyrën me borë sa të duam.

Në kulmin e Krishtlindjes, të tjerët shkuan të urojnë gjyshen time nga ana e nënës që ishte e sëmurë. Vështroja nga dritarja se si lada jonë e bardhë doli nga parking dhe u zhduk pas kthesës së rrugës. Mendoja për babain dhe vështroja jashtë disi i hutuar. Kalova nga dhoma në dhomë.

Rrëmbeva nga dollapi koshin e plehrave plot me letra, shkova në kuzhinë, mora disa gazeta dhe i vura në lavaman. Ndeza një kunj shkrepëse dhe u vura zjarrin. Zjarri u hap me shpejtësi. Shumë shpejt, flaka njëmetërshe lëpiu derën e gjelbër të dollapit të enëve.

Ia ngula sytë zjarrit. Në mes m'u bë sikur pashë një vend, në të

cilin plasmasi filloi të shkrihet dhe pjesëtarët e familjes po ndahen. U përpoqa ta rrasja dorën në zjarr, që të arrija tek doreza e çezmës, vrapova në korridor dhe vasha këpucët. Nga dera e jashtme dukej sikur e gjithë kuzhina kishte marrë flakë.

Qëndrova gjatë jashtë, duke u dridhur nga të ftohtit. Në një moment lada hyri në parking. – Po digjet kuzhina – thashë unë.

Babai nxitoi nëpër shkallë. Pas pak, ai doli, më rrëmbeu nga jaka dhe më futi brenda. Kuzhina plot tym binte erë të keqe. Kapaku i makinës enëlarëse ishte shtrembëruar, nga tharësja vareshin furça të zeza të deformuara, që u ngjanin zogjve të zhytur në naftë.

Dera e re e dollapit do të të gëlltisë paratë e xhepit për gjysmë viti. Do të ndihmohet për lyerjen e tavanit - tha babai. Ditën e dytë të Krishtlindjes vasha këpucët dhe vura në krah skitë e reja. Thashë se do t'i provoja në oborr. Babai qeshi.

Ndoshta po imagjinonte sa e kaltër është në shkurt lugina Katarina dhe sa mirë ndihen atje babai dhe i biri së bashku. Tashmë ishte errësirë. U ngjita në kodrën shkëmbore. I rregullova skitë dhe pashë tatëpjetën e pjerrët. Mora vrull dhe u nisa.

Shpejtësia rritej çuditërisht fort. Era fishkëllente në fytyrën time. Para trampolinës u lëkunda dhe nuk arrita ta kapja. Gjunjët më dridheshin nga tensioni dhe entuziazmi. Në vetëdijen time u shfaq një pamje: një grup burrash me veshje sportive po bëjnë ski.

Tashmë duhej ose të merrja kthesë të fortë, ose të ndaloja menjëherë, siç bëri djaloshi. Skitë u thyen në kanal me kërcitje të fortë. Trupi vazhdoi të përpara, fytyra m'u ndesh në diçka të fortë. Rrija shtrirë në kanal i trullësuar. Diafragma më ishte bërë nyje dhe merrja frymë si peshku në sterë.

Kjo vazhdoi gjatë. Më në fund arrita të merrja frymë, nyja në stomak m'u zgjidh dhe frymëmarrja u bë normale. Nxora duart nga rripat dhe u përpoqa të lirohesh nga një pjesë e skive. Arrita të kthehesha në shpinë. U rrotullova në fund të kanalit me skitë e ngritura. Më rridhte gjak i ngrohtë nga mjekra.

Ndjeva që kisha thyer një dhëmb të parë. Me një sy pashë në qiellin e errët rrathë të ndritshëm si emblema olimpikë e Lejk

Plesid. Në pasqyrën e ashensorit pashë fytyrën time të gjakosur. Babai më hapi derën dhe m'i nguli sytë. U shemba në stolin e korridorit me skitë në dorë. Babai më zbathi dhe më zhveshi. Në banjë më këqyri plagët. Më këqyri edhe në gojë:

-Tani, prapë do të më duhet të të çoj në poliklinikë.

E vështrova në sy dhe fillova të qaj. Në dritën e llambës ilumineshente sytë e babait më dukeshin të mëdhenj, të kaltër të çelët, seriozë dhe dashamirës siç ishin në të vërtetë, kur ka qenë fëmijë në fermën e babait të vet dhe, me këta sy doktori, ai s'mund të gënjente asnjëri.

Kur nëna mbeti shtatzënë me mua, babai shiti fiatin e kuq, të vjetër, të vogël dhe bleu një lada të re të bardhë. Për herë të parë hipa në të në janar të vitit 1972 rrugës nga materniteti në shtëpi. Babai ngiste makinën, ndërsa unë flija në krahët e nënës, pa dyshuar ç'do të thotë dimër dhe vuajtje.

Gjatë viteve 60-të dhe 70-të, finlandezët përjetuan një periudhë romantizmi politik. Koncepti vlera e shitjes dhe balanca e pagesave prodhoi njëfarë tipi njerëzish ortodoksë të budallallepsur: stalinistë të penduar në studio televizive të mbrëmjes.

Jepnin në emision sytë e tyre të përplotur – ishte shumë interesante. Fëmijët e brezit të politizuar ishin edukuar në mënyrë të pandershme. Shumë vite më vonë, shikoja një film dokumentar televiziv, në të cilin po ata fëmijë kujtonin me nostalgji ladat.

Për mendimin tim filmi ishte falsifikim i së vërtetës për makinat e shpifura të lindjes. Kur shkuam për vizitë, gjatë pushimeve verore, tek kushërinjtë tanë në Finlandën e mesme, tapiceria prej plastmase e makinës, e nxehur nga vapa, lëshonte erë të keqe, saqë mua dhe motrës na vinte për të vjellë.

Nëpër rrugët e errëta të dimrit, zhurma ulëritëse nga ndryshimi i shpejtësisë më tërbonte. Zgjohesha natën dhe ëndërroja ta bindja babain të blinte një makinë të rregullt. Nëse s'do ta bënte, unë parapëlqejta të vdisja më mirë.

Në vjeshtën e vitit 1979 më regjistruan në klasën e parë. Në edukimin parashkollor, unë isha dalluar në mundje, isha një

bukurosh mjaft i mprehtë, tip sportiv dhe luftarak. Thëmbra ime e Akilit ishte lada e babait tim. E dija që mund të më dëmtonte në shoqëri.

Nuk e kuptoja, përse babait i pëlqente të ngiste pikërisht ladën. Nuk besonte në komunizëm. Ishte mjek i specializuar dhe, kuptohet, kishte para të mjaftueshme për një makinë të mirë. Shfletova një Katalog makinash dhe ia tregova fotot. Volvo metalike taunus është makinë e bukur, tojota që bëhej në Japoni. Babai m'i bënte hi e pluhur ëndrrat e mia për një jetë më dinjitoze me një argument të vetëm: - Çmimi i ladës është më i ulëti për makinat e asaj kategorie.

Kishte edhe diçka tjetër babai që i bënte fëmijët të talleshin – e ngiste makinën me doreza lëkure pa gishta, të cilat i mbërthente me rrip. Ato do t'i shkonin Xhejms Bondit, duke fluturuar me aston martini. Babai më thoshte se, me ato, e mban më mirë timonin.

Kur nisej për në punë, ai bënte të njëjtën gjë: hapte derën e shoferit, hidhte çantën e vet brenda, vinte dorezat, i mbërthente me kujdes, ulej në makinë dhe nisej.

E gjithë kjo ishte nga lada. Një herë po më çonte në mundje fëmijësh. Një roje që kaloi pranë nesh, e pa si i vinte babai dorezat. “Është diçka e tepërt për një makinë lindore” - tha ai. Babai i buzëqeshi dhe mbërtheu dorezat, sikur po përgatitej për një operacion në zemër. Me ato doreza, i dukeshin duart si të një invalidi.

Në verën e vitit 1982 u transferuam në një zonë tjetër të periferisë, në shtëpi private. Në kamionin që transportonte bagazhet tona, u ula midis dy hamejve. Nga kabina e lartë vështroja njerëzit që, kishin qenë miqtë e mi deri kohët e fundit. E ndieja se si fytyrat dhe emrat e tyre më fshiheshin nga vetëdija.

Në vjeshtë, hyra në shkollën e zonës. Ishim banorë të rinj dhe shokët e mi të shkollës nuk dinin asgjë për makinën tonë. Ndoshta tani që kishim dhe një pishinë të vogël private, babai do ta ndërronte makinën. Një ditë gushti, ai u bë gati gjithë gëzim dhe më ftoi të dilja jashtë. Atje krekoj një ladë e bardhë, krejt e re,

kopje e plotë e së vjetrës. U tërbova.

U ngjita me vrap tek dhoma ime, u futa brenda dhe përplasa derën. U shtriva në shtrat me lot në sy dhe mata pulsën. Më e tmerrshmja ishte se babai më dukej i lumtur. Ditën e parë të mësimit, binte shi. Nuk pranova që babai të më çonte në shkollë me makinë, u nisa në këmbë nën shiun e ngrohtë të verës.

U ula në bankë me adidaset e mia të reja, shikoja shokët e klasës dhe mendoja, cilët prej tyre do të bëheshin miqtë e mi, cilin do të doja dhe cilin do të urreja. Mësuesi ynë simpatik i kërkoi secilit prej nesh të ngrihej e të prezantohej, sepse në klasë kishte tre nxënës të rinj.

Erdhi radha ime dhe tregova, cili jam, nga vij dhe çfarë interesash kisha. Desha të shtoja edhe diçka tjetër. Vështrova nga dritarja dhe pashë në rrugën bosh një makinë të zezë, pjesa e përparme e kromuar e së cilës pasqyronte diellin. Atëherë thashë: “Babai im ka ndërmend të blejë një krajsler njujorker.”

Askush nuk foli. Mësuesi tundi kokën. U ula dhe ndjeva që më digjinin faqet. Për një moment provova gëzim. Në qershor të vitit 1983, Johana më “njohu” me fëmijët e familjes Darling. Pushuam dy javë në liqenin Garda dhe udhëtuam midis Malcesine dhe Riva. Teksa anija e bardhë largohej nga moli, italianët llafazanë, hapën batanijet mbi kuvertën e kaltër, nxorën nga shportat bukë, verë, ëmbëlsira, fruta dhe filluan t’i shkëmbenin me njëri-tjetrin. Një trashaluaq i binte kitarës dhe këndonte. Një grua na hodhi verë në gotat tona dhe na ftoi të pinim bashkë

Nga shprehja e fytyrës së nënës sime, kuptova se u ngazëllye. Në fisin e saj nuk veprojnë kështu. Nëna e mori babain për dore dhe u bashkua me italianët. Unë me Johanën u ulëm në stol pranë parapetit. Vura ré se italianët flasin dhe qeshin pa pushim, por komunikimi me ta nuk ishte fare i paqortueshëm. I ngisnin motoçikletat dhe makinat e tyre me shpejtësi të shfrenuar dhe në rrugë bërtisnin, duke tundur duart si të çmendur.

Rojet e bankave ishin të armatosur me automatikë, megjithëse lireta s’kishte ndonjë vlerë të madhe. Pronari i hotelit tonë, e

mori llastikun tim, goditi një fener të rrugës, e bëri copë-copë dhe bërtiti, duke u rënë me duar kofshëve të veta.

Ishte burrë i fortë me qime të zeza nëpër duar. Në zhvillimin e tyre, italianët kishin vendosur të mbeteshin fëmijë. Liqeni ishte i ngushtë dhe i kaltër, malet të qeta. Vështrova nga kuverta dhe pashë nënën duke kërcyer. Kishte vënë duart në ije dhe tundej me sy mbyllur. Ishte veshur me një fund të shkurtër.

Vura re se burrat e atyshëm ia ngulnin sytë, megjithëse, tashmë ishte mesogrua. Ndoshta kërcente në atë anije turistike, sepse e ndiente që rinia e saj po fluturonte. Babai u afrua, qëndroi prapa saj dhe i vuri duart mbi pëllëmbët e saj. Këmishën e kishte të zbërthyer. Italianëve nuk iu interesonte. Sipas meje, prindërit e mi shtireshin. Doja të shkoja, t'u jepja nga një shqelm dhe t'u thosha: “Mjaft, ju jeni nga Turku!”

Johana vështroi nënën dhe babain, më preku në sup dhe tha: “Hajde”. Shkuam nga pjesa e pasme e kuvertës. U mbështetëm tek parapeti, vështronim ujin e shpejtë dhe brazdat plot shkumë. Qielli ishte i kaltër si guri në karficën e flokëve të motrës sime.

Në largësi lundronin varkat me vela. Johana, më shumë, nuk vinte me ne në ditën e mesverës dhe parapëlqente të qëndronte në qytet. Asaj i ishin rritur gjinjat e rumbullakët, tashmë përdorte buzëkuq dhe, shpesh, dukej sikur mbante mbi supë një barrë të rëndë, pesha e së cilës mund të lëndonte të tjerët.

Në vjeshtë ajo do të kalonte në të lartën. Gëzohesha që, midis gjithë atyre italianëve, parapëlqente shoqërinë time. Kjo ndodhte gjithnjë e më rrallë. Johana ngriti mjekrën dhe po shikonte në liqen. – Mendo për këtë Niklas. Mbaje mend këtë. Këtu janë fëmijët e familjes Darling. Menjëherë e kuptova çfarë kishte parasysh.

Prindërit tanë kërcenin aty përpara, ndërsa prapa ne mund të ishim ashtu siç jemi. I hodha sytë nga malet dhe po mendoja për fjalët e Johanës. Tingëllonin bukur dhe trishtueshëm: fëmijët e familjes Darling. Janë fëmijët e familjes Darling! Ata s'kishin prindër dhe emra. Ata i merrnin fytyrat e veta nga shpresat, nga liria dhe nga paratë, vinin nga një vend i madh, ku nuk mund të

shkoje me lada.

Atje zgjoheshin vonë dhe vendosnin rekorde për të ardhurit nga Kozmosi. Vajzat ishin më të nxira e më të egra nga ato të Finlandës. Djemtë i lyenin flokët si ato të Pier Litbarskit në kampionatin botëror të Spanjës. Fëmijët e familjes Darling. Kishin elektronikën më të mirë japoneze, megjithatë e ndienin sa e rëndë është të pish kakao në mbrëmje, ndërkohë që shiu përplaset në dritare.

Ata i shikonin hartat e qyteteve të mëdha, njihnin taksitë e aeroporteve, udhëtonin vetë, por brenda vetes mbeteshin të vetmuar. Prindërit e mi ishin thellësisht apolitikë. Për të arritur në këtë përfundim m'u deshën dhjetëra vite. Vetëm kur u rrita, e kuptova tim atë, kujdesin e tij, të formuar nga betejat në frontet e luftës së ftohtë, pragmatizmi i tij për njeriun, u ngrit nga klasa tij dhe u bë qytetar i brezit të parë, i cili synon të shmangë kontradiktat shoqërore dhe kufizon botëkuptimin e tij në kuadrin e familjes dhe profesionit.

Kështu hapi që zbrit nëpër shkallë nuk do që të shkelë mbi një copë akull. Besoja se babai e ka zgjedhur profesionin e vet falë synimit për të lehtësuar jetën e njerëzve. Ideali i tij ka qenë dhe është akoma – mendja krijuese e kombinuar me maturinë.

Ai e konsideronte të tepërt zhurmën boshe. Mendonte se mund të punonte qetësisht, me vetëbesim të mirë, me efikasitet e me paanësi dhe u shmangej rreziqeve të tepërta jetësore. Mamaja ishte më e ndjeshme ndaj padrejtësive shoqërore, përlotej dhe revoltonte, kur dëgjonte për epideminë e urisë, na tregonte për luftën në Vietnam, për ngjarjet në gjirin Tonkin, për ushtrinë e Kuqe dhe popujt e nënshtruar nga Bashkimi Sovjetik.

Por më e rëndësishmja ishte që nuk na lejonte të shikonim shumë televizorin dhe lexonim shumë libra. Librat për mamanë ishin rruga më e sigurt drejt humanizmit dhe përjetimit të ideve të shkrimtarëve më të mirë.

Na tregonte për Dostojevskin në internim dhe vrasjen e tij fiktive që ta trembnin për marrëdhëniet reciproke të vështira të Kafkës me babain e tij, për pagjumësinë dhe vegetarianizmin e tij,

për ndryshimet e mprehta në gjendjen shpirtërore dhe vetëvrasjen e tij në Ullf.

Ato shembujt e saj më dukeshin të rëndë, por duhet ta pranoj se na fisnikëronin. Ajo ulej në divan, mbulonte këmbët me batanije dhe zhytej në fjalët mirëtingëlluese të endura nga dhimbja e ndjenja e të pastrehëve, të cilët lënë urtësinë tyre mbi lexuesin. Kur u rrita dhe kujtoja fëmijërinë, shikoja qetësinë e jashtëzakonshme, në të cilën jetonim. Dhe isha gati t'i kërkoja falje. Prindërit nuk janë të detyruar t'u tregojnë fëmijëve të vet natyrën e botës.

3

Në pranverën e vitit 2003, isha tridhjetë e pesë vjeç, rrija në kabinetin tim të punës me këmbën mbi tavolinë dhe, teksa lexoja në gazetën Helsinkin Sanomat një artikull të Allo Rusit për Rah Amerikana, m'u kujtuan fëmijët e familjes Darling, para njëzet vjetësh. Problemet e SHBA-ve më dukeshin interesante.

Nga fotografia në gazetë më vështronte fizionomia e thartë e presidentit polak Kvashevnski, nën të cilën ishte mbishkrimi “Yes Sir!” Politika është thjesht diçka. Më kot kisha marrë pjesë dy në demonstrata kundër luftës, sepse, menjëherë pas tyre, filloi lufta.

E ndiqja ecurinë e saj në CNN, gazeta e televizion. Nuk më vinte keq për pamjet që tregonin njerëzit që luftonin dhe makinat. I ndërroja kanalet. I ktheja faqet me gishtat e butë. Në trup më ziente etja për jetën. Mendoja që të gjitha armët tona synojnë për të mirën dhe të shenjtën.

Në maj dikush vuri në kafene pjesën “Fishkëllima” të Don Xhonson-it. Isha i dehur dhe i lodhur nga rrëmuja. Ndeza një cigare dhe thashë: “Ndalojeni menjëherë. Amerika është në perëndim, por jo vetëm atje. Rruga është e drejtë. Shtëpitë ngrohen gjatë dimrit dhe, gjatë verës, freskohen me kondicionerë. Akulli shkrihet me shpërthim.”

Fëmija i dytë i mikut dhe kolegut tim më të mirë Korpinen, lindi në shkurt, një muaj para fillimi të luftës. Korpinen më ofroi një puro. Ishte mbrëmje e së hënës. Pinim duhan në oborin e fakultetit. Disa vjet më parë, ai u dashurua me Tajën – filologe e mekur. Habitesha. Ajo ishte një qenie e trishtuar, prej atij tipi njerëzish që, kur transferoheshin në një banesë të re, marrin me vete edhe furçën e vjetër të nevojtores.

Megjithatë Korpinen, dy herë, ia kishte arritur me dinakërinë karakteristike për një asistent, të fuste tek filologia organin e tij të gjatë, që përfundonte me një kokë të madhe, të ngjashme me një qepë. Kishte një organ të mahnitës.

Gjatë kursit të studimit, unë kisha parë, me sa vështirësi depërton në vrimë dhe mendoja se, me siguri, jashtëtokësorët me koka të mëdha nga vizatimet komike të Marvelit, i fshehin në pantallonat e tyre plastike penisë të tillë, të ndryshëm gjenetikiisht. Pinim duhan në heshtje. Pranë nesh ecnin studente të veshura trashë. Bora me flokë të mëdhenj lëshohej mbi degët e zhveshura të panjës. Faleminderit, Jusi – thashë unë. – Puroja këtu jashtë më jep kënaqësi. Po, po, kështu. Do shkojmë të pimë kafe? – Mirë. U ulëm me filxhanët në dorë në kabinetin tim të punës. Ia ngula sytë fytyrës së Korpinenit. Vitet kishin lënë gjurmët e tyre aty, si edhe në fytyrën time dhe, në atë ditë dimri, nga fytyra nuk ngjante me atë të rinisë së tij.

Ai i futi gishtat në flokët e vet të verdhë. Foli për takimin e organizuar nga shoqata kulturore Aprikoos, në të cilën do të diskutohej për gjendjen në Irak. Më kërkoi që të merrja pjesë edhe unë. Nuk kisha gjë për të thënë lidhur me çështjen.

Korpinen kundërshtoi, duke thënë se nuk janë të domosdoshme mendimet origjinale, por qëllimi është, para së gjithash, që të tregojmë se, përkundër propagandës së përpunuar për ne, ndërgjegjja jonë qytetare nuk fle.

– Për këtë bëhet fjalë. Për ndërgjegjen tonë të zgjuar. Të tregojmë se e dimë sa bën një plus një dhe forcën tonë kolektive. Edhe moralin tonë. Nënën kësaj shpatullës sime! Korpinen ngrysi

vetullat dhe shtrëngoi shpatullën e majtë.

-Nënë! Tashmë nuk mund të rri as gjysmë ore para kompjuterit. Nganjëherë, kur shtrihem, mezi e mbaj librin. S’kam fuqi fare.

Nga fjalët e tij të rrëmbyera, unë u ndjeva si në kohën, kur jetonim bashkë në apartamentin e pakëndshëm me tri dhoma në rrugën “Mariankatu” gjatë dy viteve të para të studimeve tona. Gjithandej mund të shikoje shishe dhe këpucë. Atje Korpinen vinte, me zë të lartë, pllakat e Bad Brejns-it dhe Xhon Zorn-it.

I ati ishte anëtar i lëvizjes së bretkosës, ndërsa e ëma ishte docente në politikën e majtë ndërkombëtare. Që nga fëmijëria e hershme, Korpinen dinte shumë mbi ndërtimin e botës, por kjo nuk e bënte të lumtur.

Kur jetonim bashkë, peshonte pesëdhjetë kile, jetonte me çokollata dhe portokalle të vjedhura, besonte në citatet e mësuara përmendësh nga veprat e anarkistëve, në qasjet letrare të shkrimtarëve amerikanë postmodernistë, në hashashin e jashtëzakonshëm të Libanit jugor, në solidaritetin dhe në faktin që dëshira për seks përcaktohet nga aktiviteti psikiatrik i individit.

Korpinen u rrotullua në karrige dhe rifilloi bisedën për politikën. Pija kafënë dhe dëgjoja fjalët e tij plot revoltë. Tingëllonin me përgjegjësi. Po mendoja se i vetmi shkak i zemërimit të tij është penisi i tij i deformuar ose më saktë fakti që kishte prodhuar dy fëmijë.

Zemërimi ishte i vonuar në mënyrë të pakthyeshme, i imi gjithashtu, ashtu si dhe i miliona marshuesve në demonstrata proteste. Mobilizimi kishte përfunduar prej kohësh dhe po vinte koha për rreshtimin e madh. Bombat, tashmë, kishin rënë në Mesopotami. Vështroja Korpinenin. Nuk ishte vetëm ai i shqetësuar. Pas figurës së tij të dobët ngriheshin masat që protestonin në rrugë. Nëpër të gjithë botën, organizatat për paqen, lëvizja antiglobale dhe rrjete të tjera organizoheshin në frontin kundër luftës dhe tërhiqnin me vete turma shumë të mëdha.

Të rinj të panumërt, pleq, punëtorë, fëmijë, gei, të majtë, të djathtë, nëpunës në moshë mesatare, myslimanë, ushtarakë,

induistë, profesorë, murgësia katolike, figura të njohura, imigrantë dhe kushedi se cilët akoma, madje edhe unë, merrnin pjesë në demonstratë. Kjo ngjallte pyetje. Cili është shkaku i revoltës së tyre?

Dominonte superfuqia Amerikë. Bushi ishte i urryer, por këto protesta nuk drejtoheshin kundër tij personalisht apo kundër aftësive të tij presidenciale. Kur mendon për qëndrimin e qullët ndaj budallallëqeve të qeverisë sonë të vjen në mendje, se protesta është shkaktuar nga motive kontradiktore dhe qesharake për luftën.

Jo vetëm nga pacifizmi i pastër, sepse e gjithë kjo, tashmë, kishte ndodhur, pavarësisht nga protestat, në Sudan, në Kongo, në Indonezi, në Afganistan, e në Rusi - dukej dhe dihej cilat janë pasojat. Korpinen i zhytur në mendime, përkundej në karrige. Shpina e karriges përplasej në mur. Flokët e gjatë ia mbulonin gjysmën e djathtë të fytyrës.

Nën këmishën e bardhë, pjesa e sipërme e trupit të tij kishte elegancë djaloshare, mëngët e përveshura zbulonin duart e zbehta të hijshme, me qime të verdha. Ishte tridhjetë vjeç. Kishte jetuar midis njerëzve për tridhjetë vjet. Do të mund të ishte vrarë edhe me një stilolaps të zakonshëm. Më pas do ta vajtonin.

Përzieu kafen. Në kabinet ishte zagushi. Ndihesha disi i shtypur. Kur filloi lufta, dhe ajo, me siguri, do të fillonte, njerëzit do të vdisnin në mënyrë të tmerrshme në banesat e veta të brishta, nëpër rrugë e ura, një nga një, me grupe e me familje tëra, të çdo gjatësie e moshe, me këmbë të këputura, duar e koka, të shtrembëruara në uniformat e tyre të vjetruara, të shtrirë në pragun e shtëpisë së vet me krahë të hapura, sikur të kishin rënë nga lart, tek kufoma e shqyer e qenit të shtëpisë, të veshur me ndërresa të gjakosura ose me fytyrën e mbuluar me hixhabin e ngjyer në gjak, në gjithfarë pozash, nganjëherë nga zjarri i vet ose nën çizmen e armikut, ndërsa të plagosurit do të mbushnin spitalet dhe shtëpitë e gjysheve e të gjyshërve.

Njerëzit do të vdisnin dhe të tjerët do t'i vajtonin. Diku ndonjë burrë me qëndrim ushtarak do të rregullonte nyjën e kollares dhe

do të thoshte:

-“Humbjet janë pranueshme”.

Dikush, diku, do të mbulonte me shall fytyrën e vajzës së vet. Të vdekurit do të ishin, kryesisht, të varfër, vendas, vuajtja e të cilëve do t’i dukej botës perëndimore si një lojë e frikshme fëmijësh, pjellë e fatit të tyre të ngatërruar. Do të mund të besonim, se ato pamje do të zhduken, kur të mbaronte lufta.

Kjo do t’i siguronte Perëndimit energji dhe ai do të vazhdonte politikën e suksesshme në lindjen e afërt. Kështu do të ishte gjithmonë. Iraku s’do të ishte përjashtim. Ja, përse protestonte njerëzimi. Ngriti filxhanin e verdhë dhe piu kafen. Para dy vjetësh, e kishte shkruar emrin e vet në të. Shkronjat e zeza ishin zbehur. – Bakunini – thashë unë. – Më fol për Bakuninin. – Çfarë? – Hë, më thuaj ndonjë citat nga Bakunini. – Vallë a do të më kujtohen? Korpinen u mbështet prapa, hapi sytë fort dhe vështroi lart si një fëmijë që zgjidh detyrën e aritmetikës.

Dukej i bukur, në buzë i endej buzëqeshja, sikur provonte njëfarë kënaqësie dhe tha: - Stërgjyshërit tanë... kanë qenë kushërinj të afërt me gorillat, ishin gjithëngrënës, kafshë të egra, të zgjuara, të cilat dalloheshin nga llojet e tjera të kafshëve nga dy aftësi të çmuara: arti i të menduarit dhe dëshira për të luftuar.

– Mirë. Më zunë të dridhurat. – Po kjo, përse? – Thjesht m’u kujtua se, në rini ke qenë i mrekullueshëm. I hajthëm si karkalec, i veshur me kostum të zi, me gojën gjithmonë të hapur. Vajzat të merrnin për gjysmë të krisur.

-Vetëm mos më luaj nga numri, që ty të konsideronin për të zgjuar. – Bakunini. Anarkisti, të cilit i kishin rënë dhëmbët nga skorbuti. Çfarë mendon të bësh, kur t’i vijë Tajës koha për të lindur? A nuk bërtisje ti në korridoret e spitalit të universitetit me parulla kundër qeverisë? – Atëherë isha njëzet vjeç. – Ndërsa tani je nëpunës shtetëror.

E lashë filxhanin në tavolinë. I hodha sytë në oborrin e asfaltuar, në shtresat e borës nëpër rrugë “Henrikikatu” e “Piispakatu” dhe në pemët e errëta, të zhveshura. Nuk kishte diell. – A të kam

treguar për fëmijët e familjes Darling? – Për kë? – Për fëmijët e familjes Darling. Kjo është një lojë e vjetër, me të cilën luanim unë dhe motra ime. E ka sajuar ajo. Ishim në Itali në anije, në liqenin Garda. – Ashtu, ë?

– Luanim, teksa udhëtonim me tren, me anije ose me avion.

Nuk mund ta besoj që po përpiqem të ta tregoj. Është e vështirë të ta shpjegoj. Ajo bazohej në ndjenjën që ti u përket të zgjedhurve. Në këtë apo atë mënyrë – të pasurve. Atyre, jeta e të cilëve është e bukur dhe unike. I përshkrova Korpinenit si e fillonim lojën gjithmonë me fjalët që thoshte njëri prej nesh: “Këtu janë fëmijët e familjes Darling. Udhëtojnë vetëm.”

Pastaj drejtonim shpinën dhe bënim fizionominë e fëmijëve të familjes Darling, të cilët ishin aristokratë dhe modernë. Vështronim njëri-tjetrin dhe e dinim çfarë provonim. Mamaja dhe babai zhdukeshin, zhdukeshin dhe mësimet e tyre mendjelehta. Donim që njerëzit të mendonim se po udhëtonim vetëm.

E dinim çfarë donim dhe rruga na çonte gjithnjë në perëndim. – Bakunini thotë se besimi tek shteti kombëtar është jehonë e besimit në mbretërinë Qiellore. Mua më duket se besimi tek fëmijët e familjes Darling është i vetmi mendim i krishterë në jetën time. Nëse nuk llogarisim narkotikët dhe seksin.

-Pak si për të qeshur. – Mendo. Ishte fillimi i vitit tetëdhjetë. Tipari më simpatik i finlandezëve atëherë ishte paaftësia që të ndiheshim popull i zgjedhur. E kishim më të përshtatshme ta quanim veten si popull, të cilit i është hequr e drejta për zgjedhje të lirë dhe nga lindja, dhe nga perëndimi.

-Nuk po të kuptoj. – Loja jonë pasqyronte atë që ishte e fshehtë nën sipërfaqe, në atë kohë. Bëhej fjalë për ekskluzivitet. E trishtueshme është që, sapo rritesh, fillon të kuptosh idenë e lojërave femënore. Ekskluzivitet. Mos lidhej me faktin që, në gjerësi të tjera vdekja kosiste njerëzit masivisht?

-Ky shpjegim ishte jashtëzakonisht i trashë. Ngatërron të gjithë familjen Darling. – Punë e madhe. Ulemi këtu, pimë kafe dhe flasim. S’do të ngrihem për asgjë tjetër. Pije kafën, para se të

fthohet. Nuk do të vij në atë mbledhjen. S'di për çfarë të flas aty. Kur kujtohem tani, për atë bisedën tonë në kabinetin tim, në atë ditë të largët dimri, shikoj të dy ne si qenie gjysmë fantazma, që ngrenë filxhanët me kafë, duke arsyetuar me fytyrat veriore, të zbehta.

Që nga fëmijëria, edhe dhuna në këtë planet po na përmyt nga të gjitha anët. Kishim një opinion për çfarë ndodhte. Mundeshim ta shprehnim e ta diskutonim duke biseduar në dhomën e vogël. Ekzistonte një botë, e cila, çdo sekondë, na tregonte pafuqinë tonë, na tregonte se si në atë dhomëzë guxonin dy zyrtarë të lartë ideologjikisht impotent.

Ajo pranverë më dukej e shkuar dëm, si një fantazmë. Kështu më dukej gjithë viti dhe të gjitha ato gjëra të çuditshme e të trishta, që, atëherë, më ndodhnin mua personalisht dhe nëpër botë. Tani i kuptoj më mirë disa bindje të miat të atëhershme. Me dembelizëm mbaja shënime dhe merrja pjesë në demonstrata kundër luftës për të njëjtat shkaqe, për të cilat merrnin pjesë edhe shumë evropianë të tjerë.

Lufta na kërcënonte për të na hapur sytë për çoroditje tonat, sepse ishim bërë tepër apolitikë. Natyrisht, lufta bëhej për naftë e pushtet. Askush s'do të luftonte për diçka tjetër në Lindjen e Afërt. Por, përveç këtyre shkaqeve, ishte edhe një tjetër.

Kjo ishte politika, e cila synonte ta shndërronte botën për më mirë. Pikërisht për këtë, ne evropianët shpresonim se ia kishim arritur ta ndryshojmë botën. Lufta e dytë botërore varrosi në dallgët e Atlantikut e të detit Mesdhe disa që vuanin dikur nga mania e mbikëqyrjeve të mëdha. Fundi i luftës së Ftohtë na çliroi nga domosdoshmëria për të pushtuar vendin e dikujt.

Pas këtyre ngjarjeve pushuam nga tensioni dhe iu përkushtuam zhvillimit të industrisë. Jetonim në një ishull paqësor evropian në simbiozë midis lumturisë së shëndoshë borgjeze dhe socialdemokracisë, në kohën e kursimeve në rritje dhe mallrave të lira të konsumit të gjerë.

Përshtateshim me botën e fitimit e të qiellgërvishtësve, disa si

pjesëmarrës aktivë, të tjerët vëzhgues indiferentë.

Konkurrenca fisnike dhe shpërndarja e drejtë e të ardhurave ishte krenaria jonë. Besonim se kishim merituar jetën tonë, ashtu siç është. Krenoheshim me reklamat për shoqëritë e mëdha aksionere nëpër çatitë e shtëpive të qytetit, nën dritën e butë e të qartë të të cilave ndiheshim të rëndësishëm. Megjithatë, përkundër vetëbesimit tonë të mirë, mendonim për më pak perëndimorë, sesa amerikanët. Për ne ishte më e vështirë të besonim në luftën e mirë.

4

Ndërsa kthehesha në kabinetin tim, u kujtova për ketrat. Korridoret e fakultetit ishin akoma të zbrazët. Në dhomën time ishte akoma e ngrohtë. U ula. Ndjeva se isha mbushur me një energji më të madhe se ajo e ketrave. Artikulli i pambaruar sikur ishte shkruar nga një i panjohur. Por kishte edhe diçka prej meje.

Zbërtheva këmishën. Gjoksi im pasqyrohej në ekranin e monitorit dhe i ngjante figurës së një punëtori të realizmit socialist. Trishtohesha pikërisht për të tilla tablo stimuluese, që pasqyrojnë qiellin e lartë, mbi arat ukrainase plotësisht të pjekura, lopët e kooperativës që jetojnë e pëllasin gëzueshëm.

Pas pak më erdhi frymëzimi. Shkrova, u ngrita, eca nëpër kabinet dhe u ula përsëri. Logjika e tekstit po qartësohej. Gjuha po gjente ritmin e duhur. Ndjeva kënaqësi nga krijimtaria. Ndjeva që dikush po ecën në korridor, por nuk desha ta ndërprisja. Pak para orës katër, e mbarova artikullin. E lexova dy herë dhe bëra ca korrigjime.

Mbeta i kënaqur. E dërgova tekstin. Mbusha një gotë ujë dhe i hodha një sy kutisë postare. Nga: esa.taberman@vs-sisu.org Do: Jusi Korpinen<s.berluskoni@hotmail.com>, rekka.janson@vs.sisu.org Otnosno: Një tekst qesharak suedez: Nga ana ime deklaroj, meqenëse nuk kam fshehur kurrë asgjë, prejardhja ime është nga Zvicra dhe Hollanda dhe se jam vendosur në këtë vend

shumë kohë më parë. Familja ime është vendosur në Uuisikirko, rrjedhimisht jam finlandez autokton.

Madje edhe shumë më tepër se disa, gjyshërit e të cilëve i kanë finlandizuar mbiemrat e tyre, shumë më vonë, diku nga fillimi i shekullit. E kupton? Nëse jo, nuk është faji im! Esa Taberman. E lexova mesazhin dy herë dhe u përgjigja. Nga: Jussi Korpinen<s.berlusconi@hotmail.com Do: esa.taberman@vs-sisu.org, rekka.janson@vs-sisu.org Otnosno: Një tekst qesharak suedez: Përshëndetje prapë. Mos m'u shpjego mua, gomar. Ti je trashëgimtar i geneve të degraduara të një kryqëzimi europian perëndimor. Edhe një vërejtje tjetër: teksa kërkon të jesh finlandez i vërtetë – mëso gjuhën amtare. Bën shumë gabime gramatikore. Të mos flasim për stilin tënd të rëndë, por kjo s'më intereson. Ne finlandezët jemi pak më shumë se pesë milionë, prandaj është shumë e rëndësishme të kujdesemi për bukurinë dhe pastërtinë e gjuhës dhe të shkruajmë drejt gramatikisht. Kjo është baza e identitetit tonë dhe jo genet, të cilat brenda secilit prej nesh janë të përziera me të huajat. Kujdestari dhe xheloz i finlandishtes Jusi Korpinen, patriot, qyteti Turku.

Mora nga biblioteka një fjalor gjermanisht-finlandisht. Shfletova në zyrë numrin e Frankfurten Alemajnen të para një jave. Europropoganda kishte mbledhur në një artikull emrat e dy oponentëve të vjetër: Jurgen Haberman dhe Xhek Deridan. Më mori pothuaj një orë leximi i tij dhe, megjithëse përdora fjalorin aktivisht, disa fjali nuk munda t'i përkthej. Në artikull s'kishte asgjë që një deputet finlandez i zakonshëm nuk mund ta kuptonte.

Përsëri bëhej fjalë për përforcimin e bashkëpunimit europian si kundërpeshë e superfuqisë SHBA, më tej flitej për identitetin europian. Sipas Habermasit, bërthama e Europës ishin Gjermania, Franca dhe vendet e Beneluksit, të cilat duhej të luanin rolin e lokomotivës që tërhiqte vendet e tjera periferia.

E mbylla gazetën dhe hodha disa rreshta në ditarin tim. M'u duk diçka treguese që Habermasi, për konceptin bërthamë përdor shprehjen avangardiste Kerneuropa dhe bashkon metaforën

e vjetër me lokomotivën. Kujtime për frontet e luftës së Parë botërore me telat me gjemba dhe vrasjet masive, Zyrih në vitin 1917, kabare Volter, Tcara, Top, manifest i shkëlqyer i dikujt, bërbelitjet foshnjore të Bretonit dhe Eluarit për Europën e qymyrgurit, luftërat industriale, krizat në politikën e jashtme, shkenca dhe mënyra e prapambetur e jetesës ngjallën skepticizëm për të ardhmen e Europës.

Budallallëqet në atë të premtë s’kishin fund. Pashë orën. Mjafton për sot. Mjaft me analiza. Mora çantën, mbylla derën, rrasa kapuçin tim të vjetër në kokë dhe dola. Pastaj trokita në derën e Korpinenit në mes të korridorit. Brenda tingëllonte tamburi. Hapa pakëz derën dhe vështrova brenda. Ai ishte ulur para kompjuterit i zhveshur deri në mes, me pantallona xhins dhe bënte fresk me një karton. Kishte mbledhur flokët me një lidhëse. Dhoma ishte plot tym duhani.

Hyra brenda dhe mbylla derën. – Është e premtë, Jusi – i thashë. – Çfarë bën akoma? – U mora me reportazhin e Robert Fiskit nga Bagdadi për vdekjen e fëmijëve të Huseinit. Për atë çfarë mendojnë irakenët mbi publikimin e fotove nga amerikanët.

Nga kolonat në kompjuter dukej veshja myslimane. Sinkopet ritmike ishin shoqëruara me britma në gjuhën arabe. Ky ishte një pasion i ri i Korpinenit. Dukej, se e vlerësonte muzikën si shprehje të urrejtjes. Mua ajo më shkaktonte acarim. Prapë dëgjova anekdota të treguara nga një njeri pa humor, i cili nuk kuptonte.

-Ule zërin e asaj çmendurie. Çfarë thotë Fisk? Korpinen e uli zërin dhe u përgjigj : - Njerëzit dyshojnë, se fotografia e Kusajit është e vërtetë. – Mundet që është maskuar si Abraham Linkoln. Por mjekra pak e ndryshon atë. Myslimanëve u rritet mjekra shpejt. – Fisk është i mendimit se Udaji mund të jetë vetëvrarë. Plagët në hundë të tregojnë për vetëvrasje.

-Mundet. – Dhe Fisk ka frikë, se vdekja e fëmijëve do të zgjojë keqardhje për irakianët dhe do t’i bëjë të harrojnë krimet e përgjakura të tyre. Do t’i bëjë heronj në sytë e tyre. E bazuar në

ndarje klanore, shoqëria do t'i adhurojë të vrarët në luftë kundër okupatorëve.

U ula në një karrige të zyrës së Korpinenit dhe kryqëzova këmbët, sikur përgatitesha për një diskutim të gjatë. – Frika e Fiskut është e bazuar – thashë unë dhe drejtova dorën nga Korpineni. – Por çështja më e rëndësishme është ajo e Sirisë. Si do të priten këto ngjarje në Damask. Dihej që duke folur për Lindjen e Afërme gjërat gjithmonë mbeten në Siri. Ajo i mbante çelësat. Dhe askush nuk dinte asgjë për të. - Çfarë do të bëjë Damasku? Do të ndryshojë politikën e jashtme? Do të ngrenë krye forcat demokratike? Këto janë çështjet më të rëndësishme, që i përkasin rajonit.

-Vapa t'i acaron nervat – tha Korpinen dhe kruajti gjoksin e zhveshur. – Në Europën Perëndimore kanë vdekur shumë të moshuar. Vështrova statujën e vogël prej balte të Budës në tryezën e Korpinenit. E kishte kujtim nga një udhëtim si aktivist rinie dhe ky fakt e bënte të ndihej hero.

– Çfarë bën deri tani? – pyeti ai dhe hapi gojën. – Një artikull me pesë mijë karaktere. – Dhe me çfarë teme? – SHBA dhe politika e jashtme e tyre. – Dhe çfarë ke për të thënë ti mbi këtë çështje? – Kjo tezë për mua është gjysmëserioze.

Pas kësaj lufte nuk është e drejtë që jankitë të quhen policë botërorë, por duhet folur për kryemjekun botëror. – Pse? – Lexoju gazetat e para një jave. – Më thuaj – më intereson. – Bëhet krahasim me luftën në gjirin Persik. Atje krahasimi me policin botëror mbaron punë. – Mirë. – Ky ishte operacion policor ndërkombëtar i mbështetur.

Huseini kishte pushtuar Kuvaitin. OKB-ja i dha terren të ligjshëm për operacionin. Qëllimi ishte që të vendoset statukuojë në Lindjen e Afërt. Askush nuk ishte kundër kësaj. – Po, fjalimi i parë i Bushit pas luftës, në lidhje me rendin e ri botëror ishte një mantër e pastër. Parandjenjë për të ardhmen. – Kështu. Po tani? – Lufta në Irak është diçka krejt tjetër. Ishte dhe është.

Në thelbin e saj i ngjan më shumë kurimit mjekësor. Ajo

udhëhiqet më shumë nga mendimi për shëndetin e pacientit, sesa për ndëshkimin e keqbërësit. Operacionet policore duhet të kenë bazë ligjore. Lufta në Irak bëhet nga koalicioni. Dhe ndonjëherë, për të arritur diçka pozitive, duhet shkelur pak ligji.

-I dashur kolegu im, ti je, vërtet, budalla. – Mos u nxeh. Qimet e gjoksit të janë kreshpëruar. – Nuk mund të besosh në ato gjepura. – E, këtu duhet shtuar akoma edhe nafta, influenza dhe kërcënimi ndaj të tjerëve. Por ka dhe diçka tjetër. Po filloj të besoj, që kjo luftë do të jetë në dobi të popullit irakian.

Nuk është pak edhe në lidhje me të drejtat e njeriut dhe demokracia e orientuar nga tregu. –Dhe në çfarë tjetër beson? Tek Paavo Lipunen dhe Kato-Kasinen? Për fat të mirë, akoma je në fillim të karrierës dhe do të kesh mundësi t’i paraqesësh këto idiotësi në vend tjetër.

– Nuk dua të zihemi. Çfarë do të bëni në fundjavë me Tajën? – Ajo ka shkuar me fëmijët jashtë qytetit, tek prindërit, unë do të rri këtu për të punuar. – Si po ecën? – Mirë. Po ti? Mirë. Karrigia e re e punës është e rehatshme. – Edhe ti blije. – Po, kuptohet. – Amortizatori? – i butë si pambuk. - Në djall – qeshi Korpineni. – Në fakt, nuk është e ndershme. Çfarë do bëni me Inën në fundjavë? Do të dilni në ajër të pastër. – Do urrejmë në shtëpi. – Do urreni? Si kështu? – Për shkaqe të ndryshme. – Të tërthorta? – Të fshehta. – Domethënë do të urreni. – Po. Në një idiotësi shpuese borë të bardhë. -Mjaft me budallallëqe. Ina është një grua e mrekullueshme. – E vërtetë. – Duhet ta kuptosh e ta dëgjosh. – Ne fakt, unë e dëgjoj, por ajo nuk flet. Dhe, nëse fillon të flasë, janë kilometrike “fjalimet” e saj; gjithsesi më e rëndësishmja mbetet heshtja. Edhe me mua, kështu ndodh. Ina është qaç e frikësuar, saqë dhe unë, nganjëherë, filloj të kem frikë. – Jepi kohë asaj. Ti e di çfarë po përjeton ajo. – Ashtu është. Më duhet të iki tani. Faleminderit për sinqeritetin. Kalofsh një fundjavë të këndshme! – Gjithashtu edhe ti.

Mbylla derën, eca nëpër korridor dhe zbrita shkallët. Jashtë pulsi më rrihte më shpejt. Kujtova fytyrën e qetë të Korpinenit para monitorit, lëvizjet e gishtave të tij nëpër tastierë, venat e tij në ngjyrë

manushaqe nga ndriçimi i fortë ilumineshent. Ato ushqenin me gjak trurin e përparmë.

Habitesha me aftësitë e mia për t'ia nxirë vetes. Koha ushtronte presion mbi mua nga të gjitha anët. Po të vazhdoja me këtë temp, pas dhjetë vjetësh, do të bëhesha mumie në karrigen time, amortizatorët do të kishin lëshuar gaz, do të ulesha e do të vazhdoja të shkruaja disertacionin tim, nëse, më parë, ndonjë njeri i mëshirshëm nuk do të më shkulte që andej.

Zbrita nëpër rrugën e zbrazët “Henrikikatu”. Këmisha më ishte ngjitur pas kurrizit. Kupola e kishës ishte mbështjellë me mjegull. Pemët dukeshin të gjelbra në mënyrë të panatyrshme. Mendoja, nëse do të bashkohesha me Inën në shtëpi.

M'u kujtua vera e kaluar. Një ditë në mëngjes, u zgjova, i pushtuar nga një emocion i ethshëm. Bëra kafen, u hodha një sy lajmeve të agjencisë CNN për luftën, shfletova gazetat dhe shkova në banjë. U vasha, u ula në cep të krevatit dopio për t'i thënë mirupafshim Inës që flinte. E përkëdhela në kokë. Në dritën e mëngjesit vura ré se, pas çdo jave që kalonte, flokët e saj shkëlqenin gjithnjë e më shumë. Në dhomë kishte një trishtim të hidhur dhe binte erë dimri, humbjeje ose, të paktën, kështu më dukej mua, teksa e puthja në ballë. Dola dhe nëpër urën “Kirko” u drejtova për në fakultet. Pranvera zhurmonte në degët e pemëve.

Hyra në kabinetin tim, hapa kompjuterin dhe, menjëherë, ndjeva se po më kaplonte lodhja. Kohë pas kohe zgjohesha i uritur, i mbështetur në karrige, me duart e lëshuara poshtë, pa kuptuar ku isha. U zgjova në dysheme me ndjesinë se është kryer krimi dhe unë jam i dyshuar.

Përmes derës dëgjoja zëra njerëzish dhe zhurmë në korridor, fshiva pështymën nga mjekra dhe, krejtësisht i pafuqishëm, u përpoqa të kujtoj çfarë bëj këtu.

Gjatë ditës kishin prerë një pemë të madhe në oborr, kishin prerë degët dhe pastaj kishin prerë dhe trupin. Lëndina ishte mbuluar me copa të prera degësh të ndritshme. Vështrova pemën. Kush e kishte shkatërruar? Ishte frashër i kalbur apo vidh? Si pemët që rriteshin në anë të rrugëve dhe ato në parqe, i kishin degët shumë të larta, që të ngjiteshin në to djemtë.

Prej tyre vetëvriteshin burrat. Desha ta prekja pemën, të ndieja fibrën e saj dhe të provoja një ndjesi që zhduket shpejt. Hoqa atletet dhe çorapet. Shkova në livadh me këmbë zbathur. Ndalova. Pema mbante erë. Përhapte një erë të keqe, të fortë, e cila i ngjante qelbësirës, vinte nga qoshja e errët e plevicës, ndoshta nga barku i një kafshe, ishte tharë një copë jashtëqitjeje, e atyre që qeshnin me studion televizive Jouko Turka dhe nga era e keqe e pjesëve intime të ndonjë skizofreni të pastrehë.

U ula mbi trung. Kalova gishtërinjtë nëpër koren e ashpër. Mora frymë thellë. Po binte muzgu. Dielli në perëndim binte mbi shpatullat e mia. Mbi lumë bërtiste një pulëbardhë. Në dritaret e sipërme të një shtëpie pesëkatëshe të zverdhur, prej guri, pasqyrohej qielli i kaltër. Kjo nuk më habiti.

Shumë vjet kishin kaluar kështu, me retë e zbehta dhe dallëndyshet në qiell, me njerëzit që silleshin rreth pishinës, me fishkëllimën e spërkatësve, me lule dorëzonje të thara në asfalt, me vrapuesit, me vajza që s'kanë hyrë akoma në pubertet, me gjinjte, tashmë, të fryrë, me fëmijët akoma veshur me rroba vere, të cilët tundeshin në karusel.

Në livadh, pranë këmbës sime diçka më ngacmonte. Vështrova poshtë për të marrë vesh. Ishte një vemje shumëngjyrëshe dhjetëcentimëshe, në madhësinë e një gishti. Kishte nofulla të forta dhe njolla të verdha anash. Nga koka i dilte një gjilpërë prej bronzi. Zgjata dorën dhe e kapa.

Ajo përdridhej në dorën time. Këmbëzat e saj më gërvishnin.

Nga plaga në kokë i dilte një lëng i tejdukshëm. Binte erë të keqe. E këqyra. Po si ishte gjallë akoma me gjilpërën në kokë, si? Vetëkuptohet – kot.

Më kujtohet, kur isha akoma fëmijë habitesha sa e madhe dhe e pakuptueshme është bota. “Do të shkoj në shtëpi ” mendova unë, hoqa kapelën dhe e vendosa kafshën në fund të saj. Hodha çantën në sup, mora atletet me një rën dorë – me tjetrën kapelën dhe u nisa përmes livadhit, përmes çakëllit e asfaltit.

Para derës së hyrjes ishte mbështetur një djalosh me kokë të rruar, i veshur me pantallona kamuflazhi dhe me bluzë të zezë, gjigand me duart plot tatuazhe, të cilat mbanin një kuti dhurate të lidhur me fjongo ngjyrë ari. I binte ziles.

-Mbaje këtë – i thashë dhe i zgjata kapelën. Ai më vështrroi dhe mori kapelën. Me dorën e lirë nxora çelësin dhe hapa derën. – Urdhëro. – Nuk banoj këtu – tha djali dhe i hodhi sytë diku larg, përtej shtëpisë; e mbante kapelën time, sikur lypte lëmoshë me të. E mora dhe hyra brenda.

6

Sipas mitologjisë së fisit Dagari elementi i Inës ishte uji. Dagarët besojnë se ky është element për të gjithë ata, viti i lindjes së të cilëve mbaron me shifrën një ose gjashtë. Uji është simbol i qetësisë, mençurisë dhe harmonisë.

Atë mëngjes vere, Ina u zgjua vonë. Niklas ishte në universitet dhe në shtëpi mbretëronte qetësia. Një puhizë e ngrohtë tundte perdet. Nëpër tavanin e lartë notoi një njollë dielli dhe mbeti aty. Në oborr dielli pasqyrohej tek sendet. Ajo ngriti ngadalë duart, mbylli sytë dhe i hapi prapë.

Kambana e kishës shënoi orën katër. Zhurma nga trafiku nëpër rrugën “Aninkajstenkatu” vinte nga larg. Dalëngadalë, duke lëvizur gjymtyrë pas gjymtyrë, ajo po kthehej në botë, njësoj si dje dhe si gjithmonë më parë. Nuk nxitonte. Kishte kohë.

U ul në cep të krevatit. Vështroi kofshët e saj të nxira nga dielli, të mbuluara me qime të verdha. Atë verë flinte e zhveshur. Netët ishin të nxehta, ëndrrat të thella, të egra e të vetmuara. Krevatin e ndante me burrin. Përse e kishte për detyrë ajo këtë?

Në përgjumje ajo ndiente Niklasin që rrotullohej i shqetësuar deri tek ajo, e ndiente si një territor të panjohur, në të cilin s'kishte dëshirë të futej. Iu kujtua si e përqafohte dhe e donte.

Lëkura e tij e butë i dukej e lagësht. Në frymën e tij ndihej diçka e thartë. Ndoshta kjo vinte nga gjumëndjellësit. Niklas vërtitej dhe mundohej të çlirohej nga përqaftimi i saj. Ina u tërhoq në pjesën e saj të krevatit dhe, ngadalë, u zhyt në një ëndërr marramendëse. Uji është simboli i qetësisë dhe harmonisë.

Ina u ngrit, shkoi para derës me pasqyrë të dollapit të rrobave dhe u zgjat. Lëkura e ravijëzuar nga bikinit ishte e bardhë. Domosdoshmërinë për t'u parë e provonte gjithnjë e më rrallë. Para dy ditësh shikonte se si vajzat e reja shëtisin me kokat lart pranë pishinës dhe zhyten në ujë, pa ngritur stërkala. E dinte se edhe ajo mund ta bënte. Po, akoma.

Të dielën e kaluar një vajzë e menduar që priste dikë me DVD në dorë e bëri të mendojë për garsonierat në hije, në të cilat djem të dehur pinin në krevat me brekë, pinin cigare të shtypura dhe digjeshin nga dëshira për të pasur një vajzë. Akoma më shumë digjeshin nga dëshira për të qenë me të.

Sapo mbushin tridhjetë shfaqet frika nga plakja. Së shpejti do të mbushte tridhjetë e dy. Teatrot, ekspozitat, filmat, tashmë, nuk e gëzonin. Nganjëherë frika e bënte të nxitohej. Gjatë atyre muajve të verës asaj i mjaftonte bukuria e njerëzve, ecjet e tyre dhe aftësia e tyre për të bërë budallallëqe.

Llambat halogene ndriçonin banjën dhe kabinën e qelqtë të dushit, e cila shkëlqente. Ina i gëzohej asaj. Kur doli në pension babai i saj, e rregulloi banjën. Dyshemeja dhe muret ishin bërë me terakotë. Rubintat ishin mjaft elementare, të kromuara dhe pa atë maninë tipike të fryrë skandinave. Muri përballë dushit ishte zbukuruar me ornamente floriale pseudobizantine.

Ina e shtoi ndriçimin, u ul në karrigen prej lisi zgjati këmbët përpara dhe u mbështet. Mëngjesi ishte plot harmoni. Uji nga dushi ia lagte fytyrën, rridhte nëpër qepallat e mbyllur të syve dhe e ndante nga bota e jashtme. Kujtoi, gjatë asaj larjeje të gjatë, në atë banjë, babain e saj gjashtëdhjetë e një vjeç me lëkurën e hirtë, duart e pafuqishme dhe me mesin e trashë. Ndoshta rinia e shqetësuar kareliane me DNK të shkatërruar, tashmë, ishte lodhur nga jeta.

Uji i derdhej mbi fytyrë e mbi qepalla. Kujtoi mbledhjen e fundit të grupit të mitologjisë, e cila ishte, me të vërtetë, qesharake. Niklas kishte të drejtë të tallej me pjesëmarrjen e saj. Kishte vënë ré se ai tallej me gjithçka që donte ajo. Kujtoi shënimet që kishte mbajtur.

Kishte lexuar se, në kohët e lashta, kur lidhjet fisnore kanë qenë krejtësisht të shëndosha, të vdekurit varroseshin në ishuj të pabanuar. Nuk mund të shpjegohej arsyeja. Ndoshta për t'i ruajtur nga kafshët që ushqeheshin me kërma? Apo nga ndonjëfarë frike? Për të ruajtur të gjallët nga të vdekurit? Tani përzierësi i ujit të ngrohtë e të ftohtë kërciste, atëherë ceremonitë e varrimit bëheshin nën qiell të hapur dhe nuk i lanin të vdekurit. Për ta ishte njësoj.

Stërgjyshërit tanë silleshin me të paparën si sillemi ne sot me varësitë. Tani ishte fillimi i qershorit. Për këtë verë, grupi i punës nuk kishte arritur asgjë. Tregonin shumë përralla dhe shfaqeshin njëra pas tjetrës, cila nga cila, idetë më të çuditshme. Kisha vënë ré se udhëheqësi shkencor i projektit për çdo koleksion që vinte, gjithnjë e më i ngrysur, gjithnjë e më prerazi, përdorte termin “goditje truri”.

Grupi i punës kishte filluar studimin e vet në prill. Atëherë Inës i ishte bërë shprehi serfi në internet. I ishte bërë pothuajse ide fikse që të shikonte sajtet amerikane, të lexonte biografitë dhe kujtimet e të afërmve të saj. Perëndimet e reja, fluturat e animuara flash dhe dallëndyshet virtuale që përplasnin krahët. Shpresa për takimin në shoqërinë postindustriale, aranzhimi sintetik për korin “Beautiful Isle of Somewhere”. Më interesante ishin faqet me të

rinjtë e vdekur dhe vetëvrasësit. Në sajtin High School shikonte pamje nga ballot e maturantëve, në të cilat përkrah djemve, pozonin vajzat e tensionuara, sikur e ardhmja u shtrinte palat e fustaneve.

Në sajtet kushtuar masakrës në Kolumbi, të mbijetuarit nuk e paraqisnin qartë atë që kishte ndodhur. Ina kishte vënë ré se sajtet finlandeze u kushtoheshin kryesisht kafshëve: kuajve, qenve, maceve, papagajve dhe minjve të zbutur.

Çfarë thoshin ata për ne? Mos vallë ishin të kota përpjekjet e komunitetit tonë shkencor? A jetonte brenda nesh mosbesimi primitiv tek kujtimet elektronike? Ndoshta rrjeti ishte tepër publik për finlandezin, i cili ishte mësuar të vuajë në heshtje në koliben e vet ose në korijen me bredha me shishen e vodkës në dorë? Pyetje themelore, mendonte ajo, ndërsa lahej. Lindja dhe vdekja. Zjarri dhe uji? Jo. Një vend rural me teknologji të lartë? Rezistenca e një kënete kundër kulturës? Akoma më e trishtë.

Turku, 06.07.1983. Përhëndetje, Ina! Po e shkruaj këtë letër me nxitim. Lajme të këqija. Dje vdiq Kekonen. Edhe dje, edhe sot u përpoqa të të telefonoja, por nuk m'u përgjigj askush. Siç duket po flinit. Sot, pak më vonë, do të nisem për në Bergen, prandaj po të njoftoj për Kekonenin me këtë letër.

Fillimisht mendova të të tregoj për këtë, pasi të kthehesh në shtëpi, por më duket si një lloj tradhëtie ndaj atij. Më vjen shumë keq që të jap këtë lajm me një letër në kohën e pushimeve verore dhe që nuk mund të jem me ty, që të qajmë së bashku për të. Ja si ka ndodhur: Kekonen s'kishte ngrënë asgjë për disa ditë. Ai, tashmë, nuk fliste dhe nuk fuste asgjë në gojë.

Pas dy ditësh vura ré se koka i ishte shtrembëruar, nuk i lëviznin këmbët. Vetëm zvarritej. Mendova se thonjtë e tij të gjatë e pengonin të lëvizte dhe ia preva. Teksa ia prisja ai nuk reagoi fare dhe thashë me vete që është i sëmurë pa shërim. Nuk arrita të thërrisja as mjekun – sot në mëngjes e gjeta të vdekur.

Ishte shtrirë mënjanë dhe dukej i paqtuar. Ka bërë një jetë të mirë. Ti e doje shumë dhe ai ty, gjithashtu. I telefonova xhaxha Tias dhe i thashë se, tani, s'ka më nevojë për kurim. Kekonen,

tashmë, pret në arkivol. Kur të kthehesh ti, do ta varrosim bashkë. Nën një mollë, në pjesën lindore të oborrit do të gjejë paqen e përjetshme.

Tani do filloj të përgatitem për udhëtim – kam dhe disa orë akoma. Përpiqu ta mbash veten. Jam i mërzhitur edhe për ty. Do të të telefonoj nga Bergenin.

Përqaftime e të fala të gjithëve.

Babai.

7

Ina u fshi dhe u vesh. Hëngri një mollë, një copë bukë thekre, hapi derën e dollapit në bibliotekë dhe u ngjit lart me shkallën e vogël. Në raftin e sipërm ishte një çantë e zezë. E çoi në dhomën e vet.

Mbushi një enë me ujë dhe vuri një fletë letër për të thithur. Hapi çantën dhe vuri në tavolinë penelat dhe paletën. Vuri një disk në magnetofon. I kishte mbetur nga babai, si dhe lecka prej pambuku, që e lagu. Preku me të buzët dhe e hapi mbi kavaletë. Nuk donte të nxitonte. Pasi mbërtheu një copë pëlhurë, zgjodhi penelin. Dhe me të në dorë dëgjonte duke pritur frymëzimin.

I ati e kishte blerë magnetofonin në vitin tetëdhjetë, kur ishte në një shërbim. Në librat anglezë shkruhej se emri latin i balenës është *megaptera novaeangliae*. Tingujt enigmatikë, me të cilët komunikonin balenat kishin ngjallur interesin e shkencëtarëve dhe të diletantëve.

Tingujt e ndërlikuar me lartësi të ndryshme, i lëshonin meshkujt në kohën e shumëzimit, por kishte mendime që ato kryejnë edhe funksione të tjerë sociale. Këngët e ngjashme me vajtim ishin të një diapazoni prej njëzet deri në njëqind herc. Në këngët e balenave kishte konstrukte që përsëriteshin.

Niklas tallej me interesin e saj për to. Ai tallej me gjithçka i pëlqente asaj. Ato këngë për të s'kishin kurrfarë kuptimi. Por ato i

sillnin Inës kujtimet e trishta të fëmijërisë.

Ajo dëgjonte dhe priste t'i vinte frymëzimi.

Në libra thuhej se uji të kujton dukuritë kozmike, si njollat diellore dhe rrezatimet që vinin nga kozmosi. Uji ishte organi i prekshëm i Tokës. Ai hidhte një urë midis njeriut dhe balenave. Çdo pranverë, balenat kalonin nga Ekuadori në Antarktidë si engjëj dyzettonësh. Të vdekurit u përgjigjeshin këngëve të tyre. E si mund ta matësh këtë me hercë dhe me qindëshe?

Në mëngjeset verore, Ina shpesh qëndronte në dhomë me penel në dorë.

Ambienti ishte i vogël i mobiluar thjesht, muret e bardha ishin të zhveshur.

Ajo vizatonte.

Kohë pas kohe, hidhte ndonjë penelatë në letër dhe ndalonte aty.

Atëherë dhoma mbushej me lule, pasqyrohej në mure dhe e mbulonte atë me një vello të lehtë. Ajo vështroi fletën. Fare thjesht. Në dhomë ajo ishte e sigurt. Nganjëherë mbi fletë binin disa pika uji ose kokrra kripe dhe ajo shikonte se si pigmenti jetonte jetën e tij jashtëzakonisht joshëse, plot shkëndija.

E harroi babain e saj. E harroi Niklasin. Qëndronte me penelin në dorë dhe dëgjonte.

Nganjëherë fleta mbetej e bardhë dhe kjo nuk e shqetësonte atë. Mëngjeset ishin plot harmoni. Kurrë nuk qëndronte më shumë se një gjysmë ore në atë gjendje. Fletët e thara i fuste në çantën e zezë, pa u menduar për kuptimin e tyre dhe pa e ndier domosdoshmërinë për t'i parë përsëri. Balenat nuk i dëgjonin këto regjistrime.

Ina qëndronte në dhomë me penelin në dorë. Dridhja e parë e frymëzimit u shfaq dhe ajo hodhi disa penelata. Pikërisht atëherë jashtë gjëmoi motori. Asaj i ngriu dora. E la penelin dhe u afrua tek dritarja. Disa burra ishin mbledhur në oborr. Shkoi në bibliotekë dhe hapi derën e ballkonit.

Jashtë një vinç i madh kishte ngritur kovën lart. Në të, një burrë me prerës në dorë, priste degët e vidhit. Prerësi fishkëllente, nëpër lëndinë binin copa druri. “Ata do të kujdesen” – mendoi Ina, teksa dega binte me zhurmë në tokë.

Ajo u mbështet tek parvazi metalik dhe pa se si ai burri preu edhe dy degë të tjera. Ina hyri brenda dhe mendoi, se në mbrëmje ajo pemë sonte nuk do të bëjë hije. Oborri do të ishte bosh. Nesër dielli do ta piqte lëndinë e pambrojtur. Dëshironte të dilte jashtë dhe të bënte pyetje. Por burrat, me siguri, nuk do t’i përgjigjeshin. Ishin me kombinezone, me makina dhe me duar të forta, me forcën e së cilave ushqenin familjet.

Ina qëndronte para dritares së kuzhinës, vështronte në drejtim të lumit dhe mendonte se si pema ndërronte pamjen e saj të jashtme në çdo sezon.

Në fund të vjeshtës së kaluar, ajo kishte qëndruar nën të në shi dhe kishte menduar mbi togfjalëshin shkencor të kohëve të fundit: trajtimi shëndetësor paliativ. Ishte e habitur se si mjekët i fshehin me zotësi, në fjalët e tyre të shkëlqyera, thelbin e gjërave. Një doktor i ri me duar të nxehta i kishte treguar filozofira për trajtimin paliativ. Ai kishte parasysh vdekjen e pacientit pa dhimbje dhe, në këtë mënyrë, kujdeseshin për gjendjen shpirtërore të të afërmeve të tij.

Për alternativa të tjera s’kishte nevojë të mendonin. Ina kishte marrë me vete një manual, në të cilin ishte një kapitull “Vdekja si pjesë nga jeta e familjes.” Ndërkohë që qëndronte nën vidh, i telefonoi Niklasit në universitet dhe i tha se kishte harruar çelësin.

Ai erdhi pa çadër, qull i tëri, u afrua tek pema dhe e përqafoi Inën. Ishin vetëm. Dita e ngrysur po ikte me shpejtësi. Ina vështroi përreth, toka ishte mbuluar me gjethe të zverdhura.

Dy javë më parë, Niklas kishte fjetur në lëndinë nën atë pemë. Atë mëngjes Ina u zgjua dhe shkoi tek pishina. Niklasit i kishte rënë koka mbi pjatën njëpërdorimshme me sallatë trangulli dhe me patate të skuqura të lyera me ketçap. Fytyrën e kishte pis, gërhiste lehtë dhe nga xhepi i vogël i dilte një flamur i vogël reklame.

I fjetur, Niklas dukej i huaj dhe i panevojshëm si një kafshë e shtypur nga makina. “Niklas është tip i tmerrshëm dhe askush nuk është në gjendje ta dojë” – mendoi Ina me vete. Ndoshta do ta “hidhte poshtë” para fillimit të vjeshtës. Ideja ishte tërheqëse, si aroma e shiut. U largua pa e zgjuar. Në breg të lumit, i erdhi ndërmend fytyra e tij e pistë – ndjeu pështirosje sikur po mendonte për një fëmijë të huaj të shëmtuar.

Vështronte në lumë, mendonte për vidhin dhe që Niklas gabonte e nuk e dinte sa të lëndueshme ishin ndjenjat e saj për të.

8

Ina qëndronte në korridor me shpinë nga unë. Mendova sa e brishtë dukej. Madje edhe një fëmijë ishte në gjendje ta rrëzonte.

-Më ndihmo, i dashur tha ajo dhe u kthye.

Mbante çantën e zezë. I vërvita këpucët në qoshe. Lashë çantën e shpinës dhe kapelën mbi tavolinën e telefonit. Ajo më shikonte serioze dhe më zgjati çantën, e cila më ngjante me një arkivol për një krijesë të vogël. E mora, e çova në bibliotekë, hapa dollapin dhe e vura në raftin e sipërm. U kujtua si i tha: “Më ndihmo, i dashur”.

Dhe, papritur, e kuptoi. Ishte e pabesueshme. Më ndihmo, i dashur. Vetëm tri fjalë budallaqë dhe unë, menjëherë, e kuptova. Falënderim për jetën tonë të gjatë së bashku. Pas çdo viti që kalonte duheshin gjithnjë e më pak fjalë për ta kuptuar. Po përse, çdo vit që kalonte, kjo më dukej gjithnjë e më e trashë?

U gozhdova në vend. Kundërshtitë shkatërrojnë afërsinë ose njerëzit në përgjithësi, kundërshtitë e shëmtuara dhe qesharake. Dhe e justifikova atë që kërkonte shoku në gazeta. Kuptohet, të tilla si Haberman ka në çdo qytet nga një putanë bythëmadhe. M’u kujtua vemja. U afrova tek rafti me libra dhe mora një album të trashë për kafshët. E shfletova dhe po shikoja figurat. Ina hyri në dhomë.

-Të shkoi mbarë puna sot?

-Jo. Shkrova vetëm një artikull – thashë dhe vazhdova të shfletoja librin.

- Si të duket karrigia e re? E rehatshme është?

-E kam vështirë të përqendrohem.

-Nga vapa e ke. Bëj një dush. Sapo kthehesh, ankohesh në shtëpi.

-O.

-Mos u zemëro, zemër – u mbështet tek unë dhe më përkdheli në kokë.

-Jo, jo. Je e lodhur?

-Në mëngjes isha e lumtur që të kam.

-Në Paris kanë vdekur qindra vetë nga goditja e diellit. Dhe qyteti është aq romantik.

-Më fol për çfarë të duash, po mos më thuaj marrëzira të tilla. Na e kanë prerë vidhin.

Ina doli. Unë vazhdova të shfletoja librin. Nuk e pashë vemjen e kuqe. Gjeta një kafshë të gjelbër me emrin e një gjetheje endacake – phyllium siçifolium. Krijesë e mjerë. Intelktuali në botën e insekteve. Nga ana tjetër, nuk ishte shumë e çuditshme, varet nga shkalla e vetmisë dhe, mund të ndodhë që në një gjethe endacake të tillë, të njohësh vetveten, dhimbjet e tua, gabimet dhe poshtërsitë e tua. Nëse je vetëm, nëse s'ke dikë tjetër.

9

Ina jetonte me të atin dyqind metra larg nesh, në pjesën lindore të Turkut. Në atë lagje, gjatë viteve të industrializimit, domethënë rreth viteve 20 të shekullit të kaluar, punëtorët me pasuri të paktë ndërtuan shtëpi të vogla me themele të larta prej guri dhe me çati të pjerrëta.

Për njëfarë kohe, uzina e tullave që ndodhej pranë hekurudhës, ishte bërë inkubator i masave shoqërore që përbëhej nga familje

punëtorësh me shumë fëmijë, pijanecë, kriminelë të vegjël dhe komunistë.

Gjatë viteve tetëdhjetë, kur standardi i jetesës së shtresës së mesme po rritej, ata zotëronin lagjen, lavdia dhe çmimet e së cilës po rriteshin shumë shpejt. Shtëpitë e vjetruara ishin rindërtuar, ngjitur me to ishin bërë shtesa, ndërsa papafingot ishin kthyer në dhoma fëmijësh, të mobiluara në ton pasteli.

Gjatë pranverës, në oborre zhurmonin barkositëset, njerëzit lanin makinat japoneze dhe gjermane të blera me kredi, vetëm në lanim makinën ruse. Organizata vendore e partisë komuniste ishte shpërndarë në vitin 1987. Nëpër shkallët e Shtëpisë së zbrazët të punëtorëve djali i rojës së pallatit, me zhvillim të vonuar mendor, bënte flluska sapuni.

Në varrezën e vogël të rrethuar me tulla, prapa portës së hekurt, nën gurët e rëndë të varreve preheshin në paqe të vdekurit nga epidemia e kolerës së vitit 1830. Në qiell mbi ta, era e perëndimit sillte zhurmat nga qyteti, si zëra nga një qytetërim i panjohur.

Varreza e thjeshtë ishte si një oaz i zhdukur midis shoqërisë sonë që synonte përpara. Nën panjat shumëdegëshe, në pllakat e varreve lexoheshin mbishkrimet përkujtimore si dëshmitarë të kohës së shkuar: “Këtu prehet mjeku dhe kryetari i bashkisë Vallgren, i cili besonte se Christus är mitt lif I doden är min vinning”.

Prapa parkut, pranë lagjes me shtëpi druri, shtrihej zona industriale, që përbëhej nga punishte për remont dhe përpunim druri, depo, vende për shkarkimin e plehrave dhe për groposje.

Në kohën e verës, me shokët vinim vërdallë në atë labirint ndërtime, të mbuluar me llamarinë, me mure të pista azbesti. Në rrugët me pluhur mbretëronte një qetësi e pajetë. Pranë asfaltit të ndotur me njolla yndyre, rriteshin luleradhique. Në oborr të autoservisit, në radio, këndonin Mati dhe Tepo.

Pas gardhit prej teli me gjemba, në një vend groposjeje, dëgjohej lehja e bezdisshme e një qeni stani të plakur gjerman. Në anë të thertoresh dëgjohej ulërima e derrave dhe era sillte erën e qelbur të gjakut, ndërkohë që ne rrëshqisnim me skateborde nëpër velodrom

dhe dëgjonim nga kasetofoni “Among the living” të Atraksëve.

Në pjesën lindore, në linjën e hekurudhore, ngriheshin godinat e Institutit të teknologjisë informative, shenja paralajmëruese e progresit të ardhshëm.

Në vitet e fundit të fëmijërisë banonim në zonën industriale dhe ky fakt na kishte lënë gjurmë, megjithëse atëherë nuk e kuptonim. Nuk më kujtohet që ndonjë nga familjet e shokëve të mi më të afërt të kishte shprehur përkatësi në ndonjë parti.

Jetonim në një rajon, në të cilin ndërgegjija klasore e punëtorëve ishte zëvendësuar me mirësjelljen e dashamirësinë e përdoruesit dhe respektimin e rregullave. Tashmë ishim tinejxher, pinim birrë në një ishull të ngushtë shkëmbor midis korijes halore dhe qendrës tregtare, prej ku historia e Finlandës mund të vështrohej nga dy anë. Dhe të dyja të pakuptueshme.

Ina jetonte me të atin nja dyqind metra larg nesh. Ishim njohur para disa vitesh, por të dashur u bëmë gjatë vitit 1990, pasi Ina u kthye nga një qëndrim njëvjeçar në SHBA, në bazë të parimeve të shkëmbimit. Verën e fundit të gjimnazit e kaluam bashkë.

Megjithëse Ina kishte lindur në dhjetor të vitit 1971 dhe ishte vetëm një muaj më e madhe se unë, dielli i Arizonës i kishte dhënë përvojë që më bënte të ndihesha më i vogël dhe mendjelehtë. Gjatë asaj vere, Ina mbante pantallona xhinse të vjetra, në këmbët e dobëta, në të cilat ishte shkruar logoja e Madër Llav Boun dhe ishin larmuar me vrime të vogla. Kur i pashë për herë të parë, pyeta çfarë ka ndodhur. Ishim ulur mbi batanije në oborrin e Inës dhe po pinim verë frutash, që e kishte bërë babai i saj, para një viti, përzier me sprajt.

Mbi ne lundronin retë e përdredhura. Dielli i ndriçonte gjethet e kumbullës. Ishte një ditë e shkujdesur vere. Ina ndezi cigaren dhe tregoi për Xhonatanin, djalin e familjes, mysafire e së cilës kishte qenë Ina.

Xhonatani ishte djali i parë i familjes, pesë vjet më i madh se Ina. Ishte një djalë me flokë të zinj me pamjen e një indiani, i dobët, i ekuilibruar dhe i frymëzuar; dukej shumë bukur, i veshur me këmishë të bardhë. Jetonte me prindërit në Bëllhed Siti dhe punonte si krupier në një anije-kazino, të ankoruar në bregun e djathtë të lumit Kolorado, në qytetin e lojrave të fatit Llauglin në Nevada.

Javët e para sillej me të me përzemërsi, i tregonte historinë e qytetit të lindjes, e çonte nëpër rrugët e qytetit, nëpër brigjet e lumit, në qendrën tregtare Rivervju Malin, në rrjedhën e sipërme të lumit, në pendën “Dejvis”, në të cilën Xhonatan zinte salmon.

Nga qielli pa re, piqte dielli, lumi i ndritshëm kalonte përmes shkretëtirës pa jetë dhe në lindje të qytetit qielli kaltëronte mbi lumin Bllak Mountijn. Në bregun perëndimor të lumit ngriheshin çatitë e bardha dhe ngjyrë rozë të hoteleve.

Xhonatan i tregonte se fillimisht qyteti ka lindur si vendbanim i minatorëve dhe të atyre që punonin për ndërtimin e pendës. Pas përfundimit të saj, në fillim të viteve pesëdhjetë, kishte rrezik të boshatisej. Në fillim të viteve gjashtëdhjetë, një sipërmarrës shpikës, bleu motelin e lënë pas dore dhe e ktheu në kazononë e parë.

Strategjia e tij doli me fitim: në Nevada lojërat e fatit lejoheshin, në Arizona jo. Shumica e shokëve të klasës së Xhonatanit punonin në kazino. Bumi filloi në fund të viteve tetëdhjetë – hotelet e vjetra u zgjeruan dhe u ndërtuan të reja. Në lindje u zgjerua Bullhid Siti si qytezë për personelin që shërbente në kazino.

Një pjesë e njerëzve jetonin në karvane, metamfitaminat ua gërryenin dhëmbët, rreziku personal lëvizte ekonominë. Xhonatan fitonte nga shtatë dollarë në orë. Përveç kësaj, Llauglin paraqiste një kopje të lirë të Las Vegasit. Klientët e natës ishin ish yje, të cilët zbraznin fshikëzat e tyre të urinës, duke hungëruar me zë

të ngjirur hitet e kohës para Martin Luter Kingut për të fituar medaljen e paqes.

“Nuk është aspak autentike” – i thoshte Xhonatani, i ngrysur, dhe Inës kjo nuk i dukej tipike për një amerikan, kur mendonte, çfarë i kujtonte asaj në atë qytet, Finlandën e vitit 1979.

Gjatë një fundjave në vjeshtë Ina dhe Xhonatan u nisën për në mal, i cili ishte disa dhjetëra kilometra larg nga ish qyteti i minatorëve. E reklamonin si qytet fantazmash. Lart frynte erë dhe bënte ftohtë, minus dhjetë gradë celsius. Ata panë ndërtesat e nxjerrësve të arit, veshjet e njohura dhe tiganin e Lëki Luk, ushqyem me karota një gomar qimegjatë e mendjelehtë, hëngrën në restorant dhe në rrugë panë një ford-T.

Gjatë kthimit, në rrëzë të malit, Xhonatani e ndaloi makinën në një vend me rërë, doli nga makina dhe e zuri Inën për dore. E çoi deri tek një shkëmb i thepisur, në të cilin ishte gdhendur një dele që vraponte. Ina u habit që, disa orë me radhë rrinte pranë shkëmbit, nën qiell të hapur, në kohën para minierave, kazinove, vizatimeve komike dhe figurës së thyer të deles që vraponte.

Ndonjëherë, kur Xhonatan kthehej nga puna në turnin e ditës, ata ngjiteshin në tragetin që shpërndante nëpër kazino personelin e shërbimit. Pas perëndimit të diellit fasadat e shtëpive të lojërave të fatit shkëlqenin dhe në lumë pasqyroheshin dritat e neonit me ngjyra të ndryshme.

Kur tragetin ndalonte, ai qeshte i kënaqur nga fati i vet dhe pranonte t’u blinte shokëve të klasës së Inës alkool dhe t’i çonte me ford në fushën e golfit në shkretëtirën Mohave ose jashtë qytetit, pranë bregut të lumit për të pirë alkool e duhan.

Qyteti shihej me sy të keq për qejfet e tepruara dhe, në parim, pirja e alkoolit ishte jashtë karakteristikave të tij. Për Inën kjo ishte diçka e mirë. Megjithëse mbrëmjet ishin të ftohta, asaj i pëlqente të ulej në breg të lumit, të sodiste perëndimin e diellit prapa malit dhe rënien e muzgut në qiellin mbi shkretëtirë.

I pëlqente gjithashtu që Xhonatan ishte pranë saj, esëll, i qetë

dhe dëgjonte çfarë bënin djemtë me vajzat. Ina habitej përse ai kërkonte t'u bënte shoqëri, por nuk guxonte ta pyeste. Ndoshta Xhonatan nuk kishte shokë në qytet për të kaluar mbrëmjet me ta. Ose donte të ishte afër Inës edhe që të mos i ndodhte gjë asaj.

Mikpritësit e Inës jetonin në breg të lumit. Si të gjithë fqinjët e tjerë, edhe ata kishin një varkë të bardhë me motor, të lidhur në mol, nga ana e oborrit të pasmë. Pothuajse çdo të diel, Xhonatan vishte pulovër me jakë të lartë, jelekun e gjelbër me xhepa të panumërt me kapelën e kaltër me strehë, ngarkonte pajisjet e peshkimit në varkë, i ndihmonte Inës të ngjitej dhe ndizte motorin.

Kur e drejtonte varkën nëpër rrjedhën e lumit, përshëndeste me dorë të njohurit që qëndronin në breg ose të ulur në varkë, të cilët i anashkalonte. Kur kapte grepin e peshkut dukej krejt ndryshe nga ç'ishte në steré. Atëherë Inës i dukej më i sigurt në vetvete, më i pjekur dhe që peshonte në vendin e vet.

Po të kishte mustaqe, Xhonatan do t'i ngjante Heminguejit të ri, në trurin e të cilit, lumenjtë e Miçiganit e çuan në vetëvrasje në Ajdaho. Kur Xhonatan vriste peshkun e nxjerrë, Ina i shikonte duart e tij të hijshme, në heshtje.

Nganjëherë, ai shkonte me varkë deri në skelën e elektrocentralit dhe e lidhte aty. Zbriste dhe nisej rrugës sipër digës. Një herë, teksa qëndronte në murin e lartë gjashtëdhjetë metra dhe sodiste luginën, Xhonatan tha se shpreson që dikush ta shpërthente digën. Ina nuk iu përgjigj. Ai zuri t'i tregonte çfarë do të ndodhë, nëse shembet diga.

Masat e ujit do të mbysnin elektrocentralin dhe muzeun e lumit, do të merrnin majat e shigjetave, hartat, fotografitë, Stejnuejin e vjetër, do të hiqnin njoilat e karburantit nga pista e fluturimit, do të sulleshin nëpër autostradën 95, të përmbysnin makinat, varkat dhe kanoet nëpër lumë, do të shembnin shtëpitë dykatëshe, të ndërtuara në stilin mesdhetar dhe do t'i bënin copë-copë vilat e vogla, do të mbysnin anijet-kazino, do të mbysnin hollet e hoteleve dhe do të merrnin me vete zaret, hartat dhe çipet, kapelat Stetson dhe ruletat, ndoshta, deri në ujërat e kaltra, të ngrohta të gjirit të

Kalifornisë, ku të gjitha plehurat do të vendoseshin në fund para shikimeve indiferente.

Dhe, ndoshta, një pjesë e plehrave të lojërave të fatit do të arrinin, si për çudi, pranë brigjeve shkëmbore të largëta të veriut të Finlandës.

Erdhi pranvera. Po afrohej fundi i qëndrimit të Inës në SHBA. Së bashku me Xhonatanin bënë një automarshim katërditor tek miqtë e tij në Finiks dhe Tuson. Ditën që ajo do të nisej, ai ishte tepër i heshtur. Dy javë më parë, atë e kishin nxjerrë jashtë nga kazinoja. Nuk ia tregoi asaj shkakun, por as prindërit nuk i thanë gjë.

Mbrëmjet kalonin në gjendje të dëshpëruar.

U nisën për rrugë me minivanin e familjes, në jug përmes rrethit Mohave dhe ndaluan tek penda “Llajk Havasu” për të notuar. Ishte koha e pushimeve të pranverës për nxënësit dhe qyteti ishte plot me të rinj të dehur. Në një restorant, teksa hanin sanduiçë me avokado dhe piper, shikonin si ecnin varkat me motor nëpër liqen, ndërsa nxënësit flirtojnë, hidhen nga kuverta, zhyten dhe, të shtrirë, nxjerrin në pah organet e tyre të ngritura.

Pas maturisë dhe atmosferës në prag demokracie në Bullhed, Llajk Havasu, i pluhurosur e i mbipopulluar, me shpërthimin e hormoneve steroide, për Inën ishte prova e parë e ekzistencës së ndjeshmërisë amerikane. Në gjendje depresive, Xhonatan e gëlltiti sanduiçin dhe pati dëshirë të nisen menjëherë në jug, nëpër rrugën 95 u kthyen në lindje drejt ndërshtetërores 10, nga e cila deri në Finiks mbetej akoma një orë e gjysmë.

Miqtë e Xhonatanit që jetonin atje ishin një familje gotike – Poli dhe Ami, të cilët banonin në katin e dytë të një autoservisi të dikurshëm, afër aeroportit Skaj Harber, pranë një parkingu karvanesh. Poli tridhjetëvjeçar ishte mësues në shkollën fillore, Ami, mjaft vite më e re, mësonte në shkollën e arteve figurative

dhe ishte piktor fillestar.

Ina habitej nëse Poli vishej në të njëjtën mënyrë, kur u jep matematikë fëmijëve. Ishte me pantallona të ngushta lëkure, me këmishë ngjyrë të kuqe në vishnje, me dantella, i pudrosur me pudër të bardhë, i grimuar, thonjtë me manikyr të zi.

E ngjashme me një sallë, banesa ishte e ndarë me tri kolona betoni. Kishte kuzhinë dhe një ambient për të fjetur. Dhoma e ndenjjes ishte mobiluar me divanë të lirë, një tavolinë të gjatë, një bibliotekë të lartë dhe një stereosistem danez. Nëpër mure ishin varur piktura të të bëra nga Ami me akrilik, të cilat paraqisnin Robert Smitin e ri. Duke i shpjeguar ato, Ami e veshur me kostum pseudotudorian, tha: “Këto nuk janë piktura të vërteta, këto janë porta të hapura për në ferrin tim të brendshëm.”

Mbrëmja ishte e suksesshme. Hëngrën burrito vegetarian të spërkatur me parmezan dhe pinë “Smirnoff” me “Pepsi” dietike. Ami dhe Xhonatan u zhytën në kujtimet për shokët e klasës, ndërsa Pol pyeste Inën për Finlandën. Ajo u habit që ai e njihnte muzikën finlandeze dhe nxori kasetën, të cilën ia kishin dërguar shokët e tij nga Stokholmi. Ajo përmbante regjistrime të pjesëve të grupeve rok Musta Paraati dhe Shadowplay. Në qiell, mbi aeroportin Skaj Harber oshtinin avionët reaktivë; dielli që binte mbi pjesën e prapme të parkingut me karvanët e banimit, hidhte përmes dritares së ngushtë vezullime të kuqërreme dhe Inës iu përziën koha dhe hapësira.

Të zotët e shtëpisë kishin blerë katër bileta për koncertin e The Jesus and Mary Chain, i cili do të bëhej po atë mbrëmje, më vonë. Kur arritën ishte errësirë dhe në asfalt para skenës ishte mbledhur një turmë nxënësish dhe admiruesish të muzikës alternative.

Prapa portës së jashtme ndaloi një pontiak i kuq, nga i cili zbritën katër të rinj të veshur me rroba të zeza gotike. Ishin esëll. Sipër kokës mbanin syze kiberpank me pasqyrë.

Njëri prej tyre kishte hedhur mbi sup një çantë sportive ngjyrë limoni, sikur shkonte në aerobi. Shpina e palltos së gjatë prej lëkure ishte e shpuar nga të shtënat. Palltoja ishte e fortë,

por gotikët arizonas që lëviznin me makinë sportive iu dukën Inës tepër të nxirë dhe të vetëkënaqur.

Gotiku besimtar shfaqej në sfond të qyteteve europiane të zhytur në shkatërrim, të pushtuar nga depresioni, smogu i qymyrgurit dhe epidemitë, të mbushur me kujtimet për monarkitë paranojake dhe diku, nën gërmadhat e ideologjive të shembura, tingëllonin këngët nga kabaretë e Vajmarit. Madje në qendrën e betonuar të nëntorit në Rajsio, ishte më lehtë të ishte gotik, sesa në Arizonë. Por, ndoshta Ina nuk e kuptonte gotikën amerikane. E. A. Po, bomba atomike e bëri kombin të mbytet në mendime të trishta.

Skena ishte e rrumbullakët dhe në stolat që e rrethonin atë, rrinte publiku i heshtur. Ina dhe shoqëria e saj kishin vende të mira në radhën e katërt. Po performonte një grup i ri rok industrial me emrin Nine Inch Nails, për të cilin Nina nuk kishte dëgjuar ndonjëherë. Para fillimi Pol dhe Xhonatan blenë birrë nga bari.

Dritat u fikën dhe publiku priste daljen e muzikantëve të veshur me të zeza. Pas pak, skena u vesh me drita të forta dhe basi i fuqishëm i këngëtarit filloi të vibrojë në brendësinë e Inës. Koka e këngëtarit ishte e rruar anash, hundën e kishte shumë të madhe. Muzika ishte e stilit agresiv të viteve tetëdhjetë, kur Depeshe Mood hoqën dorë nga harmonia dhe kaluan në një stil më të shpejtë, paranojak.

Pol u ngrit dhe u përzje me publikun përreth skenës, duke u lëkundur para-mbrapa, me flokët e shpërndarë në fytyrë dhe duke tundur duart. Në kohën e interpretimit të pjesës së parë, këngëtari nuk dukej shumë bindës. Por publiku dukej që po e priste me dashamirësi grupin dhe ai e ndiente këtë ngrohtësi. Në kohën e këngës së tretë, Xhonatan kërceu nga vendi, nxitoi tek Poli, e përqafoi duke e shtrënguar nga shpatullat dhe filloi të kërcejë duke tundur duart.

Ina rrinte dhe ndiente brenda vetes adrenalinën që po rritej. Kishte shpresuar që koncerti të mos ishte në atë sallë sterile, por në një vend tjetër. Nuk kishte mundur ta dëgjonte atë grup në disk, por e kuptonte çfarë donte të thoshte me muzikën e tij.

Videoklipet me muzikën e tij, do të frymëzonin njerëzit dhe do t'u kujtonin gjakderdhjen nga e shkuara e afërt: kukullat që përpëliteshin në pellgjet e gjakut, të shpërndara nga dyqanet e bombarduara në rrugë tregtare.

Ina vështroi shpinën e Xhonatanit. Gëzohej tek shikonte që muzika e bënte të harronte helmin e heqjes nga puna.

Gjatë pushimit pinë vodkë nga bari. Xhonatan i djersitur ishte i gëzuar dhe fliste shumë, përqafonte Inën dhe, me shaka, e thërriste Fina. Pol dhe Ami këmbenin puthje të gjata dhe prekeshin në pjesët intime.

U kthyen nëpër vendet e tyre. Vëllezërit Rejd përkuleshin nga skena drejt njerëzve. Publikut i pëlqente aksenti skotlandez i Xhimit, me të cilin ai murmuriste në mikrofon për ligjet e pijes në Arizonë. Dukej mendjemadh, i zbehtë dhe i dobët me xhinset e tij të ngushta. Uiliam kishte një kitarë të bukur Gretch, syze dielli dhe, nën pallton e zezë, një këmishë të bardhe me mbishkrimin SHBA 666.

Krehjet anarkiste të vëllezërve kishin ndryshuar. Kënga e parë ishte Coast to Coast e shpejtë. Uiliam i binte kitarës, Xhimi këndonte me një pamje të përhumbur e indiferente të një kafshë-viktimë. Nuk dukej që ndonjëri nga publiku të dinte emrat e bateristit dhe të basistit. Pas interpretimeve energjike të grupit, apatia e The Jesus And Mary Chain filloi ta mërziste shpejt publikun. Këngët e tjera nuk ishin të këqia, por koncerti, në tërësi, ishte i zbehtë dhe i pamotivuar.

Pas koncertit, Ina, Xhonatan, Ami dhe Pol u përpoqën të hynin në dy bare, por në të dyja kërkonin dokumentin e Inës. U kthyen në shtëpinë e mikpritësve. Puhiza e lehtë e natës sillte erën e agrumeve të prishura nga ana e rajonit të karvanëve të banimit. Pol na shpjegoi se vinte nga shkurret e kreozontit.

Ai ishte i entuziazmuar nga koncerti i grupit, u ngjiti në shkallaren e sipërme të shkallës prej betoni, u kthye që të shikonte të tjerët dhe ia mori refrenit: “Më mirë do të vdisja, sesa të të jepja kontrollin e pushtetit”. Tingëllim patetik. Ami iu lut të heshtëte

dhe e shtyu që të hynte brenda.

Brenda ajo e përqafoi Inën, mori nga bari i vogël shishen “Smirnof”, e hapi, piu me gllënjka të gjata dhe ia zgjati shishen Inës. Ina mendoi se me kalimin e mbrëmjes, Ami po bëhej gjithnjë e më e bukur dhe pak më pretenduese. Pol vuri muzikë dhe nxori shishen plastike të nargilës “Getrejd”, në të cilën kishte një lëng ngjyrë kafe.

U ulën në divanin e gjatë prej lëkure. Këtu s’kishte asgjë origjinale: në këtë mënyrë, miliona perëndimorë e kalonin fundjavën, megjithatë, kur erdhi radha e saj, u ndje çuditshëm. Kujtoi që ishte tetëmbëdhjetë vjeçe. Mbushi mushkëritë me tymin e hidhur.

Mbajti frymën, ndjeu tymin në brendësi dhe zërin tingëllues të baritonit Nik Kejvit me Stranger Than Kindness të tij që depërtonte përmes gjëmimit të avionit reaktiv, i cili, sapo ishte shkëputur nga pista e aeroportit dhe po ngrihej drejt qiellit të errët.

Ina i zbrazi mushkëritë. Me gjymtyrët e dobëta nga përhumbja joshëse, u mbështet mbrapa. I kuptonte udhëtarët. Të gjithë kishin nevojë të pushonin. Creosote bush. Xhonatan nuk deshi nargilë dhe mbushi gotën me ujë. Pol murmuriste diçka të paqartë për dildon, të cilin e kishte gjetur, kur ishte fëmijë në sirtarin e tavolinës.

Një ditë ai u shfaq aty, sikur ra nga qielli. Dikush kishte kërkuar, që ai ta gjente. Nuk kishte guxuar t’i pyeste vëllezërit dhe, për një kohë të gjatë, kishte frikë se në fëmijërinë e tij fshihej një enigmë e trishtë.

Shumë shpejt muzika tingëlloi shumë më e bukur. Falë avionëve. Ajo u shtriq në divan. Ai ishte çasti i saj dhe vazhdoi gjatë. Ndjeu Amin që bërtiste nga kënaqësia. Zëri saj vinte nga prapa shpinës së Inës, diku nga prapa kolonave. Pol jepte matematikë veshur me pantallona lëkure dhe i pudrosur. Ina hapi sytë.

Në errësirë pa disa figura, po vinte stuhia. Dikush vrapon shpejt para divanit, në të cilin ishte shtrirë. Ishte me këmishë të bardhë dhe tundte krahët. Mbi këmbët e saj i kishin hedhur një batanije. Ajo u drejtua dhe pa shumë qartë Xhonatanin që vrapon

përsëri pranë divanit me fytyrën e një njeriu të thelluar brenda vetes. Ballin e kishte gjithë djersë si një fëmijë i tërbuar. Ami bërtiste. Inës iu kujtuan fjalët e saj për portën e hapur drejt ferrit.

Kur u zgjua Ina, Xhonatan ishte shtrirë mbi të dhe i puthte qafën. Fytyrëne kishte të lagur. Ndjeu ereksionin e tij. “Xhonatan, mjaft” – i tha ajo. Ai ia futi duart nën bluzë. Ina u rrotullua mënjanë dhe ngriti bërrylin. E goditi në fytyrë dhe ai ra nga divani. U vendos qetësia. Ami kishte heshtur me kohë.

Në mëngjes herët Xhonatan kërkoi që të vazhdonin rrugën.

Ina kundërshtoi – ai akoma nuk ishte në gjendje të ngiste makinën. Syrin e djathtë e kishte të mavijosur. U ndanë me Amin dhe Polin. Ishte një ditë pranvere shumë e bukur – temperatura ishte mbi njëzet gradë.

U nisën përmes shkretëtirës Sonora dhe në largësi, në mal, panë konturet e një bajameje të rrumbullakët, të plotë, e cila ngjante si jastëk me pupla ose si një frizbi i ngrirë në ajër.

Iu afruan Tusonit nga veriperëndimi dhe kaluan pranë kullave të xhamit në qendrën tregtare. Urban Tucson is just e fucking Wanabe Los Anxhelos – tha Xhonatan duke prekur syrin e tij të ënjtur. Kaluan rrugët e periferisë së qytetit, derisa ndaluan para një shtëpie të vogël gri në të kaltër.

Në qoshe rritej një palmë. Zona ngjitur nuk kishte ndërtime. Bënte vapë. Në rrugë s’kishte frymë njeriu. I ranë ziles tri herë. Dritaret ishin të mbuluara me perde të bardha. I ranë rreth e qark shtëpisë, i ranë ziles prapë, trokitën në dritare dhe u kthyen tek makina.

Xhonatan u telefonoi miqve të tij në një restorant meksikan dhe u la një mesazh. Hëngrën bukë në një tarracë plot dritë. Ishte kohë dreke dhe restoranti ishte plot me familje me fëmijë dhe biznesmenë energjikë të veshur me kostum. Ina ishte e lodhur, me humor të keq dhe dëshironte të qëndronte vetëm.

Pas darke, u kthyen në shtëpinë e miqve të Xhonatanit. Përsëri s’kishte asnjëri. Xhonatan u inatos. Propozoi të shkonin në muzeun më të afërt, të aviacionit dhe kozmonautikës në rrethin Pima, ku,

pothuajse një orë, vizituan sallën dhe panë avionët e ekspozuar.

Ndërsa po ktheheshin në qendër, pranë gardhit të aviobazës Dejvid Monten, u shfaqën dy ujkonja të dobëta. Xhonatan e uli shpejtësinë. Kafshët e kaluan rrugën me lëvizje të ngathëta, duke tundur kokat e tyre leshtore dhe u zhdukën prapa argjaturës. Ina uli xhamin e dritares dhe nxori duart jashtë. Dielli përvëlonte. Ajri mbante erë plastmasi. Kjo erë ishte disi e njohur për të. Ajo vështroi depon e rrethuar me gardh, në të cilën ruheshin armë që nga koha e luftës së Ftohtë. Aty ishin radhitur, krah më krah, blloqe makinash metalike, të cilat pasqyronin rrezet e diellit. Dukeshin si tufë gati për fluturim, mbrojtëset e jetës, me kabina të mbuluara me kanavacë mbrojtëse, me të cilat ngjanin si fajkoj gjuetie të kapur, të mbyllur në kafaz.

Në muzg, në shtëpinë e miqve të Xhonatanit, s'kishte asnjëri. Ata vendosën të mos e kalonin natën në Tuson, por të niseshin për në Finiks dhe të kërkojnë një vend të përshtatshëm. Sipas Xhonatanit, rrugës ndërmjet dy qyteteve kishte mjaft motele të lira.

Pasi kaluan qytetin Oro Vali, Xhonatan u kthye në një rrugë ranore, që ngjitej lart drejt malit. “Të çon diku kjo?” - pyeti Ina. “Prit pak – u kthye ai dhe, pas njëzet minutash, ndaloi në një shesh të vogël, të mbuluar me shkurre, të fshehur nga sytë e njerëzve. Qëndroi i heshtur në timon. “Çfarë mund të bëj?” - pyeti ai dhe vështroi Inën. Ajo nuk e dinte çfarë kishte parasysh ai. Burri i ngrysi vetullat. Ishte një tablo interesante me kontraste të errëta, kaktuse, një djalosh i mbështetur në timon, një burrë i pafuqishëm në një rrugë gjarpëruese në perëndim të diellit.

Për të tilla pyetje kishte pak përgjigje dhe ato, pothuaj gjithmonë, ishin të gabuara.

Ai ngriti kokën dhe iu lut Inës të hiqte xhinset. Ajo e vështronte. “Zbathi ato” - tha Xhonatani. Ina zgjidhi lidhëset e këpucëve, i hodhi mënjanë, zbërtheu rripin dhe kopsën e xhinseve dhe i hoqi. Mbeti me bluzë dhe bikini. Xhonatan zbrazti xhepat dhe hoqi rripin. Doli nga makina, shkoi tek kanali dhe i hodhi xhinset mbi

një shkurre.

U kthye në makinë dhe hapi kapakun e bagazhit. Ina nuk pa se çfarë ndodhi pas kësaj. Dëgjoi dy të shtëna njëra pas tjetrës. Xhinset u përmbysën dhe ranë në tokën e pluhurosur. Xhonatan drejtoi shpinën, goditi diçka me shqelm, shkoi tek bagazhi dhe la kasën e dyfishtë, ngriti pantallonat, ua shkundi pluhurin dhe ia zgjati Inës. Ajo vuri ré se të shtënat kishin bërë dy vrima tek këmbët.

“Faleminderit” - tha ajo.

Pranë qytezës Pikasho ndaluan në një motel dhe zunë dhomë për një natë.

U gjendën në një kurth të tmerrshëm. Mbi linoleumin e vjetruar ishte shtruar një qilim i pistë, me gjurmë mashtrimesh të panumërta. Ina me kujdes u ul në krevat. Xhonatan u afrua tek dritarja dhe tërhoqi perden. Dielli po perëndonte prapa malit. Në oborr dukeshin kosha të gjelbër për plehra dhe një rezervuar i rrethuar me skela.

Prapa qoshes era ngrinte lart pluhurin, tashmë, të ftohur. Kurrsesi nuk mund të shpjegohej përse gjendeshin në atë dhomë. Shumë shpejt do të errej. Në faturën për pagesën e dhomës, të hedhur mbi tavolinë kishte njolla stilolapsi.

Xhonatan e uli perden dhe u kthye të shikonte Inën. Mavijosja i kishte zbritur poshtë në faqe dhe syri pothuajse ishte mbyllur. Dukej i lodhur dhe i sëmurë. Në dritën e verdhë të llambës së natës, në syrin tjetër, sikur i spërndriti një shkëndijë zemërimi, spërndriti dhe u zhduk. Ina mendoi se, pas gjashtë javësh, do kthehej në Finlandë dhe kjo dhomë, ky qilim i pistë dhe gjithçka që ndodhi këtu do të mbetej në të shkuarën.

Vuri dorën mbi këmbën e saj dhe ndjeu vrimat në xhinse. Askush nuk e dinte, kur bëhet i rrezikshëm një njeri për të tjerët. Ajo kujtoi fjalët e Xhonatanit që kishte thënë mbi murin e oazit Dejvis, tablotë e betonit të shpërthyer nga dallgët e ngritura të ujit që kishin shkatërruar gjithçka.

E ndodhur nëntë mijë kilometra larg, ajo nuk mund ta dinte

çfarë do të bënte Xhonatan, nuk mund ta kuptonte vendimin e tij dhe, nëse vinte nga gëzimi apo nga trishtimi. Shumë shpejt ai s' do të kishte asnjë rëndësi për të, do të zhdukej pa lënë gjurmë si pluhuri i ngritur nga era në ajër, prapa qoshes së motelit.

Kështu do të kalonte koha dhe, kur Ina do të kujtonte trupin e tij të lidhur, do të ndalej në mes të dhomës, do të ndihej e habitur, më e madhe se tani, më e mençur e më e ditur për çfarë do të thotë t'i shmangesh dashurisë. Por, atëherë, në atë dhomën e ardhshme, gjithçka do të ishte ndryshe dhe asnjë rrethanë e parëndësishme si për shembull kjo këmishë burri e hedhur në shpinëzën e karriges, nuk do t'ia çonte mendimet tek djali, i cili ishte ulur në bregun e lumit që shkëlqente.

Xhonatan u ul në krevat pranë saj. Ina hoqi xhinset, shkoi në banjë dhe lagu një peshqir. U kthye në krevat dhe ia vuri mby syrin e enjtur. Ai rënkoi lehtë, ia kapi dorën, ia tërhoqi peshqirin dhe e hodhi në dysheme. Vuri dorën e saj mbi gjoks dhe i pleksi gishtat me të sajët. Me dorën tjetër i përkëdheli kofshën dhe u përpoq ta puthë. Ajo e ktheu fytyrën anash. Hoqi bluzën dhe e puthi Xhonatanin. “Vallë këtu do ta bëjmë” – pyeti ajo, por në atë natë pranvere, Xhonatan dukej shumë i lodhur dhe nuk u përgjigj.

Ina tregonte për Xhonatanin, teksa ishim ulur në oborrin e saj dhe pinim verë frutash. Mbi ne lundronin retë e përdredhura. Dielli i qershorit ngrohte gjethnajën e kumbullës.

Ajo mbaroi dhe unë po mendoja për familje e saj, të ëmën dhe të atin, për martesën e tyre shumëvjeçare, për Johanën, e cila, tashmë, ishte studente, por vazhdonte të jetonte me ne, punonte si shitëse në një dyqan veshjesh, shkonte nëpër klube, në ditët e pushimit flinte deri vonë dhe bisedonte me ne për të ardhmen.

Mendoja për ato vite të jetuara me të afërmit e mi, këtu në Finlandë në qytetin tim të lindjes – Turku. Nuk shikoja shkak tjetër për këtë, përveç se kisha lindur në atë familje. Isha i ri. Në jetën e një njeriu duhet të ndodhin shumë gjëra të tjera, në vende të tjera dhe do të ndodhnin.

“Këto xhinse të shpuara janë diçka e trashë, një budallallëk”

– thashë unë. Ina u kthye dhe vërviti mbi mua verën që kishte në gotën. Fshiva sytë me cepin e këmishës. Dëgjova atë që qeshte. Prapa pemës kalonte rruga “Kalevantie”. Përreth dëgjoheshin zhurma të ndryshme. Gjëmonin barkositëset, lehnin qentë, bërtisnin fëmijët.

Kuptova që Ina, me siguri kishte bërë seks në atë motelin në shkretëtirë me atë djaloshin, me pamje indiani. Në atë kohë unë, akoma, shkoja në shkollë, takohesha me shokët në mbrëmje, pija nga pak nëpër bare, kthehesha nëpër urën hekurudhore, shpërndaja gazeta falas nga lagjja dhe reklama kafenesh e të elektronikës shtëpiake, të prodhuara në Lindjen e Largët, gjë që shkaktonte shumë biseda midis njerëzve.

Ishte një verë e pafrytshme, e mbushur me pritshmëri. Në korrik, në Finlandë, do të mund të shikohej eklipsi i plotë i diellit. Blemë kapele me strehë, në të cilat ishte stampuar data e eklipsit dhe paraqitja grafike e tij. E quajtëm “kapelat e eklipsit” dhe i mbajtëm gjithë verën.

Shpërndaja gazetat dy herë në javë me atë kapele në kokë, nganjëherë më shoqëronte Ina, nuk pranonte të mbante pako gazetash, por ecte pranë meje në rrugën me rërë, me çantën e hedhur në krah dhe fuste gazetat në kutitë postare.

Ecte me kapelën e kthyer mbrapsht, nganjëherë zbatthur ose e veshur me xhinset e shpuara dhe me një bluzë të vjetër ose vetëm me rroba banje në pjesën e sipërme. Kalonim pa u vënë re pranë gardheve me jargavanë, duke folur për muzikën dhe shokët, për gjërat e përditshme. Kur Ina ndalonte për të pirë ujë, vështroja shpatullat e saj të nxira dhe shpinën e tendosur.

Në ditët me shi rrinim në dhomën e saj në katin e sipërm dhe dëgjonim përplasjen e pikave të shiut në çatinë prej llamarine. Me afrimin e mbrëmjes shiu, zakonisht, shtohet; ne vinim albumin Daydream Nation të Sonik Jut dhe ndienim që, diku ka një grup të madh njerëzish, me të cilët kishim të njëjtat mendime dhe, të cilëve donim t’u përkisnim.

Një herë, pa një qiri të pikturuar nga Gerhar Rihter dhe tha,

se do të donte të bëhej piktore. Mbi bllokun industrial shpërtheu stuhia. Ina ia kishte treguar nënës së vet pikturën dhe i kishte folur për të.

U ngrita dhe vështrova jashtë. Nëpër xhamat e dritares rridhnin currila shiu. Mollët dhe kumbullat në kopsht kullonin nga shiu, nëpër rrugën e errët “Kalevakatu” kalonin makina shumëngjyrëshe me burra e gra brenda tyre, të cilët shtypnin pedalet. Sigurisht nuk doja të isha njëri prej tyre. Në kohën e shiut parapëlqejta të shtrihesha në kurriz dhe të mendoja për ata që kishin arritur qetësinë e përrjetshme.

Në ditët me diell u hipnim biçikletave dhe shkonim në pishinën e qytetit ose breg të detit në bllokun Ispojnen, ku tufa e patave kanadeze trembeshin nga fëmijët që loznin pranë ujit. Kur zhytesha nën ujin pak të kripur, ndieja zhurmën e njëtrajtshme nga motori i ndonjë anijeje ose varke që më çonte larg në kujtimet e fëmijërisë.

Në Rujsroki pamë shfaqjen e Saundgardën. Ishin rreth dyqind shikues.

Kisha frikë se, me ikjen e bas kitaristit Hiro Jamamoto, grupi do të humbiste ritmikën karakteristike të tij. Panku i ri kërcente i kërrusur nëpër skenë si orangutang në kënetë.

Eklipsi i diellit ndodhi një të diel qershori. Në mbrëmje u përgatitëm për ngjarjen, u ulëm në një bar me kapelat në kokë. Pas mesnatës, u ngjitëm në shkëmbinjtë pas shtëpisë së Inës dhe u shtrimë mbi myshk. Nata ishte e ngrohtë dhe me dritë. Në momente të tilla mund të bisedosh për gjithçka.

Kur u zgjova, tashmë këndonin zogjtë. Ina flinte akoma e kthyer në njërën anë me kapelën e shtrembëruar. Vështroja vajzën që flinte, përzura milingonat që ecnin aty dhe mendova për fjalën – mik. Ajo nuk mjaftonte. Në dhomë kisha dëgjuar zhurmën e shiut mbi llamarinë, si forcohej ajo me muzikën e albumit Daydream Nation në sfondin e mbrëmjes.

Eklipsi tjetër i plotë i diellit do të shihej në Finlandë në vitin 2100. Ishte për të ardhur keq që të zgjohesha e të mendoja për një

kohë, kur ne nuk do të jemi.

-E humbëm eklipsin – tha Ina duke fërkuar sytë. – S’ka gjë, do të ketë të tjerë.

E hoqi kapelën dhe e vërviti mbi shkëmb. Rrinim shtrirë në heshtje. Mendoja si do të ketë qenë eklipsi, si kishte lëvizur hëna me shpejtësi të madhe mbi linjën hekurudhore, mbi katedralen, mbi pemët dhe shtëpitë, mbi trupat që flinin mbi shkëmb, mbi fytyrat tona.

Ndoshta fjetja nën qiell të hapur mund të ishte mënyra më e mirë për ta ndier eklipsin e diellit. Si gjithçka tjetër, edhe eklipsi i diellit mbi Turku nuk kishte qenë i plotë, por i pjesshëm.

E ngrita kapelën e Inës nga toka dhe e rrasa në kokën time. Ishte herët në mëngjes. Përreth s’kishte frymë njeriu. Ina donte të flinte akoma dhe më ftoi në shtëpinë e saj. I ati nuk ishte në shtëpi dhe ajo s’kishte dëshirë të rrinte vetëm.

Zbritëm nga shkëmbi, kaluam nëpër oborr, afër leheve me sallatë dhe karota që i kishte mbjellë i ati, një serë e vogël, ku rriteshin domatet, kungujt, shkurre të ndryshme; u ngjitëm nëpër shkallët e pjerrëta prej druri. Papafingoja ishte e ndriçuar mirë. Në banjën e vogël, Ina më dha një furçë për dhëmbët. Ajo u zhvesh dhe hyri në dush.

I lava dhëmbët para pasqyrës me dy kapelat në kokë. I hodha kapelat në qoshe dhe u shtriva i veshur në krevat. Pastaj, u ngrita hoqa këpucët, xhinset dhe këmishën. U ktheva në krevatin e ngushtë. Ina erdhi dhe u ngjesh pas meje. E hodhi njëren këmbë mbi timen dhe u tulat aty. E ndieja frymëmarrjen e saj. Ndieja aromën e flokëve të saj.

Ajo mori frymë thellë. Dora e saj e ngrohtë pushonte mbi mua. Shumë shpejt e zuri gjumi. Vështroja trarët dhe sergjenet e ndritshëm. Sipër tyre kishte sende nga fëmijëria e saj. Stetoskopi dhe një talisman. Një fletë llamarine e vjetër. Fotografia e babait. Fotografia e një derrkuci. Fëmijëria. Një fotografi e nënës. Një çekiç i vogël avarie, i kuq, i vjedhur nga autobusi Nr. 32, në fundjavë. Përmbledhja me tabelat e Bashkimit të pedagogëve të

matematikës, mbi kopertinën e së cilës ishte ngjitur një etiketë që paralajmëronte për rrezikun radioaktiv. Romane dhe pllaka gramafoni.

Më kaploi një ndjesi vetmie. Në këtë gjendje shpirtërore bota të duket si një film, ndërsa qenësia – fatale. M'u kujtuan Ina dhe Xhonatan. Shpesh më ndodhte kjo, pa e ditur përse. Përfytyroja si kishin rrjedhur ngjarjet gjatë vitit të qëndrimit të saj në SHBA. E imagjinoja si ecte në makinë nëpër shkretëtirë pranë krupierit të papunë në një atmosferë të nxehtë, si ishte ndyrë në dhomën e gjelbër me kaktuse, në dyshtemënë e së cilës ishte hedhur uniforma naziste e shpuar me të shtëna dhe e ndotur me mustaqe misri, e zbukuruar me kuti picash me shenja satanike. Sonik Jut – që kishin vënë albumin Goo.

Isha i habitur nga ilustrimi bardhë e zi të Rejmond Petibon, i cili paraqiste familjen me syze dielli dhe krehje të vitit 60-të dhe mbishkrimin: *I stole my sisters boyfriend. It Was all Whirlind, heat and flash. Within a Week Wi killed my parents and hit the road.* Ilustrimi të ngjallte ndjenja poetike të trishta. Ina kishte lexuar se bazohej në një fotografi të vjetër të motrës së vrasësit serial Hindli, që kishte dalë me bashkëshortin e vet. Ndërsa dëgjoja Goo dhe shikoja ilustrimin, mendoja për Inën dhe Xhontanin dhe habitësia, përse, kohë pas kohe, e ndieja Inën, të dashurën time të re, si një kërcënim, të cilit doja t'i jepesha.

Vajza dhe këllëfët e pllakave, këllëfët e pllakave dhe vajza. Bukuria gjithmonë është dydimensionale. Vështroja Inën që flinte. I ngjante një fëmije. Më shkante mendja t'i bërtisja në vesh dhe t'i derdhja një gotë me ujë në fytyrë. Në vend të kësaj, vazhdoja të rrija në parvazin e dritares me penisin e zbutur duke pritur që ajo të zgjohej.

Në fillim të gushtit, Iraku i ra Kuvajtit, ndërsa në qytetin tonë kumbullat dhe manaferrat ishin pjekur. Një mbrëmje po luanim bilardo me Inën dhe babain e saj, Ionasin, në sallën e bilardos në ish fabrikën e endjes në zonën industriale. E kujtoj shumë mirë

Ioanasin në atë kohë.

Një burrë i dobët, i zbehtë, i bardhë, i përkulur mbi tavolinë herët, duke mbajtur me elegancë stekën, duke synuar tek vrimat, duke goditur topat jo me shumë sukses. Pastaj, drejtohej, shikonte me indiferencë topat që bënin rikosheto, sikur lëvizjet e tyre, ishin diçka që nuk i interesonte.

Ionas ishte burrë i qetë me ndjenjë humori të hollë, shoqëria e të cilit ishte e këndshme. Më dukej e çuditshme që ai ishte pasuruar si sipërmarrës. Ishte një baba tolerant, udhëtonte shumë, na gatuate me kënaqësi dhe me një frymëzim më të madh se të nënës sime, merrej me punët e kopshtit.

I kisha zili marrëdhëniet e natyrshme midis Inës dhe të atit. Ajo pinte duhan dhe alkool në prani të tij dhe Ionas nuk zemërohej. Ata bënin biseda të barabarta dhe, nganjëherë, laheshin së bashku në sauna. Nuk njihja ndonjë baba e bijë, që e bënin këtë. Ionas me përkëdheli e thërriste atë Pol. Këtë e kishte sajuar në kohën e pubertetit, kur ajo u zhvillua shumë shpejt dhe donte të merrej me basketboll.

Sipas meje në atë shtëpinë e tyre dykatëshe ngjyrë të kaltër, mbretëronte fryma e lirisë. Ata jetonin bashkë, por i linin njëri-tjetrit hapësirë dhe nuk krijonin probleme të tepërta. Mendoj se kjo ndodhte, falë rrethanës që ishin dy vetë.

Në vjeshtë kaluam në klasën e fundit dhe kishim përpara mbrëmjen e maturës në fund të vitit. Ina synonte t'i përkushtohej studimit dhe të meritonte, të paktën, notën katër në provime. Unë rrija në orët e mësimi i përgjumur, shurdh, i zhytur në vetvete, në një gjendje shpirtërore të çuditshme dhe nuk më interesonin vlerësimet.

Nga viti i fundit mbaja mend vetëm vuajtjet në matematikë dhe ndjesinë e çuditshme që s'kisha nevojë për ato që më mësonin. Duke menduar në retrospektivë më kujtohet se në fund të shekullit e kisha bindur veten se kam disa prirje të veçanta. Duhej vetëm të kuptoja cilat ishin, dhe rruga para meje do të ishte e hapur.

Duhej të kishim orën e biologjisë, por pedagogu ishte i sëmurë. Na shfaqën një film dokumentar për mangustët. Në Serengeti, si kudo në Afrikën e mbytur nga korrupsioni, pas lindjes së diellit, ata dilnin nga vrimat e tyre kundërmuese, drejtoheshin në këmbët e prapme, zgjasnin qafat, kureshtarë, me sytë e zinj të vegjël, të ngjashëm me Beagle Boys dhe vështronin kopetë e kafshëve të egra që nxitonin nga rrafshina.

Vajzat psherëtinin. “Janë të mrekullueshëm, tamam si njerëzit” – pëshpëritnin ato në klasë, dritaret e së cilës ishin mbuluar me perde të zeza. Dhe me të vërtetë, mangustët ishin shumë të bukur, nëse i shikon në një mënyrë të drejtë, nga këndvështrimi njerëzor dhe i krahason me njerëzit.

Vështrova përreth, fytyrat e të tjerëve, ata i kishin ngulur sytë mbi ekranin blu dhe dëgjonin zërin e spikerit. Mendova me vete: “U ngjajnë mangustëve”. Mbeta i hutuar për një çast. Edhe të përmysej bota mbi mua, nuk arrija ta përqendroja shikimin. Gjithçka ishte zhytur në errësirë.

Ajo po përfshinte hartat topografike në mure. Maketi i piramidës demografike të Hungarisë po shembej, kampionet e mineraleve nga miniera e arit Pahtavaara, të vendosura në parvazin e dritares, ranë në detin e Moskës në anën e prapme të Hënës, dallgët gëlltitën grafikët tregues të rritjes demografike, itineraret dhe vendbanimet e nikaraguanëve të zhdukur.

Ujërat në grykat e mëdha të lumenjve i merrnin me vete brejtësit e balsamosur, të rradhitur në dollap, nepërkën dhe syrin e lopës me vena ngjyrë manushaqe, të vendosura në solucion formaline. Rrija midis kësaj përmytjeje i heshtur, i ngatërruar, tetëmbëdhjetë vjeç, pa mundur të shpjegoj përse zhduket gjithçka në errësirë, gjithçka në të cilën kam besuar.

Duart më dridheshin. Veshët më buçitnin. Dalëngadalë më zuri frika. I ngjesha shuplakat pas faqeve. Mendova se duhet të jem një individ i jashtëzakonshëm. Nëse duhej të përcaktoja ndjesinë time – ishte zotësia për të mos ditur asgjë.

Pas dy ditësh i tregova Inës çfarë kisha përjetuar. Ecnim në

mëngjesin e errët dimëror për në shkollë. Nën dritën e verdhë të ndriçuesve rrugorë, dukej bora e dendur që binte. Ina tha se ndihej e lodhur. I kishte bërë detyrat e shtëpisë natën. Ndërsa unë prapë s'kisha mësuar asgjë. I tregova për përjetimin e çuditshëm. Mendova se tingëllonte misterioze dhe interesante.

-Unë s'jam si të tjerët – thashë. – Bota ime është ndryshe. Nuk ua shpjegoj dot të tjerëve.

Ina ndaloi. Ndalova edhe unë. Ajo më vështroi. Midis shtrëngatës së borës, ajo dukej e inatosur dhe e bukur. Era ia merrte kaçurrelat e saj të zinj që dilnin nga kapuçi i bardhë.

-Ti je idiot – i tha ajo. – Çdo idiot imagjinon të njëjtën gjë.

Atëherë unë bëra një zbulim. Në këtë botë me libreza bankare, të qenët i çuditshëm, nuk i intereson askujt.

11

-Në mëngjes isha shumë e lumtur që të kam – tha Ina.

-Në Paris kanë vdekur qindra vetë nga të nxehtit. E megjithatë është qytet i romantikës.

-Fol për çfarë të duash, vetëm mos u merr me problemet botërore. Pema pasqyrohej në oborr.

Ina doli. Shfletova albumin me insekte. Vështroja tartabiqet, por nuk e gjeta vemjen e zezë. Mendova për tekstin e lexuar nga Haberman. Edhe në konkluzione, ai pohonte diçka interesante: demonstratat e zhvilluara në mes të shkurtit, kundër luftës në Irak, në Paris, në Berlin, Londër e në qytete të tjera me popullsi shumëmilionëshe, flisnin për opinionin shoqëror qytetar të Europës. Edhe në Turku u bë një protestë dhe unë mora pjesë në një lëvizje qytetare.

Nga një qytet universitar që ndodhej në periferi të Europës, gjërat dukeshin më ndryshe nga si i shikonte Haberman. Ndoshta kundërshtimi intelektual? Ndoshta opinionin shoqëror evropian? Madje as në universitetin tim, nuk kisha folur me askënd për këtë

temë.

Pothuajse çdo ditë pune paraqiteshin momente, në të cilat e ndieja se zemërimi është i dobishëm për mua, nga ana profesionale. Sukses. Nëse dikur do të arrija diçka, do të ishte rezultat i zemërimit. Sukses i është diçka e rëndësishme. Kush do të ishte pa shkollën, e cila më kishte mësuar mua se emri më i goditur për suksesin është anagnorisis.

Më thirri Ina. U ktheva. Në korridor ajo mbante kapelën time dhe këqyrte brenda saj. Kur i ngriti sytë, pata përshtypjen se shikon në kokën time dhe e dinte. Ndjeva një përplasje pas meje. U ktheva. Ky ishte një moment shenje. Xhami i dritares ishte i thyer. Brenda kishte rënë një send metalik ngjyrë argjendi e errët, me një dorezë druri.

U afrova tek dritarja, vështrova jashtë copat e xhamit, të hedhura mbi tarracën prej betoni. U afrova edhe Ina. Merrte frymë rëndë.

-Pompa e biçikletës – konstatova unë dhe dëgjova dikë që bërtiste jashtë.

12

Ina mori një gjethe të lagur dhe e hodhi në koshin e plehrave. Nxori rrobat e lara dhe i nderi në ballkon. Në oborr, sharra kërciste dhe binin copa drurësh. Në një tip arke ishte mbjellë barbarozë. Sipër saj tundeshin nga era ndërresat dhe thaheshin.

Ina qëndronte në ballkon dhe imagjinonte si do të dukej pema në stinë të ndryshme.

Babai i saj ishte i sëmurë, tashmë prej kohësh. Atë mbrëmje ajo ecte nën borën që binte në rrugën “Hameenkatu” dhe mendonte, se do të donte të kishte vëlla ose motër që t’i kishte mbështetje në pafuqinë e saj.

Në shtëpi, Niklas kishte shtruar tavolinën dhe iu lutën të mos

e shkojë e të hapë televizorin dhe t'i ngulë sytë aty. Në lajmet njoftonin për katastrofën e anijes Kolumbia. Të shtatë kozmonautët ishin vrarë, kur kishin hyrë në atmosferën tokësore. Midis tyre ishin dy gra dhe një izraelit. “Palestinezët janë ngritur në revoltë” – tha Niklas, i ngrysur.

Nuk fjetën natën deri vonë. Niklas e përkëdhelte në shpinë. “Si është ai? Si duket?” - pyeti ai. Ina i tregoi se, tashmë, ishte e qartë që i ati po ikte. Me dorën e djathtë bënte lëvizje të pakontrolluara, sikur luante ndonjë lojë me një armik të padukshëm. Nga gjoksi i dëgjohej një si gërhitje e rëndë. Dridhej i tëri, kishte ethe, e mbuluan me jorgan elektrik. Ina i mbante dorën dhe mendonte, se babai i saj po shkonte në një vend më të mirë. “O perëndi” – tha Niklas dhe e përqafoi.

Ina mbyli derën e ballkonit dhe dritaren e vogël, uli zërin e sistemit. Zhurma e sharrës depërtonte brenda.

U ul në divanin e bardhë, në dhomën e ndenjjes dhe hapi librin e vëllezërve jezuitë indianë.

Jezuiti shkruante: “E vërteta kurrë nuk mund të shprehet me fjalë. Ajo shkëlqen si vetëtimë vetëm dhe vetëm si pasojë e pozicionit të shprehur.” Kjo mënyrë propagandistike e të shkruarit dhe tingulli i sharrës e acaruan dhe, pas orës katër, e vërviti librin në dysheme. E mbështeti krahun mbi divan. E vërteta shkëlqen si vetëtimë.

Iu kujtua se si, një ditë pranvere u kishte shpjeguar nxënësve të saj arsyen përse do ta linte vendin e pedagoges. Ato e dëgjonin me kureshtje, gjithashtu ajo i njoftoi se e kishin zgjedhur si prezantuese televizive. Heshtja e tyre ishte e padurueshme. Lajmëroi rektorin që do ta linte detyrën. Ai, për nga mosha, ishte si babai i saj.

Ditën e shën Gabrielit, ajo e kuptoi se, për një kohë të gjatë, ajo do të mbështetej vetëm tek paratë e babait. Jashtë ndihej pranvera. Doli nga oborri i shkollës dhe ndjeu një eufori si atëherë, kur udhëtonte natën në ndenjësën e prapme, në makinën e familjes e ngjishte faqen pas xhamit të ftohtë dhe mendonte, nëse do të

mbaronin ndonjëherë koha dhe kozmosi.

Atë pranverë ajo dhe Niklas jetonin në sinkron të ndryshëm. Ai zgjohej herët, largohej vonë nga universiteti dhe pothuaj, në moment, e zinte gjumi. Ndërkohë që ai ishte në punë, ajo pikturonte akuarele me penelat e të atit. Fillimisht, kjo i dukej pretencioze, donte të shprehte diçka, por ngjyrat mbi letër tregonin se nuk ia kishte arritur.

Nganjëherë shëtiste nëpër kopshtin pranveror, shikonte barin e gjelbëruar në parqe dhe retë që lëviznin nëpër qiell, në mbrëmje takohej me Laurën dhe me dy a tre të njohur të tjerë dhe ndihej e lumtur. Nganjëherë natën shtrihej pranë Niklasit, lexonte, pastaj, papritur, e vështronte atë në fytyrë, e linte librin dhe i ngulte sytë në errësirë sikur dëgjonte një gjë të largët.

Ina

Arhus 2. 09. 1986

Kur ta lexosh këtë letër do të jem në shtëpi dhe gjërat do të jenë sqaruar. Fillimisht kam lënë shumë punë pa mbaruar. Prandaj po i shpreh mendimet e mia në letër. Jam vendosur në një hotel të vogël, në breg të një kanali. Po shkruaj natën vonë. Në dhomën ngjitur janë dy suedezë, të cilët bëjnë shumë zhurmë. Kur po haja mëngjes, njëri prej tyre foli me mua dhe më tha se beson që agjentët amerikanë e kanë vrarë Ulof Palmen. Kur e pyeta nga e dinte këtë më tha: “E mendoj vetë.”

Dhoma është e vogël, por krevati është i rehatshëm. Që këtë nuk duket kanali. Duket deti dhe vinçat e makinave në port. Moti nuk është i mirë, ka mjegull dhe bën ftohtë. Por, kur erdha me tren nga Kopenhageni, më pëlqeu qyteti. Nga pronari, Klaus Beçilla, kuptova se emri i tij do të thotë “grykë lumi”, gjë që shpjegon përse më pëlqen.

Më vjen inat për dy gjëra, përveç vjedhjes. E para: ti më gënjen. Dhe kjo nuk ndodh për herë të parë. E dyta : Përpiqesh t’ua hedhësh fajin të tjerëve. Kjo nuk është pak, është shumë. Nëse ke nevojë për parà për rroba ose për gjëra të tjera, mund ta kuptoj që të

merresh shumë me punët e shtëpisë. Shumë shpejt do të mbushësh pesëmbëdhjetë vjet. Përpiqu të sillësh si më e madhe. Nganjëherë mendoj se kërkoj tepër prej teje, por, thjesht, kështu duhet. Më vjen keq që e bëj këtë, por e bëj me një qëllim të caktuar. I urrej vjedhjet dhe e di që i urren edhe ti.

Në mëngjes, para drake jam i lirë. Dua të shikoj qendrën. Ndoshta do të shkoj në katedrale, në pjesën e vjetër të qytetit. Treni nis në mbrëmje, ndërsa avioni im për në Kopenhagen nis në nesër në mbrëmje. Gjatë natës do të jem në shtëpi. Nëse suedezët nuk do të qetësohen do të shkoj t'u trokas në derë. Fillimisht mendova mos të të blija dhuratë, por ndoshta do të marr diçka të vogël. Mos prit kozmetikë.

Babai yt.

PS. E shkruar mëngjesin tjetër. Suedezët janë të çmendur. Bërtasin e qeshin deri në mëngjes. Dy herë shkova dhe u fola. Në reception vetëm ngrenë supet. Tani jam i lodhur dhe më ka ardhur në majë të hundës nga suedezët. Tundohem të mendoj se Ulof Palme është vetëvrarë.

13

Gumëzhima e sharrës depërtonte brenda. Ina ishte shtrirë në divan, në dhomën e ndenjjes. Mendonte se Niklas gabohet dhe nuk e di sa e brishtë është dashuria.

Në mur varej një pikturë e madhe, e bërë me bojëra akrilike. Paraqiste një avion luftarak amerikan të qëlluar, piloti i të cilit katapultonte nga ndenjësja e tij. Niklas e kishte blerë në fillim të vitit nga një piktoreshë e re. Sipas tij, fakti që piktura varet në murin e tyre, është shprehje e qëndrimit negativ ndaj luftës. Ishte koha, kur ai fliste shumë dhe me pasion për luftën.

Inës iu kujtua një ditë prilli, kur ai i tregoi një foto në gazetë.

Një djalë i vogël ishte shtrirë në shpinë dhe sytë e tij ngjyrë kafe vështronin përtej kamerës. Trupi i tij gjendej pranë telit me gjemba.

Fytyra e tij e bukur ishte shtrembëruar nga të qarët. Kokën e kishte të fashuar. Dora e dikujt ia fshinte fytyrën me shami të bardhë. Lëkura në gjoksin dhe në barkun e tij ngjante me lëkurën në një grili të harruar, e lyer me krem të bardhë.

Niklas e lexoi mbishkrimin me zë. Djali quhej Ali. Ishte rreth njëzet vjeç. Një predhë amerikane kishte goditur shtëpinë e tij, i kishte vrarë prindërit, vëllezërit dhe trembëdhjetë vetë të tjerë nga familja. Aliu thoshte se, më parë donte të bëhej oficer, por kjo, tashmë, kishte marrë fund. Tani donte të studionte për mjekësi. “Po si do të bëhem mjek, tani që jam pa duar?” – pyeste ai, (thoshte korrespondenti). Aliu thoshte se do të përfundonte në vetëvrasje, nëse nuk do të kishte duar të reja.

-E tmerrshme, kaloje këtë gazetë – tha Ina.

Niklas ia nguli sytë.

-E kupton që bota do të zhduket, sapo t’i kthesh shpinën?

-Është e pamundur t’i kthesh shpinën botës.

-Kështu është.

-Këtë pranverë, të vdekurit janë prioriteti im.

-Ina, në qoftë se nuk mund ta shikosh në sy qytetërimin tënd, kudo dhe gjithmonë do të jesh i huaj.

-Mos më manipulo.

Niklas heshti për pak minuta. Pastaj tha se askush nuk mund të mbetet i paprekur nga kjo luftë. Kur Ina lexon postën e saj, ajo, tashmë, është brenda luftës. Kur mermërit “Genie in the Botlea” të Kristina Agilerës ose shikon në vetëdijen e vet imazhin e Bred Pitit, ajo është në luftë. Djali shiit, i lyer me pomadë antibiotike, është i njëjti ilustrim i luftës si Kin Fuk lakuriq rrugës për në Trang Bang.

Ina u zgjua me gojë shumë të tharë. Dielli ndriçonte dhomën e ndenjjes. Sharra nuk dëgjohej më. E ndiente kokën të rënduar dhe filloi të ngrinte perden.

Shkoi në kuzhinë dhe pui një gotë ujë. Diku binte telefoni i saj. E gjeti në korridor. Numër i panjohur.

U përgjigj. Në telefon dëgjohej zhurmë nga lëvizja e makinës.

-Alo?

-Përshëndetje Ina, gjyshi jam.

-A, mirëdita gjysh.

-Jam ulur këtu në tarracë. Sikur nuk ndihem mirë dhe desha të ta dëgjoja zërin.

Ina u ul në divan. Gjyshi dëgjohej mirë. Ina u habit që telefoni i tij nuk ishte i regjistruar në të sajën. Ndoshta e kishte fshirë? Apo nuk e kishte pasur asnjëherë?

Ai filloi t'i tregonte gjëra nga vendlindja e tij. Foli për një bar në agjencinë telegrafike të stacionit të autobusëve. Kishte dëgjuar se, diku afër Kuorevarit dy shokë të dehur ishin varur në një bredh.

-Po ti nuk do vish mysafire tek unë?

-Ndoshta, do të mendoj diçka në fund të verës.

-Nëse do, eja menjëherë. Do të të pres në stacion.

Biseduan edhe pak. Ina i tregoi për marrëdhëniet e saj me Niklasin. Ai dëgjonte pa folur. Edhe Ina heshti. Për një moment asnjëri nuk foli. Zëri i gjyshit i vinte si nga larg:

-Këtë pranverë mollët kanë lulëzuar me vonesë.

-O gjyshi, mendoj se mund të vij në gusht që të rri ca kohë.

-Eja, eja. Do të të pres me padurim.

Ina hëngri sallatë me domate dhe mocarela dhe piu dy gota verë të bardhë. Mori çantën e saj të zezë nga tavolina dhe doli në korridor.

U hap porta e jashtme dhe hyri Niklas. Kishte veshur atletet dhe mbante kapelën në dorë.

-Të lutem, zemër, - tha Ina dhe i zgjati çantën.

-Ai i hodhi atletet në qoshe, la çantën e shpinës dhe kapelën, pastaj çoi çantën e zezë të Inës në bibliotekë.

Ina s'kishte ndërmend ta pyeste. Niklas ishte me humor të keq dhe nuk donte të dëgjonte që kishte probleme me disertacionin. Heshtje.

Në dhomën e ndenjjes ndjeu një aromë të çuditshme, e cila vinte nga koridori. Kishte një amëz metali, sikur ishte e përzier me erë urine.

-Punove sot për disertacionin?

-Jo, shkrova një artikull – tha ai, duke shfletuar një libër të trashë.

-Të pëlqen karrigia e re? Është e rehatshme?

-Në të e kam të vështirë të përqendrohem.

-Nuk është nga karrigia, është nga vapa.

I tha që binte erë, që duhet të lahej dhe e përqafoi, kur atij nuk i erdhi mirë.

-Në mëngjes isha aq e lumtur, që të kam.

-Në Paris kanë vdekur qindra vetë nga të nxehtit, nga temperatura e lartë. Dhe ai, megjithatë, është kryeqyteti i romantikës.

Ina mori kapelën e tij nga tavolina e vogël e telefonit, deshi ta vinte në varëse dhe, atëherë vuri re që kishte diçka brenda. Në mugëtirën e korridorit ajo ngjante si një karamelë në ngjyrë të kuqe të errët. Ai krimb i madh ishte i gjallë. Në të ishte ngulur një gozhdë e hollë. Nëpër anët e kapelës rridhte diçka si jargë që mbante erë të keqe.

Ina bërtiti.

Niklas u afrua të shikonte. Dritarja e dhomës së ndenjjes u tund dhe, si në film, xhamat ranë në dysheme.

Niklas vështroi dritaren e thyer. Ina shkoi pas tij.

-Pompa e biçikletës – tha Niklas.

Në oborr dikush bërtiti. Ina hapi derën e ballkonit, doli duke shmangur një copë xhami dhe shkundi kapelën. Vemja fluturoi përmbi kangjella dhe u zhduk.

-Përse e kishe futur atë krimb në kapele?

-Desha të merrja vesh çfarë vemje është.

-Pse ishte e shpuar me gozhdë?

-Nuk e di. Ashtu e gjeta në oborr.

Niklas doli në ballkon dhe hodhi sytë në oborr.

-E kush dreqin e ka atë pompë? – pyeti ai.

-Në djall të vejë! – shau ai dhe ngriti njëren këmbë. Duke qëndruar me një këmbë këqyri shputën e vet.

-Largohu nga ato copa xhamash.

Niklas e lëshoi këmbën dhe bëri dy hapa.

-Në djall! – shau përsëri dhe këqyri shputën e këmbës tjetër.

Garsoniera ishte në katin e fundit. Nga dritaret e saj dukeshin çatitë e shtëpive në lagjen qendrore dhe kulla e bardhë e observatorit. Petri akoma s'kishte perde. S'kishte asgjë për të shpëtuar nga vapa. Dielli përvëlonte brenda deri në mesnatë.

Drita e tij ia verbonte sytë Petrit dhe e pengonte të lidhte majat e fjongos së dhuratës. Më në fund i rregulloi dhe i zbukuroi pak me tehun e gërshërës. E la pakon në mes të tavolinës së rumbullakët. Dielli e ndriçonte pakon përmes dritareve me pluhur. Fjongoja e pruar shkëlqente në sfondin e letrës ngjyrë kafe.

Nga jashtë u dëgjua boria e një kamioni.

Petri doli tek dera jashtme. Pastaj u kthye dhe u afrua tek tavolina. Mori pakon e lehtë, e afroi tek veshi dhe e tundi. E ktheu mbrapsht në tavolinë, e tërhoqi fjongon dhe e grisi letrën. E hapi kutinë dhe vështroi brenda.

E shikonte folenë dhe nuk ndiente asgjë.

E mbylli kutinë. Supet e rëna të tij pasqyroheshin në xhamin e dollapit. Rrëmbeu gërshërën dhe drejtoi shpinën. Letra e ambalazhit kërciste teksa e priste. E vuri letrën në tavolinë dhe kutinë mbi të. E pakatoi kutinë përsëri dhe prapë i shpupurishi majat e fjongos. E la pakon në mes të tavolinës. Lëvizjet e përsëritura e qetësuan.

Nga dollapi i rrobave pranë krevatit nxori një bluzë me mëngë të shkurtra të pastër. Pjesa më e madhe e rrobave të tij, tashmë, ishin nëpër kuti kartoni. S'kishte mobilje të tjera, përveç krevatit, dollapit prej xhami dhe një tavoline të vogël të rumbullakët.

Qëndroi para pasqyrës në korridor. Shpatullat i kishte të forta. Veshi një këmishë të zezë të ngushtë. U rrotullua ngadalë para pasqyrës. Drita që vinte pas shpinës së tij ia theksonte venën në qafë. E vuri gishtin mbi venë dhe dorën tjetër e bëri grusht.

Mori çekiçin dhe disa gozhdë. Në banjë nguli një në nivelin e fytyrës së vet. E ktheu çekiçin në arkën me instrumente dhe mori një poster të mbështetur në derën e dollapit - bardh e zi në kornizë.

Aty ishte paraqitur Sejlllo i parruar dhe një numë i buletinit të tij.

Në këto zgjedhje Petri kishte votuar për herë të parë. Për Sejllon. Ai humbi.

Petri e vari posterin në derën e banjës. Vështroi sytë e Sejlllos.

Posteri ishte pak poshtë. Ndoshta, ndonjëherë tjetër, do ta varte më lart.

Mbathi këpucët dhe lidhi lidhëset, futi në xhep telefonin, portofolin dhe çelësat. Mori pakon nga tavolina dhe qëndroi para pasqyrës në korridor. Vështroi mirë pamjen e tij të jashtme.

Nëpër shkallë ishte errësirë. Për një çast u verbua. Në sheshpushimin e katit tjetër, shtypi çelësin e ndritshëm, ngjyrë portokalli të dritës dhe ndaloi. Ndjeu një zhurmë që vinte nga lart. Gumëzhitje e lehtë. Bisedë grash që rridhte qartë. Një fshesë me korent ose tharëse flokësh.

Në rrugë makinat kalonin me shpejtësi pranë tij. Qielli ishte i pastër.

Përballë tij u shfaq një burrë i vjetër i kërrusur, me kapele ngjyrë kafe të hapur.

I kujtoi pronarin e garsonierës që kishte marrë me qira. Edhe ai ishte i vjetër dhe shumë i kërrusur dhe e kishte të vështirë të hapte dollapët e kuzhinës. Kur e dha me qirà, kërkoi ndjesë dhe hyri në banjë. Uji bënte zhurmë, ndërsa Petri vështroi përmes dritares observatorin në bregun tjetër të lumit, oborrin e brendshëm të asfaltuar, çatinë, në të cilën vuri ré se kishte ngordhur një pëllumb. Vuri ré edhe dy të tjerë. Me siguri ishin helmuar. Pas ullukut ishte një fole, ku rrinte një pëllumb me sy të kuq. Pronari doli nga banja, duke fshirë duart pas pantallonave dhe duke folur për qiranë. Petri vështroi sytë e tij dhe mendoi për pëllumbat e ngordhur.

Në kryqëzimi e rrugës “Aninkajstenkatu” Petri ndaloi. Priti dritën jeshile. Pak para se të ndërrohej semafori, u nis. Ndiante ritmin e qytetit, ritmin e rrymës së makinave, të vitrinave të pluhurosura dhe të trupave të njerëzve që lëviznin. Ecte shpejt dhe pakoja, në çdo hap, e godiste në kofshë.

Në qoshen e shtëpisë së Suvit, ai u ndal. Përballë po afrohej një vinç i madh. U praps dhe po shikonte makinën, ndërkohë që kalonte pranë tij. Në kabinë ishin dy burra që dukeshin njësoj. Ndoshta ishin vëllezër dhe, çdo ditë, punonin bashkë. Motori gumëzhinte dhe koshi shkundej, makina, ngadalë hyri në lëvizjen rrugore dhe u nis.

Ai hyri në oborr dhe pa, në mes të tij, pemën e prerë. I ra ziles. Priti pak dhe i ra për së dyti. Iu kujtua fotografia e mjekut. Ndoshta e kishte pranë dhe e shikonte. Përfytyronte Suvin të shtrirë në shpinë që e dëgjon zilen, por nuk mund ta hapë, sepse nuk i vjen mbarë.

Djaloshi nxori telefonin nga xhepi, shkroi një mesazh dhe e dërgoi.

U largua dhe u ul mbi trungun e prerë. E vuri pakon pranë vetes. Mbi lumë çirrej një pulëbardhë. Ndjeu një aromë të çuditshme dhe u mori erë sjetullave. Që në mëngjes herët, kishte hedhur deodorant, sepse e priste një ditë e rëndësishme. Rrinte mbi trung dhe priste Suvin.

Iu kujtua pëllumbi i ngordhur pas ullukut. Çdo mbrëmje, kur kthehej nga puna, fillimisht i hidhte sytë andej. Nganjëherë atje shikonte një burrë trupmadh. Një ditë e gjeti folenë të zbrazët. Hapi dritaren, vështroi me vëmendje dhe vuri ré brenda dy zogj të sapoçelur.

Po atë ditë takoi Suvin.

Mbi lumë çirrej pulëbardha. Petri priste në vapë. Suvit nuk iu përgjigj mesazhit të tij. Përsëri ndjeu aromën e çuditshme. U ngrit dhe ajo u ndje më fort. Vështroi lëndinën e mbuluar me copa druri. I erdhi rrotull pemës. Aroma u pakësua. U kthye aty ku ishte ulur. Ajo përsëri u bë më e fortë. U ul në gjunjë dhe këqyri përreth. Nuhati. Toka vinte erë si qilimi në dhomën e pritjes.

Iu kujtua dhoma e pranimit në spitalin mbi kodër, në të cilin, kur ishte fëmijë kishte qëndruar me javë, lodrat, kali plastik me kokë të bardhë dhe me mbajtësen e kaltër. Megjithëse kishte kaluar shumë kohë, e mbante mend atë dhomë. I ulur në gjunjë,

në lëndinë, vendosi t'i tregonte Sejllos për këtë, në një moment të përshtatshëm.

Dhe atëherë pa një vemje të madhe. Në hijen e trungut ajo zvarritej nëpër bar, trupi i përdridhej, koka e saj e errët tundej, sikur studionte rrugën. Kërkonte shtegun për të kaluar. Nga vinte? Mos vallë e prisnin diku?

Ai i kushtoi më shumë vëmendje, e këqyri atë krijesë nga afër. Aroma iu fut në hundë. E preku me kujdes me gisht vemjen, ajo u mblodh, ndaloi, pastaj me gjallëri, por ngadalë vazhdoi rrugën e vet. Ishte e bukur. E harroi shumë shpejt.

Nxori një gozhdë të hollë nga xhepi, ia nguli vemjes nga sipër. Ndjeu një tingull të ulët, sikur plasi një kokërr rrushi. Vemja shtrembërohej dhe tundte kokën. Me një gozhdë të tillë ishte mbërthyer poster i Sejllos.

Vështronte vemjen. Lëndina përreth tij u ndriçua. U shfaq një rreth i gjelbër i ndritshëm, i cili zgjerohej shpejt, u ngrit mbi bar, mbi asfalt dhe u mbështet në muret e shtëpive. Ndoshta diku në katet e sipërme ndonjë plak do të zgjohej në karrigen e tij lëkundëse, do të mbante vesh dhe me telekomandë do të ndizte televizorin, do të drejtohej dhe do të vështronte nga dera e jashtme.

Petri u ngrit dhe mori pakon. Nuk kishte më dëshirë ta shikonte vemjen. U afrua tek hyrja dhe i ra ziles. U mendua për pak minuta. Përsëri shtypi butonin. Po sikur t'i përgjigjej ndonjë zë i huaj. Priti. Nuk donte ta shikonte pemën e prerë.

Ndjeu se dikush po vinte nga oborri. U ngjesh pas murit. Suvi, me siguri nuk ishte në shtëpi. Ajo mungonte shpesh dhe ai nuk e pyeste, ku kishte qenë. Kam qenë shumë herë për vizitë. Imagjinonte si i ngre ajo këmbët mbi supin e tij, i zgjat si flamingo drejt qiellit të Shark Valley në nëntëdhjetë e dyshin.

Atëherë Petri mbushi njëmbëdhjetë. Gjyshja që binte erë mente i dhuroi një fotoaparaturë "Kodak". Në Shark Valley ai kishte fotografuar një gjarpër uji dhe gjyshen. Pastaj e humbi fotoaparaturën. Gjarpri dhe gjyshja i mbetën në shiritin e filmit, i cili nuk u stampua kurrë.

I ra ziles. Pranë tij u afrua një burrë këmbëzbathur. “Ma mbaj” – tha ai dhe i zgjati kapelën e vet. E mori. Ai mbante në duar këpucët dhe në sup kishte hedhur një çantë shpine të zezë. Nxori çelësat nga xhepi i xhinseve dhe hape derën e hyrjes. “Urdhëro” – e ftoi ai. “Unë nuk banoj këtu” – u kthye Petri. Burri buzëqeshi, mori kapelën dhe hyri Brenda.

Porta u mbyll me zhurmë.

Petri u mendua. Këmbëzbathur. Një burrë këmbëzbathur.

Gjatë verës disa burra mbajnë sandale. Kur ishte fëmijë, Petri kishte mësuar nga gazetat dhe televizioni fjalën burrë qyteti. Atëherë, gjatë vitit nëntëdhjetë e shtatë një sërë dyqanesh vunë në shitje rroba të prera keq. Burri qytetar ecte me sandale.

Pasi kalonte pragun e portës njeriu nuk ishte më burrë qyteti. Në duar mbante këpucë marke, pantallonat i kishte në stilin indi, ndoshta dëgjonte The Stoogesia, The Strokesiaa dhe kërcente duke imituar ritmin e kitarës. Burri qytetar endej i veshur keq me sandale të lira në tarracë, me kanoçen e birrës në dorën e tij me kallo dhe i kërrusur fort.

Në kohën e verës, burri qytetar i zhvishte këmbët, gishtat e ashpër me morth në lëkurë dhe thonj të paprerë. Këmbëve të burrit u shkojnë çizmet. Vetëm këmba e gruas është e bukur, e zbathur, kofshët e Suvit mbi supet e tij si flamingo në Shark Valley. Petri po lëkundej – të ikte apo të priste akoma.

Iu kujtua që i ati, kur u plak, u kthye në burrë qyteti.

Shkoi tek pema, fshehu pakon dhe u nis rrugës. Prapa qoshes hyri në kafënë e lagjes. Bleu një shishe ujë dhe qëndroi në trotuar që ta pinte. Makinat buçitnin pranë tij. Ishte i qetë. Vetëm trotuari. Makinat. Uji i ftohtë.

U kthye në oborr. Në ballkonin e Suvit pinte duhan një burrë zeshkan i zhveshur deri në mes. Nuk dukej si mjek. U afrua tek pallati dhe thirri Suvin me zë të lartë. Burri e vështroi.

Para pallatit ishin parkuar disa biçikleta. Sipër bagazhit të një biçiklete të vjetër grash ishte një pompë blu.

Petri shkoi dhe e mori. Mori vrull dhe e vërviti drejt burrit në ballkon.

Pompa u rrotullua, shkëlqeu në diell dhe fluturoi drejt tarracës së gjatë. U ndje tringëllimë xhami. Petri qëndronte dhe vështronte burrin. Edhe ai e vështronte. Petri e thirri përsëri Suvin. Nga lart ra diçka e vogël dhe u përplas në asfalt. Mendoi që ai burri kishte dashur ta pështynte.

Në asfalt pranë tij ishte një vemje e kuqe. Kishte një gozhdë të ngulur në trupin e saj. Ishte gjallë akoma. Përdridhej ngadalë.

Petri u ndje i sëmurë, me këmbët si të buta. Ngriti këmbën dhe e shtypi vemjen.

Pastroi shollën e këpucës pas asfaltit dhe doli nga oborri.

15

Vendi ishte zyra. Suvi ishte njëzet vjeçe.

Moketi ishte gri në blu.

Zyra pranë linjës hekurudhore.

Në moshën njëzetvjeçare, ajo mendonte për verën e nxehtë me kufjet në veshë. Ajo u përgjigjej telefonatave dhe, në ditët më të mira, shkruante rreth dyqind njoftime.

Gjatë verës së qetë ishte bërë riparimi dhe dhoma ishte kthyer në zyrë me ndarëse xhami. Mbi ato të parat, kishin vënë perde me ngjyrë të hapur.

Sipas drejtorit ekzekutiv Miko, koncepti pamor shkon në ferr. Bashkëshortja e drejtorit për shitjet, Silia bëri nëpër mure ca lyerje abstrakte. Njoftoi se dhoma e pushimit të shkruesve, do të mbetej njësoj. Në mure varej një kalendar biznesi nga koha e Luterit dhe Marksit.

Zyra pranë linjës hekurudhore. Dhjetëra shkrues njoftimesh punonin me kohë të pjesshme dhe përfaqësonin kastën më të ulët. Disa ishin nxënës, disa, gjatë kohës së lirë, mësonin për provimet e pranimit. Vinin dhe iknin – pagesa ishte shtatë euro në orë.

Ata të paemër belbëzonin nëpër mikrofonë dhe pranonin lajmërimet idiote.

Shes makinë stampuese.

Shes iriq mashkull me bark të bardhë.

Shes ibrik luksoz.

Frezë profesionale.

Shes fustan nuseje të veshur një herë, korsé dhe mbajtëse rrobash.

Blej sinjalizues nate. Pompë zhytëse, lavaman.

Para pushimit Suvi mori njoftimin e një burri të moshuar.

Suvi hoqi kufjet, u ngrit dhe shkoi në dhomën e pushimit. Zukaste qetë ventilatori i tavolinës duke u rrotulluar. Ajo mori nga frigoriferi një kos “Danon” dhe një mollë. Mbi tavolinë ishte një gazetë me artikuj shkencorë, në të cilët tregohej për Pompejin. Ajo u ul dhe pa telefonin.

Mesazhi i parë ishte nga e ëma.

Përhëndetje, Suvi, do kalosh këtej sonte?

I dyti nga Petri:

Kam një dhuratë për ty, megjithëse nuk e meriton.

Suvi kafshonte mollën dhe nuk ndiente brejtje ndërgjegjeje.

Lexoi për viktimat e fatkeqësisë natyrore të Pompeit.

“Petri” – mendoi ajo.

Petri rruajti kokën dhe u vesh me të zeza.

Një të shtunë maji në mëngjes, Petri ecte nëpër oborr, ndërsa Suvi, e ngrysur, rrinte vetëm në kabinë, në katin e parë. Petri afrohet, vështron përmes xhamit, pastaj shkon tek dritarja e vogël. Suvi merr njoftimin e radhës dhe thotë:

-Sähköpora strëvitje painonnostopenkki, atletikë e rëndë molemmat osstetaan, Suvi sanoo – nakee pojan mustan villapadan hihojen alta kammenselkiin kaartavat tribaalikiehkurat.

-Jo, faleminderit.

Petri ia ngul sytë, pastaj kthehet dhe shkon tek porta me aq rrëmbim, saqë e detyroi Suvin të nxirrte kokën nga dritarja, që ta ndiqte me sy. Petri bën një rrethrotullim dhe kthehet tek ajo.

-A do të shikosh ndonjë gjë?

Ai shkon tek një ford blu, hap bagazhin, merr kutinë e vogël

prej kartoni dhe e vë mbi mbulesën e makinës.

-Ulu.

Suvi ulet në cepin e ndenjësës së prapme. Petri hap kutinë dhe ia jep Suvit. Në fund të saj është një fole zogjsh ngjyrë kafe dhe dy zogj të shëmtuar, të mbuluar me pupla të pista. Njëri zog zgjat qafën me sqepin e hapur, por tjetri dukej i sëmurë. Me sytë e mbyllur mbështet kokën në anë të folesë dhe dridhet. Suvi i prek me gisht kurrizin.

-Çfarë i ka ndodhur kësaj kafshe të vogël?

-Eh, do të ngordhë.

-Çfarë do të bësh me ta?

-Nuk e di. Ndoshta do t'ia çoj Anja Eerikajnenit.

-Ky po mbaron.

Petri e merr kutinë nga duart e saj dhe e vë mbi ndenjësën e parë.

Suvi habitet, kur, për herë të parë, shikon tatuazhet e Petrit. Ato rrethojnë mesin dhe ngjiten tek shpatullat, nëpër gjithë shpinën dhe formojnë një tablo të madhe. Me gjymtyrët e tij të gjata dhe trupin gjatosh i ngjan një qeni muskuloz.

Kur bëjnë dashuri, ai shtrëngon sytë e mbyllur dhe dridhet. Zbret prej saj dhe fut kokën nën jastëk. Shpatullat i rrëqethen, kur Suvi ia përkëdhel tatuazhet, i numëron me gisht unazat e shtyllës kurrizore dhe i përkëdhel kokën e rruar. Petri rri shtrirë gjatë me kokën në jastëk, pastaj ngre kokën dhe e vështron.

-Mund të bëjmë kafe.

Pas disa takimesh, Petri qetësohet, tashmë nuk dridhet, por përsëri e bën me sy mbyllur.

-Më shiko në sy – i thotë Suvi.

Ai hap qepallat, vështron me egërsi pak sekonda dhe i mbyll sytë prapë. Suvi ndihet e agresuar.

-Më shiko në sy – përsërit ajo.

Ai i hap sytë dhe i mbyll prapë. Ajo e shtyn, e largon nga vetja.

-Seksi me ty i ngjan lojës symbyllazi.

Në qershor, pas mesit të verës Suvit iu mërztit kjo gjë. Në zyrë

ajo hap një zarf, në të cilin ka një njoftim të shkurtër me fotografi:

Një doktor i keq kërkon një vajzë për kënaqësi reciproke. Përgjigja duhet patjetër me fotografi.

Poshtë tekstit është numri i kutisë postare. Në foton e bërë me kamera dixhitale, një burrë i veshur me bluzë të bardhë mjeku, qëndron pas një tavoline me mbulesë të bardhë dhe shikon në kamera. Bluza është e zberthyer. Burri ka vënë maskë mbrojtëse dhe doreza lateksi në duar. Në tavolinë ka një stetoskop dhe instrumente të tjerë mjekësorë.

Në cep të tavolinës dukej një kanë me ngjyrë rozë të çelur me buzëqeshjen e stampuar të Minni Hiirit.

Suvi e këqyr fotografinë. Kuptohet që s'mund ta vendosë në gazetë, sepse doktori i keq nuk kishte dërguar faturën me nëntë eurot e paguara. Suvi e lexoi edhe një herë njoftimin dhe e hodhi foton në koshin e plehrave. Nxori nga çanta romanin e Agata Kristit dhe e vuri njoftimin në mes të faqeve. Tashmë ajo ndiente pështirosje nga ai njoftim.

Askush nuk dëshiron të dhurojë macen e vet, për shkak të alergjisë, nga e cila vuan. Ajo hapi një zarf të ri. Pastaj zgjati dorën, nxori nga koshi i plehrave foton, të cilën, pak më parë, e kishte hedhur dhe e vuri midis faqeve.

Po fillon vapa e korrikut. Petri nuk e kupton. Ai kërkon të rrijë me të. Flet me pëshpëritje. Suvi shtrihet me të dhe ndien rëndesë në gjoks. Ajo është në krevatin e gabuar, e humbur në ndjenjën e gabuar.

Në mëngjes Suvi merr foton nga libri dhe e vë në tavolinë. Pas dushit Petri hyn në dhomën me dritë duke u fshirë me peshqir, mërmërit diçka dhe hesht, kur shikon fotografinë. E merr.

-Kush është ky?

Suvi e shikon.

-Një burrë, me të cilin takohem.

Petri ia ngul sytë fotografisë. E lëshon peshqirin dhe kthehet. Vështron Suvin pa folur. Ajo afrohet pranë tij. Petri lakuriq hesht, e lëshon foton dhe i ngul sytë në mur. Suvi i vë dorën në sup.

-Më vjen keq.

Petri ia heq dorën. Ulet në dysheme, pastaj ngrihet dhe vishet. Tek dera kthehet dhe e vështron Suvin në sy.

Ajo përpiqet ta përqafojë. Ai kthehet dhe del. Suvi mbyll derën. Qëndron në korridor dhe dëgjon një gërvishtje në ashensor. Shkon në dhomë, merr foton dhe e shikon me vëmendje. Nën maskë, me siguri doktori buzëqesh. Ajo hedh vështrimin jashtë, shikon pemën dhe diellin.

Në pushim Suvi lexon për viktimat e Pompejit. Pushimi mbaron. Ajo kthehet në vendin e punës. Derisa vjen turni i mbrëmjes, u përgjigjet thirrjeve telefonike dhe shkruan njoftime. Pastaj merr çantën, zbret nëpër shkallë dhe shkon në parkingun e nxehtë nga vapa. I afrohet mercedesit ngjyrë argjendi. Hap derën dhe ulet në ndenjësën e djathtë.

“Është e premtë” – thotë drejtori Miko dhe ndez motorin. Ora pesë e pesëmbëdhjetë. Akoma bën vapë. Mbi trasenë e hekurudhës – një mjegullnajë dridhëse. Afër linjës një vinç i verdhë përfshin qoshen prej betoni të silosit të uzinës që shkatërrohet. Miko kap një radiostacion dhe nget makinën me shpejtësi. Në radio flasin për Junk Majlin. Suvi mërzhitet duke e dëgjuar.

-Si do të shkojë Silia në shtëpi?

-Mos u shqetëso për këtë.

Miko parkon makinën në rrugë. Hyjnë brenda dhe ngjiten në katin e katërt. Në korridor Miko e kap atë për dore dhe ngjesh pas pasqyrës. Suvi duket nga larg, sikur e vështron përmes syrit magjik.

Miko i merr një cigare dhe hap perdet. Përmes dritareve derdhet drita. Ajo qëndron para dritares.

-E prenë pemën.

Burri e vështron dhe i vë dorën në sup.

-Ishte e rëndësishme ajo pemë për ty?

-Urdhëro?

-Ishte e rëndësishme? E dashur?

-Pemë e zakonshme.

Ai del në tarracë. Suvi shikon burrin e zhveshur deri në mes që pi duhan. Miko është më i moshuari nga të gjithë dashnorët e saj. Ai është pothuajse dyzet vjeç, shpatullgjerë dhe me muskuj të dukshëm. Miko përkulet dhe vështron jashtë. Që andej dëgjohet kërcitja dhe tringëllimi i xhamit të thyer.

Miko vështron brenda.

-Aty poshtë, një djalosh po të thërret me emër.

-Le të thërrasë. E ka bërë edhe tjetër herë.

-Të rri sonte?

-Po.

16

Mbrëmja e së premtes është e ngrohtë. Nëpër ballkonet e shtëpive fqinjë, burra të rinj pijnë cigare të zhveshur deri në mes. Nga rruga vijnë këngë festive dhe të qeshura. Në qiellin e zverdhur zhurmon një helikopter.

Ina lexonte në krevat një libër me titullin “Zgjimi”. Unë shikoja një artikull për kiberfeminizmin, të printuar nga arkivi i revistës “Vagina”. Sipas autorit, në kohën e luftës kundër terrorit, ideja e vjetër kiberfeministe mbi zhvillimin e teknologjisë, nga këndvështrimi i vaginës ishte e pamjaftueshme. Kishte nevojë për baza teorike dhe praktike politike.

“E shikon” – mendova unë. Dikur kisha menduar të shkruaja një esé, në të cilën të flisja për revolucionin dixhital gjatë pesëdhjetë viteve të fundit, nga pikëpamja e fatit tim personal. Hapi më i rëndësishëm progresiv ishte anonimiteti në rrjet dhe qëndrimi i rinisë së sotme ndaj pornografisë. Duke menduar për këtë, ndjeva trishtim dhe zili. Pjekuria ime ishte e shoqëruar me situata të sëmura, të lidhura me pornon.

Nga sa mbaj mend gjatë viteve tetëdhjetë në sfondin e

marrëveshjes së miqësisë, bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke, të garës bërthamore dhe integritit në tregjet e brendshme europiane, ditët e punës për të rinjtë finlandezë lulëzonin nga beteja e mundimshme për porno.

Vidhnim kartëmonedha nga kuleta e nënës. Kalonim orë të tëra në dyqane librash dhe antikuaresh, duke u shtirur sikur shfletonim gazetat. Gënjenim shitësit. Nxitonim nëpër rrugë të skuqur si gaforre dhe me vetëvlerësim të coptuar. Deficiti i pornos na shkatërronte moralin, ndjenjën e dinjitetit personal dhe korrektesën.

Nga ana tjetër, kurrë s'do ta provoja joshjen shokuese të posedimit të pornos, ashtu si, kur isha trembëdhjetëvjeçar, në një natë gushti kthehesha në shtëpi në këmbë, me një qese najloni në dorë. Tensioni i madh, gjymtyrët që dridheshin, lumturia nga pornoekstaza, pritja e paduruar dhe ereksioni i shpërthyer.

Isha trembëdhjetë vjeç, jetoja në një vend që po pasurohej shpejt dhe e ndieja këtë në çdo qelizë të trupit. Pornografia ishte lajmëtari i tregut të pasuruar. Gjatë vitit që pasonte, nëpër dyqane do të blihej më shumë.

Kurrë nuk më mjaftonte durimi që të prisja për t'u kthyer në shtëpi. Më kujtohet një herë, që u fsheha pas gardhit me dërrasa në një shesh ndërtimi dhe, midis shelgjeve, nxora revistën nga qesja. Zbërtheva pantallonat midis pelinit të egër të lulëzuar. Kapa penisin, i ngula sytë tek cicat e mëdha në fotografi dhe u vetëkënaqa në sfondin e lëvizjes rrugore. Mbylla zinxhirin dhe, ndërsa shikoja spermën që rridhte nëpër dërrasën e errët, mendoja se mund të nxirrja vetëm përfundime pesimiste për të ardhmen time. Në realitetin e kufizuar një onanist nuk mund të ushqente iluzione të mëdha në lidhje me fatin e vet të ardhshëm.

Falë televizorëve me ekran të sheshtë, para të cilëve shkarkoheshin të rinjtë që rriteshin në vitet 2000, në krahasim me mua, ata ishin porno subjekte autonome. Vështrova Inën. Po vajzat? A ishte studiuar përvoja e tyre mbi përdorimin e pornografisë në internet? A ekzistonte një statistikë për këtë? A kënaqeshin ato me stimulimin vizual dixhital?

Ky mendim më preku. Shpresoja që vajzat profesionale, duke bërë

sërfing nëpër sajtet pornografike, përjetojnë orgazma të mrekullueshme demokratike.

E lashë artikullin dhe stilolapsin në raftin e vogël. Jashtë dritares, helikopteri vazhdonte të gjëmonte. Mbylla sytë dhe u mundova të arsyetoj për rrjetin në internet, si diçka e tërësishme. Arrita të vetmin përfytyrim, shumë të përgjithshëm e të paqëndrueshëm.

Truri është organi me të cilin perceptojmë vetëm dimensionet e afërta, të paktën unë kështu e kisha. Por rrjeti ekzistonte dhe punonte. Diku kishte server, i cili kujdesej që postimet e Esa Taberman dhe Peka Janson të veprojnë.

Përtej gjirit janë suedezët. Rrjeti propozonte gëzime, njohuri dhe mbresa. Në faqen e Institutit të pyjeve, për disa sekonda, gjeta të dhëna mbi vemjen e kuqe. Ishte vemje e fluturës së madhe të natës. Vemjet i dëmtonin pemët, aq sa nga një erë e fortë, ato mund të thyheshin. Tipar dallues i vemjes ishte era e saj e shpifur.

Ishte trishtuese që njerëzit gjatë mijëvjeçarëve të mëparshëm, jetonin pa internet. Çfarë pseudonimi do të zgjidhte, vallë, Emanuel Kanti? Dhe çfarë do të kërkonte në internet? Kanti e kishte përcaktuar shkollimin si çlirim të njeriut, zgjedhje, të cilën ai e kishte bërë në një moshë shumë më të hershme.

Mulliri i teknologjisë postmoderniste është sfidë për arsyetim. Për Kantin e ardhmja është një kategori e mundshme. Me ndihmën e logjikës është e mundur të kuptosh më mirë realitetin. Loja e sotme superteknike e fut në mjegull të ardhmen.

Nuk mund ta parashikosh as për pesë vjet. E ardhmja do të ishte, mbi të gjitha, ajo çka sot është e pamundur. Makinat janë më të vogla, më të shpejta e më të lira, po për çfarë drejtin shërbejnë?

Hapa sytë. Në dhomën e gjumit ishte nxehtë dhe ndihej zagushi. Inës, siç dukej, nuk i pëlqente libri që po lexonte. Mendova që marrëdhënia e saj me teknikën është po aq drejtvizore, sa edhe me vibratorin e saj. Kur i duhej, e përdorte me efekt, por ai nuk zgjonte dashuri tek ajo.

Në vitin 1991 mbusha nëntëmbëdhjetë vjeç. Shoku im Sami, i cili e kishte ndërprerë shkollën, organizonte një mbrëmje argëtimi në vilën e prindërve të vet, e cila ndodhej disa kilometra larg nga Turku. Ishte muaji shkurt dhe temperatura ishte diku tek njëzet gradë nën zero.

Shtëpia dykatëshe, e ndërtuar pas luftës, ishte e pajisur me të gjitha komoditetet: video JVC, furrë me mikrovalë, me stereosistem të markës “Maranc”, kompjuter “Amiga 500” dhe sobë për bukë “Melisa”. Pas gardhit të ulët prej murrizi, kalonte linja hekurudhore, prapa së cilës ndodhej pylli me drunj halorë.

Ishim dhjetëra vajza e djem, shumica maturantë, shokë shkolle. Të premtën në mbrëmje u lamë në sauna, u rrokullisëm në borë, pimë “Bakardi kola” dhe birrë.

Në fillim të viteve tetëdhjetë konsumatori kishte një zgjedhje të pasur. Në treg u shfaq një shumëllojshmëri markash të ndryshme birre, të cilat shiteshin jo vetëm në Allko, por edhe në dyqanet më të vegjël.

Të shtunën dhe të dielën folëm shumë për ekzistencializmin, dëgjuam muzikë nga grupi kolegji-rok dhe nga grupet indi të dekadës së kaluar.

Të dielën shëtitëm deri tek fshati i afërm dhe kuruam përgjumjen tonë në pijetoren e fshatit me birrë, derisa na përzunë vështrimet armiqësore të vendasve. Sami mori me qira një film nga mesi i viteve tetëdhjetë me Randi Uest. Ishte nga periudha e artë e pornoindustrialisë kaliforniane. Fytyra e nxirë e Randi Uestit që akoma nuk i kishte mbushur dyzet, nuk ishte rrudhur akoma dhe flokët nuk i ishin thinjur. Akoma s’kishte përfunduar seriali “Up And Cummers”, i cili shënoi fundin e karrierës së tij.

Randi luante rolin e doktorit për gratë mendjelehta, shpikte substanca që stimulonin gratë për t’u pasuruar dhe për të shpëtuar nga borxhet. Hajduti e merr substancën nga laboratorit i tij. Andi e

kërkon hajdutin në gjithë qytetin dhe takon, gjithnjë e më shumë, gra të reja të ndezura, të cilat hajduti i ka furnizuar me këtë substancë, që të argëtojnë ndjekësit e tyre. Subjekti ishte i mirë dhe Randi në lartësinë e duhur, por subtitrat finlandezë shkëputeshin nga tingulli. Replikat nuk përputheshin me skenat.

E pamë filmin dy herë, pjesërisht nga përkthimi qesharak, pjesërisht, sepse në atë moshë, akoma ishte interesante të shikonim filma porno, së bashku me vajzat. Pas filmit vumë lajmet televizive, të cilat na sollën në realitet që, në sfondin e pornos, nuk na dukeshin si farsa.

Tensioni në Ballkan rritej. Balltiku dhe Europa Lindore zienin. Ekonomia e tregut kishte hequr nga puna një numër të madh çekësh, polakësh dhe hungarezësh, gjithashtu edhe dyqind mijë finlandezë.

Radioja njoftonte për operacionin Stuhia e shkretëtirës, në mënyrë monotone. Bombat me lazer vazhdimisht bombardonin të njëjtat objekte irakiane. Në mars presidenti Bush mbajti një fjalim në kongres, sipas të cilit shtyllat mbështetëse të rendit të ri botëror do të jenë liria, të drejtat e njeriut dhe OKB-ja e rilindur pas fundit të luftës së ftohtë.

Bushi tha: “Lufta e Gjirit e vuri këtë botë të re në testimin e saj të parë, dhe ne, amerikanët e mi të guximshëm, ne e kaluam testin.” Në rendin e ri botëror, korrekt - do të thotë të jesh amerikan, do të thotë të jesh i biri i Xhorxh Hëbërd Uokër dhe të quhesh Xhorxh Uokër.

Më vonë, kur të tjerët flinin, unë dhe Ina u ulëm në tavolinën e kuzhinës. Ishim të dehur dhe kaluam në temën – a janë të vërtetë peshkaqenët në filmin “Laguna e kaltër”, kur Bruk Shilld i ka thonjtë me maniky.

Vështrova jashtë. Prapa dritares nata po shtrihej deri tek malet, nga të cilat e kishin origjinën finlandezët. Ina tregonte se, kur ishte fëmijë, luante me një djalë fqinjë spiritizmin në një vendstrehim nga bombat dhe kishte ndier sikur diçka ose dikush i lëshoi frymë

të ftohtë në flokët e saj. Ina donte edhe tani ta provonte spiritizmin.

E ndjek Inën nëpër shkallë dhe dalim në oborrin e mbuluar me borë. Shikoj shpinën dhe prapanicën e saj joshëse. Ajo shkëlqen nga spiritizmi. Nata është e ftohtë, qielli i kthjellët, Gjithësia është nëntëmbëdhjetë vjeç. Në errësi të rruga e Qumështit është në një distancë që mund ta arrish me dorë...

Në sauna Ina ndezi një qiri dhe e fiku llambën. Temperatura kishte rënë, por prapë është ngrohtë. Dritaret janë djersitur. Ulemi mbi stolin prej mëshkteke dhe kapemi për dore. U morëm vesh që të shikonim qiririn dhe të fokusohemi tek flaka, fokusohemi tërësisht duke pritur të ndodhë diçka, që të marrim ndonjë shenjë, ndonjë sinjal. Qiriri digjet. Muret kërcasin. I ngul sytë flakës. Kujtoj një film mbi jetën e Krishtit, që e kisha parë.

Aparati projektues e rrotullonte shiritin më ngadalë pas çdo episodi, kuadrot nga kopshti Getsiman dhe Golgota projekttoheshin në një lëvizje gjiithnjë e më argëtuese, zëri i Shpëtimtarit tingëllonte si ai i Dart Vejdërit dhe, në fund, filmi u këput. Koha kalon, qiriri digjet. Sytë më djegin.

M'u kujtuan kapelat me eklipsin e diellit të verës së kaluar. Kujtova se si, pas mesnatës, unë dhe Ina u ngjitëm në shkëmbinjtë prapa shtëpisë së saj dhe, ndërkohë që në qiell luhej një dramë, ne fjetëm mbi myshk. Kujtova si u zgjova dhe mendova për kohën, kur ne nuk do të ishim më.

Qiriri digjet dhe që nga linja hekurudhore u dëgjua fishkëllima e trenit të parë. E ndiej se duhet të ngre sytë e të vështroj Inën. Nuk mund të përqendrohem. Përkulem përpara. Në stearinën e zverdhur të tejnxehur, është ngjitur një mizë, një mizë e zakonshme, e zgjuar nga nxehtësia e saunës, e cila mblidhet dhe, shumë shpejt, kthehet në diçka të zezë dhe më kujton kapelën me eklipsin e diellit.

Ina më vështron me sytë e saj të zinj dhe, sikur shikon një kohë tjetër, më përkëdhel me gisht dorën, më shikon në sy dhe unë e di, që kam ëndërruar për të sjellë ngrohtësi në fund të barkut të saj, si valë e ngrohtë, njësoj si, kur lëkundesh, por arrin të mos rrëzohesh.

Mendova për të, kur ngisnim së bashku biçikletën nëpër rrugët ranore të Itahariu ose duke pirë cigare në tarracë në shtëpinë e saj. Ul kokën dhe e afrojmë dorën e Inës tek buzët e mia, e puth dhe dridhem, sepse gjesti më duket si i huazuar nga filmat. Ina vjen rrotull tavolinës dhe ulet në prehrin tim. Vë pëllëmbën në qafën time, puthemi dhe ndiej sa aromë të mirë ka lëkura e fytyrës së saj, ndoshta nga kremi hidratues.

Gjuhën e ka të vogël, të butë, me kërshtëri dhe miqësisht studion dhëmbët e mi, gjuhët tona preken, ajo merr frymë thellë dhe fut pëllëmbën nën këmbët time, rrëshqet poshtë nëpër shpinën time dhe unë përkulem. “E lehtë është” – mendoj unë – “aq e lehtë, sa mund ta mbaj për shumë kohë”.

E ndiej që ka pak frikë, edhe unë gjithashtu. Edhe më parë kam pasur vajza që shtriheshin në dyshek me flokët e shprishur, me makijazh të prishur dhe këmbë të hapura, të zbërthyer dhe të huaja, ishin si të kripura dhe, fatmirësisht, në mëngjes zhdukeshin nga stacioni i autobusit për në lagjet e tjera.

Ina është e afërt për mua dhe e kuptoj frikën e saj. Në qepalla bombat me lazer bien mbi objektivat e duhura. Ina ngrihet, heq pantallonat dhe bikinin e saj, por lë çorapet me vija, mesin e ka të ngushtë, legenin të rrumbullakët, kofshët të gjata dhe të hijshme. Pasi zhvishem, e hedh tutje përmbi kokë bluzën e saj. Nuk mban sutjena. Gjinjtë e rrumbullakët, me thitha të errëta, i njoh nga frekuentimi i saunës dhe rrokullisja në borë, nga larjet tona në det natën. Shikoj qimet e turpshme që dalin anash nga rrobat e banjës të cilat ngrihen përpjetë, kur ajo rënkon dhe vështron organin tim të elektrizuar, i cili dridhet budallallëkshe. Ajo zgjat duart dhe kapet pas tij, e tërheq me gishtat e ngrohtë, mbyll sytë dhe, për një moment, duket sikur fle.

Nuk di çfarë të bëj, ndoshta duhet të heqë çorapet e leshit që të mos më kujtojë gjyshen, por ajo hap sytë, më ul ndenjor, mbërthehet në supet e mia dhe ulet tek unë me këmbë të hapura. Fytyrat tona preken. Organi im penetron brenda saj, ajo e shtrëngon fort dhe ngjshet pas meje. E mbaj frymën, derisa depërtoj plotësisht.

Ndoshta kjo duhet bërë shumë më ngadalë, e di që femrave u pëlqen t'i përkëdhelësh, t'u pëshpëritësh, t'i sjellësh në formë dhe të afrosh shumë, shumë para aktit. Dua që gjithçka të jetë mirë, por Ina shpërngohet pas meje dhe unë, tashmë, jam plotësisht dhe thellësisht brenda saj, në vaginën e saj të ngrohtë e të lagësht dhe kjo është një mrekulli, gati për të mos e besuar, nëse nuk do të ndodhte këtu dhe tani.

Ndërmjet vetullave të saj shfaqet një rrudhë e hollë. Ndoshta nga dhimbja e çastit. Ajo është shumë e bukur me atë shprehje në fytyrë. U mbusha me krenari dhe ndjeva që po bëja gjithçka si duhet. Ajo lëvizi legenin dhe organi im pothuajse doli jashtë, por ajo ndaloj tamam në kohë dhe u ul poshtë, ndërsa unë i vë duart në prapanicë dhe pa dashur, i prek anusin, por ajo nuk kundërshton, m'i hedh duart rreth qafës dhe mbërthehet fort tek unë si fëmijë, megjithëse ne tani nuk jemi fëmijë, përderisa mund të bëjmë gjëra të tilla.

Ndienim vetëm frymëmarrjet, unë kthej kokën dhe shikoj se si nga muri në errësirë shfaqen brirë të një dreri mashkull, mbi të cilat ishte hedhur një shami e bardhë.

Të tjerët nga grupi flenë në shtëpi, ndërsa ne të dy jemi në dhomëzën e vogël midis peizazhit dimëror. Ina lëviz gjithnjë e më shpejt, unë bërtas. E kuptoj se asaj i pëlqen lëvizja në legenët tanë, kërcitja e divanit, qiriri, muskujt tanë të tendosur. Ajo e shtrëngon më fort organin tim, tendoset, më kafshon lehtë faqen, e ndiej se shumë shpejt do të përfundojë, por nuk e bëj, sepse është akoma herët – bëjmë seks aq bukur. Jemi plotësisht të tendosur, kur për një çast – bllokohemi. E përfundova brenda saj, ajo ngre ballin nga supi im dhe pëshpërit diçka me zë të ngjirur.

Dëgjoj me sy të mbyllur. Ina ngrihet ngadalë. Penisi im i zbutur më përplasat pas barkut. Sperma ime rrjedh nga vagina e saj mbi testikuj e kofshët e mia dhe kjo gjë nuk më duket e shpifur. Ina shkon në banjë, ndërsa unë e kap organin tim dhe buzëqesh në errësirë. Ajo ndez dritën në banjë, mbush ujë në një kanë të vogël dhe kthehet tek unë.

Është akoma me çorape leshi, kaçurrelat e shpupurishur mbi fytyrë, i ngjan një kafshe të hijshme. Vjen në divan shtrëngohet pas meje, më zgjat kanën dhe më thotë: “A do të pish?” Pi ujin e ftohtë dhe ia kthej kanën. Ndërsa ajo pi, nën dritën e qiririt, sipër kofshëve të saj, shkëlqen sperma. Jashtë është akoma errësirë. Uji në kanë mbaron dhe ajo e vë atë në dysheme.

Ndihem mrekullisht, si për festë dhe më duket e rëndësishme që ta them këtë.

E kthej atë në shpinë. Në fillim kundërshtoi, por pastaj ngre këmbët i hap, e kap pas të ndenjurrave dhe e afroj buzët në vaginë. Dua që ajo ta përjetojë bukur. Kërkoj që në mëngjes që të tjerët të na shohin çfarë bëjmë ne. Ngre fytyrën dhe them: “Dua që ti të kënaqesh.” Vazhdoj dhe përfytyroj se si në mëngjes jam ulur në tavolinë me sy të ndritshëm duke mbajtur Inën në prehër, të tjerët shkojnë në kuzhinë dhe e kuptojnë çfarë kemi bërë ne. E ndiej në errësirë frymëmarrjen e saj, ngre kokën dhe i them. “Dua që ty të të pëlqejë.”

18

Në mars nga tavani i sallës sportive pikon ujë dhe rrjedh në kovat e vendosura për atë qëllim. Pas disa javësh pranvere, unë ndryshova fizikisht dhe, nga një djalosh, u ktheva në burrë me ndihmën e femrës që kisha pranë. Gjatë ditës përkulesha mbi librat shkollorë. Prisja ardhjen e mbrëmjes, kur mund të isha me Inën. Ndoshta vetëm në shtëpi. Prindërit ishin në punë. Vjeshtën e mëparshme motra ime u transferua.

Unë i preva lidhjet e vjetra dhe krijova të reja. Kur binte muzgu unë shkoja tek Ina. I ati, zakonisht na përgatiste darkë të lehtë, uleshim në dhomën e ndenjjes, bisedonim ose shikonin televizor.

Ionas, në një moment, hapi gojën, piu uiskin e tij të fundit, i uruam “natën e mirë” dhe u ngritëm në katin e dytë, në dhomën e Inës, e cila u zhvesh shpejt. Dhoma e saj ishte plot kujtime nga

fëmijëria. Nganjëherë ishte pasionale dhe e shqetësuar. Gojën e kishte të hapur. E ndieja sa më dëshironte. E ndjeva që është e mërzitur. Ndonjë ditë mund të kthehem dhe të shohim që dimri është kthyer. Mund të shikohesh në pasqyrë dhe të mos e njohësh veten.

Ditët dhe netët po rrokulliseshin. Më verbonte ardhja e pranverës. Organi im i ngritur i shihte sythet e pranverës nëpër pemë dhe rritjen e barit. Isha i tëri në pritjen për të qenë me të. Nuk ndieja cicërimin e zogjve të sapo çelur në fole. Mësova të ndiej fillimin e orgazmës së saj nga frymëmarrja e saj e çrregullt. Nganjëherë ndieja Ionasin që kollitej në katin e poshtëm. Ne ritmikisht kryenim marrëdhënie seksuale mbi kokën e tij. Me siguri ai na ndiente.

Në maj ndjeva njëfarë ndryshimi. Kalonim shumë kohë në krevat, nganjëherë gjithë ditën, duke e filluar e duke përfunduar orgazmat tona, prapë fillonim me orë të tëra, të hutuar e të palodhur. Duke penetruar brenda saj, vëreja në shikimin dhe buzëqeshjen e Inës një gëzim të pastër. Duke u ngritur nga krevati, midis nesh vendosej një qetësi shqetësuese. Sikur trupat tanë të dërmuar na e kthenin shpinën të turpëruar.

Atë ditë ishim bashkë në shtëpinë e saj. Ionas kishte shkuar me shërbim.

Rrinim shtrirë të përqaftuar në krevatin e ngushtë të Inës. Ajo rrinte sipër meje. Ndjeva si rridhte prej saj sperma ime dhe heshta. Ajo u ngrit, u fshi me çarçaf dhe ashtu, e zhveshur, zbriti në katin e poshtëm.

Edhe unë u ngrita, pa ditur se çfarë të bëja. Shkova tek tavolina e punës. Mbi të ishte një kalendar. E hapa. Shënime në të m'u dukën prekëse. Ato ishin për diçka që Ina nuk donte që dikush tjetër t'i dinte. Ishin sistematike dhe të frikshme. Midis faqesh gjeta dhe një letër nga i ati.

E dija që i shkruanin njëri-tjetrit, kur mungonte njëri. Nganjëherë ishin shënime të zakonshme të lëna në tavolinën e kuzhinës, nganjëherë përbëheshin prej disa fletësh. E shfletova kalendarin,

kur e pashë. Mbi një fletë me stilolaps ishte shkruar emri im i plotë. Një pjesë e tij, ishte rrethuar me një zemër. Sikur e kishte shkruar rastësisht, duke folur në telefon me ndonjë shoqe. E vështrova gjatë.

Ina u kthye me një tabakà, plot me sanduiçë, një kanë me lëng dhe gotat. U ul në krevat dhe më ofroi një sanduiç. E mora, por nuk e hëngra. Dielli i mbrëmjes ndriçonte dhomën, pasqyrohej në kanën, nga e cila Ina mbushte gotat me lëng. E shikoja derisa ngrinte gotën tek goja. I thashë se e dua. Zëri m' u drodh sikur kisha shqiptuar fjalë para një mikrofoni të dëmtuar. Ajo e la gotën, u gëlltit dhe ngriti gishtin para gojës, si gjest paralajmërues.

Prita të thoshte diçka. Ajo heshtte dhe më shikonte. Ma vuri dorën në sup, më tërhoqi dhe më bëri të shtrihem sipër saj. Akoma e mbaja sanduiçin në dorë. E hodha në dysheme. Ajo ishte e lagësht, tashmë gati. Depërtova në vaginën e saj. Fillova ta bëj aktin seksual shumë ashpër, duke kërkuar që të fshij kujtimin e pohimit, për të cilin isha penduar.

Rënkoja në heshtje. E shtrëngoja egërsisht. I dridheshin supet. Mbarova. Nën qepallat e saj të mbyllura rrodhën lot. Ajo më shikonte, përkundër lutjeve të mia. U shtrëngova pas saj dhe e përqafova fort. E puthja kokën e saj të djersitur me të gjithë ëmbëlsinë e mundshme. I vinte aromë gruaje, aromë e një vajze të rritur. E ndieja si dridhej poshtë meje.

Ishte e lehtë, ishte elementare. I pëshpëritja ngadalë fjalët më të bukura që kisha thënë ndonjëherë. Ajo heshtte. Ajo heshtëte. Dridhej me sytë e mbyllur, e mbytur në lot në krevat, në dhomën, në të cilën sendet e fëmijërisë ia rrethonin kokën dhe trupin.

U errësua, ra nata dhe Ina fjeti. Qëndroja shtrirë dhe vështroja fytyrën e saj, sytë e mbyllur. Në shtëpi ishte qetë. Jashtë gumëzhinte trafiku, një erë e lehtë frynte mbi parqet. Së shpejti do të fillonte vera. Mendova për Ionasin dhe për dhomën e hotelit. Nëse ai hante darkë vetëm. Ndoshta ulej para televizorit me gotën në dorë dhe bënte planin për ditën e nesërme. Ai ishte burrë, unë isha djalosh.

Ndihesha i lodhur, krenar dhe i papeshë. Ndoshta pjekuria ishte gjendja papeshë. Imagjinoja që jam rreth njëzet centimetra

mbi krevat. Imagjinoja të ngrihem në tavan, të kaloj përmes tij dhe trarëve. Ina flinte poshtë, nën qiellin e majit, e mbështjellë me batanije dhe merrte frymë qetë.

Dëshira e saj më bënte të papeshë, më ngrinte dhe më tregonte këmbësorët e ndriçuar nga fenerët e rrugës, shtëpitë dhe pemët e rrethuara me pelin. Nëpër rrugën “Kalevakatu” një makinë po shkonte drejt qendrës.

Muri i gurtë i varrezës së kolerës rrethonte atë, çka kishte mbaruar prej shumë vjetësh dhe, ndoshta, nuk kishte lënë as gjurmë. Dyert e depove në rajonin industrial ishin mbyllur, hekurat në oborret për mbetje metalike ishin zhdukur.

Në kancelerinë e stacionit dikush gjallërohej para një monitori, zgjidhte ca probleme dhe krijonte të tjera, ndërsa unë u ngrita dhe e dija që fletët në kalendar do të shfletoheshin, dielli dhe hëna do të vazhdonin rrugën e tyre, ne do të plakemi dhe do të ikim që këtej, por lumi do të mbetet, do të mbetet bota e sigurt e biznesit, të cilën e filluam, kur ishim të rinj dhe, tek e cila do të kthehemi duke pasur parasysh si filloi gjithçka.

19

Ina e la librin dhe vështroi manikyrin e ndritshëm në thonjtë e saj. E vështrova. Heshtëm. Helikopteri, gjithë kohën, gumëzhinte në qiell, i cili kishte filluar të errej. Ina tha:

-Pas dy javësh do të shkoj tek gjyshi. Folëm sot në telefon? Ai e ka nxjerrë telefonin fiks nga dritarja në kabinet jashtë dhe ulet aty në diell. Ishte i kënaqur.

-Nuk ka celular ai?

-Jo, nuk ka. Pastaj tha: “Lulëzimi i mollëve është me vonesë këtë pranverë.”

-Po ti si iu përgjigje?

-Nuk i thashë asgjë.

-Do rrish gjatë tek ai?

-Nuk e di. Një javë, dy, ndoshta më shumë.

-Folët për Ionasin?

-Jo.

-Duhej të kishit folur.

-Do të flas, kur të kem dëshirë.

Ina e kontrolloi çarçafin. Ishte vetëm me zarfe të zinj. Mbi krevat varej një llambadar me abazhur letre. Në errësirën e dhomës së gjumit lëkura i dukej ngjyrë kafe në sfond të krevatit.

-Duhet të rregulloj dritaren e prishur – tha ajo. Nuk është mirë për shtëpinë të ketë një xham të thyer. Pare kemi.

-Të kujtohet atë natë, në Itahariu? Kur po diskutonim me rastin e nisjes tënde për në Londër? Atëherë ti bëre një çadër me batanijen dhe jastëkët dhe ndeze brenda një llambë të kuqe.

-Po.

-Ti ishe shtrirë, më përkëdhelje me gisht lëkurën dhe më the, që jam sëmurë.

-I sëmurë? Tingëllon e trishtë.

-Ishim rreth nëntëmbëdhjetë.

-E pabesueshme.

-Atëherë ti, akoma, kishe nevojë për mua, Niklas.

-Dhe për pemën.

-Të flasim për diçka tjetër.

-Dikur ishte e lehtë.

-Hajde këtu.

-Hajde ti.

20

Po vinte një mbrëmje e ngrohtë.

Në parkingun e stacionit, autobusët ishin parkuar në radhë. Qielli zverdhonte dhe në sfondin e tij, fytyrat e kalimtarëve dukeshin të panatyrshme. Petri preu rrugën “Mariankatu” me

semafor të kuq. Prapa vitrinave të një restoranti indian një grua dhe një burrë kishin kishin vënë kokën mbi tavolinën e tyre. Ajri ishte i ndenjtur dhe binte erë gazrash të djegura dhe asfalt i nxehur.

“Me natën fillon edhe jeta e natës”. Mendoi me vete Petri. Kur vëmja e kuqe ra pranë tij në oborr, ai ndjeu veçanërisht, sikur u përmbys bota. Tani gjithçka ishte në rregull.

Bëri disa hapa dhe hyri në restorantin me më shumë dritë. Në njërën nga tavolinat ishin ulur tri vajza, të cilat po shkriheshin së qeshuri. Thërrisnin me zëra të dehur. Nga megafoni vinte një melodi lindore. Në mes të sallës ishte një shatërvan.

Baristi ishte zeshkan, me flokë të zinj, i veshur me këmishë të bardhë. Qëndronte me shpinë nga Petri. Tha diçka me zë të lartë, në një gjuhë të panjohur duke shkuar në kuzhinë. Duart i kishte të mbuluara me qime të zeza. Me siguri, në kuzhinë vërtiteshin bashkëkombësit e tij me lëkurë kafe dhe zë të lartë, madje mund të ishin bashkëfshatarët ose kushërinjtë e tij.

Petri u ul në bar dhe vështroi menynë e varur. Burri heshti, u kthye dhe i përshëndeti me dashamirësi. Petri porositi dhe ia nguli sytë fytyrës së tij. Syri i djathtë, në qepallën e shëmtuar vështroi pa rënë qerpik, ishte ngjyrë gri, pa iris. Kjo ia bënte fytyrën si me një anë. Me siguri burri kishte vuajtur në vitet e rinisë.

Baristi i uli sytë, shkroi porosinë dhe pyeti, nëse donte rigon ose hudhër.

-Çfarë? – pyeti Petri.

-Me rigon, apo me hudhër? – burri u përpoq të fliste më qartë.

-Më falni për finlandishten time të keqe – tha Petri dhe vuri gishtin tek qepalla e tij e djathtë.

Baristi ndryshoi qëndrimin, ngriti kokën dhe e vështroi. Petri fshihi ngadalë qepallën me pjesën e sipërme të gishtit.

-Aa, hudhër, po-o.

Burri shkruan, shtyp kasën dhe i thotë çmimin. Petri nxjerr portofolin dhe i zgjat një kartëmonedhë. Me një lëvizje të shpejtë, baristi i kthen kusurin. Petri e merr e falënderon dhe e çon kanën me ujë në një tavolinë tjetër. Ulet dhe vështroi nga rruga.

Atje qeshnin. Nata do të ishte e gjatë. Në mëngjes shumë vetë do të vuanin nga dhimbja e kohës.

Në tavolinën ngjitur, vajzat ia plasën të qeshurit përsëri. “Sa të mbarojë kjo verë, do të alkoolizohem” – tha njëra prej tyre. “Jo” – ia ktheu tjetra, rregulloi vathin e saj dhe vështroi Petrin. Kishin moshën e Suvit. Vajza, të cilat e kanë jetën përpara.

Në restorant hynë akoma njerëz. Ai me një sy, i solli picën. Vajzat dolën. Petri hëngri dhe shkoi në bar, për ta falënderuar. Baristi përshëndeti me kokë duke vështuar përtej tij dhe sigurisht duke soditur natën mbi rrafshinën ranore më shumë se pesëqindvjeçare

Para derës së jashtme, Petri mbylli një sy dhe doli jashtë në rrugë.

Ndërkohë që ecte, mendonte çfarë do të mbetej pas tij, çfarë do të mbetet nga burri zeshkan. Në çdo qytet kishe vende, ku të prisnin surpriza.

E hapi syrin. Teksa po hante, qielli ishte vrenjtur. Tiparet e njerëzve e kishin humbur mprehtësinë dhe boja e makinave shkëlqente.

Lumi ishte errësuar si çdo mbrëmje. Si çdo mbrëmje të rinjtë në brigjet e tij, zbaviteshin.

Në urë afër katedrales, një djalë me një krehje të çuditshme xhonglonte me birila. Shokët e tij ishin ulur me shishe në dorë dhe vështronin nga lumi. Petri u ndal, nxori telefonin nga xhepi dhe pa orën.

Mendoi se Sejlllo i madh, i parruar, tashmë, është në pabin “Helmetat” me gotën në dorë dhe lëshon tym mbi tavolinë, drejt e në fytyrat e të tjerëve, të cilët e dëgjojnë me vëmendje. Përreth tij, ajri është i kaltër prej tymit të duhanit. Duke tundur dorën me cigare, ai flet i përkulur përpara. Në mur, pas shpatullave të tij të gjera, shkëlqejnë drapri, kosa, sëpata dhe dy duaj të zverdhur thekre. Sejlllo është në qendër të vëmendjes dhe është i sigurt, se të tjerët e dëgjojnë.

-Ti, djalë, ke premisa, megjithëse akoma nuk je i vetëdijshtëm

për to” – i tha atij një mbrëmje, ndërsa po e përcillte në shtëpi pas mbylljes së pab-it. Petrit iu bë qejfi, megjithëse Sejlllo fliste me kokën e rënduar nga pija. Nën yje kjo tingëlloi si premtim dhe ai mori guximin t’i tregonte për Suvin, çfarë kishte bërë dhe, në fund, i tregoi edhe për mashkullin tjetër në jetën e saj, i cili ishte doktor, ose, të paktën, paraqitej si i tillë.

Në fillim, Sejlllo nuk foli, vështroi nga fabrika e birrës, pastaj i rrahu shpatullat: “Zbulo Amerikën Petri. Mos u mërzit. Femrat vijnë e ikin si zogjtë e lirë.” Petrit nuk i pëlqente të shikonte mëngjesin që zbardhte mbi Sejllon, por atëherë, në bregun e lumit të qetë mendoj, se një pjesë e tij e pëlqen Sejllon. E dinte që Sejlllo, në të vërtetë, nuk mendon kështu. Ai i kishte kaluar të pesëdhjetat e, megjithatë, e respektonte Petrin dhe kishte parë prirje tek ai, të cilat as vetë Petri nuk i kishte vënë ré.

E futi telefonin përsëri në xhep. Duhej të shkonte në pijetore më vonë. U nis nëpër rrugën “Multavierukatu” për tek shtëpia e Suvit. Dritaret e saj ndriçonin lehtë dhe, nga kjo pamje, ai u drodh. Ai e kishte parë Suvin në këtë dritë. Me këtë dritë ajo e kishte zhveshur duke e urdhëruar që ta shikonte në sy, por tani lëkura e tij ishte krejtësisht e pandjeshme.

Ai rrinte mbi trungun e pemës së prerë, kur orë më vonë, drita në shtyllë të ndizej. U ngrit, shkoi në fund të oborrit, u fut pas një shkurreje me lule të ndritshme dhe u mori erë.

Prapa portës së hyrjes u shfaq një burrë, e hapi dhe doli jashtë.

Ndaloi dhe ndezi cigaren. Në dritën e flakës së çakmakut, Petri u përpoq ta shikonte. Ishte zeshkan. Burri nga fotografia ishte me bluzë të bardhë dhe me maskë. Në tarracë ishte i zhveshur deri në mes. Tani kishte pantallona xhinse dhe me këmishë të zezë me mëngë të përveshura. Në kohën e lirë mjekët pinë cigare. Puna e tyre është stresuese. Mbajnë përgjegjësi për shëndetin e njerëzve.

Burri e futi çakmakun në xhep. Zjarri i cigares herë ndriçonte, herë humbiste, ndërkohë që ai kalonte nëpër oborr. Petri doli në rrugë dhe u nis pas tij. Ecte i nevrikosur. Radhë mund të ndodhë që një burrë i kënaqur të ecë në atë mënyrë. Ndoshta s’kishte arritur

asgjë. Ndoshta Suvi e kishte shtyrë nga vetja duke i thënë: “Seksi me ty është si lojë symbyllazi”. Ose mund të ketë ndodhur diçka e papritur. Ndoshta Suvi ishte shtrirë, nuk mbushej me frymë, notonte në djersë, në errësirën e dhomës dhe përpiquej të shtrinte këmbën e saj të fryrë.

Në rrugën “Kutomokatu”, një iriq kaloi trotuarin dhe u fut me nxitim në barin e rritur. Burri ndaloi për të parë kafshën e vogël, e hoqi cigaren nga goja dhe e hodhi në rrugë. Ndoshta natyra e natës e kishte magjepsur burrin, duart e të cilit mbanin akoma aromën e Suvit. Burri mori rrugën përsëri, kapërceu një kodërz të pjerrët dhe u kthye tek pallatet. Aty afër një grua shiste mallrat e veta nga bagazhi i një pikapi fermerësh. Nga radio e pikapit dëgjohej muzikë e qetë.

Petri priti që të largohej i panjohuri dhe u nis nëpër rrugën “Helsinkikatu”, e cila ndriçohej nga një llambë e verdhë. Rruga ishte e zbrazët. Petri mori drejtimin për tek linja hekurudhore. Vuri ré që edhe ai burri, nja njëqind metra para tij, ishte drejtuar andej. Pas pak e humbi nga sytë.

Petri ndaloi dhe po lëkundej – të kthehej mbrapsht dhe të shkonte në pijetore të takonte Sejllon. Burri ecte nëpër urën mbi hekurudhë. Vështronte prapa dhe fliste në telefon.

Petri zbriti nga ura ndjeu erën e tokës me pluhur dhe të urinës. Që nga kampusi i universitetit derdheshin tingujt e lëvizjes së mjeteve të transportit. Qielli ishte i kthjellët. Ajri ishte i ngrohtë dhe i palëvizshëm. Mbi lumë vareshin degët e pemëve të larta. Burri i veshur me këmishë të zezë arriti deri mesin e urës. E ndërpreu bisedën në telefon dhe zbriti nga ura.

Dy biçikletistë i bërtisnin njëri-tjetrit, teksa kalonin nëpër rrugën me çakëll, drejt qendrës së qytetit. “Ndoshta do ta takosh sonte” – bërtiste ai që ngiste biçikletën i pari? “Ose një herë tjetër” iu kthye i dyti.

Petri, me hapa të lehtë, arriti në fund të urës dhe doli në rrugë. Tashmë, ai burri nuk dukej më. Mendoi se, ndoshta, është kthyer nga rruga dhe është fshehur në hijen e pemës. Ndoshta edhe tani

po e shikonte, vlerësonte lëvizjet e trupi të tij dhe mundësitë e veta.

Pas pak, Petri e pa – qëndronte nja dhjetë metra përpara, në hijen e pemës, me shpinë prej tij. Merrte frymë rëndë, lëvizte gishtat dhe rrotullonte kokën si boksier. Hapi njërin krah anash, ndaloi, thirri, u përkul përpara dhe e shqelmoi gardhin. Lëvizja ishte e matur, burrë i shkathët dhe i fortë. Njëra nga dërrasat e gardhit u thye me zhurmë. Burri mbeti në një pozë të çuditshme me një këmbë të ngritur, duke mbajtur ekuilibrin me tjetrën. Petri u përkul mori një gur të madh sa grushti. Burri kërcëu në një këmbë, tjetra vazhdonte të mbetej e shtrirë përpara, shau dhe, pastaj, filloi të qeshte.

Petri e kuptoi. Këmba më të cilën ai theu dërrasën, kishte mbetur në vrimë dhe këpuca, gjithashtu, i kishte ngecur ndërmjet dërrasave.

Në errësirën nën urë, Petri qeshi. Deshi të shkonte tek ai, por u kujtua për Suvin dhe ndjeu se diçka kishte ndodhur. Shikonte shpatullat dhe pjesën e prapme të burrit, të cilit nuk ia dinte as emrin. Iu kujtua si e kishte shpuar kurrizin e vemjes dhe tingullin e ngjashëm me shtypjen e kokrrës së rrushit. U kujtua që mbante akoma në dorë gurin.

21

-Afrohu edhe pak – i tha Ina.

-Afrohu ti.

Ina u shtrëngua pas Niklasit dhe i preku faqen. Ai filloi t'i fliste për artikullin e shkruar një ditë më parë. Ajo vështronte përmes dritares qiellin e kuqërremë dhe iu kujtuan fjalët e babait për lulëzimin e mollëve.

Ishte ora dhjetë pa një çerek. Ina mendoi se në vapë, gjyshi flinte në katin e poshtëm. Në shtëpi mbretëronte qetësia. Në muzgun e mbrëmjes enët e ditës dhe anët e praruara të librave

shkëlqenin. Panja e lartë sa shtëpia bënte hije mbi dritaret veriore. Pranë lavamanit, në banjë, ishte një gotë uji, në të cilën gjyshi kishte futur protezat. Kur ishte e vogël, kishte frikë nga ajo gotë. Gjyshi i dukej i pasigurt, sepse natën ndahej në pjesë.

Duke menduar për të, Inës iu kujtua peizazhi përreth fshatit të tij, brigjet e larta të lumit, kodrat, kallamishtja në breg të liqenit, stacioni, ku gjyshi kishte puthur për herë të parë gjyshen. Për shumë vite kishte luajtur atje me kushërinjtë, kujtimet për ta ishin të gjalla.

Ina mendonte për faktin se, tani, koha e kaluar tek gjyshi, ishte e pakëndshme, madje e shpifur. Nuk e kuptonte përse.

Ajo u kthye në kurriz dhe dëgjonte. Dëgjoi një kërcitje dhe një burrë që thirri. Ajo vështrroi Niklasin. Edhe ai i kishte dëgjuar. U kthye dhe vështronte në tavan.

Rrinin shtrirë në qetësi dhe dëgjonin.

-Epo si mund ta bëjnë në këtë pikë vape – tha Ina.

Niklas ia mori dorën dhe e përkëdheli. Ajo dëgjonte britmat e çiftit lart dhe mendonte për gotën e ujit me protezat. Mendonte për trupin e Niklasit. Kishin kaluar së bashku mjaft vite të bukura. Ajo e kishte ndier zgjimin e atij trupi së bashku me trupin e vet. Ndonjëherë mendonte se kishte mbështetur të gjitha shpresat tek Niklas, por, tashmë, nuk ishte kështu.

-Më prek – tha Ina.

Niklas u kthye nga ajo dhe i përkëdheli gjinjtë. Qeshte, por dukej i mërzhitur. Mbylli sytë dhe mendoi për zgjimin me shpresën që shprehja e fytyrës së Niklasit do të ndryshojë.

Ia kapu duart dhe i shtrëngoi fort pas vetes. I hapi sytë. Ia hoqi mbathjet. Preku organin e tij të ngrohtë. Ai kalonte shpejt në ereksion.

Niklas penetroi këndshëm brenda saj, Ina u qetësua dhe e ndjeu veten në ujrat e veta. Ai e puthte, bënte dashuri me të ngadalë dhe ajo i mbylli sytë.

Dhe gjithçka ishte në rregull, derisa u kujtua për gjyshin, pastaj për babain.

Ndjesitë e rënda e kapluan dhe shkatërruan gjithçka.

Hapi sytë dhe e zuri nga shpatullat.

-Më merret fryma.

E largoi nga vetja. Ai lëvizi dhe organi i tij doli jashtë. U ul mbi kofshën e saj. I shtypi me dorë gjoksin, mushkëritë u zbrazën. E bëri disa herë me lutjen e saj. Nën dritën e llambës së natës e vështroi në sy dhe u përpoq, pa sukses, të mbushte mushkëritë. Kur, më në fund, ai e ngriti dorën ajo thithi ajër, nga trupi i doli një britmë, pastaj ia dha të qarit. E njëjti trup që donte të ishte i hapur për Niklasin. Ai qëndronte shtrirë mbi të dhe i përkëdhelte fytyrën.

Mori frymë thellë. U kap pas flokëve të tij. Duke iu marrë fryma i tha me zë të lartë:

-Jepi, ma bëj. Dua të ma bësh fort, fort.

-Duhet të bëj dush – u kthye Niklas.

Ai u ngrit dhe doli nga dhoma, ndërsa ajo rrinte shtrirë me sytë në tavan. Në katin më sipër bërtisnin të dy njëkohësisht. Pastaj ra qetësia.

Kur ndjeu që u hap dera e banjës, ajo mori librin dhe bënte sikur lexonte. Niklas hyri në dhomë dhe hapi derën e garderobës. Filloi të vishet. Ina nuk e shikonte. Ai i tha se do të shëtiste pak dhe e pyeti, nëse gjithçka ishte në rregull.

-Po, po. Mos bëj zhurmë, kur të kthehesh.

Ai i tha se nuk do të vonohej, e puthi dhe doli me flokë të lagura. Ajo ndjeu zëra në korridor. U dëgjua zhurma e çelësave. Dera e jashtme u mbyll.

Hapat e tij po largoheshin nëpër shkallë.

Jashtë ishte errësirë. Fiku dritat e dhomës, të parin – abazhurin e Niklasit, pastaj të vetin.

Rrinte shtrirë në errësirë. Donte të qetësohej, para se të përqendrohej.

Donte ta riprodhonte atë që kishte menduar më parë. Ishte një vizion i qartë me elemente hakmarrjeje.

Të dy me Niklasin ishin në aeroport dhe ishin ulur vetëm në

një stol të gjatë. I ndriçonte drita që vinte nga dritaret e mëdha. Jashtë uleshin dhe ngriheshin avionët. Pasagjerët kalonin me nxitim pranë tyre, ndërsa ata të dy rrinin në heshtje.

Kishte arritur një moment i vështirë ftohjeje në marrëdhënien e tyre. Përballë tyre ishte një burrë i veshur me kostum të zi, i cili ishte ulur pranë Inës. Ajo nuk ia pà mirë fytyrën. E dinte që i sapoardhuri ishte më i madh në moshë dhe, sigurisht, më me përvojë se ata. Pa u kushtuar vëmendje atyre, ai hapi çantën dhe nxori ca dokumente. Jashtë uleshin dhe ngriheshin avionët. Ina dhe Niklas heshtnin. Niklas ia kapi dorën Inës dhe e shtrëngoi. Burri e vuri ré.

E mbylli çantën dhe u ngrit.

-Ngrihu – i tha ai Inës.

Ajo e vështroi, por nuk ia dalloi fytyrën. Burri bëri me dorë një gjest urdhërues. Ajo e hoqi dorën nga ajo e Niklasit dhe drejtoi trupin. Burri i tregoi drejtimin nga do të shkonte. Ajo u nis andej, teksa Niklas vështronte atë nga pas. Burri e ndiqte në një distancë fare të afërt.

Ina vazhdoi të ecte përmes turmës në drejtimin e treguar. I dukej se njerëzit që vinin përballë e shikojnë në fytyrë se ku po shkonte ajo. Më në fund arritën tek një derë xhami. Se nga e dinte që ajo është dera e kërkuar. E hapi dhe u fut brenda. Dhoma ishte e vogël dhe brenda s'kishte njeri. Pranë mureve ishin vendosur tavolina ngjyrë blu. Burri e ndoqi, afroi derën dhe e mbylli me çelës. Ina ndaloi në mes të dhomës.

Burri qëndroi pas saj. Ajo ia ndiente frymëmarrjen. Merrte frymë thellë dhe në mënyrë të rregullt.

-Vajzë. Grua – i tha ai.

E urdhëroi të hiqte mbathjet. Ajo ngriti fundin, i hoqi dhe i la të bien në dysheme. Ai e urdhëroi të hiqte në karrige e të ulej në gjunjë me fytyrën nga mbështetësja dhe të ngrinte fundin. Ajo iu bind. Burri e urdhëroi të përkëdhelej. Ia plotësoi edhe këtë dëshirë.

Pastaj ndjeu se ai zbrërtheu rripin e vet dhe ajo disi e dinte se nuk duhej ta prekte. Qëndronte pas saj dhe e shikonte. Filloi të

fliste. I tha gjëra të shëmtuara dhe fyese për Niklasin dhe për çka do t'i ndodhte atij. Ajo deshi ta mbronte Niklasin, por nuk guxoi ta ndërpriste. Burri thoshte gjëra të shëmtuara dhe fyese për Inën dhe për çka do t'i ndodhte asaj.

Pastaj ajo dëgjoi që dikush trokiti në derë dhe i ra me shqelma.

Burri heshti. Merrte frymë me ndërprerje, Ina e ndjeu se ai kishte mbaruar. Merret frymë rëndë, ndërkohë që ngrinte mbathjet dhe mbërthente rripin. Pastaj mori mbathjet e saj nga dyshemeja dhe fshiu duart. I hodhi në dysheme dhe e urdhëroi Inën të ndalonte. Ajo zbriti nga karrigia, pa e vështruar, u përkul, mori mbathjet nga dyshemeja dhe fshiu me to spermën në dysheme. Ajo ishte e ftohtë. Atëherë burri i vuri dorën në faqe – dorën e kishte të ngrohtë.

Kur u ngrit Ina, tek dera e hapur qëndronte Niklas dhe e vështronte. Ajo e shmangu shikimin e tij, ndërsa vishte mbathjet e saj të ndotura me spermë.

Orgazma ishte e qetë. U mbulua me batanije, megjithëse ishte ngrohtë. Nuk dinte ç'të bënte tjetër, nuk dinte ç'mund të bënte tjetër as Niklas. U kthye anash dhe shtrëngoi duart pas trupit.

Turku, 2. 4. 1990

E dashur Ina,

Mund të të them një gjë: në tregti dhe në jetë lidhjet janë gjithçka, derisa, papritur, humbasin rëndësinë e tyre. Kam pasur një mars tmerrësisht të vështirë. Të kam treguar për problemet me ata nga Goteborgu dhe atëherë ishte vetëm fillimi. Gjithçka u mpleks në një nyje. Për herë të parë më duket se e kam humbur kohën kot. Nuk dua dhe nuk mundem të vazhdoj kështu.

Po shkruaj shkurt. Kam temperaturë dhe po ha portokalle. Faleminderit për fotot. I kam parë disa herë. Më pëlqen më shumë ajo, ku ti ke dalë mbi murin e oazit. Dukesh më e rritur dhe pas teje duket lumi, toka djerrë dhe ndërtesat e larta në bregun tjetër.

Kur e pashë për herë të parë, u emocionova – ti dukesh si e madhe. Nuk e di kush të ka fotografuar, por duket qartë që ti je në

gjendje të mirë shpirtërore.

Të përqafoj. Pres të të takoj së shpejti. Bëji të fala familjes tënde të atjeshme. Ka shumë kohë që jam vetëm, prandaj fjala “familje” më ngroh shpirtin.

Qofsh mirë, kij kujdes për veten.

Babai.

PS. Për ditëlindjen time (nuk të qortoj që e ke harruar) Ula më dërgoi një libër të çuditshëm, të cilin u përpoqa ta lexoja. Zgjedhje e çuditshme, por Ula është Ula. Titullin e ka “Kozmosi” nga Gunar Bjorling. E lexova, në fillim nuk më pëlqeu, sepse më dukej i papërfunduar, i paplotë. Pas leximit të dytë mendova për ty. Ndoshta ngaqë e mora librin në të njëjtën kohë me fotografitë e tua.

Po të dërgoj disa vargje.

Ky pikëllim që je gjallë

Ky pikëllim që je i ri

Ky pikëllim që je gjallë

Ky pikëllim që është i pikëlluar

Ashtu si dhe lumturia.

22

-Si mund ta bëjnë në këtë vapë.

Isha shtrirë pranë Inës. Dëgjonim britma nga kati i sipërm dhe kërcitjen e krevatit. Gruaja ulërinte si hienë. Burri hungëronte, sikur jepte komanda ushtarake : Aa – haha... oo – hooo... uu – haa. Ritmi u shtua. Jepi – më fort– jepi – më thellë. Nuk e dinte që dikush mund të bënte seks aq shpejt. I ngjante goditjes së një qukapiku. Ajo duhej të ishte jashtëzakonisht e fortë. Ndoshta ishte dashuri e madhe.

Duke i dëgjuar u bëra melankolik, si një artist që nuk e njeh asnjëri në festë. Kapa dorën e Inës. Ia putha gishtat. I vinte era sapun dhe krem duarsh.

M'u kujtua zakoni i Inës për të bërtitur, kur bënim dashuri.

Jeta është tregim për shurdhëri. Britmat ndaluan. Në një mbrëmje dimri, dy pleq shëtisnin me kokë ulur dhe ndienin mall për këngët e bulkthave. Për kohën, kur trumcakët cicëronin nëpër pemë. Mbështeteshin pas njëri-tjetrit në heshtje, duke kaluar nën mështeknat. Qetësi.

Përkëdhelja gishtat e Inës. M'u kujtuan boritë e makinave gjatë natës. Në vitin 90-të ato ulërinin, ndërsa qëndroja në errësirë kokulur, me cigaren në dorë, para dritares së vogël dhe ndieja se qenësia fshihet – e vërteta tepër e hidhur – magji me forcë të tmerrshme. Pas progresit tonë teknik, gjatë vitit 2000, shkollat dhe parkingjet, tashmë, kishin rënë në qetësi. Më kishte marrë malli për boritë e makinave.

-Prekmë – pëshpërit Ina.

Ajo heq mbathjet dhe i lëshon në dysheme. Zhurma nga kati i sipërm shtohet. Vështroja gjinjtë e Inës. I kishte të bukur e të hijshëm. Vulva e saj ishte e lëmuar.

Zgjata dorën dhe i përkëdhela gjinjtë. Ajo mbylli sytë dhe përkuli qafën.

Buzëqeshte. “Kasetofoni dhe boria e makinës” – mendova unë.

Ina m'i kapi duart dhe i vuri mbi gjinjtë e saj. Hapi sytë dhe m'i hoqi mbathjet. E kapi organin tim dhe filloi të masturbonte shpejt me të. U hodha mbi të. Ajo e futi vetë organin tim në vaginën e saj. Penetrova. E pata më të lehtë, sepse ishte e lagësht. E përqafova dhe e putha. Buzët iu hapën. Ndjeva gjuhën dhe dhëmbët e saj. Bëra dashuri ngadalë dhe ndieja frymëmarrjen e saj. Shpatullat iu tendosën. Ajo i hapi sytë. Më shtyu.

-Mezi po marr frymë – pëshpëriti ajo dhe e kuptova se, prapë, po përsëritej kriza.

U ngrita. Vura pëllëmbët mbi gjoksin e saj dhe fillova ta shtyp ngadalë dhe fort, që t'i zbrazeshin mushkëritë. Ishte bërë si një ritual. Ajo luftonte që të mbushte mushkëritë. Vazhdova ta shtyp. Pastaj i hoqa duart dhe i mbushi mushkëritë me ajër. Ndjeva

njëfarë ftohjeje. Fytyra iu shëmtua. Trupi iu ngurtësua. Ajo bërtiti. E këqyra në fytyrë. Kurrë më parë nuk e kisha parë në këtë gjendje. Kurrë më parë s'kisha provuar një ndjesi të tillë.

Ina filloi të qante. E shtrëngova pas vetes dhe e përkëdhela. E kishte të lagur nga lotët. Kërceva mbi të. Ajo lëvizi vithet. Dridhej. Ishte si e ndarë në tri qeveri. Koka qante, vagina e saj më donte brenda, ndërsa krahët të hapur. Pjesët u bashkuan në frikë dhe trishtim.

Pushoi së qari dhe mori frymë thellë. Në katin e sipërm bënin seks. Ina më zuri për flokësh.

-Ma bëj fort. Ma fut thellë – përsëriste ajo me një zë të pandjeshëm, sikur më urrente.

-Më duhet të bëj dush.

U ngrita, pa e vështruar. U vështa. Dola nga dhoma. Papritur më pushtoi zemërimi. Ecja nëpër korridorin e errët dhe mendova që burri ka të drejtë të marrë kënaqësi nga gra të gëzuara. Trishtimi nuk është ngjitës, megjithëse shkakton probleme nga më të ndryshmet.

Ndalova. Pashë veten në pasqyrë.

M'u kujtua një fjali që kam lexuar në faqen e internetit Plejboj: “Respektojmë si bukurinë e gruas shtëpiake, ashtu dhe të asaj biznesmene.” E thënë shumë bukur. Mbylla sytë. U përqendrova në atë fjali si myslimani në Kuran.

“Respektojmë si bukurinë e gruas shtëpiake, ashtu dhe të asaj biznesmene”.

Hyra në banjë dhe ndera dritën. Mbylla derën.

Rafti i banjës ishte plot me sende kozmetike. Vazo të vogla të bukura, shishe me manikyr për thonjtë, krehra, spirale, gërsërë, pambuk, locione pastruese për fytyrën, kremra për duart, këmbët etj. Shikoja atë bollëk kozmetike dhe fillova të ndihem burrë përsëri. Në banjën time kishte vetëm furçë dhëmbësh, deodorant, shkumë rroje, llak për flokët dhe dy shishe kolonje. E qartë dhe e thjeshtë.

Jeta i kishte bërë reagimet e mia elementare si të qenit të

Pavllovit. Disa burra e shikojnë misterin e gruas në pikurat, të tjerët në figurat prej balte që nga kultura parakolombiane, disa të tjerë në reklamën e ndërresave të brendshme me Keli Minogin në videon “Agjenti provokator” mbi kurrizin e demit artistik të Rodeos. Për mua femra e zbukuruar është pamje e shenjtë.

I lava dhëmbët dhe kujtova mbrëmjet e lumtura, kur rrija me gotën e verës në dorë, duke marrë erën e manikyrit, duke vëzhguar se si, me ndihmën e kozmetikës, ndërtohet një e tërë, femra e gëzuar, e cila, teksa zbukurohet, flet me zë të butë, e përqendruar, e vetëkënaqur, në fund shtrëngon buzët, kthehet dhe pyet: “E?”

Mashkulli i gëzuar dëshiron të jetë i paanshëm, indiferent. Rruga duhet të humbasë në errësi. Gruaja që zbukurohet me pamje të rëndë më copëton zemrën. Sipas meje, çdo mashkull ka të drejtë të grabisë e të vrasë për t’i siguruar femrës së vet kozmetikën e domosdoshme.

Hapa rubinetin e çezmës. U zhvesha. Lava fytyrën. Vura shkumën e rrojës. U rrova. Lava briskun dhe fytyrën. Vështrova sytë e mi. Pas meje rriteshin lule manushaqe. Muret ishin ngjyrë gri të errët. Hyra në kabinën e dushit dhe rregullova ujin që të jetë i freskët.

Në nëntor, kur u vendosëm tek Ionas, pamja e banjës më ngjallte pështirosje. Nuk e di përse. Ndoshta, sepse luksi i saj binte në kundërshtim me natyrën e tij. Asgjë tek ai nuk e presupozonte këtë. Me sa isha në dijeni, gjatë njëzet vjetëve të fundit, ai kishte jetuar pa lidhje të qëndrueshme me femra dhe ishte dhënë pas punës. Ishte njeri i qetë dhe miqësor, me të cilin mund të komunikojë lehtësisht. Ai më njihte, qëkur isha shtatëmbëdhjetë vjeç, kishte parë burrërimin tim, nëse është kjo fjala e përshtatshme dhe gjithmonë e kam ndier që i pëlqej, megjithëse nuk e dija arsyen. Unë e doja atë.

Ionas e riparoi banjën pasi doli në pension dhe e kuptoi, që është i sëmurë nga kanceri i testikujve. Këtë fakt e mori me qetësi. Thoshte që ai lloj kanceri është karakteristik për djemtë dhe për burrat e rinj. E operuan. Po çfarë mendonte? Ndoshta, në fshehtësi,

kënaqej me banjën e tij. Po përse?

E freskova ujin akoma.

Në shtator të vitit 2002 Ionas kishte parë në televizor një reportazh për zgjedhjet parlamentare në Suedi. Ishte një mbrëmje me shi. Ishte vetëm në apartament. Më vonë më tregoi se atë mbrëmje ai ndjeu marramendje dhe u përkeqësua.

Ndezi një cigare kanabisi dhe hëngri një pjatë me lajthi. Shikonte gëzimin e Joran Personit, pas fitores së tij dhe pa që, nga diku u shfaq një dorë e ia mbuloi fytyrën.

Mendoi se ishte dora e vet dhe vështroi duart. Prapë i hodhi sytë tek ekrani – dora ishte aty, e palëvizur dhe pas saj, dilte fytyra e Personit, e cila u mjegullua dhe iu duk e panjohur.

Ionasit iu errësua shikimi. U përpoq të ngrihet, por sikur e goditi diçka. Gjymtyrët i ngrinë dhe i oshinin veshët. Erdhi në vete ngadalë mbi qilim para divanit. Jashtë vesonte shi. Buza e poshtme i dhembte shumë. Arriti të ngrihej dhe mbi tapicerinë e ndritshme të divanit pa njolla gjaku, gjithashtu edhe në peshqir.

Ora e murit tregonte pothuaj njëmbëdhjetë. Doli në korridor dhe u pa në pasqyrë. Qëndroi gjatë ashtu. Kishte kafshuar buzën e poshtme. Nga cepi i majtë i buzës zgjatej gjaku i ngrirë, që kishte rrjedhur nëpër qafë mbi jakën dhe në gjoksin e tij. Në banjë u la dhe u vesh. U kthye në dhomën e ndenjjes dhe u ul në divan. Binte shi dhe përplasej në xhamat e dritares. Televizori ishte i fikur. Në ekranin e tij pasqyrohej një burrë lakuriq, shumë i kërrusur. Telekomanda ishte mbi tavolinën e vogël para divanit. Ai nuk ishte i sigurt; nëse e kishte fikur televizorin para krizës apo më pas, por s'kishte kuptim të mendonte tani për këtë.

E bëra ujin të ftohtë.

U fshiva dhe e lidha peshqirin rreth mesit. Hapa derën e banjës. Në korridor u ndala dhe pashë veten në pasqyrë. Pak më parë u

pashë dhe e kuptova.

Në dhomën e gjumit Ina lexonte. Çifti nga kati i sipërm ishin të dërmuar nga orgazmat e tyre. Nën dritën e llambës së natës, flokët e Inës, kishin një shkëlqim metalik. Vesha pantallonat dhe zgjodha një këmishë të zezë, i përvështa mëngët. Mora telefonin nga komodina.

-Po dal shëtitje. Gjithçka në rregull?

Ina e hoqi librin dhe më vështroi.

-Mirë. Mos bëj zhurmë, kur të kthehesh.

-Nuk do të vonohem.

E putha dhe e vështrova në sy. Tashmë, isha bërë vonë. Përse? Mbatha këpucët në korridor. Nga tavolina e telefonit mora kartën e kreditit, cigaret, çelësat dhe hapa derën e jashtme.

Jashtë muret rrezatonin ngrohtësi. Nata e korrikut e mjegullonte peizazhin. Shkurret kishin çelur. Në lëndinë dukej trangu i pemës së prerë që ngjante si një zhguall i madh.

Ndeza cigaren dhe mendoja për ditën e kaluar. Dielli. Vapë në zyrë.

I-mail-et e nazistëve. Artikulli për doktorin amerikan. Vajzat në breg të lumit. Karrige pune. Hapermas. Fjalët e Korpinenit për djalin e vdekur të Sadamit. Siria. Dalja ime nga shtëpia. Vemja. Gozhda. Frika e Inës dhe dritarja e thyer. Pompa e biçikletës. Masazhi që i bëra Inës në kohën e krizës dhe si qante ajo. Të qarët e saj. Dita mund të vendoset mbi një kartolinë postare. Dhe vazhdimi - tani është natë dhe unë dola nga shtëpia.

Kapërceva oborrin dhe dola në rrugë. Në fytyrë ndieja ajrin e ngrohtë. Ishte e këndshme të shëtisja nën llambat e rrugës në orët e vona të ditës.

Një iriq, përmes trotuarit, nxitonte të futej në barin e anës së rrugës. Ndalova. Turiri i zi merrte frymë dhe lëvizte. Kafshëza më ndjeu dhe u kruspullos si lëmsh. Donte të fshihej nga vështrimi im. Dridhej. Pa dyshim, kishte frikë se mos doja ta kapja. A mos ishte ky një takim? Në njëfarë kuptimi, unë isha më i zhvilluar se ai, madje më mirënjohës. Çdo ditë laja sjetullat me sapun, qaja, kur

merrja vesh për ndonjë vdekje, madje, ndonjëherë, nuk veproja si egoist.

Si kurorëzim i evolucionit, jeta ime ishte shumë më e vlefshme se e atij. Uria, dëshira dhe frika ishin të njohura për të dy ne. Ndoshta në ëndërr, mbi të kishte fluturuar pterosauri.

Luajta vendit dhe vazhdova të ecja.

Kalova oborrin e fabrikës së tekstilit dhe dola në rrugën “Helsinki”.

U nisa nëpër rrugën me rërë pranë linjës hekurudhore, në të cilën, herë pas here, tingëllonte ndonjë Pendolino. Në largësi, pranë lumit dukeshin lëndinat dhe shelgjet. M’u kujtuan pipskinët në bregun tjetër, të cilët në fillim të verës, mbuloheshin nga merimangat. Unë ulesha aty, në prag të Krishtlindjes, dëgjoja gumëzhimën e transformatorit dhe bëja plane për javët e ardhme.

U ngjita në urën mbi hekurudhë dhe i telefonova Samit. Ai e hapi menjëherë. Përreth dëgjohej muzikë dhe zëra të ndryshëm.

-Përshëndetje. Si je, Niklas?

-Përshëndetje, Sami. Ku je?

-Në teatër.

-Në teatër? Ti?

-Para teatrit. Në breg të lumit. Po bërtas.

-Vetëm je?

-Jo. Jam me motrën. Po presim shokët e saj.

-Kam nevojë për shoqëri.

-Mos u tall.

-Dhe për ca gllënjka.

-Ka ndodhur ndonjë budallallëk?

-Edhe kështu mund të thuhet.

-Epo nënën. Hajde.

Hapat kërcisnin në mbulesën e drunjtë të urës. Vështrova poshtë në lumë. Po në atë moment, edhe Sami qëndronte në bregun e lumit dhe vështronte. Ujërat e tij ishin të thella dhe të qeta. Trenat e shpejtë nuk e pengonin. Desha të çlirohesh nga ndjenjat e mia dhe të mendoja për lumin dhe lumturinë e tij.

-A e di çfarë po mendoja? – e pyeta unë.

-Jo.

-Për shpërbërjen. Për Inën. Për çastet e rrezikut.

Dëgjova që Sami ose po nxirrte tym ose psherëinte.

-Kjo punë nuk është kaq e lehtë, sa e mendon ti. Akoma je në fillim. Ju jeni në fillim fare. Duhet të mësosh të veprosh drejt. Duhet vite. Nganjëherë dua të pyes: “Për çfarë mendon ti në fakt? Një botë ka plot femra që janë gati të më përqafojnë.” Por më kalon shpejt. Ecim në drejtim të rrezikshëm. Të duket se është e pamundur. Ashtu është. Të mbulon të tërin. Njësoj si treni nëpër urë. Do të mësosh.

-Nuk do t’i ngatërroj gjerat kështu. Të të lë për të pirë?

-Dashuria nuk duhet të përfundojë. Më lër, në djall të vejë.

-Je larg?

-Pas pesëmbëdhjetë minutash do të jem tek ti, nëse nuk ngecem diku tjetër.

-Hajde këtu. Do të gëzohem të të takoj.

-Mos bëj shaka. Ma jep telefonin e motrës.

Fola pak me Sallën – motrën e vogël të Samit. Ajo ishte një histerike magjepsëse dhe më ktheu humorin. Zbrita nga ura, u nisa nëpër rrugën me zhavorr dhe e ndërpreva bisedën. Anash rrugës rriteshin shkurre, shelgje dhe bar i lartë. Era e njërës prej tyre më kujtoi erën e acetonit. Një djalë dhe një vajzë me biçikleta më kaluan pranë dhe u drejtuan për në qendër të qytetit. Vajza ecte përpara dhe u kthye të shikonte prapa.

-Ndoshta do ta takosh sonte – tha ajo me zë të lartë.

-Ose ndonjë tjetër – ia ktheu djali.

Zhurma e rrotave nëpër zhavorr u largua. Fragmenti i bisedës që dëgjova më bëri të zhytem në mendime. Do të ishte bukur t’i japësh biçikletës me shokun, poshtë nëpër rrëpirë me dehjen në rritje të rinisë nga nata, e cila nuk i premtonte gjë askujt.

Çdo burrë budallallepset për dy shkaqe – nga mendimi dhe ndjenja.

Ishte errësirë. Nën pemë ishte freskët, mbante erë toke të lagësht, erë vjeshte. Nga bregu me shkurre dukej lumi. Në ujërat e tij pasqyroheshin dritat e Tuomansilitit.

U ndalova. Pesë metra nga toka para gardhit me dërrasa murmuriste nata e zezë. Sikur po luftonte. Ndjeva një dridhje në gjoks. Në gojë m'u bë një shije metali. U ktheva pas.

Barërat tundeshin dhe zhurmonin. Krijesa u nda në dy pjesë kërcyese, të cilat, pas pak, u mblodhën si një top dhe vazhduan të lëvizin si hardhuckë e qëlluar ose si gjarpër. Nuk e kuptova, nëse ishte nga helmi apo luftonte me diçka. Shumë shpejt lëmshi u nda në dy krijesa të rregullta, të cilat, njëra pas tjetrës, kaluan me zhurmë përmes hapjeve në dërrasat e gardhit. Prapa tij, për njëfarë kohe fëshfërinte bari. Pastaj ra qetësia.

U afrova tek gardhi dhe kisha ndërmend të shikoja çfarë bëhej prapa tij, kur pashë një mbishkrim të madh me sprajt të bardhë: i + N FOREVER.

Kur isha fëmijë e dija që bota na dërgon mesazhe. Këto ishin vëzhgime të vogla të qarta, numra regjistrimi të makinave që vinin përballë (NIK-654, LAS-123), reklama që në kohën e filmit “Dielli i bardhë i shkretëtirës”. Nuk ishte e nevojshme t'i kuptoja, ato nuk e prishnin ecurinë e ngjarjeve. Ato vetëm përzinin vetminë dhe tregonin se vendi ynë është këtu, që jemi të mirëseardhur dhe, meqenëse kemi ardhur, nuk duhej të prishnim asgjë.

Kur je i rritur, këtë lloj kënaqësie e merr nga seksi, nga paratë dhe nga narkotikët.

Vemja e gjetur në muzg më kujton si kam qenë fëmijë- djalë i qetë, që lexonte pa u lodhur gazetatat, të cilat ia dërgonte bota.

Qëndroja para gardhit me sytë e ngulur në geramat e bardha. Mendova për kafazin e kraharorit të saj dhe për njollat e bardha të mbetura nga bikini. Sa të njohura ishin gjinjtë e saj në duart e mia, si i shtyp me pëllëmbë kafazin e kraharorit deri në zbrazjen e mushkërive, sa shpejt kthehet në njeri të huaj për mua, si mbush mushkëritë dhe fytyra e saj shëmtohet nga dhimbja, ndërsa trupi

i saj ngurtësohet i një varkë e hedhur në sterë.

Si nuk mund të bëhet asgjë, kur filloj të dal prej saj, kur do të bërtasë dhe të zbulojë atë fytyrë që fshihet. Një gjë të tillë, kurrë s'e kisha parë më herët. Kurrë më parë s'kishte ndier diçka të tillë...

Dhe ja tani që kaloi kjo, ndiej gishtat e saj në flokët e mi, fytyrën e saj të mbështetur tek e imja dhe pëshpëritjet e saj me inat: “Ma fut thellë. Ma bëj fort, siç duhet.”

Por unë doja vetëm ta përqafoja gjatë, ta prekja, i çliruar nga shqetësimi, dashuria, flokët dhe fytyra e saj, sepse ato dhe vdekja i kishte prekur e ta pyesja: “A mund të bësh dashuri me një njeri të gërryer nga ndjesi të tilla?”

Po mendoja si punon besëtyti. Diçka duhej të ndodhte, që ta çlironte atë e të qetësohej. Unë duhej ta bëja, ta çliroja, ta tërhiqja, sepse ajo s'kishte njeri tjetër të afërt. Hapa krahët. Ngriva. Bërtita. U tërhoqa shpejt majtas, mbylla sytë, u hodha dhe kapërceva gardhin. Këmba më ngeci në një dërrasë, sikur të ishte dekor poroz për spageti. E vura këmbën tjetër në tokë. U lëkunda dhe u përpoqa të çliroja këmbën, por thembra më kishte ngecur ndërmjet dy dërrasash të mbërthyera me njëra-tjetrën.

24

Qesha, kërceva në këmbën e majtë dhe tërhoqa të djathtën nga gardhi. Shava. Hapa krahët që të ruaja ekuilibrin. Dërrasat ma shtrëngonin këmbën dhe trari kryq më pengonte ta ulja më poshtë. Thembra e këpucës nuk dilte dot nga dërrasat. Mblodha forcat dhe e tërhoqa përsëri.

Ndjeva zhurmën e një motori dhe përmes degëve pashë dritat e një helikopteri që afrohej nga veriu. Mbi urën Tuamansilta ngadalësoi, bëri një kthesë dhe fluturoi drejt grykës së lumit. Parafytyroja pilotët me rripat e sigurimit të lidhur, me vetëbesim, vigjilentë dhe hyjnorë, si vështrojnë nëpërmjet aparateve të

posaçme për shikim gjatë natës, lumin e zhytur në dritën e gjelbër, në të cilën pasqyroheshin dritat e tarracës së gurtë.

Me siguri diçka kërkonin dhe shikonin nën dritat e llambave të rrugës grupet e vogla të atyre që festonin. Nga ajo lartësi nuk mund të vinin ré problemet e tyre.

E pashpjegueshme se si, por, pavarësisht nga zhaurima e helikopterit, nga zhurma e rrobave të mia dhe e pemëve, unë ndjeva praninë e dikujt. E dija që dikush qëndron pas shpinës sime. Ktheva kokën dhe u përpoqa ta shikoj, por dallova vetëm nënkalimin e errët të linjës hekurudhore.

-Një gjë e tillë nuk ndodh çdo natë. Situatë idiote thashë unë me zë të lartë dhe mbajta vesh.

Helikopteri largohej në drejtim të detit dhe, shpejt, gjëmimi i tij nuk ndihej. Nga qendra e qytetit vinin tingujt e muzikës. Era tundte shkurret në anë të rrugës. Ishte qetësi. Fillova të lodhem dhe më dhembte kyçi i këmbës. Prapa meje diçka ra në tokë. Ndjeva hapa. Nuk dalloja dot drejtimin nga vinin.

Nxora telefonin nga xhepi dhe hapa kapakun. Ekрани ndriçoi me një nuancë blu dorën time. 22:51. E kuptova që kisha bërë gabim, kur nxora telefonin. Ai më ndriçonte fytyrën, ndërsa gjithçka përreth ishte e zhytur në errësi.

-Ej, a do të më ndihmosh pak?

Hapat prapa shpinës sime ndaluan. Zëri i burrit ishte i qetë dhe indiferent:

-Ndoshta do ta takosh prapë sonte. Ose ndonjë tjetër.

Më hipën nervat. E tërhoqa këmbën. U përpoqa ta rrotulloja anash. Diçka e lagur më goditi në qafë dhe rrodhi nëpër jakë. Kërceva në një këmbë dhe bërtita. Diçka e mprehtë ma lëndoi kyçin. U mbështeta fort në këmbën e lirë dhe u tërhoqa prapa, sikur tundja trupin para prapa. Ndjeva se këmba m'u drejtua. Rashë dhe godita kockën e kërbishtes. Telefoni më fluturoi nga dora. U drejtova. Në rrugë s'kishte asnjëri. As nën urë. U ktheva të vështroja shkurret. Më dhembte kurrizi, edhe kyçi gjithashtu. Fshiva me dorë qafën e lagur dhe i mora erë dorës.

Ishte pështymë. Kjo s'mund të ishte imja? Si mund të pështyja qafën time?

Qëndroja dhe merrja frymë thellë. Frika m'u këmbye me inat. Duart më dridheshin dhe kisha dëshirë të rrihesha. Hera e fundit ka qenë para shumë kohësh në tetëdhjetën dhe hëngra një dru të mirë.

Pastaj u ngjita në urë dhe vështrova në drejtim të kampusit. Rruga që të çonte andej ishte bosh. U mbështeta në parmak dhe thirra:

-Nënëëën.

U nisa të kërkoja telefonin. E gjeta dhe e futa në xhepin e pantallonave. Nxitova nga qendra e qytetit, duke lëvizur krahët fort. Këmba e lënduar po lehtësohej. Dëgjova orën e katedrales që numëroi njëmbëdhjetë. Duke thithur thellë e ritmikiqist ajrin e ngrohtë, gjendja ime shpirtërore filloi të normalizohet.

25

Petri qëndronte në nënkalim dhe shikonte kurrizin e një burri që vuante duke u përpjekur të lironte këmbën e vet. Vetëm një idiot mund ta bëjë këtë. Këmba i kishte ngecur ndërmjet dy dërrasave. E kishte të qartë që ai nuk ishte ndonjë mjek.

Shtrengoi një gur në grusht. Nga bregu tjetër i lumit u dëgjua një gjëmim. Lart mbi ujë po afrohej një helikopter. Burri ktheu kokën dhe vështroi makinën. Helikopteri fluturoi mbi urë, ngadalësoi shpejtësinë, u kthye dhe u drejtua nga deti. Zhaurima e motorit iu duk e fortë.

Petri u afrua tek burri dhe ndaloi. Ai ishte një shpatullgjerë, rreth një metër tetëdhjetë i gjatë, por jo sa Petri. I ngecuri rrotulloi kokën për të parë, çfarë ka pas shpinës së tij.

-Kjo nuk ndodh çdo natë – tha ai.

Zëri iu duk i njohur Petrit, i cili mendoi se mos ishte ai burri, të cilit i kishte mbajtur kapelën para portës së jashtme të Suvit.

Në errësirë nuk e kishte dalluar mirë... Ndoshta Suvi ia kishte dhënë çelësin e shtëpisë.

Në largësi zhurma e helikopterit, dalëngadalë, u shua.

Petri e lëshoi gurin. Mendoi çfarë do të bëhej, nëse helikopteri bie në lumë. Helikat do të ngrinin ujin në formë stërkalash të mëdha, uji do të ziente, helikopteri do të mbytej dhe, pas pak, sipërfaqja e ujit do të rridhte e qetë dhe e blertë.

Petri nuk po vendoste si të vepronte. U afrua edhe pak tek njeriu që nxori telefonin nga xhepi. Ekрани ia ndriçoi fytyrën. Kishte një hundë të madhe.

Ej, do të më ndihmosh pak?

Petri ngriu.

-Ndoshta do ta takosh atë prapë sonte. Ose ndonjë tjetër.

Burri u përpoq të çlirohet. Petri nënqeshi. Në mendje i spërndriti ideja ta godiste atë burrin në kokë. Iu mbush goja me pështymë. Pështyu, por nuk e kuptoi, nëse i ra atij.

U nis qetësisht prapa shelgjeve dhe shkurreve tek hija e urës. I vinte për të qeshur. Ai andej luftonte me gardhin. U dëgjua një thyerje dërrase. Burri ra, por u ngrit shpejt dhe vështroi përreth. Trupin e kishte të tendosur, ndërsa drushtat të shtrënguar. Ai u nis u nis drejt urës dhe kaloi pranë Petrit. Pastaj u zhduk nga shikimi. Për një çast ra qetësia pastaj u dëgjua një sharje:

-Nënë tënde!

Burri u kthye dhe filloi të rrotullonte kokën si për të kërkuar diçka në tokë. E gjeti dhe e futi në xhep. Pas gjithë gjasash ai ishte telefoni i tij. Burri u nis në drejtim të qendrës me hapa të mëdhenj.

Petri e priti sa të kalonte shtëpitë e bregut të lumit, u ngrit dhe u nis të ecte edhe ai. U mbush me krenari. Një herë Sejlllo i kishte thënë që të mësonte ta përmbante zemërimin e vet. Ai kishte vepruar tamam kështu. Mendonte që Suvi kishte shkatërruar gjithçka, që është në një grua, e cila nuk zotërohet dhe e bënte Petrin të dobët.

Petri u nis po në atë rrugë si dhe i panjohuri. Ishte, tashmë,

në gjysmë të rrugës “Piispankatu”, kur u kujtua që pakoja kishte mbetur në oborr të Suvit. Ndoshta ishte më mirë që Suvi të mos e merrte. Mesazhi ishte i dykuptimshëm dhe mund ta zemëronte atë, në vend të kësaj e detyron të provojë keqardhje ndaj meje. Ai duhej ta harronte Suvin. Vetëm ta harrojë. Kjo nuk ishte e pamundur.

Arriti në “Kaski” në njëmbëdhjetë e njëzet. Një shevrolet e madhe e bardhë e Sejllos ishte parkuar para pijetores. Petri mendoi se sonte Sejllo nuk do ta ngasë.

Restoranti ishte i mbyllur, kuzhina e errët. Në gardërobë s’kishte asnjeri. Ai kaloi pranë drerit të balsamosur, të cilin, me përkëdheli e quanin Risto dhe ishte pagëzuar – Risto Rutin. Petri hyri në tualet, u vesh, u pa në pasqyrë, doli dhe u ngjit shpejt nëpër shkallë.

Nga pab-i vinte njëfarë zhurme. Ajri ishte bërë blu nga tymi i duhanit. Nga altoparlanti dëgjohej një melodi e qetë, gjumëndjellëse.

Në sallë ishin ulur nja dhjetë vetë.

Sejllo ishte rehatuar në vendin e tij të zakonshëm në krye të tavolinës, afër barit dhe të pranishmit ishin kthyer nga ai. Ishte burrë trupmadh me mjekër të zezë, të parruar, me gotën në dorë, thithte cigaren dhe ua lëshonte tymin në fytyrë të tjerëve, i sigurt që e dëgjojnë. Ajri afër tij ishte shndërruar në ngjyrë blu nën dritën e llambës. Muret ishin të veshura me panelaturë të trefishtë.

Ai fliste i përkulur përpara, duke bërë gjeste me dorën, në të cilën mbante cigaren. Në mur prapa tij ndriçonin turbull një drapër, një kosë dhe një sqepar – të varur në mur. Mbi shpatullat e gjera dukeshin dy kapa thekre. Sejllo rrinte në mes të shoqërisë. E vuri ré Petrin.

-Çfarë narkomani me tatuazhe qenka hequr zvarrë deri këtu. Si thua Mose, ndoshta e kanë nxjerrë jashtë.

Mose qëndronte në bar dhe përziante filxhanin e kafes. E përshëndeti me kokë Petrin. Petrit iu duk sikur lëvizja e qafës

së tij të fortë i bën muskujt në pjesën e sipërme të trupit të tij, të tendosen. Sejllo tërhoqi një karrige nga tavolina tjetër dhe e vendosi pranë së vetës. Petri i ra rrotull tryezës dhe u ul në të. Të tjerët e vështronin. Midis tyre ishte Tabermani me mjekër, këmisha e kaltër e të cilit ishte e lagur në kurriz dhe një djalosh i stërmadh, i cili e kishte mbiemrin Kojto. Të tjerët ishin të panjohur për Petrin. Sejllo i vuri dorën në sup Petrit dhe ai ndjeu një erë të rëndë djerse.

-Si je, Petri? A do pish një birrë? – e pyeti Sejllo.

Petri i vështroi në sy. Psherëtiu Sejllo akoma nuk ishte i dehur tapë dhe do të mund të flisnin, derisa ta përcillte, në këtë natë të nxehtë, në shtëpinë e tij. U përgjigj pozitivisht dhe, në të njëjtin moment, atij i spërndriti një mendim i papritur: ai do të kujdesej për Sejllon.

26

Dehja e Samit ka tri shkallë.

Muzika u përgjigj në emrin tim. Asgjë nuk është siç duhet. Rreth orës tetë të mbrëmjes, nga etanoli trupi iu lëshua fare, ndërsa fytyra i ishte fryrë. Kunjat e shkrepëseve i thyhen në duar. Në tavolinë bateria e filxhanit dëgjohej në pozicion të dorës së dytë. Depërtonte në muret. S'kishte për kë të mendonte. Ndërsa kthehej në shtëpi në orët e vona, qielli i pafund binte mbi kokën e tij. Në gojë kishte shijen e një mjellme të ngordhur. Përgjumshëm shtrengonte në duar lodrat e fëmijëve.

Dehja e kazakëve karakterizohet nga një ekstazë e pafund. Vodka mbizotëron mbi trupin. Fjalët fillojnë të rrjedhin me shpejtësi. Gjendja shpirtërore bëhet luftarake, por dashamirëse ndaj njerëzve të tjerë. Kishte dëshirë të griste këmishën, të rrëzohet e të bëjë seks. Atëherë ndodhin telashet.

Në fund të fundit, dehja mbretërore e hedh përtokë dinakërisht. Për disa ditë simptomat nuk shfaqen, pastaj shpërthejnë si rrufeja

në qiell të kthjellët. Fjalimi madhështor, gjenial dhe i paqartë rrjedh si lumi. Në gota derdhet vetëm konjak markash. Atë e kap euforia me flakën e saj të bardhë. Në tavolinë luhet baleti mbretëror.

Nuk është turp të qash para atij që qëndron më poshtë. Diku thellë në tru përfundohen lidhje të fshehta qeveritare. Në orët e hershme bën skandale dhe, i mbyllur në banjë, atë e kap deliri i madhështisë. Në mbrëmje zgjohet me ndjesinë që është i parëndësishëm dhe ndien frikë.

Ka ndjesinë që ka shkuar shumë larg me trojkën, me kuajt më instinktivë në botë. Në korridor është hedhur posta e paprekur prej dy javësh. Në mur mbi sobë, është shkruar me mustardë një parullë revolucionare.

Në brigjet e lumit kishte shumë njerëz. Djem të dehur endeshin nëpër tarracë dhe thyenin shishe. Nën fenerët e rrugës përgjatë brigjeve të lumit shëtisnin grupe shokësh dhe çifte. Në grykën e lumit nja pesëdhjetë pushues shpërthyen në ritmin e xhazit.

Para teatrit të qytetit, Sami rrinte në bar me kapelën prej lëkure lope me strehë të gjerë. Pranë tij çuçuriste e motra – Salla. I përqafova. Përsëri mendoi që Salla është e vetmja grua, pirsinget e së cilës nuk më ngjallnin pështirosje.

Ajo më prezantoi me miqtë e saj: katër panksa njëzetvjeçarë, të cilët vërtiteshin nëpër lëndinë me veshjet e tyre të çuditshme dhe i thërrisnin njëri-tjetrit. Menjëherë unë i harrova pseudonimet e tyre të tipit Ritca, Tavi, Oraali dhe Strutci. Nuk ndihesha mirë në shoqërinë e tyre. Shpesh mua më ndodhte, kur ndodhesha i rrethuar nga të rinj të vetëkënaqur, të cilët pretendojnë të jenë mishërimi i frymës së kohës. Sami e vuri ré sikletin tim. Më zgjati mua një shishe “Bombaj Sapfir”. Pija xhin të ngrohtë të paholluar dhe vështroja gjestet e Samit. Ishte plot me energji. Ishte shoku im më i vjetër prej njëzet vjetësh. Jemi njohur në klasën e shtatë.

Isha dëshmitar i faktit që ai nga një djalë i dobët i gjatë me

shpatulla jo fort të gjera u kthye në një burrë shpatullgjerë, figura e të cilit fliste për forcë fizike.

Pas mbrëmjes së maturës, ai e la shkollën dhe hyri në punë në një firmë të sapokrijuar të vëllait të tij të madh, i cili merrej me organizimin e banxhi-xhamping. Pas kësaj, çfarë s'kishte punuar: marangoz, barist në anijet suedeze, ndërtues rrugësh, vullnetar, punëtor skene, ndërtues varkash. I kishte qëlluar të punonte me gjithfarë njerëzish.

Shpesh e kisha zili vetëbesimin në kontaktet sociale të atij njeriu të aftë për dhunë fizike – diçka që unë asnjëherë nuk do ta arrija. Mendjemprehtësia e tij, e shfaqur në shoqëri, ishte si kundërhelm për nervozizmin tim, të cilin pa dashjen time, e mora në universitet.

Gjatë njëzet viteve të miqësisë sonë, ne kemi mbajtur kontakte kryesisht nëpër festa. Pothuaj kurrë nuk mblidheshim esëll, por, gjithsesi, ndiheshim të afërt.

Në anije hipëm rreth orës dymbëdhjetë. Ishte plot e përplot me të rinj, të cilët bërtisnin dhe argëtoheshin në natën e ngrohtë. Një dixhej me pamje kriminelë seksual kishte vënë teknomuzikë, e cila ngrinte gjendjen shpirtërore të publikut në kuvertë. Arritëm të ulemi në tavolinë, në pjesën e parë të kuvertës. Shumë shpejt e kapa ritmin e pijes – verë molle brusko, koskenkorvë me akull, një gotë ujë. Dëgjoja bisedën e shokëve të Sallës. I tregova Samit ndodhinë me gardhin prej dërrase. Ai më tregoi për miken e tij Leena, me të cilën donte të martohej në fillim të shtatorit. Nuk donin të bënin dasmë. Vetëm ceremoninë civile. Pastaj do të nisen për në ishullin tajlandez Koh Samujn. Sami e pranoi që kurrë s'ka menduar se mund të dashurohej kështu dhe se ajo do t'i bëhej çdo ditë më interesante.

Filloi të më zërë alkooli. Dixhej vuri pjesën e U2 “The hands that built Amerika”. Dëgjoja me vëmendje. Vështroja pemët në breg dhe muzgun e kaltër mbi to. Kjo ishte e vetmja pjesë gotike në repertorin idiot të grupit. Ndoshta me përjashtim të “Lemon”. Pas “The Joshua Tree” i urreva U2.

Më vonë shkuam në një bar, në të cilin një trio grash luante një pjesë rok. Interpretuan pjesën nga repertori i “The Sonics”. Pija xhin tonik dhe sodisja skenën nga afër. Ishte aq gëzueshëm të shikoje gratë e reja që tundeshin nga entuziazmi. Pasi mbaruan, u ktheva në tavolinë. Midis tymbit të cigareve, shokët e Sallës me pseudonime të çuditshme, bërtisnin si të çmendur.

Afër Sallës rrinte një djalë flokëzi, i cili pinte kafe dhe ujë. Ishte një tip i çuditshëm. Kishte një ballë të lartë, hundë shqiponje, vetulla të drejta, mollëza të ngritura si femrat. Salla e kishte kapur nga ijet e hijshme dhe shikonte në sy.

-Ky është i dashuri i Sallës? – pyeta vëllain e saj.

-Po. Lidhja e saj e parë serioze.

-Mirë. Bukurosh qenka.

Sami e vuri dorën mbi timen.

-Ti ke gradë shkencore në filozofi, ke lexuar Niçen. Më shpjego ndonjë gjë.

-E?

-Pse, para seksit gratë budallaqe, kërkojnë t’u përkëdhelësh kokën dhe t’i shikosh në sy, ndërsa të zgjuarat duan që t’u lidhësh sytë dhe di godasësh në prapanicë.

-Oho! Leena kështu bën?

-Nuk të takon ty kjo. Po të pyes parimisht?

-Nuk besoj të ketë lidhje me atë që budallaqet s’kanë problem me pjesën e poshtme të trupit të tyre, ndërsa pjesa e sipërme është dru. Të zgjuarat kanë tru, por kanë problem me pjesën e poshtme të trupit të tyre dhe duhet ta zgjojnë.

-Teori e dyshimtë dhe me rrezik shpërthyes.

-Seksualiteti i gruas është pikërisht i tillë. Po mjaft folëm për të. Kjo bisedë më bezdis. Të flasim për ndonjë gjë tjetër.

-Dakord.

E këqyra në sy. Shikimi i tij ishte si i përhumbur. Ai shtrëngoi duart dhe tha ngadalë:

-Njerëzit shpresojnë, se shkenca do t’i bëjë të përjetshëm. Secili kërkon të jetojë përgjithmonë. Përse askush nuk dëshiron

që shkenca të ndalojë maturimin mendor?

-Por edhe për këtë ka mënyra.

E mbyllën barin dhe na përzunë. Shoku i Sallës e kishte parkuar kamionçinën e vet tojota hias, të bardhë e të vjetër, aty afër. Sami dhe Salla u futën në kabinë, ndërsa shokët e Sallës hipëm mbrapa.

U mbështeta në spondën e kamionçinës. Një biondinë gjoksmadhe u shtri pothuajse mbi këmbët e mia. Situata nuk dukej premtuese. Biondja dhe Salla ishin të vetmet femra në shoqëri. Ndalua në rrugën “Pitkalakatu Lindor” dhe Salla shkoi deri në shtëpinë e saj për të marrë vodkë. I dashuri i saj e ngiste kamionin si i çmendur. Në periferi të Martinamakit, dera e makinës rrëshqiti dhe u hap. Gomat fishkëllenin në asfaltin e natës dhe ajri që na rrihte përballë, na shpupurishte flokët. Pamë dritat në rrugën e breglumit. U kthyem tek porti.

Arritëm para një depoje afër kështjellës së Turkut, fluturuam përmes portës prej teli dhe ndalua para një salle gri me llamarinë të valëzuar. Ajri kaltëronte para lindjes së diellit. Muret ishin të pikturuara me grafit. I dashuri i Sallës hapi derën. Mendova se ndoshta banonte këtu.

Salla nuk ishte e madhe, brenda kishte mobilie të buta, televizor, stereosistem dhe instrumente muzikorë. Me siguri ambienti përdorej për prova. Shpresoja që askujt të mos i shkonte mendja t’u binte veglave. I zoti i shtëpisë na tregoi, ku është tualeti. Pastaj hapi laptopin.

Hapëm shishet e Sallës dhe mbushëm me vodkë gotat njëpërdorimshme. Sami pinte cigare dhe e nxirrte tymin rrathë-rrathë. Nga altoparlantët tingëlloi muzikë elektro fynk, pjesë që unë e kisha harruar. Biondja zvarritej në katër këmbë, njëri gji i kishte dalë nga bluza. Njëri nga panksat zvarritej pas saj. Zbardhi dita dhe asgjë interesante nuk po ndodhte. Dielli shkëlqente në dritaret e vogla të çatisë. Biondja tashmë ishte bërë esëll dhe puthej me një panks në një qoshe. Salla përkundej afër të vëllait dhe diçka murmuriste. Të tjerët u nisën. Dikush e kishte ulur

muzikën. Vendosa t’u jepja fund budallallëqeve.

Fillova të bisedoja me të zotin e shtëpisë. Ai, të paktën, ishte esëll. Më tregoi se donte të studionte teologji. E pyeta përse i interesonte pikërisht ajo. Ai nuk m’u përgjigj. Nxori nga xhepi i xhinseve një flakon ngjyrë kafe me njëfarë ilaçi dhe ma tregoi.

-A do një “magistrallka”?

-Po, sigurisht.

-Jo para Sallës.

I kujtoj qartë minutat që pasuan. E ndoqa mikpritësin tek pjesa e prapme e sallës. Njëpër shkallët e pjerrëta u ngjitëm në një shesh dy metra mbi dyshemenë. Mendjen e kisha në vend dhe e zotëroja trupin tim. Kisha pirë vetëm disa gota më tepër dhe dy xhointa. Hymë në një dhomë të vogël, e cila shërbente si ambient pune. Raftet ishin bosh. Sipër një tavoline pune të pistë ishte një numërorator telefonash. Prapa dritares dukej një tarracë e ngushtë e rrethuar me parmakë. Dielli ndriçonte një pishinë për fëmijë që ndodhej aty, me ngjyrë të kaltër e të verdhë, karrige të bardha plastike dhe shishe birre bosh. Nga dritarja dukej muri verior i kështjellës dhe parku.

I dashuri i Sallës nxori shishkën dhe e hapi me tehun e biçakut të xhepit. Pastaj më dha një qese në formë konike. Bllokova vrimën e djathtë të hundës me gishtin tregues dhe u përpoqa të thith.

-Tani përpiqu ta bësh nga ana tjetër – më këshilloi ai.

E ktheva qesen, e vura anën e saj më të ngushtë në vrimën e hundës dhe u përkula mbi tavolinë. E thitha deri në fund magistrallkën dhe ia ktheva qesen. Sytë m’u mbushën me lot. Qiellza m’u mpi dhe në gojë ndjeva hidhësirë.

Dola në tarracë përmes dritares dhe, me këmbë, e ndjeva sipërfaqen e ngrohtë. Atëherë vura ré që jam zbathur. Këmbe e djathtë, e shpuar nga një copë xhami të thyer, nxirrte gjak. Qielli ishte i kthjellët. Dielli më ngrohte gjoksin përmes këmishës së zezë. Dita dukej që do të ishte shumë e nxehtë. Diku nga

porti vinin krakëllimat e një tufe pulëbardhash. Kështjella dukej e vogël dhe me lashtësi historike. Kërkova në xhep për telefonin që të shikoja sa ishte ora. Preka kartën e kreditit dhe ca kartmonedha. Nuk e dija, ku janë çelësat e mi. Më shkoi mendja tek Ina – a ishte zgjuar ajo tani. Shpresoja të flinte akoma, kur të kthehesha në shtëpi. Mendoja se do të gëzohet me pamjen time të jashtme. Nuk isha keq fare. Hoqa pantallonat dhe zbërtheva këmishën.

Hyra në pishinën e fëmijëve, të stampuar me syze uji. Uji ishte i ngrohtë. Nuk ishte ndërruar prej shumë kohësh. Në sipërfaqe notonin gjethe dhe insekte të ngordhura. Fundi plastik ishte rrëshqitës dhe i pistë. U ula në ujë dhe vështroja fluskat e ujit që dilnin nga bokserët e mi. Dielli më digjte gjoksin dhe fytyrën.

E mbështeta shpinën në anën e pishinës dhe ndieja se si uji, pas meje, derdhej në dysheme. U shtriva dhe qafa m'u mbështet në buzën e pishinës, ndërsa këmba dilte jashtë përballë. Po mendoja si e kishin hedhur ujin në pishinë – e kishin mbushur me tub apo me kovë. E kuptova që po gjykoj si fëmijë.

I dashuri i Sallës kaloi nga dritarja në ballkon. Zbathi këpucët, çorapet dhe tërhoqi poshtë këmbët e xhinseve. Afroi një karrige plastike pranë pishinës, u ul në të dhe zhyti këmbët në ujë.

-Unë jam Timo – u prezantua ai dhe zgjati dorën.

Ia shtrëngova me dorën e lagur. Nënqesha. Nuk i shkonte emri.

-Unë jam Niklas.

-Më ka folur Salla.

-Dua të ta them që je shumë i bukur.

Timo më vështroi për nën balluket e tij të zeza. Tundi kokën. Në lindje dielli po ngrihej gjithnjë e më lart. Një rrugën “Linankatu” dëgjohej zhaurima e kamionëve të mëdhenj, të cilët me siguri çonin mallra në port. Ndihejsh mirë dhe i gjallëruar.

-Këtu banon?

-Kohë pas kohe. Nganjëherë tek Salla.

-Si jeni njohur?

-Ishte për t'u bërë.

Asgjë s'ndodhi me mua - i thashë dhe i bëra me dorë nga vrimat e hundës.

Pas gjithë gjasash, ato ishin fjalët e fundit që i thashë atij, atë mëngjes.

Timo hapi flakonin, nxori biçakun dhe futi tehun e saj brenda; e nxori prapë dhe ma zgjati mua, me aq qetësi, sikur s'kishte asnjë rrezik që ta derdhte atë. U ula. Bllokova vrimën e majtë të hundës dhe thitha me të djathtën. Një pjesë e pluhurit ra mbi buzën time të sipërme. E fshiva me gisht dhe e lëpiva.

Mbështeta kokën në buzë të pishinës me sytë e mbyllur. Trupi e kisha të ngrohtë dhe të shtensionuar. Ndjeva një marramendje të lehtë dhe, për një çast, nuk e ndjeva veten mirë. Të ndenjurat dhe kofshët më digjnin, më dukej sikur më ishin lehtësuar. Puls i më rrihte më shpesh.

Megjithëse sytë i kisha të mbyllur, ndjeva se fushëpamja m'u ngushtua, sikur po largohesha në një dhomë të errët me një dritare të vetme. Ndjesia ishte e këndshme dhe më gëzonte. Veshët më buçitnin. Ngrihesha gjithnjë e më shpejt dhe kjo më pëlqente, deri në momentin, kur lëvizja lart u përshkallëzua në një rënie të padrejtueshme.

Ndieja se, tashmë, nuk jam në pishinë, por diku tjetër. Nuk kishte më pishinë. Kësaj ndjesie iu shtua frika. Mendova se duhet të përqendrohem me sytë mbyllur. Shpejt u ndjeva sikur isha sëmurrur dhe jam në spital. Nga sipër më ndriçonte dhe më ngrohte një llambë e ndritshme.

Disa mjekë të veshur me bluza të bardha u përkulën për të parë trupin tim të lëshuar, të shtensionuar. U përpoqa që të hapja sytë që t'i shikoja e t'u thosha çfarë kishte ndodhur, sipas meje. Arrita të shikoj. Mbi mua ishte një llambë shumë e ndritshme.

Në qiellin e kaltër një re e bardhë la një gjurmë të kaltër të errët: një pulëbardhë në qiell, për habinë time - e vetme. U përpoqa të rrotulloj kokën dhe të shikoj cilët ishin njerëzit që më

rrethonin. Doja t'u tregoja të vërtetën për kohën dhe hapësirën.

Një superfuqi e kishte asgjësuar unin tim. Nga fytyra e figurës mungonin sytë dhe goja. Megjithëse nuk mund ta shikoja në sy, prania e saj më ngushëllonte. Nuk e ndieja trupin. Figura fliste jo qartë, si fëmijë dhe kjo më mbushte me lumturi dhe qetësi.

Nuk mbaj mend çfarë ndodhi pastaj dhe sa vazhdoi. Kur humbi ndjenjat, koha pushoi së ekzistuari. Pashë tablo fantastike, isha në shoqërinë e këndshme të të vdekurve dhe bisedoja me ta, shikoja tablo nga fëmijëria ime, motrën time Johana. Luaja Nintendo.

Përmes shkretëtirës, luftëtarë të vegjël me motoçikleta fluturuan në fushën e minuar – minat i copëtuan ata. Pas tyre erdhën luftëtarët e rritur. Në gji digjej një anije gjysmë e mbytur. Në Sudan Osama Bin Laden rriste lule dhe shëtiste me djemtë e tij nëpër bregun e Nilit.

Një grup mjekësh punonte pa u lodhur dhe, që pas mureve prej xhami, i ndiqnin ca gra lëkurerrëta. Ionasi tullac qëndronte në korridor para pasqyrës. Avionë të panjohur përshkonin qiellin. Nuk kisha frikë. Gjithçka shkonte mirë e bukur. Doja t'ia tregoja Inës, megjithëse nuk e shikoja. Doja që ta kuptonte. Sikur ajo të më dërgonte atje, ku isha, që të bëja pyetje dhe, tashmë, e kisha përgjigjen për çfarë paraqet vdekja.

M'u duk se Ina u zgjua. Një erë e lehtë tundte perdet. Trafiku në rrugën "Aninkajstenkatu" gjëmonte. Ishte ora nëntë. Pashë vendin bosh pranë meje. Netët ishin të nxehta, plot zagushi, ëndrrat të thella dhe të vetmuara. Zgjohej ngadalë. Nuk nxitonte për askund. Kishte kohë.

Llambat halogjene ndriçonin kabinën e dushit. Ajo ftohu ujin e dushit, u ul në stolin prej lisi, mbështeti shpinën në mur dhe shtriu këmbët. Currilat ia mbuluan fytyrën dhe qepallat e mbyllura të syve.

Përpiquej të mos mendonte për Niklasin, por nuk ishte në gjendje ta hiqte nga mendja. Ndërsa ai ia dilte shumë mirë. E bënte instinktivisht. Kështu mbronte dhe lirinë e vet, dhe të

sajën. Ishte në gjendje të pinte deri në humbje vetëdijeje, kur të dëshironte.

Në vjeshtë u zhduk për tri ditë. E kishte mbyllur dhe telefonin fare. Ajo merrte në telefon shokët e tij. Askush nuk e dinte se ku është. Ina e kishte pritur deri të shtunën në mbrëmje dhe ishte nisur për ta kërkuar. Kaloi bar pas bari dhe u mundua ta dallonte midis shumë fytyrash, tymit dhe zhurmës. Kishte pyetur të njohur, gjysmë të njohur, e të panjohur dhe vetë ishte ndier e panjohur. Nuk mundej të besonte se ajo ishte e gruaja që, gjatë një nate me shi, i kishte rënë përqark qytetit për të kërkuar burrin dhe kishte imagjinuar fatkeqësi të ndryshme që mund t'i kishin ndodhur atij. Më e keqja ishte që, kur ishte më e re, ajo bënte të njëjtën gjë. Por, tashmë, nuk ishin fëmijë, prandaj i binte qytetit kryq e tërthor dhe shqetësohej për atë dhe babain e vet.

Të dielën pas darke, ai u kthye dhe hyri në dhomën e ndenjies me këpucë. Ina e vështroi. Ai qëndronte me duar të lëshuara dhe dukej i plakur. Ajo i tha: “Të kam kërkuar” Ai psherëtiu dhe u ul në divan pranë saj. Jakën e lëkurës e kishte të rrudhosur. Ina e përsëriti. “Të kam kërkuar në gjithë qytetin. Nuk do ta bëj më këtë. Kurrë më nuk do të të kërkoj.”

Ina u tha me peshqir dhe u lye me krem kundër diellit. Veshi tangat e verdha. Në kuzhinë mbaroi sallatën me mocarela dhe mbushi një gotë verë të bardhë. Doli në ballkon, por u kujtua që aty kishte xhama të thyer. E piu verën në dhomën e ndenjies. Bëri grimin e fytyrës dhe leu buzët me të kuq. Veshi një bluzë të zezë, një fund të shkurtër dhe mori çantën.

Zbriti në oborr. Qielli po aq i kaltër sa dhe dje, dielli digjte njësoj. Ajo ndaloi, pa ditur nga të shkonte. Shkoi deri tek trangu i pemës së rrëzuar dhe mendoi përse burrat e kishin prerë atë. Nuk dukej i kalbur. Rreth mesit të tij të errët rrathët e viteve dalloheshin qartë dhe mund të numëroheshin. Trangu ishte i shëndetshëm. Ajo vuri dorën përmbi të dhe mendoi për pemën, u përpoq të kujtonte si dukej dhe si fëshfërinin gjethe t e saj.

Pranë trungut, në tokë, kishin lënë një pako të mbështjellë me

letër kafe dhe të lidhur me fjongo të praruar. Ajo u ul mbi trung dhe e tundi pakon. Brenda kishte diçka të lehtë dhe të butë.

Vështroi nga dritaret e shtëpisë, u bë kurioze. E zgjidhi fjongon, e grisi letrën ngjyrë kafe dhe e hapi kapakun e kutisë prej kartoni.

Fillimisht nuk e kuptoi çfarë kishte në të. Në hundë ndjeu një erë që nuk ishte e pakëndshme, i ngjante kashtës, ose dheut, ose letrës së vjetër të orizit. Ishte një fole, në fund të saj pa dy zogj të balsamosur. E lëshoi kutinë. Folenë e nxori prej saj, e ktheu me fund lart dhe e vuri mbi trung.

Ina rrinte në trung dhe vështronte fundin gri të folesë. Kuptoi se nuk kishte dëshirë të takohej me njerëz të panjohur.

Vendosi me vete të ngrihej e të kthehej në shtëpi.

Në oborr hyri një taksi e zezë dhe ndaloi para shkallëve.

Ajo vështroi në drejtim të makinës dhe pa se, nga ndenjësja e pasme zbriti Niklas dhe përplasi derën. Ishte veshur vetëm me mbathje dhe me një kapele të çuditshme kauboj ngjyrë kafe.

Taksia manovronte, kur ai thërriste dhe tundte dorën.

Shoferi ndaloi dhe hapi xhamin. Niklas u afrua, i tha diçka dhe i dha kartëmonedhën që e shtrëngonte me dy gishta. Taksisti përshëndeti me dorë, ngriti xhamin e dritares dhe u nis.

Niklas qëndroi para shtëpisë dhe vështroi dritaret e sipërme. U tund dhe ngriti mbathjet. Në dritën e diellit, lëkura dukej tepër e zbehtë, vetëm qafën dhe duart i kishte të nxira.

Ina u ngrit nga trungu. Ai u kthye dhe e pa. Vështronin njëri-tjetrin në heshtje. Burri shikoi veten, rregulloi kapelën, fshiu fytyrën me dorë dhe u nis në drejtim të saj.

Dukej tmerrësisht keq dhe lëkundej. Sytë i kishte të skuqur dhe mjekrën të kreshpëruar. Mbathjet i kishte të lagura.

Ai e përqafoi dhe e vështroi në sy.

-Ina. Mos u mërzit, e dashur. Do të bëj që ti të ndihesh mirë.

Dalëngadalë, gradualisht, sikur e mora përsëri veten, fillimisht ndjeva duart, pastaj këmbët, barkun, gjoksin, kokën dhe u ktheva prapë në trupin tim. Isha shtrirë në tarracë, në pishinë për fëmijë, kisha mbështetur qafën në buzën e saj. Qielli ishte i kaltër, dëgjoja zhurmën e trafikut dhe krakëllitjen e pulëbardhave. Bota përreth më lëndonte. Ndihesha keq. Më vinte tmerrësisht për të urinuar.

U ula, e spërkata fytyrën me ujë, mora frymë thellë dhe piva. Ndjeva lehtësim.

Dalëngadalë po e merrja veten. Kisha ftohtë. Nga bokserët më pikonte ujë. Aq shumë më vinte bota rrotull, sa që mezi e ruaja ekuilibrin. Parmakët në tarracë tundeshin e lëkundeshin. Këmbët nuk më bindeshin, sikur isha ndonjë plak i rrëgjuar ose fëmijë që mësonte të ecte.

Mora frymë thellë. Vështrova kështjellën dhe pemët përreth saj. Përpiqesha të përqendroja shikimin. Vendi m'u duk i njohur. Dikur, teksa rrija në park pranë kështjellës, mbështesja shpinën pas murit. Dëgjoja krakëllitjet e pulëbardhave dhe heshtjen e gurëve. Përfytyroja historinë e Turkut, plot me luftëra, tregti e rrëmujë. Tani kështjella dukej ndryshe, kishte rënë dhe kishte humbur rolin e saj si themeltare e qytetit.

Në tarracë isha vetëm. Megjithatë, gjithë kohën, kisha ndjesinë se është dikush që kujdeset për mua. Isha i qetë. Mbi një karrige ishin hedhur çorapet e Timos. U kujtova se, kur isha fëmijë gjeta afër vilës sonë, një fshikëz gjinkalle bosh. Imagjinoja si do të dukeshin i mbytur në pishinë për fëmijë – me fytyrën e ngriërë dhe me insektet e ngordhura mbi të.

Ngadalë, rrëshqita përmes dritares dhe u futa në dhomë. Shkova tek dera e pjesës metalike dhe vështrova poshtë. Sami dhe e motra ishin ulur në divan dhe bisedonin. Timo flinte në qoshe i kruspullosur si një lëmsh. S'kishte të tjerë. U mbajta pas

kangjellave dhe, me hapa të pasigurt, zbrita nëpër shkallë.

Sami dhe Salla vështronin si po lëshohesha poshtë duke u lëkundur. E parandieja çfarë bisede do të bëhej pas një çasti: “A, ti je akoma këtu” do të thoshte ndonjëri.

-A, ti je këtu akoma.

“Ke fjetur në nënçati?”

-Ke fjetur në nënçati?

U afrova ngadalë tek ata, por e kisha të vështirë të përqendrohesha. Tiparet e tyre më mjegulloheshin.

“Dukesh tmerrësisht keq.”

-Dukesh shumë keq.

U shemba në divan pranë Samit. Bokserët e mia të lagura më ishin ngjitur pas të ndenjurrave.

-Çfarë ishte ajo substancë? – pyeta unë.

-Cila substancë?

-Ai helmi që më dha i dashuri i Sallës. Timo.

Sami ia nguli sytë Sallës. Hoqi kapelën kaubojsje dhe e hodhi në dysheme.

“Ka marrë ketaminë”

-Ka marrë ketaminë.

-Më vjen keq – tha Salla. – Nuk je ti i pari, të cilit Timo ia bën këtë. Ai është i angazhuar me temën ketaminë dhe e adhuron.

-Ndërsa unë mendoja se është kokainë.

Ngrita prapanicën nga divani, i shqita mbathjet e lagura dhe fillova të qaja.

Sami dhe e motra heshtën. E mbulova fytyrën me duar. Salla u afrua dhe u ul pranë meje.

-Ishte një përjetim i pabesueshëm. Mrekulli. Ju nuk e kuptoni – u thashë unë.

Qava gjatë në shoqërinë e dy vetëve, të cilët nuk i ndieja si të afërt.

-Më porosisni një taksì dhe më jepni para.

-Ku i ke rrobat? Të të ndihmoj t’i gjesh?

-Lëri fare? Do t’i marr një herë tjetër. Tani duhet të kthehem

në shtëpi.

-Nuk e di çfarë adrese ka kjo ndërtesë.

-Thuaj taksistit të ndalojë para portës së kështjellës. Do shkoj vetë deri atje. Duhet të kthehem, menjëherë, në shtëpi.

Doja të isha pranë Inës. Ishte me rëndësi jetike që ta bëja këtë. Sami telefonoi dhe më dha një pesëdhjetëshe. I përqafova atë dhe Sallën. Kërkova xhepin e mbathjeve të lagura, që të fusja kartëmonedhën. Të dy qeshën me mua, teksa lëkundesha i pasigurt. U afrova tek Timo që flinte në pozën e një embrioni. Këmbët e tij të zbathura ishin të pista, sikur kishte ecur shumë pa këpucë. Ia preka me dorë faqen. Lëkurën e kishte të ngrohtë e të lëmuar si fëmijë i vogël.

Jashtë të piqte dielli. Ngrita kokën dhe vështrova nga tarraca e çatisë. Përmes vrimave të kangjellave, dukej një pjesë nga pishina e fëmijëve. Mendova se nuk do ta harroja kurrë përjetimin e atjeshëm.

Një mercedes i zi, me motorin e ndezur, priste para portës së kalasë. Kalova rrugën “Linankatu”. Shoferi doli nga makina dhe m’i nguli sytë. Ishte një burrë trupmadh nja pesëdhjetë vjeç. Flokët ngjyrë gështenje të errët, i kishte lëmuar me xhel. Shikimi i tij ishte vlerësues.

-Natë e vështirë, ë?

-Po-o. Duhet të kthehem në shtëpi.

Ia tregova kartëmonedhën. Shoferi vështroi bokserat e mia të lagura dhe kapelën kaubojs.

-Vëre këtë mbi ndenjësë – tha ai, mori një gazetë nga ato të mbrëmjes dhe ma hodhi.

Hapa derën, vura gazetën mbi ndenjësën e pasme dhe u ula mbi fizionominë e Aneli Jaatenmaki. E mbylla derën dhe i tregova adresën. Ai ngiste makinën dhe më shikonte në pasqyrë të pasme. Rrezatonte një dashamirësi të sinqertë.

“Dhe gruaja të pret në shtëpi?”

-Dhe gruaja pret në shtëpi. Nuk jemi të martuar.

-Do të të duhet punë për t’u shpjeguar me këtë pamje që ke.

-Aha.

-E tmerrshme është. I urrej shpjegimet.

Shoferi më tregoi se, javën e kaluar, një koleg i tij tridhjetë e shtatë vjeçar bëri aksident me motoçikletë në rrugë automobilistike. U përplas me një autobus dhe vdiq në vend. Shumë nga kolegët mblodhën parà për të ndihmuar familjen e tij.

-Nuk e njihja shumë mirë, di vetëm që luante në saksofon. Ka gruan dhe një djalë pesë vjeç. Nëse do më japësh bakshish – shkon për atë.

Nga goja i doli një tingull i shurdhët. Shoferi më vështroi në pasqyrë.

-Më fal. Mëngjes i rëndë.

-Mos kij merak dhe mua më ka qëlluar të humbas pantallonat.

Rrija me duart e lagura të hapura. Njëkohësisht provoja edhe gëzim, edhe trishtim. Doja t’i thosha shoferit diçka të këndshme. U afruam në qendër të qytetit. Në atë mëngjes të diele, qytetarët ishin të veshur lehtë, por, gjithsesi, jo aq sa unë. I vështroja dhe mendoja për Inën. Taksia ecte njëtrajtësisht dhe mua më lindi shpresa se gjithçka do të rregullohej.

PJESA E DYTË

NJERËZIT E PUNËS MENDORE

Në taksi Rejçëll Ferçajlld ishte nervoze. Shoferi ishte një burrë flokëkuq, në moshë mesatare, i cili e quante atë “floriri im”. Rruga deri në hotel “Milenium Gllloçestër” ishte e shkurtër, vetëm disa kilometra, por Rejçëll arriti të mendonte shumëçka.

U përpoq të mos mendonte për Nikolasin, sepse kjo e nervozonte.

Mendimet e saj ishin të përqendruara tek Ali.

Për dhjetë javë kishin arritur të kuptonin shumë. Ai ishte i frymëzuar, i zellshëm dhe tregohej si djalë aktiv. Ishte i zgjuar, kishte ndjenjë humori dhe mësonte jashtëzakonisht shpejt. Nuk i lejonte të butët e të humburit ta thyenin. Por Rejçëll e dinte se ai do të kishte shumë vështirësi, para se të bëhej i zoti për jetë të pavarur.

Ishte fare në fillim të një rruge të gjatë.

Ali kishte mësuar t’i përdorte me zotësi gishtat e tij të rinj. Pikturonte në akualet dhe luante me videolojra. Me protezat gjithçka ishte në rregull për të dhe tani po mësonte t’i përdorte. Në vend të dorës së majtë kishte vetëm një protezë kozmetike. Por në pjesën e dorës së djathtë kishte mjaftueshëm nerva dhe muskuj, të cilat lëvizin në mënyrë gjeniale protezën bionike të bërë nga Nikolasi.

Rejçëll përfytyroi shkëlqimin e vendosur në sytë e tij ngjyrë

kafë me nuancë lajthie dhe u emocionua.

Rejçëll pyeste çfarë dinte, në fakt, për Alin si njeri, dhe jo si jetimin më të njohur në botë, të mbetur nga lufta.

E dinte që kishte lindur në mes të luftës, në shkurt të vitit 1991 në kohën e operacionit “Stuhia e shkretëtirës”. Fëmijëria i kaloi në varfëri e sakrifica të skajshme, të shkaktuara nga sanksionet ekonomike ndaj Irakut. Diktatori fodull dhe paranojak kishte mbajtur një popull të tërë peng. Bijtë e tij psikopatë dhe xhelatët e tjerë të tij e kishin terrorizuar popullin me mënyra të tmerrshme.

Ali kishte jetuar me familjen e tij të madhe në një fshat afro njëzet kilometra larg nga qendra e Bagdatit midis plantacioneve me palma finikase dhe pemë portokallesh. Kishte pasur biçikletë, top futbollit dhe rreth metalik, që e rrotullonte duke vrapuar nëpër rrugën me pluhur dhe duke ëndërruar për oazin e bukur.

Vetëm biçikletën, topin dhe rrethin.

Por lufta ia mori të gjitha këto.

Fillimisht Rejçëll ishte habitur, kur mësoi se Ali kishte dy nëna. Organizimi në familjet myslimane shiite ishte krejt e ndryshme nga ajo, me të cilën ishin mësuar në Perëndim. Burrat kishin disa gra. Në fillim kjo iu duk Rejçëllit gjë e shpifur. Pastaj e kuptoi që nuk mund të gjykonte zakonet e një kulture të huaj, duke u nisur nga e vetja. Dhe në Hejurd Hijt (qytet në Angli – 58 km në jug të Londrës – B) kishin ndodhur gjëra, me të cilat nuk mund të krenoheshë.

Ndoshta në kushtet e ashpra të Irakut jopjellor, ishte diçka e zakonshme që njëra bashkëshorte të sëmurej dhe të vdiste. Atëherë burrit i binte të mbështetej tek gratë e tjera të tij. Me siguri, burri shiit kishte një grua të dashur, ndonjë bukuroshe zeshkane e skalitur, me të cilën ishte i dashuruar më shumë, sesa me të tjerat dhe që kishte nderimin më të madh.

Ndalja e taksisë para hotelit u vuri pikë mendimeve të saj kaotike. Ajo pagoi. Shoferi i shkeli syrin dhe i uroi një mbrëmje të

paharrueshme.

-E tillë duhej të ishte, por jam këtu me shërbim dhe kjo është vetëm punë dhe asgjë tjetër – i tha ajo me një ironi të thatë dhe qeshi.

Para hotelit shikon një grup mysafirësh që përbëhej nga burra, në dukje, autoritarë dhe nga të qeshura, të veshura bukur. Rejçëll vuri ré një burrë që bënte ca gjeste të gëzueshme dhe mbante cigaren me protezë.

Radhazi, kishin arritur, tashmë, anëtarët e Shoqatës së njerëzve me proteza. Makinat ndalonin para hotelit dhe prej tyre zbrisnin e gjymtyrë artificial. Rejçëll u ndie disi e ndrydhur, sepse kishte ardhur në festë vetëm. U afrua tek porta me vendosmëri, i buzëqeshi grupit dhe hyri në hotel.

Holli ishte mbushur plot me njerëz. Mbretëronte një gjendje shpirtërore për një pritshmëri të gëzueshme. Rejçëll e la pallton në gardërobë. Në pasqyrën e murit kontrolloi krehjen dhe grimin. Ndaloj një çast në mes të hollit dhe vështroi përreth.

Vuri ré Ksanadu Kanin dhe Elajza Milerin, të cilët ishin drejtues të Shoqatës së personave me proteza dhe i përshëndeti me dorë. Ata ia kthyen përshëndetjen. Ksanadu kishte humbur dorën në një aksident me skuter në Guinenë e Re. Elizën, në moshë të re, e kishte shtypur treni – i kishte prerë të dy këmbët deri tek gjuri.

Por tani të dy ishin krenarë dhe gati për të festuar. Me siguri ishin një shembull shumë i mirë për Alin. Në një cep të qëndronte, përsipër një mbështetëseje, një dre i balsamosur, mbi të cilin varej një llambadar luksoz. Hoteli nuk shkëlqente - më shumë, rrezatonte rehati shtëpie. Në fund të hollit dy kamerierë mbanin tabakatë me gota shampanje.

Rejçëll u drejtua për tek ata, kur dëgjoi, pas shpine, një zë të gëzuar:

-Rejçëll! Dukesh e mrekullueshme, megjithëse të pashë vetëm shpinën!

Rejçëll u kthye dhe pa sytë bojëqielli të Peni Pendëlltën. Këmbyen puthjet. Peni me figurë atleteje, me flokë ngjyrë lajthi,

ishite fizioterapistja më e re në qendrën e rehabilitimit. Ishte veshur me një fustan të ngushtë ngjyrë floriri, i cili ia theksonte format e gdhendura në fitnes dhe lëkurën e nxirë. Rejçëll e donte atë, megjithëse nuk i aprovonte prirjet e saj për shaka erotike.

Pranë saj qëndronte një burrë mjaft më i madh në moshë se Peni, i cili iu duk Rejçëllit si fytyrë e njohur. Peni i prezantoi me njëri-tjetrin. Ishte Xhek Udrëf, anëtar i këshillit drejtues të spitalit “Queen Mary”. Ai ia mori dorën Rejçëllit me dy duart e tij të ngrohta.

-Është kënaqësi për mua që u njohëm – tha ai. – Peni më ka folur shumë për ty dhe vetëm gjëra të bukura. Në Rouhemptën ju bëni çudira dhe kjo nën vështrimin e kujdesshëm të mediave.

-Faleminderit. Secili prej nesh jep më të mirën nga vetja, por kjo s’ka asgjë të çuditshme.

Burri qeshi.

-Mos ji kaq modeste, Rejçëll. Kuptohet, qendra ka tradita të vjetra. Aty bëhen proteza që nga koha e luftës së Parë botërore. Luftërat nxisin zhvillimin teknologjik dhe sidomos atë të protezave. Nga shumë vende dëgjoj se mjeku juaj Nikolas Strong është vërtet një magjistar. Nganjëherë më vjen ta pres dorën me sharrë që të provoj magjitë e tij.

Doktor Udrëf pa një person, një autoritet të njohur që po kalonte pranë tij, kërkoi falje dhe e ndoqi nga pas.

Rejçëll u kthye nga Peni dhe e pyeti shkujdesur:

-Mos e ke parë Nikolasin? Ose Alin?

Peni e vështroi me një buzëqeshje lozonjare:

-Nikolasin? E dashur Rejçëll, dukesh si vajzë e vogël që kërkon mbështetje tek babai.

-Lëri budallallëqet Peni. Kam dy probleme pune me Nikolasin që dua t’i sqaroj para se të fillojë ceremonia.

-Vërtet? Me siguri është në dhomën e Alit. Janë ruajtur dy dhoma në rastin që festa do të vazhdojë deri vonë dhe Ali lodhet. Dua të të tregoj një të re surprizuese, të cilën e dëgjova dje. Xhaxhai i Alit ka sjellë që nga Bagdati motrën e tij, Lajla. Do të

ulen në aeroportin Nortollt me avionin personal Gëllfstrijm V, të kryeministrit të Kuvajtit. E imagjinon dot? E varfër si mi kishe, vajza fshatare do të fluturojë në Londër me avion luksoz njëzet milionë paundësh.

Peni bëri një pauzë shumë domethënëse dhe vuri pëllëmbën e saj mbi dorën e Rejçëllit:

-Por vë bast se, akoma para mbarimit të kësaj ceremonie, Nikolas do të të propozojë. E kam parë si të shikon – tha Peni me zë të ulët.

-Çfarë ke parasysh?

-Mos bëj, sikur nuk e ke vënë ré. Në çdo moment të përshtatshëm, ai burrë të përpin me sy!

Pulsi i Rejçëllit u shpeshtua. Ndjeu që valë të nxehta po derdreshin mbi fytyrën e saj. Mori frymë thellë. Dhe, papritur, ndjeu erën e koteles.

-Nikolasi? Nuk të besoj, Peni. Ai nuk më kushton kurrfarë vëmendjeje. Komunikon me mua vetëm si kolege.

-Besomë mua. Unë nuk jam vetëm fizioterapiste, por dhe një lojtare me përvojë. Në të tilla gjëra, nuk më gënjejnë instinktet. Midis tjerash, si të duket Xhek?

Kjo pyetje e thjeshtë e Penit, e gjeti Rejçëllin të papërgatitur. Ajo i nguli sytë tek grupi i mysafirëve.

-Aaa. Domethënë Xhek Udrëf. Të lë përshtypjen e një burri shumë simpatik. Dhe është i përkushtuar pas punës.

-Xhek është shumë i mirë – qeshi ngadalë Peni. – Dhe është shumë i zgjuar e serioz. Por është edhe një dashnor i mrekullueshëm dhe kemi pasur çaste të nxehta në krevat.

-Mos thuaj asgjë më shumë.

Atëherë Peni shkoi në tualetin e femrave që të kujdesej për herpesin e saj. Rejçëll vendosi të merrte një gotë shampanjë. E ndiente që kishte nevojë pikërisht për këtë. U kthye që të shkonte tek kamerieri dhe të takonte Nikolasin.

Po dilte nga ashensori. E kishte gjoksin të gjerë, shpatulla të forta, të tendosura dhe ishte veshur me smoking, nën të cilin dukej

këmisha e bardhë borë dhe papioni i zi.

Nikolas dukej shumë burrëror dhe i ngjante aq shumë një grabitqari, saqë, për një çast, Rejçëllit deshi të fshihej pas drerit të balsamosur.

Por ky ishte vetëm një çast.

Pas tij ecte një burrë i shkurtër me mustaqe të zeza. Ishte xhaxhai i Alit. Pranë tij ishte një vajzë flokëzeze, e bukur, e cila vështronte me habi njerëzit që kishin mbushur hollin. Pas gjithë gjasave, nuk i kishte mbushur njëzet vjet. Kishte një lëkurë të zeshkët, shumë të bukur, sy të mëdhenj dhe një fytyrë të mrekullueshme, e cila të bënte të mendoje për kohët legjendare të Hamurapit.

Nikolas u tha diçka xhaxhait të Alit dhe vajzës flokëzeze. Ata u ndalën. Nikolas, i vendosur, qëndroi në mes të hollit dhe hodhi sytë përreth. Rejçëll ia nguli sytë. Ai u kthye pak dhe vështrimet e tyre u takuan. Buzët iu hapën me një buzëqeshje të ëmbël.

Pas pak, erdhi tek ajo me një pamje serioze dhe e puthi në faqe. Pastaj bëri ca hapa mbrapa dhe ia nguli sytë fort asaj.

-Rejçëll, ti dukesh... ti dukesh si... si... Thjesht një mrekulli !

Shikimi i tij ia përkëdhelte fytyrën, qafën, supet, krahët, shtatin, kofshët.

Në sytë e tij lexohej një dëshirë parësore.

Rejçëll ndjeu se u ndez flakë. Pa dashur buzëqeshi dhe uli sytë. Ndoshta Peni kishte të drejtë?

Në atë çast, Rejçëll, mbi gjithçka në botë, dëshironte që Nikolas ta merrte në krahët e tij, ta çonte në dhomë dhe të bënte dashuri me të për gjithë natën.

Kur ngriti fytyrën e ndezur, Nikolas ishte kthyer dhe vështronte diku larg. Pastaj lëmoi mjekrën dhe tha disi i hutuar:

-Më duhet të gjej ndonjë pije për Lajlën. Kishte etje. Por ajo nuk mund të pijë asnjë lloj alkooli. Në këtë drejtim, islami paraqitet si fé shumë e mençur.

-Nikolas edhe unë...

-Më vonë, Rejçëll.

Ai u kthye dhe u largua.

Ajo, e zhgënjyer, ndoqi me sy kurrizin e tij që largohej shpejt. Kishte ndjesinë se do t'i pritëshin këmbët. Pikërisht, kur ndërmjet tyre diçka ndizet, ai e asgjëson.

Asgjëson gjithçka.

U drejtua nga kamerieri dhe mori nga tabakaja dy gota të gjata. U tërhoq tek cepi i hollit, pothuajse u fsheh pas bimëve të gjelbra dhe i piu të dyja gotat me shampanjë të ftohtë me sy mbyllur.

Pas një çasti poshtërimi, shampanja iu duk hyjnore!

Që prapa shkurre, Rejçëll shikonte Lajlën. Vajza qëndronte me sy të ulur pranë xhaxhait dhe priste Nikolasin që t'i sillte ndonjë lëng ose diçka të gazuar.

Duhet pranuar që s'kishte parë kurrë vajzë më të bukur. Papritur ndjeu që po nervozohej. Kjo kuçkë shiite, krejtësisht esëll, qëndronte në një vend të huaj, me sytë në dysHEME, si ndonjë bashkëshorte e virtytshme e imamit në hijen e minares.

Po, Rejçëll e kuptonte se nuk duhet të ketë mendime të tilla. Lajla kishte diçka të përbashkët me sjelljen e Nikolasit ndaj Rejçëllit.

Ajo e la gotën bosh në një tavolinë, ngriti të dytën tek buzët dhe e thau me disa gllënjka të shpejta.

Pas kësaj, mori vendim.

Do t'ia tregonte qejfin Nikolas Strongut.

As që do t'i kushtonte më kurrfarë vëmendjeje.

Po, kurrfarë.

Timo iu përgjigj ziles së tretë. Në zërin e tij të qetë ndihej njëfarë dyshimi. Mendoj se, ndoshta, mund t'i kishte marrë para borxh ndokujt.

-Të telefonon Niklas. Ai i çatisë.

-Po, sigurisht që të mbaj mend.

I thashë se numrin e tij ma kishte dhënë Sami, se po marr nga shtëpia, nga telefoni fiks, sepse celulari, çelësat dhe rrobat i kishin mbetur tek ai. Nuk u kujtova për kartën e kreditit në xhepin e xhinseve.

-Më duhet t'i marr gjërat.

-Po, mund të vish edhe tani, këtu jam.

-Epo mirë, brenda një ore do të jem aty. Kam diçka për të të thënë.

-Çfarë?

-Do të ta tregoj pastaj.

Bëra dush dhe u vешa. Ina kishte lënë mbi tavolinë një listë me ca gjëra që duhej të blija. E lexova. Ishte ngushëlluese që gruaja kërkonte prej meje të blija piperka të verdha. Dhe që do t'i paguaja me paratë e saj. Në korrik tërhoqa shumë qesharake të fundit nga ndihma sociale, e cila deri në mes të vjeshtës u harxhua.

Që nga fillimi i pranverës, shpenzimet për ushqimin, qiranë, ujin dhe energjinë i paguante Ina. Më ndihmonte edhe me kontributet për huatë e studimeve. Është e vërtetë që ishte propozimi i saj, por kjo s'ndryshonte gjë – mua më mbante ajo. Tani ajo ishte e pasur në krahasim me mua. I isha lutur vetë që të mos ma thoshte shumë e saktë që fitonte ajo. Një herë Sami më pyeti, nëse jetesa me paratë e gruas e fyente dinjitetin tim. Jo, iu përgjigja. Jo, aq sa mungesa e parave.

Jashtë kishte lagështirë dhe zagushi. Ndoshta ishte dita më e nxehtë e asaj vere. Vapa më detyronte të pulisja sytë dhe të ecja ngadalë. Balli dhe gjoksi më notonin në djersë akoma pa arritur

pranë bibliotekës, në breg të lumit. Dhe njerëzit që hasja rrugës dukeshin të lodhur e pa humor. Ndryshimet e motit ndikonin tek të gjithë.

Në qoshe të rrugës “Kristinankatu” qëndronte një familje japoneze. Babai fotografonte një burrë të moshuar. Djali dhe vajza qeshnin me të madhe dhe tingulli i asaj të qeshure japoneze me lemezë, më mbeti gjatë në vetëdijen time.

Nga përvoja e ketaminës kishin kaluar dy ditë e net. Akoma ndihesha në një gjendje shpirtërore entuziaste, përjetoja një gëzim të qetë. Ishte një ndjesi e mrekullueshme, me të cilën nuk isha mësuar. Të dielën gërmoja në internet për të kërkuar të dhëna mbi përdorimin e ketaminës dhe lexova përshtypjet e atyre që e kishin provuar. Gjeta shumë gjëra të përbashkëta me përjetimin tim. E njëjta ndjesi për ndarjen nga trupi, për ndjenjën e afrimit të vdekjes, për entuziazmin, për dashurinë e gjithësisë, për shenjtërinë, për kujtimet nga fëmijëria, për ëndrrat, për vegimet kozmike, endjet nëpër rrugë dhe figurat hyjnore.

Deri tek kalaja eca nëpër bregun e lumit. U ndala pak në park, në hijen e pemëve të gjelbra. Vështrova muret e kalasë. Ishte e lehtë të thuhej e të përfityrohej që ishte ndërtuar nga gurët dhe historia. Vetëdija më solli në kujtesë javët plot dashuri për një genie tjetër njerëzore.

Isha i përmbushur me mirënjohje ndaj të gjithëve, madje edhe ndaj vetes. Nuk më mërznisnin as zërat e fëmijëve që bërtisnin para portës së kalasë dhe as nënat e tyre rrumbullake. Isha shumë mirëbesues dhe me gjendje shpirtërore festive prej budallai. Mendova se nëpërmjet kohës dhe gurëve e kam matur rrugën deri tek njerëzit e tjerë.

Kalova rrugën “Linnankatu”. E gjeta lehtësisht sallën e mbuluar me llamarinë gri të valëzuar dhe hyra në oborr. Salla ishte më e ulët sesa e kujtoja. Në tarracën e vogël të çatisë dukej një pjesë e pishinës së fëmijëve. Tojota e bardhë ishte parkuar në oborr. Isha i emocionuar si fëmija që kthehet në shtëpinë e babait.

Dera e sallës ishte e hapur. Timo rrinte në divan me laptopin në

gjunjë dhe me shpinë nga dera. Trokita në kasën e derës.

-Përshëndetje.

Timo më vështroi dhe mbylli kompjuterin. U afrova. Vinte erë boje të freskët dhe polimeri plastik. Kishte veshur një bluzë të bardhë dhe pantallona të zeza. Këmbët i kishte të zbathura.

-Përshëndetje.

-Të falënderoj që më pranove shpejt.

-Këtu është gjithçka kam gjetur.

Këpucët, çorapet, këmisha e zezë dhe pantallonat ishin hedhur pranë divanit në dysheme. Çelësat dhe telefoni ishin vendosur më lart. Bateria i kishte mbaruar. Kontrollova, nëse karta e kreditit ishte në xhepin e xhinseve dhe i futa të gjitha në çantën e shpinës.

-Do diçka për të pirë?

-Faleminderit, jo. Dua të jem esëll.

-Këtu ka vetëm ujë.

-Mundet një gotë.

Timo ngrihet dhe shkon në tualet. Shikoja lëvizjet e tij të qeta. E lëvizte trupin e tij të hijshëm, sikur kjo i jepte kënaqësi.

Kishte një dhunti të rrallë, trupin me proporcione shumë të hijshme dhe fytyrë të bukur. Ishte universal. Në çfarëdo pjesë të botës të binte, do të ndizte dëshirat si të femrave, ashtu dhe të meshkujve. Bukuria do ta dallonte atë nga të tjerët dhe do ta vinte në pozita të vështira.

U kthye dhe i zgjati një kanë të vjetër, të bardhë, të emaluar. Në të ishte stampuar një dredhëz e lulëzuar.

-Faleminderit. Ku është Salla?

-Timo hapi krahët, mblodhi supet dhe më vështroi me vëmendje, sikur të kisha thënë ndonjë gjë të mençur.

-Salla është atje, ku do të donte të ishte.

Kjo përgjigje më inatosi. Mendova se lëkura e tij do të plakej. Tani ishte rreth njëzet vjeç. Do të kalonte kohë dhe trupi i tij i hijshëm do të kërrusej dhe të zhdukej si uji avullues dhe do të linte pas vetes një grumbull çorapësh bosh.

-Si ndihesh? – pyeti Timo dhe u ul në dysheme.

E piva ngadalë gotën. Uji kishte një shije të lehtë, të hidhur, kimike. E lashë gotën pranë divanit dhe fshiva buzët.

-Të shtunën, këtu, kam përjetuar diçka të veçantë. Kurrë s'kam provuar ndjesi të atilla.

Kjo njohje i ngjalli interes atij. Ai u mbështet prapa, duart i vuri përpara dhe përkuli kokën.

-Dhe ato nuk më janë larguar akoma. Vazhdojnë.

Timo buzëqeshi. Kështu i buzëqesh babai të birin, kur e mëson të ngasë biçikletën.

I tregova për të gjitha përjetimet, vegimet dhe ndjesitë. Ai më bëri pyetje dhe kërkoi hollësi, nga të cilat kuptova se flas për diçka mbi të cilën ai ishte menduar shumë kohë.

-Në të vërtetë, unë s'kam frikë nga vdekja. Të paktën jo, pasi jam rritur. Nga sëmundja dhe dhimbja kam frikë, kuptohet. Dhe pas përjetimit shikoj akoma më pak arsye për të pasur frikë.

-Në parim, ëndërron shumë?

-Jo. Ta paktën nuk i mbaj mend.

-Ti je me fat. Rrallë ndodh që ketamina të mbajë dikë kaq gjatë dhe ai t'i mbajë mend përjetimet. Ndoshta nuk e di, por ke një aftësi të rrallë për t'i kujtuar, për t'i diskutuar e për t'i kuptuar.

-Dhe ajo gjendje idiote gëzimi që vazhdon. Sikur më zbulon se, në thelb, jam njeri i mirë – zëri m'u drodh. – Dhe gjërat që u bëj të tjerëve janë të mira. Kurrë s'kisha provuar një ndjesi të tillë. Ose të paktën, jo prej shumë kohësh.

Timo më shikonte në sy. Ishte serioz.

-Ketamina është një substancë kimike e veçantë. Dhe neve na jepet që të mund të rritemi shpirtërisht dhe mendërisht.

-Aha. Kuptova që ketamina është e sintetizuar prej dikujt si Kalvin Stivëns në një laborator në Miçigan në vitin 1962, si mjet gjumëndjellës dhe qetësues dhimbjesh për njerëzit dhe kafshët. Si zëvendës i "Fenciklidinës" më të rrezikshme dhe që "Park Dejvis" ia ka dhënë patentën në vitin 1966.

-Ti noton në sipërfaqe. Unë flas për diçka shumë më të rëndësishme, për destinacionin e saj të vërtetë.

-S' e di çfarë është.

-Rastësisht ndoshta e di që ketamina për herë të parë është përdorur ashtu siç u është dhënë ushtarëve amerikanë në Vietnam?

-E kuptova që është përdorur atje, sepse është një anestetik i mirë, i cili nuk e ngadalëson frymëmarrjen dhe, me ndihmën e saj, kirurgu mund ta operojë të sëmurin, madje edhe vetëm.

Timo u ul këmbëkryq dhe u përkul nga unë. Fliste qetësisht.

-Molekula e ketaminës është shumë, shumë e lashtë. Në botën tonë, nuk gjendet një molekulë e tillë. Ajo nuk ekziston në planetin tonë. Prejardhja e saj fshihet në gjithësi. Gjatë kohës së ekzistencës së saj, ketamina ka menduar, ka vepruar e ndier, duke marrë forma të panumërta të jetës.

Ka treguar rrugën në përputhje me nevojat e tyre. Tani është radha jonë. Dhe kur të zhvillohemi mjaftueshëm, sa për të filluar perceptimin e gjithësisë në figura, ajo do të vazhdojë përpara. Patentimi i saj është qesharak, sa ç'është patentimi i gravitetit tokësor.

E vështroja dhe s'dija çfarë të thosha. Më vinte keq të kuptoja që ajo qenie magjepsëse gabohet plotësisht. Filloi të më vështirosej.

-Ne të dy kemi botëkuptime të ndryshme – i thashë unë, duke buzëqeshur. – Por kjo s'ka rëndësi. Kam disa pyetje për ty.

-Më pyet. Do të përpiqem të të përgjigjem.

-Kam parë publikime, sipas të cilave, ketamina është përdorur si mjet terapeutik.

-Nuk kam shumë njohuri për këtë aplikim të saj. Kam dëgjuar se në Rusi me të kurojnë alkoolizmin dhe varësinë nga heroina.

-Kisha parasysh përdorimin e saj gjatë streseve posttraumatike, siç janë viktimat e dhunës, të aksidenteve dhe sëmundjeve.

-Po, ashtu është.

-Ketamina mund të provokojë ndjesinë se je shumë afër vdekjes dhe kjo u ka sjellë një shumice të madhe njerëzish një lehtësim të madh dhe besimi që jeta është e bukur dhe askush s'duhet të ketë frikë nga vdekja. Gjithashtu, rrit aftësitë e njeriut për të dashuruar, për t'u gëzuar dhe për të shpresuar.

-Edhe unë këtë po them. Doktor Ketamina ka dëshirë që ne të

përparojmë mendërisht dhe shpirtërisht.

-Të supozojmë që dikush ka pësuar një humbje, për shembull vdekjen e një të afërmi. Shkaku mund t'i ketë rrënjët larg, prapa në kohë, për shembull në fëmijërinë e tij. Tani ai pëson humbjen e dytë dhe kjo ngjall trishtim më të madh se e para, frikë dhe pafuqi. Ky njeri nuk do të pranonte të fliste për çka i ka ndodhur dhe vetë ai nuk mund ta realizojë dot në mendje situatën, në të cilën ka rënë. Kjo vuajtje mund shfaqet, për shembull, në kohën e seksit. Prandaj pyetja ime është, nëse i japim ketaminë – do ta ndihmojmë?

Timo mori laptopin nga divani dhe e hapi. Mblodhi vetullat, i menduar. Fytyra e tij e re ndryshoi dhe në të u shfaq njëfarë çoroditjeje. E kuptova sa pa mend vepro, kur kërkoj prej tij t'u përgjigjet pyetjeve. Më në fund, i ngriti sytë e më vështroi.

-Nuk besoj që mund të ndihmojë në këtë rast. Në parim ajo vepron më mirë tek ata, të cilët janë kureshtarë dhe të sinqertë. Por, pse jo edhe në trishtim e frikë. Femrat, në parim, janë më të predispozuar për eksperimente psihedelike.

-E qartë.

-A e do gruan tënde.

-Po.

-Sepse varet shumë prej atij që ia jep ketaminën. Meqë ra fjala, më vjen keq që të lashë në çati. Ishte gabim.

-Jo, unë nuk u ndjeva i vetmuar.

-Kjo vjen nga ketamina. Kjo mund të ndihet nga ana muskulore, por marrja nga hunda është më e efektshme.

-A mund të më furnizosh?

-Mundem, pas një kohe të caktuar.

-Në rregull. Do të paguaj sa duhet.

U ngrita dhe hodha çantën në krah. Dëshiroja t'ia mbathja që andej dhe nga shoqëria e Timos. Kisha frikë se do të humbisja ndjesinë e lumturisë.

-Të shtunën më the që do të ndjekësh mësimin e fesë, kështu?

-Jo. Nuk e mora dot provimin.

-Atëherë, mbetet për herën tjetër.

Nga: Jusi Korpinen s.berlusconi@hotmail.com
Marrësi: esatabermann@vs-sissu.org
Lënda: Plehra

Përshëndetje përsëri, Eka.

Mezi u qetësova nga tmëri që përjetova duke lexuar sajtin tuaj qesharak, kur përjetova një stres të ri, tek gjeta foton tënde online.

E kupton dot çfarë plehu? Me atë mjekër dhe me atë fytyrë ngjan si stalinist në vitet shtatëdhjetë. Por ti je i gjatë vetë 160 centimetra, more.

Shprehuni kundër “përzierjes së panatyrshme të racave”. Epo mirë de, por ti vetë je shembull i shëmtuar i përzierjes së racave, madje dhe i llojeve. Nga ana tjetër qenia, në njëfarë mënyrë të keqe, është ilustrim për atë që ti përmend “Ruajtja e shumëllojshmërisë natyrale”.

Gjëja që më gëzon është se ti nuk je në gjendje të riprodhosh ngatërresën tënde gjenetike. Asnjë grua në moshën për të lindur fëmijë, madje as po të jetë e verbër ose të ketë gjymtyrë të prera nuk do të shtrihej me një shëmtirë të pështirë si ti.

Mund vetëm të të falënderoj fatin që ushtarët tanë në kohën e luftës së Dimrit s’kanë qenë gjermadha si ti. Po të ishin kaq llafazanë dhe të pavlerë si ti, rusët do ta merrnin Turkun brenda një jave.

Jusi Korpinen,
Një finlandez i vërtetë.

2

Pasi iku xhamaxhiu, me fshesën e korentit mblodha copërat e xhamave nga ballkoni. Ina vuri në shportë një shishe shardoné të ftohtë, byrek me mish pule, specë, bukë, fruta dhe ujë. Veshi një fustan të bardhë dhe sandale me taban të trashë.

Futa në çantën e shpinës një shtresë të vogël dhe peshqirët. Veshja një bluzë me logon e Tur Djo Frans dhe pantallonat e shkurtra ngjyrë kaki.

Rrasa në kokë një beretë të markës “Kangol”. Në korridor u pashë në pasqyrë. Sytë i kisha të skuqur. Nuk isha rruar. I ngjaja një sadisti australian të alkoolizuar. E vara prapë beretën në varësë dhe rrëmbeva shportën.

-Gati jemi?

-Po, po.

Ina duhej të ngiste biçikletën e blerë vitin e kaluar. Ndërsa unë mora biçikletën e vjetër të Ionasit. Në fakt, unë nuk e dija, nëse ishte e përdorur, sepse gomat i kishte si të reja, kurse timonin dhe zinxhirët i kishte akoma me vaj.

Kaluam nëpër rrugën “Naantilintie” tek Jurkala, pastaj u kthyem në një rrugë anësore, e cila na hante më shumë kohë, por donim të shmangnim lëvizjen e ngarkuar. Qielli ishte i kaltër. Nga qendra e qytetit frynte një erë e freskët. Bënim një bisedë nga ato që harrohen shpejt. Gëzohesha, kur dëgjoja Inën të qeshte. Nganjëherë qëllimisht mbetesha prapa dhe sodisja me kënaqësi lëvizjet e trupit të saj. Kohë pas kohe prekeshim spontanisht.

Kaluam pranë shtëpive të vogla në anë të rrugës, përshkuam lëndina dhe kodrina. Ina kishte vithe të hijshme feminale, bel të hollë dhe lëkurë të butë, të lëmuar, të nxirë bukur nga dielli. Ishte tridhjetë e një vjeçe. Jetonim së bashku prej tetë vjetësh. Kjo do të thoshte tri mijë ditë e net që përbëheshin nga fjetja së bashku, ushqimi, festat dhe grindjet.

Nganjëherë më dukej se duhej të kishim fëmijë. Ky mendim më lodhte pashmangsisht. Më mërziste aq shumë, saqë nuk më ndahej. Kisha parë sa shumë kohë i kushtonte Johana djalit të saj Aarane. Për fatin e vet, Ina nuk dëshironte fëmijë. Mendimi për ta, e trembte.

Arritëm pranë gjirit Rajsko dhe ndjemë erën e qymyrit që vinte nga Naantali. Kjo më kujtoi artikullin që lexova në mëngjes mbi vdekjen e drejtorit të uzinës së vajrave bimore në Bagdat.

Nga shkrimi kuptohet, se irakianët duhej të mësonin të jetojnë në kapitalizëm me fytyrë njeriu. Drejtori ishte përkrahës i privatizimit të ndërmarrjes që ishte shtetërore, por nuk punonte prej pesë muajsh. Kishte katër mijë punëtorë, prej të cilëve vetëm një mijë punonin. Mjetet e punës ishin mbeturina ruse. Prodhimi aty bëhej vetëm për mungesë konkurrence dhe subvencionimi nga shteti. Qeveria pushtuese amerikane kishte filluar shëndoshjen e ekonomisë së vendit nëpërmjet privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore.

Ekonomia e lirë zotëronte më shumë rezerva nga politikanët dhe burokratët. Drejtori i uzinës së vajrave bimore donte të racionalizonte prodhimin, të kërkonte investitorë dhe të çlirohej nga forca e tepërt punëtore. Një mëngjes ia ndaluan vrullin atij. Sipas dëshmitarëve, tetë burra të maskuar ia vranë shoferin. E nxorën drejtorin nga makina dhe vranë me katër plumba në trup dhe një në kokë.

Naantali ishte plot me familje me fëmijë, nga rrugët e ngushta të pjesës së vjetër të qytetit vinin turistë të huaj dhe finlandezë, kryesisht skandinavë, gjermanë dhe japonezë.

Në ujin e gjelbër në port vërtiteshin varka të bardha me motor dhe varka me vela. Ne mbyllëm biçikletat. Ecëm nëpër bregun e gjirit, kaluam pranë kishës së manastirit dhe varrezës që ndodhej në lartësi midis pemëve gjethegjëra dhe arritëm tek plazhi. Ishte plot me njerëz.

U ngjitëm në një kodrinë plot me pisha dhe aty u vendosëm. Shtriva batanijen. Ina zhveshi fustanin dhe sandalet, u lye me krem kundër diellit, palosi peshqirët si jastëk dhe u shtri që të marrë rreze dielli. Unë u ula në hijen e një pise.

Çanta me sistemin frigorifer e kishte ruajtur të ftohtë verën. E hapa shishen dhe mbusha dy gota.

Piva një gllënjë dhe hodha sytë përreth. Familjet e vendosura në rërë dukeshin miqësore. Dëgjoheshin të thirrura dhe të qeshura fëmijësh. Nga diku vinin tinguj muzikorë. Aty këtu rrinin të rinj me këmbë të dobëta të përthyer, me gjokse të sheshta dhe fytyrat

me puçrra. Dukej se i mundonin shqetësimet seksuale.

Disa nga fëmijët ishin të shëndoshë. Në shkollë, me siguri, ishin objekt talljeje. Shumica e baballarëve ishin barkmëdhenj. Tingëllonin telefonat dhe nënat bisedonin me zë të ngritur me shoqet dhe të afërmit. Në dyqanet e artizanatit dhe në galeri shiteshin gjëra unikale. Fëmijët mbanin veshje shumëngjyrëshe të lira, të prodhuara në Azinë Juglindore.

Në restorantet e bregdetit njerëzit hanin salçiçe, pure patatesh, hamburger dhe pica. Parku për argëtimin e fëmijëve “Mumimaaillma” ishte i tejmbushur. Para sportelit të biletave ishte një radhë e madhe. “Mumjet” shëtisnin midis fëmijëve që bërtisnin, të cilët besonin në ekzistencën e vërtetë të tyre. Foshnjat flinin të qeta në karrocet e tyre, të prodhuara në Kinë.

Vera më turbulloi shpejt. Mendoja për gjëra të ndryshme. Çfarë do të ndodhte, nëse që nga Ajsto, pesëqind metra lartësi, do të na sulmonte gjëmimi shurdhues i avionit F-16, do të lëshonin bombat dhe në qiell do të ngriheshin shtëllunga tymi. Shpërthimet do të na shurdhonin.

Pas rënies së pluhurit dhe tymit, do të shikonim të vrarët dhe të plagosurit. Të spërkatur me gjak, me pluhur e pisllek, mumiet do të largoheshin nga turma njerëzore. Parku i fëmijëve do të zhdukej dhe nga gërmadhat do të nxirrnin kufomat e vogla të fëmijëve pa rënë nata. Të tronditur, të tmerruar, prindërit do të ngrinin grushtat drejt qiellit me dëshpërim e indinjatë e do të ulërinin nga dhimbja.

Përveç artikullit mbi drejtorin e vvarë, në mëngjes lexova edhe për një irakian tjetër – Ali Ismail Abaz, fëmija-yll i luftës së Irakut. Në prill familja e tij ishte vvarë nga një bombë amerikane. Ali kishte humbur të dyja duart. E kishin fotografuar në spitalin “al-Kindi” të Bagdatit dhe fotot e tij kishin bërë xhiron e botës.

Ali u tregonte gazetarëve se, më parë, kishte dashur të bëhej ushtar, por, pas asaj që i ndodhi, vendosi të studionte e të bëhej mjek. Do të vriste veten, nëse nuk do të mund të kishte duar të reja.

Njerëzit në Perëndim u prekën. Masivisht i dhuronin parà,

lodra, veshje dhe shprehnin dëshirën për ta birësuar. Këmbësoria detare e dërgoi Alin në Kuvajt, në qendrën e kurimit të djegieve dhe kirurgjisë plastike, ku atij i vendosën lëkurë.

Lajmi më i freskët për të tregonte se Ali është nisur për në Londër. Atje do t'i përgatisnin protezat në repartin e specializuar për protezat. Rrjedhoja: bombat dhe protezat. Rrjedhimisht do të ishte idiotësi që të ëndërroje për sinqeritetin e ndihmës së njerëzve perëndimorë.

Pyeta, nëse i kishin dhënë Alit ketaminë kundër dhimbjeve. Në zhvillimin e vendit, shpesh, përdorej pikërisht për djegiet dhe vendosjen e protezave. Do të më interesonte të kuptoja cilat kishin qenë vegimet e atij djaloshi shiit njëzetvjeçar.

Ina u ngrit dhe tha se do të shkonte të notonte. Hoqa pantallonat e shkurtra dhe u nisa bashkë me të përgjatë kodrinës.

Uji ishte i ngrohtë. Qëndronim deri në mes në ujë, midis zhurmës së fëmijëve dhe vështronim njëri-tjetrin. U afrova dhe i ia hodha krahët rreth vitheve. E putha me sy mbyllur. Ia përkëdhela të ndenjurit.

Mendova për fëmijët-ikona të gjymtuar në luftërat e mëparshme. Për Kim Fukun vietnamez. Për Irmën e plagosur në Sarajevë. Për djalnin me një sy nga Srebrenica. Për Isa Kamara dhjetëvjeçar nga Siera Leone, të cilin rebelët e kishin djegur në zjarr. Mendoja për ata fëmijë të sakatuar, ndërsa gishtat e mi hynë në mbathjet e Inës dhe depërtuan në organin e saj gjenital. Hapa sytë. Ina më përqafoi dhe më vështronte plot besim. Mori frymë thellë dhe më puthi në biceps.

3

Ina preu byrekun. Filluam të hamë. Pinim verë të ftohtë. E zhvendosëm batanijen në hije. E shtrëngova në krahët e mia dhe ia përkëdhela flokët. Lëkura e qafës së saj, mbante një aromë të mrekullueshme.

-Ti ke menduar për propozimin tim? – e pyeta unë.

Ajo u kthye nga unë dhe më vështroi.

-Po përse të është bërë kjo ide fikse?

-Beso se do të ndiesh kënaqësi. Edhe Timo kështu mendon. Ai di gjithçka për këtë temë. Kjo ka ndihmuar me sukses shumë njerëz nëpër botë.

-Përjashtohet. Ti e di që unë nuk i duroj dot injeksionet.

-Do të të shpoj në krah ose në të ndenjura.

-Nuk më pëlqen të përdor narkotikë në këtë moshë.

-Kush po flet për narkotikë. Ky është ilaç. Madje, yt atë e merrte në fund dhe ishte mbi gjashtëdhjetë vjeç.

-Ai ishte duke vdekur.

-Ke frikë nga vdekja.

-Jo.

-Diçka të frikëson.

-Jam e trishtuar.

-Ajo substancë është e parrezikshme. Vjen nga laboratorit steril. Ua injektojnë shpesh herë edhe fëmijëve.

Ina u shkëput nga krahët e mi dhe i kthye të më shikonte.

-Dëgjo, unë nuk jam fëmijë. E besoj që ke përjetuar diçka tronditëse. Por unë nuk jam ti. Ne jemi të ndryshëm. Ngulite në kokë këtë një herë e përgjithmonë. Kur ndonjë mizë të zukat në kokë – ti nuk dukesh normal. Njësoj si atëherë që fillove të shkruash disertacionin. Kam nevojë për mbështetje dhe është bukur që ti më dëshiron të mirën. Jam e stresuar. Jam vazhdimisht me ankth, e tensionuar. Por, Niklas, përdor logjikën e shëndoshë. Në vend që të më injektosh narkotikë, trego dashuri për mua. Bëj seks me mua më shpesh.

Vështrova përtej saj fëmijët që luanin në breg.

-Atëherë unë do ta injektoj vetë ketaminën.

-Bëje, por mos harro të bësh seks me mua fort.

Dita që kaluam në Naantali la një gjurmë të qartë në vetëdijen time. Me afrimin e mbrëmjes, bregu filloi të boshatisej dhe ne mblodhëm bagazhin. Në tarracë të portit, pimë nga një gotë shampanjë. Lëviznim qetësisht pedalet e biçikletave rrugës për në shtëpi.

Prapa nesh dielli po perëndonte. Hijet tona drejtoheshin nga lindja. Ndiqja Inën me biçikletën e zezë të babait të saj. Pranë gjirit Rajso ndaluam. Ecëm përgjatë një shtegu nën mështekna dhe u ngjitëm nëpër shkallët e kullës ornitologjike. Që andej dukeshin shkurret dhe pemët e vogla në breg të gjirit.

Sodisnim ujin e kaltër dhe shtëpitë përgjatë bregut. Kallamat e gjatë lëkundeshin nga fladi. Qëndroja pas Inës dhe e shtrëngoja pas kangjellave. Ia hoqa fustanin dhe ia ula poshtë tangat. U lagështova menjëherë.

Hoqa pantallonat dhe mbathjet e banjës dhe penetrova në në vulvën e saj. Me dorën e djathtë i përkëdhelja klitorin, me të majtën e shtrëngoja pas vetes. Kjo vazhdoi gjatë. Afër nesh zukasnin grenxat. E shtrëngoja dhe nuk i jepja mundësi të lëvizte. Ajo u qetësua. Harroi për grenxat. Përkuli supet dhe kokën mbi kangjellat dhe bërtiti në ekstazë.

Afër mbi bar fluturonin zogjtë. Ajo merrte frymë rëndë e mbështetur tek kangjellat, pastaj më shtyu dhe u kthye. Ngriti tangat e rëna në tokë dhe e mori penisin tim në gojë. E vështrova në sy. Ata ishin plot frikë të pashprehshme. Ajo mbylli sytë. Ashtu bëra dhe unë.

4

Të premtën shkoi në mbledhjen e grupit të vet. U ndava me të, e mbusha çantën e shpinës dhe thirra një taksì. S'kishte kuptim të mbaja as bagazhin më të lehtë në atë vapë.

Prapa xhamit në kasën e biletave të stacionit ishte ulur një grua zeshkane trupmadhe e veshur me uniformë bojëqielli të punonjësve shtetërorë të hekurudhave. Buzëqeshte. Jo se ishte e trashë, thjesht përmasat e saj ishin të mëdha. Koka, shpatullat, gjinjtë, qafa, duart, gjithçka dukej si e prodhuar për Boeing.

Kur e la biletën në sportel dhe kusurin pata frikë nga dora e saj e madhe. Mbahej mirë, e formuar mirë, me thonj të gjatë me

manikyr në ngjyrë të pruar, por për dorën e një femre – ishte e madhe, më e madhe se e imja dhe fshihte forcë të tmerrshme. Më erdhi në mendje t’i lutesha që të rrinte pak drejt.

Ana me e mirë e parave është mungesa e karakterit të tyre. Ajo zhvesh marrëdhëniet individuale të punës dhe kalon çdo pengesë. Dikush i zgjati kartëmonedhat. Një person është - klient, ose punonjësi i personelit dhe e harron këtë për gjysmë minute.

Por në sallën e pritjes të stacionit, dora e gruas bën të lindin midis nesh marrëdhënie individuale. Nuk mund të mos e vija ré që, pikërisht ajo ma dha kusurin, edhe kur tërhiqja bagazhin tim nëpër peronin e ngrohur nga dielli dhe, pastaj brenda në vagon kisha ndjesinë se e bartja me vete atë dorë, dorën gjigande të lëshuar në sportel dhe mendova, nëse Ina do të kishte një dorë të tillë, nuk do të mund ta doja.

Treni fluturonte përmes peizazhit të gjelbër. Fushat plot me bimësi zverdhonin. Udhëtimi ishte i këndshëm. Në kabinën e freskët, përveç meje, ishin edhe disa vetë. Askush nuk i kushtonte vëmendje askujt.

Po pija pak verë të bardhë, kur vura ré se të gjithë hambarët pranë linjës hekurudhore ishin të vjetruar dhe të shtrembëruar. Por edhe fermerët me qëllim i kishin bërë kështu që të ngjallin keqardhje tek vëzhguesit e bashkimi European. Çdo natë shkonin fshehurazi me traktorë, shpërthenin trarët mbështetës me zinxhirë dhe i tërhiqnin, derisa ndërtesa të anohej akoma më shumë.

Në stacionin Lojma nxora nga çanta librin e Kirkegor “Stadet në rrugën e jetës” të cilën e lexoja për herë të dytë. Nuk e besoja që edhe këtë herë do ta çoja deri në fund, megjithëse në disa vende ishte i bukur dhe zbavitës. Kërkova një pasazh të shënuar m parë, në të cilin Johannes Klimakus përshkruan kotësinë e jetës së tij si i ri dhe që, gjatë leximit të parë, më solli një ngushëllim të madh. E lexova prapë: “Dhjetë vjet mësova. Nuk jam dembel, por nuk kam arritur asgjë. Kam lexuar shumë, por e kaloja kohën pa bërë asgjë – në përtaci dhe mendim ose në mendim dhe përtaci.

Shpejt do të plakem, thosha me vete, dhe s’kam arritur

pothuaj asgjë. Ndërsa kthehesh diku, në jetë dhe në letërsi has emra dh njerëz, të respektuar dhe që meritojnë admirim, sepse me veprimtarinë e tyre e kanë bërë jetën e shoqërisë më të lehtë: dikush ka ndërtuar hekurudhë, tjetri omnibus ose anije, dikush tjetër aeroplan. Ka mendimtarë dhe shkencëtarë, punimet dhe njohuritë e të cilëve kanë rëndësi të madhe për shoqërinë.

Po ti çfarë bën?”

Pyetja ishte e rëndësishme dhe si të gjitha pyetjet e rëndësishme – shumë e vështirë. Për disa javë nuk i hapa dosjet e disertacionit tim. Kisha lexuar shumë artikuj, kisha përkthyer faqe nëpër libra, tek të cilat do të kthehesha më vonë, kisha bërë një grumbull fotokopjesh në makinën e universitetit, i kisha klasifikuar nëpër dosje, isha ulur në karrige me amortizatorë gazi, u kisha dërguar mesazhe fyese nazistëve.

Diku afër Krishtlindjes më ndodhi diçka tronditëse. Atëherë po rrija në kabinetin tim dhe lexoja një artikull nga gazeta filozofike “Niin& nain”, i cili më dukej i pamundur për t’u kuptuar. E lashë. E lexova prapë, duke shënuar pikëpyetje me lapës. Ajo faqe më kujtoi se si, para dhjetë vjetësh, me Korpinenin kishim bërë zakon të organizonim, në apartamentin tonë, takime, të cilat i quanim rrethi lexues.

Merrnin pjesë dhjetëra vetë. Uleshim në dysheme në dhomën e ndenjjes të pamobiluar, pinim kafe, çaj, verë shtëpie, thërrisim e diskutonim deri në mbrëmje, tekstet që kishim lexuar nga Sheling, Niçe, Hajdereg dhe Derida. Në ato rrethe, pothuajse mungonin femrat. Koha kalonte. Dhe askush asnjëherë nuk thoshte: “S’kuptoj asgjë prej kësaj”.

Fytyrat tona të reja ndizeshin – unë rrija në kabinet dhe i kujtoja këto me qartësi kristali. Godita kofshën me dorë. Gjërat brenda meje u lidhën nyje. Nuk e desha këtë. Fillova të qaja. Njerëzit e rretheve lexuese u zhdukën nga vetëdija ime, ndërsa lotët më pikonin mbi gazetën e hapur. Ishte diçka e pështirë. Qava deri sa u qetësova. Fshiva fytyrën me perde, mora frymë thellë dhe i urova Korpinenit të ketë sukses në atë që unë kisha dështuar.

Moti në Tamper ishte njësoj si në Turku. Ishte verë. Hoteli ishte në rrugën “Hameenkatu”. U gëzova që në dhomë kishte kondicioner.

Në mbrëmje kalova nëpër baret e Doganës dhe të Ndërtimit të anijeve. U ula vetëm dhe vështroja të tjerët. Askush nuk më foli. S’ma ndiente fare. Thithja cigaren dhe pija. Mendoja për veten time. S’mund të bëja asgjë.

Në tarracën e ndërtimit të anijeve mendova për atë çast, kur shpirti im përpiqej të ndahej nga trupi. Ishte vetëm një çast. Gjatë atyre viteve kam përjetuar mjaft incidente. Kam rënë, jam goditur, jam lënduar dhe dy herë gati sa nuk jam mbytur. Kam dëmtuar kokën dhe gjymtyrët. Isha krenar që në Finlandë ka dy liqene, në të cilët edhe për pak do mbytesha. Hera e dytë ishte në liqenin Kakseran. Atëherë Ina jetonte në Londër. Ishte dita e mesit të verës. Zjarri digjej dhe në agim unë u pengova duke ecur në molin e vogël dhe godita kokën pas një varke motorike. Sami pohonte se duke rënë, kisha arritur të thosha: “Prapë?”.

Të premten, kur po pinim një gotë, Sami më tha diçka fare të thjeshtë, nga e cila kuptova se ai e donte Leenën. Pasatj me tregoi se do të martohen dhe do të nisen për në Koh Samuj. E pyeta sa e kishte ndryshuar atë kjo gjë. Ai heshti pak dhe m’u përgjigj: “Tashmë unë vendos rripin e sigurimit, kur ngas makinën”.

Sipas meje kjo ishte një përgjigje shumë e mirë. Vdekja përbëhet nga arkivoli, lulet dhe ngushëllimet. Njerëzit si Sami janë miq të vërtetë dhe për ata je gati të hidhesh në zjarr.

U ktheva në hotel. Hapa minibarin dhe i telefonova Inës. Zëri i saj më bëri përsëri të zhytem në kujtime. Disa njerëz i argumentojnë marrëdhëniet familjare me teorinë e aromave. Por, për mendimin tim, në dashuri zëri është më i rëndësishëm. Ina më tha që mbledhja e grupit që merret me mitologjinë ishte e padobishme.

Më njoftoi se fqinji nga kati i sipërm i kishte bërë vizitë. E kishin kaluar mirë, kishin folur për gjëra të ndryshme dhe kishin pirë verë. Kujtimet më kthyen prapa në kohë, kur Ina ishte vajzë dhe unë djalosh. Biseda na ecte, edhe pse, në të vërtetë, nuk flisnim për të njëjtat gjëra.

Hapa një pornokanal. Jeta është plot çudira. Pija alkool dhe cigare në një hotel familjar, në të cilin pirja e duhanit ishte e ndaluar. Në gjendje të përgjumur shikoja nga krevati filmin dhe, papritur, ndodhi diçka magjepsëse, diçka si magji. Regjisori gjenial kishte vendosur ta linte surprizën në fund.

Ngjarja zhvillohej në sallonin e një shtëpie në breg të oqeanit të qetë, i cili kaltëronte përtej dritares. Divanet ishin me damask të bardhë, ndërsa dyshemeja nga një dru i ndritshëm. Burri ishte nxirë dhe muskuloz, gruaja e hijshme, nga Europa Lindore, e cila mund të ishte si vajza më e bukur e Shkupit, ashtu dhe nga Tretruvizusta – krenaria e babait postier. Tani i ishte nënshtruar një operacioni plastik për rritjen e bustit dhe e nxirrte bukën me porno në SHBA. Ajo ishte pa emër, s'kishte atdhe, me gjymtyrë të hijshme, punonte me prodhuese të ndryshëm filmash pornografikë, xhirohej në skena seksi dhe bënte seks tmerrësisht mirë.

Kjo dyshe ishte profesionaliste dhe i bënte të gjitha ashtu siç duhej. Dhe atëherë brenda fluturoi një zog i madh ngjyrë gri e çelur dhe u përplas në dritare, i rrihte krahët pas xhamit në panik, duke u përpjekur të fluturojë jashtë.

Burri dhe gruaja ngrinë në vend në pozën anale dhe ia ngulën sytë zogut. Gruaja thirri në gjuhë të huaj dhe qeshi. Burri bëri të njëjtën gjë dhe e nxori organin prej saj. Qeshën së bashku.

Ajo rrinte afër tij me dorën mbi fytyrë, duke qeshur akoma, pastaj e lëshoi dorën mbi kofshën e burrit. Pavarësisht nga gjinjtë e mëdhenj, ajo, në atë çast, i ngjante një vajze të vogël. Burri hodhi krahun tek shpatullat e saj, afroi faqen tek e saja dhe e përqafoi. Gjesti ishte plot ëmbëlsi. Prapa tyre zogu përplasej në xham dhe krakëllinte. Burri dhe gruaja përqafoheshin, e qeshura u qetësua dhe ekrani u errësua.

Në gusht të vitit 1991, Ina më njoftoi, si midis tjerash, që do të shkonte si guvernante në Londër. Ishim në sauna dhe rrinim të mbështjellë me peshqirë në shkallë. Mbrëmja u freskua dhe qielli u zverdh. Brenda, Ionas merrej me enët në kuzhinën e ndriçuar.

Nën pemët e mollëve ishte errësirë. Dera e hyrjes ishte e hapur. Ionas shtronte tavolinën. Ndjeva që brenda në trupin e nxehtë nga sauna dhe vera më kaloi një dridhje e akullt. Piva një gotë me birra deri në fund.

-Kur? – pyeta, duke u përpjekur të ruaja qetësinë.

-Pas tri javësh. Në Kesington.

Nga buzëqeshja që i kaloi në fytyrë ndjeva një dhimbje aq të fortë, saqë gati e lëshova gotën.

U veshëm dhe u ulëm të hamë darkë. Nuk pati shumë biseda. E piva verën në gotën time dhe Ionas ma mbushi prapë. Ai duhej ta dinte çfarë më tha Ina.

-Do shkoj të shtrihem. Ju, me siguri, doni të flisni. Natën e mirë – tha ai dhe hyri në dhomën e vet të gjumit.

Mblodhëm enët nga tavolina, vumë makinën enëlarëse dhe u ngjitëm në dhomën e Inës. Ajo u shtri në krevat, në bark. Ishte veshur me një triko të zezë dhe bluzë të kaltër. I kishte prerë flokët shkurt dhe i kishte lyer me bojë të çelur. Cullufja i kishte shkuar djathtas dhe kjo i jepte pamje djali. E doja atë kështu. Më pëlqente t’i largoja kaçurrelat nga fytyra e saj. Tani rrija në qoshe të dhomës në karrigen lëkundëse, të veshur me lëkurë.

Ajo më tha se i kishte dërguar dokumentet në agjencinë ndërmjetësuese që në maj. E pyeta përse nuk më kishte thënë. Nuk u përgjigj. Mendova verën e kaluar së bashku që kishte filluar me festën e shkollës, çastet e bukura, të cilat mendoja se do të vazhdonin gjatë.

Ina i dhà me sukses provimet për mësuese në shkollën fillore, kurse mua, me vlerësim të keq, më qëlloi specialiteti “Historia e

kulturës”. Nganjëherë imagjinoja si do të dukej banesa jonë, raftet me libra e dosje, të renditura sipër një tavoline pune prej druri, dokumentet, dhoma e gjumit, dritarja e së cilës binte mbi lagjen në stilin “Art nuvo”, mbi të cilën do të shtroheshin flokët e borës.

-Do të rrish gjatë atje?

-Të paktën një vit.

U ula, i paaftë për të thënë diçka. Nga kati i mëposhtëm dëgjohej zhurma e makinës larëse. Poshtë nesh, Ionasi, me siguri rrinte shtrirë me sy hapur dhe vështronte tavanin me një fytyrë pa shprehje dhe me irisët e errët.

-Nganjëherë bëhesh djalë tmerrësisht i ngrysur – tha Ina pas një heshtjeje të gjatë.

-Atëherë duhet të më ndihmosh.

Ajo më vështroi, u ngrit nga krevati, m’u afrua, mbështeti dorën në kofshën time dhe më puthi në faqe.

-Zhvishu.

-Nuk dua.

Ajo u ngrit, tërhoqi batanijen nga krevati, e hapi mbi bibliotekë e mbi tavolinë që të formohej ndërmjet nesh diçka si çadër, ku kishte vend mjaftueshëm për të dy. Shtroi edhe në dysheme një batanije dhe vuri dy jastëkë. Mori nga rafti i fundit i bibliotekës llambën e natës dhe e ndezi.

-Kjo është foleja jonë. Hiqi rrobat.

-Jooo.

Doli para meje dhe ma tërhoqi bluzën nga sipër. I ngrita krahët, megjithëse më vinte ta qëlloja. Ma nxori bluzën nga koka dhe më urdhëroi të drejtohesha. Zbërtheu rripin dhe kopsat e pantallonave të mia dhe i uli poshtë bashkë me mbathjet. Zhveshi trikon dhe bluzën e vet, u ngjesh pas meje dhe i vuri duart e mia mbi të ndenjurat e veta. Krahët e mi vareshin si të paralizuar. Pas çdo çasti që kalonte unë ndieja gjithnjë e më shumë pështirosje. Ajo më kapi për krahu dhe më çoi në çadrën e improvizuar.

-Mbylli sytë.

-Nuk dua.

-Mbylliii.

E bëra, teksa ajo filloi të më përkëdhelte ngadalë gjithandej, i kalonte gishtat nëpër fytyrën time, në ballë e në qafë, lëmonte gjoksin, kofshët, gjunjët, testikujt e mi dhe penisin, sikur kërkonte të më fotografonte me gishtërinj. Prekjet e saj më bënë të gëlltitem. Ia ndalova dorën mbi barkun tim, pastaj e kalova më poshtë.

Hapa sytë dhe ktheva fytyrën. Në llambën e natës tavolina e ngrohtë e purpurt ngrihej më lart dhe formonte një figurë të ngjashme me penisin. Sipas meje, këto llamba paraqisnin shakara, por, pastaj m'u kujtua Rejma, mësuesi ynë i biologjisë dhe gjeografisë në gjimnaz, Rejma Mak, një burrë trupmadh me mustaqe, i cili kishte problem me alkoolin, por e donim për hir të ndjenjës së humorit dhe notave dorëlëshuara. Dhe sepse ishte mësues i mirë.

Thoshin që, një mëngjes, erdhi, parkoi në oborr të shkollës, aq i dehur, saqë s'dilte dot nga makina. Mësuesi i fizikulturës e pa, e shtriu në ndenjësen e pasme, ngau makinën vetë dhe e çoi mbrapsht në shtëpi. Pëshpëritej që gruaja dhe vajza nuk e praninin.

Një herë në mësimin e gjeografisë, Rejma e errësoi klasën dhe vuri mbi katedër një llambë të ndezur, si të kuqërremtë. Donte të na ilustronte karakterin e rrymave konvektore. Preku xhamin e llambës dhe shpjegoi çfarë ndodh brenda.

Rrymat e kuqërreme të substancës e ndryshonin formën në mënyrë të paparashikueshme, binin, ngriheshin prapë dhe prapë binin. Rejma na shpjegoi se, pikërisht kështu, llava e shkrirë në koren e tokës zgjerohet dhe ngrihet, pastaj, duke u ftohur, bie prapë poshtë. Këto procese shkaktojnë lëvizjen e ngadalshme të kontinenteve dhe kështu lindin malet. Na shpjegoi gjithashtu se, pikërisht këto dukuri, kryhen pandërprerë edhe në atmosferën tokësore dhe në brendësinë e yjeve, duke përfshirë edhe diellin tonë.

Klasa dëgjonte në heshtje dhe ia kishte ngulur sytë burrit të madh, i cili rrinte i ndriçuar nga drita e zbehtë e llambës, prekte xhamin dhe fliste qetësisht, sikur gjithçka kishim brenda vetes dhe

dritës mund të kuptohej, duke studiuar atë llambë. Duke përfshirë edhe atë që rrija shtrirë nën batanije, i prekur nga Ina që do të nisej shpejt për në Londër dhe vështroja gjuhët dhe mendimet që ngriheshin e uleshin, që kështu ishte dhe nuk ishte.

Ina e kapi me duar fytyrën time dhe e afroi nga vetja. Më përkëdheli sytë. Ngriti njërën këmbë mbi mua, u ngjesh mbi pjesët e mia intime. Ma mbajti kokën me duar dhe, ngadalë, e fërkoj organin e vet pas penisit tim, pastaj e futi brenda vetes, centimetër pas centimetri, gjinjtë e saj u ngjeshën pas gjoksit tim dhe kaçurreli i saj më përkëdhelte fytyrën. Ajo ndaloi, më puthi në faqe, afroi gojën tek veshi dhe filloi të tregojë.

Më tha që jam një ishull. Qetë, me zë të butë, thoshte çfarë shikon tek unë dhe përreth meje. Det, një mal të madh, shkëmbinj që rrokullisen prej tij, shkëmbinj të bardhë, të lëmuar, barëra të gjata dhe në to – zjarr.

Më shumë se barërat, shkëmbinjtë, halorët, zjarri dhe hijet e pulëbardhave nëpër shkëmbinj, jam unë mes disa pemëve, kështu tha ajo dhe unë pashë mbi vete drurë të lartë, ajo fliste siç donte, teksa rrija shtrirë pranë saj, duke dëgjuar dhe duke parë gjithë këto, pa mundur të bëja asgjë. Edhe për pak sa nuk e lëndova keqas, atëherë, sepse kërkoja ta kisha përgjithmonë.

7

Të premten Ina u nis për në mbledhjen e rrethit të mitologjisë dhe e la Niklasin, i cili do të shkonte në seminarin veror afër Tamperit, duke paketuar bagazhin. Kur u ndanë, të dy u ndjenë të kënaqur që do të ndahen për disa ditë.

Para derës së jashtme, Ina ndaloi dhe nxori nga çanta syzet e diellit. Atë verë, për herë të parë në jetë, kishte filluar të flinte lakuriq dhe të përdorte syze të errëta.

U kthye në rrugën “Aninkajstenkatu”. Një burrë i dobët flokëzi

u preu rrugën para dritave dhe shigjetave të makinave. I ngjante një turku kurd ose një irakiani. Njëri nga shoferët i ra borisë dhe burri tundi një qese gjysmë të tejdukshme, në të

cilën kishte sallatë jeshile. Kur kaloi pranë Inës, ajo vuri ré se burrit me mustaqe i mungonte syri i majtë, në vend të tij, kishte një gropëz të zezë. Ina e vështroi me syzet e errëta dhe e imagjinoi, tashmë, të zbardhur, të rrëzuar në dyshtemenë e dhomës së qetë, teksa syri i shëndoshë errësohej.

Në rrugën “Eerinkatu”, ndërsa shikohej në vitrinën e një dyqani pengjesh, ndjeu, njëkohësisht, edhe krenari, edhe turp. Fustani i zi, i ngushtë i rrinte mirë, nxirrte në pah këmbët e saj të hijshme e të forta dhe ajo e dinte se dukej mrekullisht. Në ajër ndihej se, tashmë, po kalonte ajo.

Në sheshin “Kaupatori” përballë saj, vinte një burrë i moshuar, i veshur me një këmishë ngjyrë kanarine në të verdhë, i cili mbante një kuti me ëmbëlsira, të lidhur me një shirit të bardhë. Ecte i kërrusur, me mundim.

Ina u këmbye me të dhe, me mendje, uroi që të mos i hante vetë dhe që lidhësja të mos i këputej në mes të rrugës së tij të vështirë. Shpejt do të vinte dita, në të cilën dikush t’ia pastronte këmishën nga thërrimet, do t’ia zhvishte, do ta t’ia hekuroste dhe do ta paloste diku dhe askush nuk do ta dinte çfarë gëzimi do të provonte ai burrë i veshur me të.

Ina hyri në qendrën tregtare “Hansakopteli” përmes portës lëvizëse. Megjithëse nuk ishte herët, qendra ishte bosh. Disa vajza të veshura me të zeza po rrinin pranë shatërvanit dhe lëpinin akullore.

Duke kaluar pranë tyre, Ina vështroi flokët e tyre të krehur pa vijë dhe kuptoi se do të kishin gjithë kohën e botës, derisa të fillonin të stresoheshin siç duhet dhe, kur flokët e tyre të vjetër, përsëri do të jenë të shpupurishur dhe, atëherë, ndoshta do të kujtojnë se si, dikur, hanin akullore nën çatinë prej xhami të qendrës tregtare.

Në katin e parë, në një tavolinë të nxjerrë para kafenesë së mbyllur, rrinte një çift dhe ziheshin. Gruaja bërtiste, ndërsa ai

përgjigjej i nxehur por me zë të ulët. Ina, si me turp, kaloi pranë tyre, teksa jehona e zërit të tyre përplasej në dyshtemenë e gurtë dhe në vitrinat e dyqanit; po ngjitej në katin e dytë të ndriçuar më mirë dhe ajo mendoi sa të padurueshme janë marrëdhëniet njerëzore.

Në korridorin pak të errët të Komisionit të artit, binte erë kafeje. Ina hoqi syzet e diellit. E priti drejtuesi i rrethit dhe ia shtrëngoi dorën me entuziazëm. Ishte rreth dyzet vjeç, flokëzi, me syze – flokët e gjatë i kishte të lidhura bisht kali. Ai e ftoi të merrte kafe dhe ëmbëlsira, i tregoi sallën, në të cilën do të mbledheshin:

-Atje është ulur vajza ime Ada. Sot jemi bashkë.

Në krye të tavolinës së mbledhjes ishte ulur një vajzë flokëzezë, fytyra e së cilës, mezi dukej që andej. Ajo ia nguli Inës sytë seriozë. Ina buzëqeshi:

-Përshëndetje Ada. Unë jam Ina.

Ina mori një kafe, një gotë ujë dhe u ul në tavolinë pranë vogëlushes. Ajo ishte një qenie e vogël e nxirë nga dielli. Para saj ishte një gotë me qumësht dhe një pjatëz me dy kekë të vegjël. Në gjunjët e saj të nxirë, të zbuluar nga fustani veror i ngritur lart, dukeshin kore plagësh të vogla. Ajo këqyrte Inën dhe tundte këmbët e saj të zbathura. Sandale e saj ngjyrë të kuqe të hapur ishin nën tavolinë.

Ina përziante kafën me lugën e vogël dhe çuditej, nëse mund të fliste Ada. Rrinin në heshtje. Ina pinte kafën dhe shikonte në dritaren përballë. Përmes dukeshin degët e një shkurreje trëndafilash dhe qielli blu. Salla ndodhej në bodrumin e qendrës. Ina po mendonte me habi sa të largëta i dukeshin tani vitet, kur kishte qenë mësuese. E dinte se nuk do të jepte mësim më.

Ajo po kujtonte se si ishte takuar me drejtuesin pothuajse të panjohur të rrethit në prill, në parkun afër Muzeut të arteve. E kishte pyetur çfarë të rejash kishte. Ina i tha se i kishte vdekur babai. Ai e ngushëlloi dhe e ftoi t'i bashkohej rrethit.

Dalëngadalë filluan të vijnë pjesëtarët e tjerë të rrethit. Përbërja e tij kishte ndryshuar me kalimin e kohës. Grupit i ishte bashkuar

një burrë rrumbullak, i parruar, i cili, me siguri ishte më i ri nga sa tregonte. Ishte larguar regjisori mendjemadh. Ina ishte e kënaqur. Regjisori bënte monologë të gjata, të mjegullta dhe shpërthente në të qeshur në momente që shkaktonin shqetësim. Ai me siguri mendonte për guru-në hiperealist të dramës.

Pjesëmarrësit e grupit, qetësisht, duke tringëllitur me filxhanët e tyre, u ulën përreth Adës në tavolinë, sikur ajo të ishte drejtuesi dhe, shpejt, do të hapte mbledhjen. Vajza mori një kek nga pjata dhe i mori erë.

Drejtuesi u ul në anën tjetër të tavolinës, ngriti dorën dhe buzëqeshi.

-Epo, mirë se erdhët. Siç e shikoni kemi disa ndryshime – Juoni na ka lënë dhe në vend të tij ka ardhur Sepo. Nga pikëpamja profesionale, Sepo është një thesar i vërtetë, ai është teolog. Mirë se erdhe Sepo.

Teologu dukej i ndrojtur, përshëndeti dhe u mbështet në karrige. Ina ndjeu se rrobat i vinin era thartirë.

-Do t'ju njoh me Sepon. Pranë teje është Ina, mësuese e shkollës fillore, e cila, që nga pranvera, është pa punë. Kështu apo jo?

-Po.

-Përballë Inës është Majla, e cila është gazetare dhe kritike teatri.

Pavarësisht nga vapa, gazetarja kishte një veshje leshi me shumë ngjyra që të kujtonte orkestrën indiane që luante në sheshin “Kaupatori” dhe lamat që kullosnin në livadhet mbi malet e larta. Ndoshta në ato rroba, sipas saj, fshihej një romantikë delikate revolucionare.

Pranë saj ishte ulur një grua shpatullgjerë, rreth të pesëdhjetave, e veshur me një bluzë të zezë, me flokët të prera shkurt. Kishte sy të mprehtë dhe rrudha në faqe që flisnin për përvojë të gjatë në jetë.

-Tulla është punonjëse sociale dhe briri i realizmit në grupin tonë, nëse mund të shprehem kështu.

-Mundesh.

Drejtuesi buzëqeshi.

-Unë jam Ari dhe sot me ne është vajza ime Ada, shtatë vjeçe. I përket brezit që duhet ta gëzoj me idetë e mia. Përshëndeti njerëzit Ada.

Vajza përshëndeti me dorën e vogël, në të cilën mbante kekun gjysmë të ngrënë.

-Mendoj që është e domosdoshme të përsëris edhe një herë idenë për këtë projekt dhe pjesëmarrjen tonë në të. Ju mund të shtoni diçka, nëse e quani të nevojshme.

Ai tha, se objektivi i grupit të projektit përbëhet nga fëmijë 7-9 vjeçarë të emigrantëve dhe moshatarët e tyre finlandezë. Projekti realizohet prej mësuesve, tre artistë dhe anëtarët e komisionit bashkiak për artin. Financimi vjen nga administrata e qytetit, nga Muzeu dhe dy fondacione.

Praktikisht fëmijët do të stërviten në seminarin e fotografisë, do të ketë ekspozita me fotot e tyre dhe nga Krishtlindja do të organizohen tri shfaqje në shesh para qendrës tregtare, të cilat, përveç fëmijëve, do të ndiqen dhe nga qytetarë të tjerë.

Ai mori zjarr. Ideja ishte që të mblidhnin mbi nëntë fëmijë nga kombësi të ndryshme, të cilët së bashku të ndikojnë në kryerjen e punës së përbashkët. Njohja e gjuhës dhe përvoja e tyre duhet të jenë të ndryshme. Ishte e rëndësishme që të gjithë të kishin mundësi të njëjta për pjesëmarrje. Prandaj, si qasje, ishte zgjedhur mitologjia.

Detyra e pjesëmarrësve në rreth ishte që të gjenerojnë ide, të lidhura me botën e miteve, të cilët fëmijët do t'i zhvillojnë vizualisht, në mënyrë figurative dhe do të shërbejnë si bazë për imagjinatën. E rëndësishme është që mendimet fëmijëve për botën të mos jenë të ngarkuara me ndikime politike dhe fetare.

Drejtuesi tha se besimi i tij në domethënien e projektit gjatë muajve të shkuar është rritur. Edhe në Turku është rritur tensioni etnik. Nacionalizmi është gjallëruar, siç e kanë vënë re të gjithë nga lajmet e masmediave. Ne nuk mund të ndikojmë mbi ngjarjet

politike botërore. Domethënë ky projekt do të jetë një hap i vogël, por i rëndësishëm përpara, i cili mund të ketë një prurje të madhe në të ardhmen.

Ai buzëqeshi.

-A keni ndonjë pyetje?

-Cilit besim fetar i përkasin këta fëmijë? – pyeti teologu.

-Do të jenë të krishterë, katolikë dhe ortodoksë, myslimanë dhe hebrej. Nuk e di të ketë indusë. Dhe vetëkuptohet edhe ateistë.

Ari vështroi dokumentet e tij.

-A-a, pjesëmarrje e hebrejve nuk është e sigurt. Oho. Rrjedhimisht – të krishterë, myslimanë dhe ateistë.

-Atëherë, përse ne këtu jemi të gjithë të krishterë, duke gjykuar sipas fytyrave? – pyeti teologu.

-Pyetje e mirë.

Drejtuesi mbushi ujë në gotë dhe e piu.

-Dhe kështu, ky është rrethi i katërt. Dhe më duket se akoma s'kemi dhënë gjithçka nga vetja. Koha, megjithatë, na nxit, sepse duhet të jemi gati para fillimit të vitit shkollor. Të përpiqemi të jemi të efektshëm.

Gazetarja mori fjalën.

-Para disa ditësh më lindi një ide, e cila më frymëzoi dhe sigurisht do t'u pëlqejë fëmijëve. Kam përgatitur diçka.

Ajo u përkul, mori nga dyshemeja një zarf letre nga ato të pazarit dhe e vuri mbi gjunjë. Nxori dy figura të mbuluara me pellush. Njëra ishte e zezë, tjetra e bardhë. Kishin koka në formë pikash, bishtat si spermatozoid dhe këmbë membrane ngjyrë portokalli. Ajo i vuri mbi tavolinë. Figura e bardhë kishte në ballë një njollë të zezë, që të kujtonte syrin e ciklopit, ndërsa e zeza kishte njollë të bardhë.

Gruaja e palosi qesen, e vuri në çantën e saj dhe tregoi figurat. Dora e saj e mbuluar me vena, dridhej.

-Emrat e tyre janë Tit dhe Vit.

-Si? – pyeti drejtuesi.

-Tit dhe Vit.

Në dhomë u vendos qetësia. Pas dritares, era tundte degët e trëndafililit. Ina vuri ré se vajza ia kishte ngulur sytë asaj.

-Interesant – tha Ari. –Kënaqësi që njihemi me Titin dhe Vitin. Na trego më me hollësi për ta, Majlla.

Gruaja i zhvendosi figurat në mes të tavolinës. Ato u lëkundën mbi këmbët e tyre të shkurtra, por e ruajtën ekuilibrin. Gazetarja i vështroi të pranishmit me radhë. E pavendosur iu drejtua figurave.

-Nuk e kuptoni? Ata nuk e kanë të qartë?

Të gjithë ia ngulën sytë qenieve pushatake me këmbë ngjyrë portokalli. Ari pinte ujë me gotën e tij. Teologu u përkul dhe e mori figurën e zezë në dorë. Ina përsëri ndjeu erën e pakëndshme që vinte prej tij.

-Domethënë ky është Viti? – pyeti teologu.

-Po. Ky është Viti.

Burri i menduar mbante në dorë figurën, sikur të ishte një objekt ritual i një fisi të zhdukur. E shtypi pak dhe ia hapi njëren këmbë, e cila mbeti ashtu mënjanë.

-Aa. Poo. Tani e kuptova.

Ai u kthye dhe vështroi Inën.

-Jan.

Gazetarja e frymëzuar mbështeti bërrylat në tavolinë dhe vuri duart nën mjekër.

Tamam kështu. In dhe Jan. Emrat, vetëkuptohet, që duhet të ndryshojnë. Ajo nxori syzet dhe një tufë letrash, të cilat i renditi para vetes dhe vuri syzet.

-I pari vjen Tit.

-Ajo filloi të lexonte me zë të tendosur.

-Tit është i etshëm për vëmendje. I parashtron mendimet e veta në monologë patetike, me mënyrën e një profesori, disi i hutuar. Kështu ai frymëzohet nga sjellja e vet që nuk vëren ndryshim ndërmjet fjalëve dhe veprave.

Ndershmëria dhe mprehtësia ndaj vetes janë anët më të forta të tij. Për shembull: Tit rri në zabel dhe ha bonbone, si mjedisi i ndotur përreth, sepse i hedh gjithandej letrat e bonboneve.

Situata është komike, por ai nuk e kupton këtë.

-Më falni që po ju ndërpres, por si i hap ky Titi bonbonet, kur s'ka duar? Po pyes, thjesht, teknikisht – tha punonjësja sociale.

-Nënkuptohet që ka duar. Thjesht, nuk arrita t'ia ngjis.

Gazetarja vazhdoi të lexonte.

-Tit është ekstrovert dhe shikon nga perëndimi. Po të ishte objekt – do të ishte megafon. Por, nëse Tit ndërton shtëpi, do ta bënte në një vend larg nga vendet e tjera, në shpatin e malit më të lartë ose në humnerën më të thellë. Dhe, nëse Tit do të vijë në fshatin tuaj, menjëherë do të mbledhë gjithë familjen rreth tij, por do të ndiheni të lehtësuar, kur ai të niset për në shtëpinë e vet në malin e lartë.

Ajo piu ujë. Dukej e prekur. Ina e kuptoi se gruaja ishte natyrë e ndjeshme. Duke sajuar ato figura ajo i kishte tejkaluar njëfarë kufiri krijues dhe Ina u përmbush me një keqardhje për duar e saj që dridheshin.

-Pastaj vjen Vit.

Gruaja uli kokën dhe filloi të lexonte:

-Vit është më i thellë se Tit dhe fjalëpakë. Por në brendësinë e tij – gjithçka zien. Ai është plot ndjenja të forta, të cilat herë pas here shpërthejnë dhe e bëjnë atë të kryejë gjëra të çuditshme, të papritura edhe për atë vetë. Atëherë atij i duhet të qetësohet dhe ai e mbërthen shikimin larg, atje, ku nuk ka qenë asnjëherë.

Ina ndjeu një prekje poshtë tavolinës. Vështroi poshtë dhe pa që po e preknin gishta të vegjël të pistë. Vështroi vajzën e vogël, e cila kishte pamje serioze. Ina i buzëqeshi, vështroi figurat pushatake dhe u përpoq të përqendrohej tek fjalët e gazetares.

-Jeta dhe e kaluara për Vitin janë një humnerë, në të cilën, nganjëherë zhduket dhe diku kërkon dije dhe qetësi. Për shembull: Vit pi ujë në kuzhinë. Ai, papritur, ndien se ka nevojë të shikojë detin. Niset dhe ecën gjatë, arrin në breg të detit, vështron valët dhe e di që çfarë i ndodh atij, kurrë s'do t'i mërzitet.

Ada guduliste me gishtërinj këmbën e Inës. Ajo e largoi këmbën, por vajza u kthye menjëherë dhe vazhdoi ta prekte.

-Vit është introvert. Vit shikon nga lindja. Po të ndërtojë një shtëpi, do ta bëjë këtë në rrëzë të maleve tililejski, ndërsa përreth shtëpisë do të ketë një lëndinë të verdhë me kambana të vogla që i tund era. Dhe, nëse Vit do të vijë në fshatin tuaj, me siguri, në fillim nuk do ta vini ré, do të ndieni vetëm qetësi dhe do të vazhdoni të punoni me gjallëri. Vit do të ulet në cep të divanit dhe do të rrezatojë mbrojtje. Dhe kur të niset, kur nata do të mbushet me zëra të panjohur, do të zgjoheni të habitur dhe do të pyesni me zë të ulët: “Ku është Vit?”

Gazetarja e largoi letrën nga vetja, hoqi syzet dhe ngriti kokën, mbështeti bërrylat në tavolinë dhe vuri duart nën mjekër. U gëlltit në një mënyrë të tillë, sikur i vinte për të vjellë. Ina dëshironte t'i thoshte diçka pozitive, por nuk gjente fjalët e duhura.

-Nuk jam e sigurt – tha punonjësja sociale. Më shumë besoj në babagjyshin e Krishtlindjes.

-Tulla, tani për tani nuk do të hedhim poshtë asnjë ide. Jemi mbledhur për sulmin e trurit – foli me qortim drejtuesi. Punë e mirë, Majlla. Pa dyshim Tit dhe Vit janë figura të forta. Ka vetëm një problem. Ne synojmë të krijojmë njëfarë mitologjie të re, e cila të jetë e lirë nga çfarëdo dhe të jetë ideologji. Këta të dy, Tit dhe Vit i kanë hyrë taoizmit apo diçka tjetër.

Filloi një bisedë, në të cilën u diskutuan disa parime dhe çështje praktike.

Ina largoi këmbën e Adës dhe e ndërpreu drejtuesin.

-Kam një pyetje për Sepon. Ai nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me temën që diskutohet, megjithatë e ka diçka të përbashkët me të.

-Pyete atë vetë – tha drejtuesi.

Teologu vështroi Inën dhe fërkoji hundën.

-Para disa kohësh kam lexuar një artikull për një ishull-varrezë në liqen. Atje dikur varrosnin të vdekurit. Autori thoshte se e kishin bërë për arsye praktike – për të mbrojtur të vdekurit nga ujqërit dhe kafshët e tjera të egra, të cilat do të mund të t'i gërryenin arkivolet, sepse ato ishin arkivole të përkohshme.

Kohërat ishin jo të qeta dhe nuk mund të shkonin tek varreza pranë kishës. Mendoja, nëse kjo mund të ishte e vërtetë. Ndoshta kanë kërkuar të vdekurit të ishin larg të gjallëve dhe prandaj i kanë varrosur në mes të ujit?

Teologu pastroi fytyrën.

-Nuk jam specialist që mund t'i përgjigjet kësaj pyetjeje. Unë jam fenomenolog. Duhet të pyesësh ndonjë historian të besimit ose ndonjë arkeolog. Por, me intuitë, mund të shpjegohet në mënyrën e mëposhtme: ishulli është vend me kufij të dukshëm qartë, i ndarë nga stëra dhe nga vendet e banuara. Në përfytyrimin e tyre ndoshta ka qenë mishërim i mbretërisë së të vdekurve.

Ina vuri re se teologu vështronte gjinj të saj. U përpoq me fjalë t'ia tërhiqte vëmendjen.

-Gjithsesi, a mundet që ky ritual të jetë i paracaktuar nga dëshira e të gjallëve për të mbrojtur të vdekurit, por edhe të mos i lejojnë të kthehen në këtë botë dhe të përzihen në punët e tyre?

-Nuk guxoj t'i përgjigjem kësaj pyetjeje. Mundem vetëm të bëj hipoteza.

Ada e shtyu këmbën e Inës me gishtërinjtë e këmbës së saj. Ina tha:

-Për mendimin tim, ne duhet ta kemi parasysh vdekjen në idetë tona.

Atëherë vajza zbriti nga karrigia dhe u afrua tek Ina. Në heshtje ia largoi duart dhe u ul në prehrin e saj.

-Ide e mirë – tha babai i saj. – Por unë mendoj se administrata e qendrës tregtare nuk do të jetë e kënaqur, sepse ata kanë interesa të tjera. Shfaqjet do të jenë në kohën e shitjeve të mëdha për Krishtlindjen dhe vdekja do të jetë një motiv i pakuptimtë atëherë.

Ada u rregullua më rehat dhe vuri faqen mbi gjirin e djathtë të Inës. Ajo e përqafoi vajzën, sepse nuk kishte si të rrinte me krahë varur.

Drejtuesi e pà dhe buzëqeshi ëmbëlsisht.

-Ada është si një kotele e vogël – tha ai.

Të tjerët i kthyen sytë nga Ina që nuk dinte çfarë të bënte. Donte

ta lëshonte vajzën, që të binte dhe të ishte edhe një mësim për të. Ndërsa ajo mbështeti kokën në gjoksin e saj dhe mori frymë thellë. Ina vështronte përmbi kokën e saj, mbi flokët e zinj të lëmuar dhe pa krijesat me një sy të gazetares që vështronin njëra-tjetrën me sy të shqyer dhe u kujtua për Niklasin që tani ishte në tren. Ndjeu që vajza po e prekte përmes fustanit. Ajo donte të kuptonte çfarë kishte veshur poshtë, por Inës kjo iu duke e tepërt.

Ajo u rrotullua në karrige dhe e hodhi në dysheme. Mori çantën dhe u ngrit.

-Më falni.

Doli nga dhoma. Eci nëpër hollin bosh, duke parë dritat jashtë dhe nxori syzet e diellit. Para portës së jashtme u ndal. Me dorën, në të cilën mbante syzet e diellit u mbështet në mur dhe filloi të qante.

I ra tri herë pishinës me not.

U kthye dhe vështroi qiellin, ngrysi vetullat, notoi drejt murit me pllaka të pishinës, kaloi përmes një grupi fëmijësh që po luanin dhe doli. Shkoi në lëndinë, ku la bagazhin e saj të varfër. I vuri syzet e diellit dhe u shtri mbi peshqir. Dëgjonte thirrjet e fëmijëve, zhurmën e dusheve dhe transmetimin e radiove në altoparlantë.

Ina u drodh. U ul dhe preku barkun e fytyrën e saj. Lart në park fluturonin dallëndyshet. Ajo piu ujë nga shishja dhe fshiu buzët e lagura me kurrizin e dorës.

Disa metra larg saj rrinte një çift i ri mbi një rrogoz kallamash dhe shikoheshin në sy. Në atë ditë me diell ata ekzistonin vetëm për njëri-tjetrin. Ina i vështronte përmes syzeve të errëta dhe parashikonte që, pas ca vitesh, ata nuk do të kuptoheshin e nuk do të ishin të aftë të shikohen si tani.

Jo larg prej tyre ishin shtrirë dy vajza ruse me trupa si të gdhendur. U ngjanin motrave suedishtfolëse. Ina u përpoq ta gjente, nëse njëra prej tyre, nën rrobat e banjës kishte silikon. Atë duket se e kishte zënë gjumi me gjinj të zbuluar; djemtë kalonin pranë saj dhe provonin një dëshirë të zjarrtë, dielli i nxehtë ia ngrohte kofshët e gjata dhe, pastaj, lëvizte nëpër orbitën e tij.

Një ditë vajza do të zgjohej, lëkura e saj e bukur do të rrudhej, nuk do të mbante mend nëse quhet Malina apo Karina, ndërsa djemtë do të dëshironin vajza të tjera, por gjinjtë e saj, gjithsesi, do të ishin të bukur dhe elastikë.

Nëpër të tatëpjetën ecte një burrë muskuloz me një djalë të vogël. Në trupin e tij të stërvitur kishte një tatuazh me gjarpër kinez, nga goja e të cilit dilte flakë e kuqe. Ai e mbante për dore fëmijën me kujdes dhe, ndërkohë që ecte përkrah tij shikonte se, tashmë, djali ishte rritur, kishte dalë nga foleja dhe kishte marrë lodrat e tij të dashura; viti i derrit do të këmbehej me vitin e miut dhe burri i drejtuar nga egërsira e vet e brendshme do t'i kishte zili ata, që do të vazhdonin të zienin në gjakun e djalit të tij.

Ishte mesi i një vere të lodhshme. Ina shikonte njerëz gjysmë të zhveshur buzë pishinës dhe përmes syzeve lexonte gjuhën e trupit të të rinjve. Në pauzat ndërmjet këngëve e reklamave, drejtuesi i programit në radio tregonte për çka i kishte ndodhur në një restorant.

Përshkruante sjelljen e pakëndshme të një kamerieri në një restorant. Ina rrinte aty në vapë dhe mendonte për njerëzit, të cilët tallen dhe, në fund të fundit, kur të plaken, do të shkojnë atje, ku e meritojnë, në një vend, ku askush nuk do të qeshë me shakatë e tyre. Ky vend ekziston, por fati i atyre që do të bien atje nuk do të ketë kurrfarë rëndësie, sepse do të jenë nëpër zgëqe të gërryera nën tokë.

Ina hapi kapakun e celularit dhe mendoi për Niklasin e pamenaxhueshëm. Ajo ishte tridhjetë e një vjeçe. Ishte verë. Niklasi diku ecte me pamjen, me të cilën akoma mund të dashuroheshe. E mbylli telefonin dhe e futi në çantë. Vështroi nga çifti i ri. Ndërkohë që njerëzit bëjnë gjithçka drejt, ata mbushen me krenari dhe pacenueshmëri. Por vinte dhe një kohë tjetër. Nëse Niklas do të shfaqej, pikërisht atëherë, ajo do ta pranonte. Ai, akoma, dinte të bënte disa gjëra drejt, të ecte drejt dhe të rrinte mirë në divan, kur aty kishte vend mjaftueshëm.

Berlin 3à.7. 1991.

Tashmë është java e tretë që udhëtoj, por kjo është letra ime e parë. Jam zhytur deri në fyt në punë dhe nuk kam fare kohë të lirë. Dy ditët e para qëndrova në Hamburg, pastaj një javë në Bremen dhe tani jam në Berlin, ku do të qëndroj dy ditë. Këtë verë nuk do të udhëtoj më.

Dje ose pardje (ky qytet më bën të mos jem i qetë dhe të harroj) në mbrëmje shëtitëm me drejtorin ekzekutiv të firmës së kontejnerëve në Kopenhagen, Xheri, pranë sheshit Strausberger Platz. Xheri është danez i sinqertë, fjalëshumë, i zgjuar, por i hutuar dhe i shkujdesur.

Pamë përmendoren e Karl Marksit, folëm për biznesin dhe unë i thashë se Finlanda do të dështojë dhe se shpresoj që kjo të ndodhë sa më shpejt. Ndalua në qoshe të rrugës dhe u habitëm, ku ndodheshim. Xheri hodhi sytë përreth dhe tha:

-Kemi qenë këtu?

-Jo – u ktheva unë.

-Nuk kemi qenë, tashmë, në këtë vend?

-Po, kemi qenë.

Dhe, në njëfarë mënyre, në atë bisedë u kristalizua gjithçka që kisha kuptuar për Berlinin.

Dy herë të kam telefonuar, por ti nuk ishte në shtëpi. Ditën e nisjes sime pashë që kishe marrë letër nga universiteti.

E mora me mend përmbajtjen e saj, por nuk të thashë çfarë të bësh, megjithëse, tashmë, e dija. I tregove Niklasit për Londrën? Duhet t'i thuash menjëherë. Duhet të ta përsëris unë që ai është i dashuruar marrëzisht pas teje.

Kjo duket nga sjellja e tij, sa me ndrojtje dhe ngathtësi vjen ai tek ne, të shikon me admirim, madje edhe kur, për mendimin tim, thua budallallëqe, gjë që nuk ndodh aq rrallë sa mendon ti. Oho, kam filluar të mendoj si gjerman.

Sipas meje, ata kanë një ndjenjë humori të veçantë, në bazë të të cilit qëndrojnë përgjegjësitë për të tjerët. Në Finlandë të gjithë i marrin shakatë mirëfilli dhe askush nuk qesh. Humori gjerman

i detyrohet faktit që ata janë njerëz shumë të përgjegjshëm. Por tregoji Niklasit për Londrën. Nuk është e drejtë të fshehësh prej tij diçka që atij do t'i shkaktojë dhimbje.

Dëgjo, ndoshta nuk veproj drejt që e diskutoj këtë çështje në dhomën e hotelit, natën vonë, kur jam i lodhur dhe kjo shprehet edhe në letrën që do të arrijë në shtëpi pas kthimit tim. Por kam menduar gjatë për këtë që, tani, dua ta ndaj me ty.

E dënoj veten që nuk e kam hapur këtë bisedë për një kohë kaq të gjatë dhe e dija, që para dy vjetësh, kur ti u nise për në Arizona dhe unë jetoj vetëm në Itahariu. Mendova të shes shtëpinë.

Përballë këtij mendimi kishte dy kundërshtime:

1) Ti. Kjo është shtëpia e fëmijërisë tënde.

2) Konjuktura nuk ishte e përshtatshme që të jepte një shtëpi kaq të madhe.

Nga ana tjetër, do të kisha dashur të blija një banesë të mirë e të lirë në qendër. Ne kemi qenë të lumtur aty dhe nuk do të doja të isha vetëm në kohë të vështira që kam përpara. Besoj që do të kuptohemi.

Në favor të shitjes ishte vetëm një rrethanë: nuk do të jetoja aty vetëm. Që tani unë e di që ti do të jesh shumë kohë jashtë shtetit. Kam një parandjenjë dhe, në lidhje me ty, ajo nuk më gënjen.

Ndoshta shtëpia do të shitet dhe aty do të jetojë një familje e re, por Zoti të ndihmoftë, nëse ke harruar të ujitësh serën.

A të kujtohet që në verën e kaluar para ballos së maturantëve, kemi biseduar në shkallë. Ishte mbrëmje e ngrohtë, ne flisnim për gjëra të zakonshme dhe ti the se nuk do të mërzhitesh me mua, nëse do të krijosh familje të re dhe do të jetoj me të. Mbeta i habitur. Unë jam dyzet e nëntë vjeç. Ti e di si kanë përfunduar dy përpjekjet e mia për të krijuar familje. Më vjen turp dhe e di se, tashmë, kam bërë zgjedhjen më të rëndësishme.

Nëse mbetem pa ty në Itahariu, do të jem fare i vetmuar, megjithëse do të kem edhe njerëz të tjerë përreth. Nuk jam si ti ose si Mari. Më mjafton që unë të djersij në punë dhe, kohë pas kohe të flas me dikë për këtë, por më e mira është me ty. Gjëja më

e mirë që më ka ndodhur është se unë e ti ia kemi arritur të mbetemi të afërt. Tani shqetësohem se ti jeton tepër larg meje.

Dhe kështu po e përfundoj. Nuk di për ku të ta dërgoj këtë letër. Pres me padurim që të takohemi. Tani do të shikoj lajmet.

Babi.

8

Ina zbriti nëpër kodrën Sampalina dhe eci nëpër rrugën “Rantakatu”. Vapa ishte sflitëse. Ujrat e lumit ishin pakësuar fare. Lëvizte ngadalë, i lodhur nga të notuarit edhe dielli. Ndihej i qetë dhe ndryshe nga të tjerët. Më kujtohen fjalët e Niklasit në breg të Naantalit: “Do të ta injektoj. Në gojë, në krah ose në të ndenjura.”

Mendova për trupin e zbehtë të Niklasit. Javën e parë ai u shfaq me mbathje dhe me një kapele të huaj. Ishte i hutuar dhe nuk ishte në vete. Ina i ndihmoi të hynte brenda dhe të hiqte mbathjet e lagura dhe kapelën. Ai u shtri në krevat dhe filloi të qante.

Tha që ishte marrë diçka dhe kishte hasur vdekjen. Ina e përqafoi dhe u përpoq të kuptonte për çfarë flet. Ai i tregoi se vdekja është diçka e mirë dhe se ajo nuk duhej të kishte frikë prej saj. Ajo kundërshtoi duke thënë se ai s’mund të dinte asgjë për këtë çështje. “Mos u bëj specialiste për vdekjen, para se të hasësh në të” – i tha Niklas. Ajo e kundërshtoi, sepse ai s’kishte humbur ndonjë njeri të dashur. Ajo vlerësoi se po bënin një bisedë të pakuptimtë. Pas ditës së nesërme, ai fliste si ndonjë i sapokonvertuar. Donte të provonte narkotikë së bashku me të. Bërtiste. Dikur ajo e konsideronte monomaninë e tij si tipar pozitiv. Tashmë, nuk dinte çfarë të mendonte.

U kthye në shtëpi, hapi një shishe verë, mbushi një gotë dhe u ul në tavolinën e vogël të divanit në sallon. I vari në ballkon rrobat e banjës dhe peshqirin e lagur. U kujtua se nuk i kishte ujitur lulet prej disa ditësh.

Në kuzhinë nxori nga dollapi kanën metalike dhe e mbushi me ujë, ujiti lulet në njërën arkë të vjetër, pastaj mbushi kanën e dytë

dhe ujiti tjetrën. U mbështet në kangjella dhe vështroi nga oborri. Po binte mbrëmja dhe ajo ishte e kënaqur që sonte do të ishte pa Niklasin.

Pranë saj ra një send i vogël, kërceu dhe goditi në mur. Ishte një çakmak i kuq.

Nga sipër ndjeu një zë gruaje:

-Ej, ju në katin të katit të poshtëm. Më falni.

-Ina ngriti çakmakun, u afrua tek kangjellat dhe vështroi lart.

Nga ballkoni i sipërm shikonte poshtë një vajzë me flokë ngjyrë lajthi.

-Më ra çakmaku. Kështu jam unë – i lëshoj të gjitha. A mund të vij ta marr?

-Sigurisht.

-Mirë pra. Vetëm një sekondë.

Ina hyri brenda dhe e la kanën mbi tavolinën e dhomës së ndenjjes. Doli në korridor dhe hapi derën. Vajza kërcente poshtë nëpër shkallë zbathur, me pantallona të ngushta dhe bluzë të bardhë. Ina ia dha çakmakun.

-Falemiderit. Unë jam fqinja në katin më sipër. Suvi.

Vajza buzëqeshi dhe i zgjati dorën. Ina ia shtrëngoi dhe u prezantua. Mysafirja vështronte mbi supin e saj brenda në shtëpi, pa e fshehur kureshtjen e saj. Ina nuk mund ta mbyllte derën para atij shikimi të hapur dhe e pyeti:

-A do të vish brenda?

-Po. Do të doja të njihesha me fqinjët e mi. Akoma nuk njoh askënd në këtë shtëpi.

Ina e la vajzën të kalojë dhe mbylli derën. Mysafirja arriti në gjysmë të korridorit dhe vështroi nga dhoma e ndenjjes.

-Ha, ky apartament është shumë i madh. Përse mbi të është vetëm një garsonierë?

-Këtu janë bashkuar garsoniera dhe tri dhoma. Më parë këtu banonte im atë, tani – unë.

Ina hyri në dhomën e ndenjjes. Suvi e ndoqi dhe u ndal para dritares.

-A do një gotë verë të bardhë?

-Po, faleminderit, po të jetë e ftohtë. Dha pak ujë.

Ina shkoi në kuzhinë për të marrë verën dhe gotën e ujit. Kur u kthye, Suvi këqyrte kanën.

-Shumë e bukur.

-Është e vjetër, nga vitet dyzetë. Ma kanë dhuruar, kur isha fëmijë. Mund të thuhet se tani ka vlerë koleksioni.

-E, kur njerëzit kanë vend të tepërt, koleksionojnë gjithfarë gjërash.

Ina i dha gotat Suvit dhe u ul në divan. Mysafirja u ul në karrigen lëkundëse, vuri gotat në dysheme dhe e hodhi këmbën mbi njërin krah të karriges. Kishte qejf të bisedonte. Fliste me ngut dhe bënte shumë gjeste. Folën për apartamentet. Ina i tregoi për banorët e pallatit.

-Çfarë pune bëni? – pyeti Suvi.

-Jam mësuese, por, tashmë, nuk punoj dhe sigurisht, nuk do të kthehem kurrë në atë punë.

-Je mësuese? Më vjen keq, po nuk do ta besoja. Gjithmonë kam menduar se dhaskalët janë specie në zhdukje.

-Po ti? Studion?

Suvi qeshi. Kishte një të qeshur të ashpër, të trashë.

-Bëj çfarë dua. Nuk qëndroj gjatë në një vend, kështu që nuk e di saktësisht se çfarë bëj. Një muaj e gjysmë mësova anglisht. Por ishim mbledhur një grup aq i çmendur, saqë nuk durova dot. Ishte shumë zbavitëse të flisje anglisht me aksent indian, kur dehesh. Tërbohem, kur e kujtoj. Tani kaloj nga një vend në tjetrin dhe pres të më dalë fati.

Ina mendoi që Suvi, në mënyrë të tërthortë, donte t'i thoshte se është e papunë.

-Ke ndonjë mashkull? – pyeti Suvi.

Ina piu një gllënjë dhe heshti.

-Jo.

-Po pse? Apo parapëlqen femrat?

-Jo, sigurisht jo.

Suvi i tregoi, se dilte me një kokërruar. Mendonte që kokërruarit janë të fortë, por ai i saji ishte i ndrojtur dhe i ngathtë. Ndërsa ajo kishte nevojë për një burrë, tek i cili të mund të mbështetej. Kërkonte dhe priste.

Ina e ndërpreu.

-Kam një mashkull. Prej kohësh jam me të njëjtin. Nuk e shpjegoj dot, përse, pak më parë, thashë që nuk kam.

-Edhe unë tregova gjëra që nuk i kuptoj. Por unë e di se këtu jeton një burrë.

-Nga e di t?

Suvi tregoi me dorë pikturën në mur, ku nga kabina e një avioni gjuajtës, katapultohej një pilot.

-Asnjë femër nuk do të varte në dhomën e ndenjjes diçka të tillë. Vetëm, nëse diçka nuk shkon.

-E përse?

-Ky është një tip pikturë ferri. Luftë. Burrave u pëlqejnë vrasjet. Për mendimin tim, në televizion japin tepër luftë.

Ina e mbaroi verën.

-Suvi, nëse nuk guxon ta shikosh në sy qytetërimin tënd, gjithmonë dhe kudo do të jesh e huaj.

-Oho, po filozofon. Duhet ta mendoj mirë këtë.

-Mos mendo. Do edhe pak verë?

-Faleminderit.

Ina shkoi në kuzhinë të mbushte gotat. U ulën dhe biseduan për Turkun dhe stinën e verës. Ina zbavitej në shoqërinë e Suvit, por e dinte se një orë do të ishte më se e mjaftueshme. Suvi piu verën dhe u ngrit.

-Duhet të shkoj të dëgjoj lajmet. Do të dal me vëllain dhe shokët. Kam ndjesinë se sot do të vdes në ndonjë bar. Ndjesi luksoze. Faleminderit për verën. Ishte kënaqësi që biseduam bashkë. Në këtë pallat, tashmë, njihem me ty, megjithëse ti nuk më tregove shumë për veten.

Ina e përcolli. Para derës, Suvi e përqafoi, sikur ishin mike të vjetra.

- Do të flasim një herë tjetër.
- Sigurisht. Mbrëmje të këndshme.
- Gjithashtu.

Ina e ndoqi me sy mysafiren e re tek ngjitej shkallëve.

Mbylli derën dhe mendoi se jeton në botën e lidhjeve të brishta. U kthye në dhomën e ndenjjes, u ul dhe mbaroi gotën e verës. Telefonoi Niklas nga hoteli në Tamper. Nga intonacioni dukej qartë që kishte pirë. Foli më gjatë se zakonisht, ajo i tregoi për mbledhjen e grupit dhe i përshkroi Adën e vogël flokëzezë. I tregova edhe për Suvin. Megjithatë, Niklas donte të fliste për të kaluarën.

Pas dushit, u shtri lakuriq. E përgjumur, mendoi për Adën, për figurat e gazetares, për Suvin dhe për të gjithë fëmijët e botës. Gjithashtu edhe për Niklasin dhe që jeton në një botë me lidhje të brishta. Siç i ndodhte shpesh teksa flinte, filloi të shikonte kafshë – një qen që vrapon, zogj të ndryshëm dhe një gomar që notonte në shatërvan.

9

Vendi është një restorant tematik, Suvi është rreth njëzet vjeçe.

Emri i restorantit është “Kaski”. Aty Suvi punon si kameriere.

Në hollin e restorantit dykatësh është vënë një dre i balsamosur me emrin Hujtinen. Salla është zbukuruar me gur mulliri, me plug, vaskë dhe sharrë. Në muret e veshura me panele druri janë varur kallinj thekre dhe dy televizorë plazma dyzet e dy inçesh, të cilët shfaqin një film shkencor-popullor të arkivit nga vitet tridhjetë të shekullit të kaluar mbi përpunimin e varkave. Sopata dhe kazma, zjarri dhe rrëshira transmeton sistemi audio i filmit. Në katin e sipërm gjendet një pab, në të cilin këmba e Suvit nuk shkel kurrë. Që andej dëgjohen biseda, të cilat, me afrimin e mbrëmjes, kalojnë në britma.

“Djali ta marrë” – thotë pronari i restorantit Sejllo, i cili synon

të paraqesë kuzhinë fshati.

Bërxolla të mbushura me mish dreri dhe thëllëza të marinuara të Veriut, byrek me boronicë të zezë dhe peshq të vegjël nga Lindja, kek me tërshërë, verë vishnjeje nga Ahvenmaa, kaçkavall dhe stafidhe nga Varsinajs-Siomi.

“Dhe klientët budallenj nga dy brigjet e komunës së Aurës” – thotë kuzhinieri flokëkuq, Markus.

Në faqen e parë të menysë së restorantit është shkruar motoja e tij: “Ne në Kaski besojmë në fjalët finlandeze dhe në mënyrën finlandeze për t’i shqiptuar ato në shoqërinë e gëzueshme finlandeze të tryezës”.

Në muret e sallës janë varur katër fotografi bardhë e zi. Sejllio ia prezanton burrat e fotove Suvit.

-Ky është Torkell Knutson. Amator ahengjesh dhe njeri shpirtmirë, të cilit ia hoqën kokën. Armiq të tillë dinjitozë si të atij meritojnë respekt.

Henrik Renkvist. Njeri kishëtar i kthjellët, i trishtuar dhe botues. Unë nuk i lutem Zotit në momente dobësie, por kam respekt për çdo besimtar të sinqertë, i cili përpiket të mbytet në lumin Aura.

“Ti, me siguri, e njeh Paavo Nurmin, vrapuesin nga rruga Bregu Lindor”. Kur banori i Turkut fillon të vrapojë- nuk ndalon më.

Gjeneral A. F. Ajro. Dhe tani një minut heshtje. Kështu. Një burrë i tillë, s’mund të lindë diku tjetër, veçse në Turku.

“Djalli ta marrë” – thotë Sejllio.

Në ditët e nxehta të verës, restoranti është i qetë. Suvi hap gojën, e mbulon me duar. Për drekë ka vetëm katër klientë. Kondicioneri zhurmon përgjumshëm.

Në tavolinën e qoshes, Torkell Knutson fërkon mjekrën dhe do t’i tregojë Suvit çfarë do të thotë ujë me shkumë. “Tashmë s’ka gra, s’ka as peshk” – thotë ai, ndërsa shfleton menynë. Ai drejtohet për të kruajtur testikujt e vet të plakur.

Gjeneral A. F. Ajro zgjat tallonin e ushqimit dhe thotë duke

pasur parasysh të nderjaturat e Suvit: “Zonjusha është pasqyrim i së bukurës”.

Henrik Renkvist porositi kafë dhe shurup manaferrash, pyet Suvin, ku shkojnë gjurmët e njeriut në borë, kur shkrihen. Dhe shton: “Por mos u rrëmbe nga metafizika, vajza ime”.

Torkell Knutson e derdhi supën me perime dhe mish dele në prehër dhe murmuriti: “Çfarë bën një njeri i madh?” Mos vallë është dëshira e tij e tepruar? Kujtesa e dobët? Apo guximi për të urinuar në mes të erës?

Në një tavolinë, Paavo Nurmi përtypet dhe kujton emocionet që kishte përjetuar në stadiumin e Stokholmit në vitin 1926. Në kohën e nxehtë, me dinakëri, i kishin futur në mbathje një tub të gjatë, pak të shtrembër dhe i kishin shtrydhur brenda shumë pastë dhëmbësh.

Ajro, duke shkuar në tualet dhe duke pasur parasysh trupin e Suvit thotë: “Këmba e zonjushës ndoshta është shumë tërheqëse? Ndoshta është infektuese e kënaqësisë? Ndoshta e paharrueshme?”

Paavo Nurmi gjerb me lugë supën me panxhar sheqeri dhe kujton emocionet e olimpiadës në Antwerpen, në vitin 1920: Bëja nxehtë e vrapimit pesëqind metra. Ndjeva barkun të më tendoset. I habitur e fërkova. M’u gris këmisha dhe zbuloi imitim të kokës së nënës sime, e cila thërriste: “Kajra, Kajra” (një lloj pulëbardhe). Ndoshta është e tepërt të them se në ato sekonda kontradiktore, u bëra aksioner dhe komunist.

Ajro kthehet nga tualeti dhe thotë duke pasur parasysh gjinjtë e Suvit: “Nëse ëndrrat e mia të mëdha patriotike shkojnë në kinema, zonjusha mund të më grijë kockat e mia të vjetra dhe të pudrosë ato kumbullat sportive.”

Paavo Nurmi i shton kaviar supës me peshk dhe kujton emocionet e olimpiadës verore në Los Anxhelos në vitin 1932: “Jeta dhe vdekja ime ishin drejtuar, radhazi, tek qetësia. Gjatë kohës së qëndrimit tim në qytetin e engjëjve nuk ndieja asnjë fjalë nga qenia njerëzore. Vetëm amerikanët janë të aftë për këtë. Kudo mbretëronte një qetësi varri. Në krahasim me ta, Europa është amatore. E kupton moj vajzë?”

Petri nxiton për të paketuar rrobat rezervë. Sejllo kishte premtuar ta marrë në dymbëdhjetë. Tani ishte e pesëmbëdhjetë. Ai futi portofolin dhe telefonin në xhep, mbylli derën dhe shpejtoi poshtë nëpër shkallë.

Sejllo kishte parkuar makinën e tij të bardhë me dy rrota në trotuar. Makina që shkëlqente dukej si trajler i ankoruar pranë bregut. Sejllo, i mbështetur në makinë, pinte cigare. Pamja ishte zbavitëse – një burrë i trashë me pantallona të shkurtra, me sandale dhe bluzë me mëngë të shkurtra, dukej si xhaxha që mirëpriste nipërit në stacion.

-Më fal, fjeta pak. Kam qenë në turnin e natës.

Sejllo hodhi bishtin e cigares në rrugë, hapi bagazhin dhe vuri aty çantën e fryrë të Petrit. E mbylli bagazhin me dorën e tij të gjerë dhe u kthye nga djaloshi.

-Mos kij merak. Është ditë pushimi dhe nuk nxitojmë gjëkund.

Sejllo e nget makinën qetë, i përqendruar. Petri s’kishte hipur kurrë më parë në makinën e tij. Lëmoi me dorë tapicerinë prej lëkure gri të hapur. Makina ishte e bukur.

Ndaluuan në Kupitala, para dyqanit të Allkos. Sejllo bleu një pako me birra, një shishe uiski të markës “Lafrojt” dhe katër shishe verë të bardhë brusko. Nuk e la Petrin të paguante.

Kaluan nëpër urën Hirvensallo dhe u nisën për në jug. Uji në grykën e lumit Aura dukej në ngjyrë gri në të gjelbër dhe ishte i ftohtë. Pylli ishte i errësuar dhe i ndryshuar, sikur vjeshta, tashmë, e kishte marrë fuqinë e saj dhe fëshfërinte në gjethnajën e pemëve. Petri nuk po gjente dot ndonjë temë bisede.

-Makinë e freskët.

Sejllo e vështroi dhe buzëqeshi. Tha që në dimër mërzhitet për verën për shkak të kësaj makine. Tregoi se, fillimisht, do të të blinte sheviolet të modelit ët vitit 1958 me dy dyer, si ajo që ngiste Ron Hauërd në filimin “Grafitet amerikane”.

Nuk gjeti një të tillë që të ishte në gjendje të mirë dhe me një çmim të përshtatshëm. Makina nga viti pesëdhjetë të shekullit të kaluar, gjenden vështirë, madje edhe në Amerikë. Ishte i detyruar të mjaftohet me modelin e vitit 1960 me katër dyer. Kushtoi shtrenjt, por, gjithsesi, ishte në gjendje të shkëlqyer. Sipas mendimit të tij, ishte më e bukur se modeli i mëparshëm, megjithatë nuk ishte makinë e Ron Hauërdit.

Petri nuk fliste, sepse e kishte parë “Grafitet amerikane”, nuk e njihte Ron Hauërdin dhe nuk dinte si ka qenë modeli i vitit 1958. Mendoj me vete që duhej të informohej.

Vapa kaloi, dita ishte me ré, e freskët dhe po binte muzgu. Motori zhurmonte, shishet në bagazh kërcisnin. Pas Kajstarniemit, Sejlljo e uli shpejtësinë. Petri nuk e dinte përse.

Filloi shiu dhe pikat e tij përplaseshin në xhamin e parë. Që nga Pamatula, era shtynte retë e zeza. Deti ishte i rrafshhtë si sipërfaqja e një tavoline prej mermeri.

-Marja, tashmë, është në vilë. Do të njiheni.

Petri e vështroi. Mendonte se do të ishin vetëm ata të dy.

U kthyen në jug në drejtim të Kuolemanokës, pastaj ecën nëpër rrugën me rërë, në fillim të së cilës ishte një pyll i gjerë. Dy kuaj, ngjyrë kafe të errët, kullotnin para tij. Në sfond të pemëve të errëta, ata dukeshin kafshët paqësore që rrezatonin forcë dhe qetësi.

-Mos u mërzit me Marjën. Ajo është e qeshur dhe miqësore. Dhe kuzhiniera shumë e mirë. Do të të pëlqejë.

Ruga e ngushtë me rërë përshkonte një lëndinë dhe dilte tek një portë me kolona të gurta gri. Mbi portë me germa hekuri të salduara ishte shkruar “Aloha”. Prapa saj kishte pisha të larta. Përmes tyre dukej deti.

-Po e lë këtu makinën. Nuk futet në oborr.

Zbritën. Sejlljo mbylli dyert e makiës. Mori nga bagazhi çantën e udhëtimit dhe shishet. Sejlljo veshi xhupin me kapuç ngjyrë gri dhe ndezi një cigare. Petri mendoi se ai pinte duhan tepër.

Pranë portës u duk një qen i hijshëm ngjyrë kafe dhe të zezë

që kërceu para Sejllës me birrat në dorë. Qeni u ngrit në këmbët e pasme.

-Hajde Kusti! Poshtë!

Kafsha u bind. Kërceu tek këmbët e Petrit, tundte bishtin dhe u merrte erë. Sejllë hapi portën.

-Emër memec, e di. Por kafshët duhet të pagëzohen presidentë. Kjo mbante ekuilibrin botëror.

Petri kaloi përmes portës dhe mendoi sa pak di për Sejllon. Nuk ia njihte gruan dhe nuk e di si ka qenë.

Vila njëkatëshe prej druri ishte ndërtuar mbi një shpat shkëmbor të pjerrët. Tek porti të çonin shkallë betoni pa kangjella. Pranë shtëpisë kishte sauna dhe një strehë të kuqe për dru.

Marja qëndronte në shkallë e veshur me një bluzë të kaltër leshi, xhinse dhe çizme llastiku. Ata e lanë bagazhin përtokë. Marja ia zgjati Petrit dorën e saj të ngrohtë. Ajo ishte pak më e re se Sejllë, nja tridhjetë e pesë vjeçe. Në pamje ishte fare e zakonshme, mbi buzë, nga e djathta, kishte një shenjë të thellë dy centimetra. Petri ishte disa i zhgënjyer. Priste që Sejllë të kishte një grua shumë më të pashme.

Brenda në vilë kishte hapësirë të gjerë dhe dritë. Mbi dyshemenë e ndritshme prej mështekne ishin shtruar qilima të vegjël me lule natyrale. Para oxhakut të lartë, të ndezur ishte një divan i bardhë dhe një kolltuk. Përmes dritareve të mëdha hapej pamja nga deti. Nja dy kilometra në brendësi dukej një ishull i vogël i gjelbër. Sejllë shpjegoi se ai e kishte emrin Vespa.

Marja e çoi çantën e Petrit në dhomën e mysafirëve. Petri e ndoqi. Dhoma ishte e vogël dhe e mobiluar vetëm me një krevat. Nga dritarja dukej bregu shkëmbor. Në qoshe, në një vazo prej balte ngriheshin kërcej të lartë kallamash. Dhoma binte erë pastërtie.

-Të kam vënë dy batanije, sepse pas disa ditëve me vapë, këtu dy net ka qenë ftohtë.

Petri e vështroi në sy Marjën e qeshur. Pati përshtypjen se ajo nuk ndruhej para askujt.

Sejllë shkoi të ndizte sobën në sauna. Marja shtoi dru në oxhak

dhe hyri në kuzhinë.

Mysafiri u ul në divan dhe vështronte shpinën e zonjës së shtëpisë. Hidhte sytë nga deti dhe s’dinte çfarë të thoshte. Doli jashtë dhe mori një shishe birra. E hapi dhe zbriti nëpër shkallë tek porti. Qeni u nis pas tij, thonjtë e tij gërvishtnin betonin.

Petri u ul në gjunjë dhe e provoi ujin me gisht, nuk ishte aq i ftohtë, sa dukej. U ul në stol. U kollit. Qeni rrinte me shpinën mbështetur në këmbët e tij. Ai e përkëdheli në kokë dhe piu birra.

Sejlo çante dru para strehës. Kishte zhveshur xhupin dhe këmishën.

Petri shikonte si tendoseshin duart e tij të trasha, muskujt i shtrëngoheshin për çdo goditje. Kishte këmbë të shkurtra të forta dhe duar të gjata. Ishte i fortë fizikisht. Petri ishte më i gjatë se ai, por Sejlo peshonte nja tridhjetë kile më shumë. Petri e dinte që jeta e tij nuk kishte qenë gjithmonë kështu, kishte pasur periudha për të cilat ai nuk fliste. Edhe Petri kishte pasur të tilla.

Marja hapi derën e vilës dhe thirri, sepse kishte nevojë për ndihmë. Petri u ngrit dhe nxitoi nëpër shkallë. Ndihej si djalë i vogël që pret paratë javore të xhepit dhe kishte dëshirë të ndihmonte.

-Më duhet ta hap – tha Marja dhe preku sipërfaqen e ndritshme të tavolinës. Është më mirë, kur ka më shumë vend.

Petri qëndroi para tavolinës, e kapi fort atë dhe e tërhoqi. Marja u shtrëngua pas shpinës së tij, futi dorën midis shalëve të tij dhe e shtrëngonte.

-Ama, sa i madh qenka – pëshpëriti ajo me zë të ulët.

Petri u kthye e vështroi, ajo vazhdonte ta prekte. Ai ia hoqi dorën, doli jashtë dhe mbylli derën.

Qëndronte në tarracë dhe shikonte detin e valëzuar. Zemra i rrihte fort dhe i dridheshin gjunjët. Iu kujtua Suvi dhe si ndihej me të.

Erdhi Sejlo me sëpatën në dorë, u ul në stol dhe e la në dysheme pykën gri. Mori një shishe birra dhe e hapi mjeshtërisht me tehun e sëpatës. Kapaku tringëlliu në dyshemenë e tarracës dhe u rrotullua. Sejlo ia zgjati birrën Petrit, hapi shishen e dytë, e

piu me gllënjka të gjata dhe filloi të mprehë sëpatën.

Petri u ul në stol. Shiu përplasej në çati, era tundte pishat. Ishte ora dy. Petri po mendonte si do të arrinte deri në qytet, po të nisej tani. E vështroi fshehurazi mikun e vet dhe vendosi që duhej t'ia tregonte menjëherë atë që kishte ndodhur, por nuk gjente dot fjalët. Rrinte në heshtje. Sejlllo mprehte sëpatën, Petri rrotullonte shishen në duar dhe ndiente se ishte pjesëmarrës në pabesi.

Marja doli jashtë e mbështjellë me peshqir të bardhë dhe zbathur. Thonjtë e këmbëve i kishte të lyer me manikyr të kuq. Vështroi Petrin dhe buzëqeshi.

-Do shkoj në sauna. Ejani dhe ju. Atje ka peshqirë.

Marja zbriti nëpër shkallë dhe mori rrugën e ngushtë. Sejlllo e ndiqte me sy.

-Marja ka një të kaluar jo të lehtë dhe, ndoshta, ndonjë ditë do të ta tregojë. Por ia doli, ajo është guximtare. Jam përpjekur ta bëj të lumtur dhe, ndoshta, do t'ia arrij. Të shkojmë edhe ne.

Sejlllo e mbaroi birrën, u përkul dhe hoqi sandalet. U ngrit dhe hoqi pantallonat. Petri pa organin e tij të trashë e të shkurtër.

Sejlllo zbriti nëpër shkallë me sëpatën në dorë. Petri e ndiqte me sy. Mollaqet i tundeshin dhe ai ecte duke hapur krahët.

Para derës së strehës Sejlllo u përkul dhe e hodhi sëpatën brenda. Petrit nuk i pëlqeu ajo pamje. U ul në stol, mbuloi fytyrën me duar dhe psherëtiu thellë.

Para saunës u zhvesh dhe pas një hezitimi të shkurtër, hyri në sauna.

Marja ishte shtrirë në stol me këmbët në prehër të Sejlllos, i cili i fërkonte asaj shputat. Ajo u ngrit dhe vështroi djaloshin. Ai u vendos ndërmjet tyre.

Sejlllo hodhi ujë akoma dhe filloi të fliste për restorantin. Nuk ishte i kënaqur nga rezultatet. E kishte atë prej dy vjetësh, pabi e trishtonte, por salloni i ngrënies jo. Del që nuk është me humbje. Ushqimi finlandez me produkte finlandeze ekologjikisht të pastër, por s'kishte ndonjë frekuentim të madh.

Megjithatë, po të mos kishte fitime, deri tani do të kishte

falimentuar. Ai fshiu djersën nga fytyra dhe mori zjarr. Petrit i pëlqente mënyra, me të cilën zëri i ulët i Sejllos bënte lidhjen midis gjërave dhe i bënte të tjerët ta dëgjonin. Petri mbylli sytë dhe përfytyroi sallën e zyrtë në katin e dytë të restorantit me muret e veshura me dru të gdhendur, tavolinat, kokat e klientëve dhe tymin e cigares.

Sejlllo tregonte, shikonte çdo ditë që bashkëqytetarët e vet shkonin në picerinë turke ngjitur për pica me pesë euro, të cilat i hanë si somnabulët nën degët e palmave plastike. Dalin pas pesë minutash dhe shikohen në xhamin e derës së hyrjes. Ja ku të çon socialdemokracia. Nëse populli nuk e pëlqen kuzhinën e vet, atëherë beteja është e humbur, në djall të vejë. Marja përkulet dhe e zë për dore.

-Ej, a do ta ndërrojmë temën? E mërzhite mysafirin. Të rinjtë nuk interesohen për problemet e ushqimit. Kanë gjëra të tjera në kokë.

Petri nxitoi të thoshte se gjendja e restorantit i interesonte shumë, sepse është vendi i tij i dashur. Gruaja qeshi.

Ra qetësia, vetëm drutë në sobë kërcisnin. Sejlllo hodhi akoma ujë mbi gurë.

Marja zbriti nga stoli i lartë, u ul në të poshtmin dhe i tha Sejllos ta ndiqte. Mora tubetin me shampo dhe filloi t'i lante flokët atij. Ia shkumëzoi kokën dhe veshët me kujdes, pastaj ia shpëlau me ujë. Flokët e lagur i dukeshin mjaft të gjatë, i arrinin gati deri tek supet. Marja sapunisi edhe trupin e tij. Ai e falënderoi me një puthje në faqe dhe doli. Petri e ndjeu të kollitej duke shkuar nga deti.

-Është radha jote – Marja ia nguli sytë djaloshit. – Hajde.

Ai zbriti nga stoli i sipërm dhe u ul në tjetrin më poshtë. Gruaja u ngrit para tij. Petri vështroi barkun e saj të lagur, të ngjeshur, legenin e gjerë dhe vithet e rrumbullakta.

-Ti s'ke nevojë ta lash kokën – tha ajo dhe i përkëdheli kurorën e flokëve.

U ul galiç dhe ia sapunisi trupin. Njëpër shpatulla dhe gjoksin e saj të vogël rridhte djersa. Buzët i kishte të kuqe. Ajo e pyeti me

zë të ulët :

-Çfarë historie kanë tatuazhet e tua?

-I kam blerë.

-Kanë ndonjë kuptim?

-Nuk e di, ka shumë kohë, kam harruar.

Ajo ia sapunisi kofshët. Pastaj me një dorë e kapi pas testikujve, ndërsa me dorën tjetër i rrëmbeu organin mashkullor.

-Oh, është i bukur – tha ajo, e këqyri dhe ia tërhoqi lëkurën e kokës prapa.

Dera e sallës u përplas dhe hyri Sejlllo. Petri u përpoq të kthehej me shpinë nga dera. Marja ia shtrëngonte fort organin dhe ia përkëdhelte kokën e vogël të tij me gishtat e sapunisur. Ajo mbështetej drejt e në fytyrën e saj.

-Një mrekulli.

Ajo e lëshoi, u ngrit dhe derdhi mbi Petrin një tas me ujë.

-Cili prej jush do të më lajë?

-E ka radhën Petri – tha Sejlllo që ishte shtrirë në stolin e sipërm.

-Nuk mundem, duhet të shkoj të notoj, përndryshe do të më merren mendtë – tha djaloshi, u ngrit dhe doli.

Shiu ishte shtuar. Qeni lehte prapa vilës. U ngjit lart duke pllaquritur këmbët e zbathura nëpër shkallët e lagura. Shkoi në fund të portit dhe u hodh me kokë. U zhyt aq thellë, sa e lejonin forcat. Doli në sipërfaqe dhe ndjeu shiun në fytyrë.

Notoi nja njëqind metra, u kthye në kurriz dhe vështroi nga bregu, nga vila dhe sauna në kodrinë. Organin e vet e kishte akoma të ngritur. Ai e preku. Madje edhe në ujë të ftohtë mbetej i fortë si gur. Me Suvin kurë s’do të bëhej kështu. Pëshpëriti, vështronte në qiell dhe atje i shfaqej fytyra e Suvit.

Notoi drejt bregut me lëvizje të ngadalshme. Ngjiti shkallët e skelës. Qeni i doli përpara i gëzuar. Thinjtë e tij e gërvishtën nëpër kofshë. E largoi qenin më tutje.

-Juho Kusti! Poshtë!

Në sauna Sejlllo i fërkonte shpinën Marjës, e cila lëshonte tinguj të qetë. Petri u ngjit në stolin e sipërm. Ajo e ngriti fytyrën

drejt atij. Flokët e saj ngjyrë lajthi ia rrethonin fytyrën e saj të lagur e të skuqur. Vazhdonte ta shikonte, duke u zhvendosur më afër tij. Ajo ia kapi organin dhe e futi gojë.

-Një mrekulli.

Sejlo e fërkonte Marjën dhe ajo thithte organin e mysafirrit, i cili ishte mbështetur në mur me sy mbyllur dhe mendonte sa pak i njihnte njerëzit. Iu kujtuan rruga me rërë dhe kuajt e fortë në sfondin e pyllit të errët.

Marja ia lëshoi organin dhe tha duke iu marrë fryma:

-Ej, nuk duroj dot më. Më merren mendtë. Duhet të freskohem.

Sejlo i hodhi një kovë ujë përsipër, ia largoi flokët nga fytyra dhe e puthi në sup e në qafë.

-Urdhëro, vogëlushe.

Ajo qeshi dhe tha me sy të mbyllur:

-Falemiderit, kreshnik.

Petri, në dhomën e zhveshjes, u mbështoll me një peshqir. Doli dhe u nis zbathur për në tarracën e vilës. U mbështet në kangiella dhe vështroi nga deti. Përmes peshqirit preku organin e tij, gjysmë në ereksion dhe mendoi për emrin Rumatula. Marja dhe Sejlo dolën nga sauna zbathur, të kapur për dore.

Sejlo tha se do pinte një cigare. Marja e mori Petrin për dore e çoi atë në një dhomë gjumi të madhe dhe ndezi dritat. Në mur ishte varur një qilim, ndërsa krevati ishte i gjerë. Petri tha se kishte etje. Gruaja zgjidhi rripin e peshqirit të saj dhe e hodhi në dysheme. Tërhoqi peshqirin e Petrit dhe e shtyu atë në krevat. U shtri pranë tij dhe e puthi, trupin e kishte të ngrohtë e të lagësht. Hapi këmbët në mënyrë joshëse. Ai u shtri mbi të dhe penetroi në vaginën e saj. Ajo psherëtiu, u kap pas shpatullave të tij dhe lëvizte vithet me ritmin e tij. Ai vështronte nishanin në buzën e saj dhe depërtoi akoma më fort. Ajo buzëqeshi, kur ai, pas pak arriti kulmin.

-Një mrekulli.

Petri ejakuloi gjatë. Mbaroi dhe u ndje bosh. U shtrëngua pas saj dhe mori frymë thellë në qafën e saj. Ngriti kokën, e puthi në ballë dhe ndjeu aromën e flokëve të saj. Ajo buzëqeshte me sytë

mbyllur dhe lëvizte lehtë vithet duke e përkëdhelur në faqe dhe në të ndenjura. Ai e futi fytyrën në qafën e saj dhe mbylli sytë.

U dëgjua një kollitje. Petri nxitoi të largohej nga Marja. Sejlllo buzëqeshte pranë krevatit dhe shtrëngonte organin e tij të zmadhuar nga ereksioni. “I dashur” - tha Marja dhe hapi krahët.

Ai u hodh mbi të. Petri e ndjeu veten keq. Kurrë më parë s’kishte parë një skenë të tillë. Në hundë kishte një pikë uji – nuk e dinte, nëse ishte djersë apo ujë, s’dinte çfarë të bënte – të rrinte apo të dilte. Sejlllo bëri disa lëvizje, ngjante me një kafshë të trashë.

U ngjesh pas gruas, e puthi në buzë, ia përfshiu trupin me krahët e tij të fortë, pastaj ngriti pak vithet dhe u lëshua mbi të. Penetronte në të pa i lëvizur vithet, vetëm me lëvizje lëkundëse e shtypte me të gjithë peshën e vet dhe nga frymëmarrja, Petri e kuptoi se asaj kështu i pëlqente.

Sejlllo bënte diçka, për të cilën një burrë është i aftë ta bëjë vetëm nëse e do një grua për një kohë të gjatë dhe ia ka studiuar dëshirat e saj. Sejlllo i trashë shtypte Marjën trupvogël, e cila merrte frymë rëndë dhe kthente kokën sa djathtas – majtas. Kur u afrua orgazma, Petri u afrua më shumë dhe vështroi atë në fytyrë. Marja perëndoi sytë dhe arriti momentin kulminant.

Hëngrën salmon me djathë kaçkavall.

Marja e pyeti Petrin për familjen e tij. Ai i përgjigjej si me zor. E pyeti sa vjeç ishte. “Njëzet e një” -iu përgjigj ai.

Sejlllo mbushi gotat me verë dhe tregoi se një asistent i kishte dërguar e-mail-e fyese, të cilat e kishin zbavitur. Kishte ndërmend ta ftonte në takim.

Pasi hëngrën, Marja tha se do ta qethte Sejllon. Petri u ul në stolin e tarracës me një gotë uiski në dorë dhe shikonte Sejllon të ulur në stolin e vogël, me peshqir hedhur në supe. Marja ia priste flokët që binin në dysHEME, prej nga era i merrte menjëherë.

-Të t’i pres flokët si të Petrit?

-Jo, kokërruarit janë qesharakë dhe të dobët në krevat.

Ato fjalë i kujtuan Petrit një ndodhi nga dimri i kaluar në “Kaski”. Sejlllo kishte pirë. Në tavolinë kishte shumë njerëz, ishte

një atmosferë miqësore intime. Aty ishte edhe një kokërruar me syze, i cili, më vonë, u largua nga grupi.

Gjithë mbrëmjen rrinte i qetë. Kur Sejllo tregoi një gjë veçanërisht interesante dhe heshti që të ndizte cigaren, djali u hodh përpara dhe tundte krahët para dhe lart.

-Zig Hajll! – thirri ai.

Sejllo e këqyri, thithi cigaren dhe tha:

-Ti nuk je në “Folenë e shqiponjave”, Gëbels, por në restorantin “Kaski” dhe këtu flitet finlandisht.

Sikur u errësua më herët se ditën e mëparshme. Shiu pushoi. Era sillte frymën e vjeshtës, megjithëse ishte vetëm java dytë e gushtit. Në oxhak digjeshin ashklat e mëshateknës. Marja dhe Sejllo rrinin në divan. Petri në karrigen lëkundëse.

Shikonte qenin. Flinte mënjanë mbi qilim. Dukej sikur shikonte ëndërr, meqenëse këmbët i lëviznin dhe dukej sikur qante lehtë. Kohë pas kohe, zgjohej, ngrinte kokën dhe vështronte me habi njerëzit, akoma në robërinë e ëndrrës. Pastaj, i qetësuar nga pamja, lëshonte kokën mbi qilim dhe psherëtinte. Ishte vetëm një qen, por Petrit i dukej e çuditshme që, në botë, ekzistonte një qenie e tillë – e kuqërreme, leshtore, e cila ushqehet në pjatë, kërcente, lehtë dhe psherëtinte. Çfarë përfaqësonte në thelb ajo?

Pas orës dhjetë, Petri u ngrit, shkoi në banjën e vogël dhe lau dhëmbët. U pà në pasqyrë dhe vuri ré se ishte i njëjti, si më parë. U uroi natën e mirë të zotëve të shtëpisë dhe shkoi në dhomën e gjumit. E la derën pak të hapur, u zhvesh, u shtri dhe u mbështoll me batanije.

Rrinte shtrirë lakuriq në errësirë, dëgjonte bisedën e Marjës dhe Sejllos. Ai vuri duart mbi bark dhe ndjeu një gëzim, i cili, në fillim, përjetohej vështirë, por me të cilin mësoheshe dalëngadalë.

Atë e zgjoi Marja. Jashtë prapë binte shi.

-Më bëj vend pranë vetes. Sejllo gërhet aq shumë, sa që unë nuk mund të fle. Petri ngriti batanijen, ajo hodhi në dysHEME këmishën e natës dhe u struk pranë tij. Shiu përplasej në xhamin e dritares dhe në llamarinën e çatisë. Prapa murit Sejllo gërhiste me guxim.

Marja u ngjit me gjinjtë e saj pas tij.

Ai e përqafoi. Ajo futi kokën në jastëk dhe mori frymë rëndë. Ai hipi sipër saj ngadalë, duke ia mbajtur vithet, penetroi në të, rëndonte mbi trupin saj me të gjithë peshën. U përpoq t'ia bënte siç ia kishte bërë Sejlllo. U përpoq gjatë. Gruaja merrte frymë mbyturazi dhe rënkonte, por po arrinte në orgazëm.

Petri e kuptoi se si ishte puna, por mendoi se atij nuk i takonte të bënte si burri i saj. Rrinin pranë njëri-tjetrit në krevat. Marja filloi ta përkëdhelte. Petri e shtrëngoi me dorën e majtë, ndërsa me të djathtën masturbohej.

Frymëmarrja iu shpeshtua, muskujt e saj u tendosën, u drodh dhe mbaroi me britmë. Ai masturbohej akoma më shpejt. U kujtua si depërtoi deri në orgazëm Sejlllo tek Marja dhe farat e spermës së tij u përzien me lëngun e saj brenda. Me këtë mendim Petri arriti në ereksion.

Sperma e tij njollosoi çarçafin dhe u ngjit pas lëkurës së tyre.

Marja qeshi dhe fshiu fytyrën. U kthye nga djaloshti që merrte frymë rëndë, e futi fytyrën në qafën e tij, e puthi, lëshoi kokën mbi barkun e tij të lagur dhe e mori në gojë organin e tij.

-Mrekulli, mrekulli, mrekulli.

Pastaj e vuri kokën në jastëk. Ai e këqyri në fytyrë. Ajo gërryente thoin e gishtit me dhëmbë dhe vështronte nga dritarja. Ajo nuk ishte ndonjë bukuroshe e madhe. U struk nën sqetullën e tij dhe kapi prapë organin e tij.

-Ti je grua e shqetësuar.

-Tashmë nuk jam. Kur isha e re, isha e shqetësuar dhe e trishtuar.

Marja përkëdhelte ngadalë penisin e tij të butë. Zëri i saj tingëllonte mendueshëm.

-Organi seksual është një përcaktim i tmerrshëm. Për shembull, nëse në gjysmë të aktit, hyn dikush dhe pyet: "Përse dihasni?" do t'i përgjigjen: Po përdorim organet tona seksuale".

Ajo largoi flokët nga fytyra.

-Më shumë më bezdisin shkencëtarët dhe mjekët, të cilët

fasin për dashurinë dhe seksin. Nuk dua ta di cila është natyra e dashurisë dhe e seksit. Në rinë kam qenë shumë e dëshpëruar. Më dukej se akti seksual është e vetmja arsye për të jetuar.

-Akoma mendon kështu?

Për një çast, Marja dukej sikur dëgjonte shiun dhe Sejllon që gërhiste pas murit.

-Jo, nuk është e vetmja, por më e rëndësishmja.

-Kurrë s'kam menduar kështu.

-Shpresoj të kesh pasur arsye të tjera.

-Po, kam pasur.

-Shpresoj që dikush të të mbrojë. Mua më mbron Sejllon.

Petri ia përkëdheli gjinjtë. Marja u mbështoll me batanije. Ai mendoi nëse duhej t'i tregonte për Suvin, për gjithçka që ai nuk kuptonte tek ajo dhe që e bënte të pafuqishëm. Në errësirë mbi veten dhe atë shikonte fytyrën e Suvit. Ndjeu se duhej të pushonte së menduari për të.

-Ju më bëtë të lumtur. Duhet të mendoj mirë për gjithçka që më ndodhi.

-Mos mendo më për asgjë. Hajde të flemë tani. Sejllon më tha se nesër je në punë. Ai do të të çojë me makinë në shtëpi në kohën e duhur.

-Kështu më premtoi.

Sejllon e la para shtëpisë afër drekës. Dielli dukej sikur dridhej. Gjatë gjithë rrugës Petri mendonte t'ia thoshte.

-Kam varur në derën e tualetit pllakatën tënd të zgjedhur.

Sejllon buzëqeshi. Dukej i menduar.

-Mirë që është në banjë dhe jo në dhomën e gjumit.

-Nuk kam dhomë gjumi. Jetoj në një garsonierë.

-Ah, more djalë. Çdo burrë ka nevojë për një dhomë gjumi. A e di çfarë kuptimi ka kjo?

Ai vështroi Petrin.

-Dhe mbaje mend se për Marjën nuk ndodh që askush të thotë diçka të keqe. Nëse e bën ti, do të ta këpus kokën.

-Të siguroj që s'do ta bëj.

Sejlllo e la pranë pazarit. Nxori çantën nga bagazhi dhe ia dha. Petri e uli përtokë. Zgjati duart e përqafoi para syve të blerësve e kalimtarëve dhe e shtrëngoi, sikur përqafonte të dashurën ose sikur të ishin vëllezër.

11

Bleu një gazetë në stacion dhe u nis për tek autobusi. E futi çantën në bagazh, ndezi një cigare dhe hodhi sytë mbi turmën e njerëzve. Ndihej mirë. Kishte kaluar një natë të qetë, në gjumë të thellë. Mendonte se, madje kishte parë ëndrra ose kështu i dukej në mëngjes, kur u zgjua. Ishte e kotë të kalonte natën në Tamper, mund të ishte nisur që dje për në Turku, por në dhomën e hotelit u ndje i qetë dhe vendosi të rrijë aty.

Në autobus u ul në fund. U nisëm. Piu shishkën e konjakut që kishte marrë nga minibari dhe hapi gazetën. Vuri ré në një foto të vogël, sa një pullë poste, fizionominë e vet. Mezi njohu veten. Fytyra ime dukej e fryrë e skuqur, e lëmuar.

i ngjaja një viktime nga zjarri. Në syrin e majtë, si të verbër dukej një si njollë, sikur të më kishin qëlluar në kohën e fotografimit. Redaksia e kishte ndryshuar titullin e artikullit tim. “Kryemjeku global dhe rreziku nga mjekimi i gabuar” ishte ndryshuar në “Kryemjeku global dhe përgjegjësia e tij për kurimin”.

Ishte pothuajse e njëjta gjë dhe, me siguri, titulli i ri ishte më i përshtatshëm, por unë u nervozova.

E lexova dhe pa e ditur përse, ndjeva bezdi. Artikulli nuk ishte i keq. Stili ishte elastik dhe ironia ime e dallueshme qartë. Krahasimi i SHBA-ve me mjekun botëror dhe jo me policin botëror ishte mënyra e më e mirë për të paraqitur politikën e tyre të jashtme dhe vlerat e saj.

Më dukej se kishte një përputhje ndërmjet ndërhyrjes së tyre humanitare dhe betimit të Hipokratit, megjithëse kjo nuk ishte realiste. Në fund të fundit ai ishte një artikull i zakonshëm, të

cilin dikush do ta lexonte në mëngjes dhe pastaj do ta harronte, i tërhequr nga diçka më interesante.

E grisa faqen e gazetës, e palosa, nxora nga çanta një libër dhe e vura midis faqeve të tij.

Më vinte turp nga vetja. Mendova se ndihesha i turpëruar për shkak të interesit tim ndaj veprës sime. Kur askush tjetër nuk paraqet interes për punën tënde, kureshtja jote ndaj saj, të bëhet e panatyrshme. Nuk e di a ka ndonjë profesion tjetër, në të cilin, me punë krijuese këmbëngulëse, të arrihen rezultate kaq pak të kënaqshme.

Përqindjet e humbjes ishin të pabesueshme. Dhe s'kisha fare nevojë që të tjerët të më kuptojnë. Ky do të ishte një mendim shumë romantik. Kisha nevojë vetëm për parà dhe autoritet, por këto i arrija shumë rrallë.

Supozoj që, si biznesmen ose mjek, do të kisha më shumë respekt për veten. Disertacionin e kisha vënë në binarë dhe për disa muaj shkrova katër analiza politike të shkëlqyera. I bëra relativisht lehtë dhe puna më dha kënaqësi. Nuk e di përse.

Ishte e këndshme që puna të më jepte popullaritet.

Synimi për t'u bërë i njohur nuk është problem vetëm i njerëzve që merren me disiplina humanitare. Para dy vitesh mora pjesë në një seminar ndërkombëtar postdiplomant, në të cilin merrnin pjesë dhe natyralistët. Në grupin tim kishte gjashtë biologë të lënë pas dore.

Njëra nga detyrat tona ishte të mblidhnim informacion gazetaresk për disertacionin. Lexonim artikuj, i diskutonim dhe ndreqnim gjuhën dhe konstruktet. Shtypi dhe mediat elektronike vazhdimisht injoronin punimet e biologëve të mi.

Ata kishin studiuar shumëllojshmërinë e algave të kaltra planktonike, genotipin e virusit, që infektonte rrushin francez dhe se si përmbajtja e fosforit në fund të liqeneve ndikon tek kopepodët. Gjithmonë kam besuar se qëllimi kryesor i biologëve është të kuptonin themelin e biosferës.

Por biologët e mi synonin të tërhiqnin vëmendjen tek mjetet

e informimit masiv dhe flisnin për këtë jashtëzakonisht shumë. Me këmishët e tyre të leshta dhe çizme llastiku, ata dukeshin simpatikë, por të dënuar për t'u harruar. Ishte vështirë të bëje diçka për njohjen e tyre. Në takimin e fundit u lodha nga tregimet tyre dhe u thashë: “Nëse doni të bëheni të njohur, qethuni, në djall të vejë. Buzëqeshni. Përpiquni që të mos dukeni si vajza të përdhunuara

Tamperi mbeti pas. Përreth shtrihej peizazhi fshatar. Mendova për gjendjen në të cilën ndodhej Ina dhe për sa shumë gjëra ëndërronte. Paratë e babait do t'i siguronin një ekzistencë të durueshme, ndoshta deri në fund të jetës. Çfarë do të bënte ajo në vitet dhe dekadat e ardhme? Kurrë s’kishim folur për të ardhmen, pavarësisht nëse ishim bashkë apo të ndarë.

Si vëzhgues anësor, shikoja trupin tim ulur. Ishte njëfarë lloj makine luftarake pretencioze. Isha veshur me kostum të zi, i cili, nuk e di përse, më dukej i përshtatshëm për rastin. Në të trupi im pushonte qetë dhe i kënaqur, në njëfarë ekuilibri gjendeshin kockat, kyçet dhe nervat e ndjeshme, por kjo ishte një ndjesi e rreme. Isha i mpirë nga tmerri.

Po të mund ta kuptonim pamjen tonë, do të mund të përpunonim teorinë gjithëpërfshirëse të dhunës. Do të shikonim garzën e kuqe si gjaku, e cila mbulon gjithçka që lidhet me njeriun – që nga sjellja e tij deri në vendosjen e bazave amerikane në Azinë e Mesme.

Mendimet e mia ishin abstrakte. Rrëmoja në qesen e birrës. Piva. Vështrova nga dritarja. Verë. Idil fshataresk. Autobus.

12

Kisha prej guri ngjyrë gri, qendra tregtare, shkolla dhe bari i karaokes në qoshe të stacionit të makinave. Pesë, gjashtë mijë banorë në qytetin provincial, në Finlandën Jugore, vend i rrethuar me fusha të gjera, ku mund të shkosh për të parë fëmijët, derisa vdekja nuk do të të shembë.

Disa kilometra pas qendrës së qytetit zbrita nga autobusi dhe mora çantën në bagazh. Autobusi u nis. Dielli të digjte. Në buzë të rrugës kishin çelur lulet e fushës dhe bulkthat këndonin. Në të majtën time kalonte një rrugë ranore. Afër kryqëzimit, një mështeknës e gjatë kishte varur degët e saj.

Në largësi dukej një fermë. Nxora hartën, e pashë me kujdes dhe kuptova se kisha zbritur shumë herët. Harta s'kishte shkallë, por e kuptova se do të më duhej të përshkoja në këmbë tre ose katër kilometra.

E hoqa xhakëtën dhe e futa në çantë. Zbërtheva këmishën, mora një birrë, e hodha çantën në sup dhe u nisa. Në fakt kisha kënaqësi të ecja ngadalë në një rrugë të panjohur, me çantë në krah, duke pirë birrë të ngrohtë, i djersitur. Deri në fillimin e seminarit kishte mjaft kohë dhe s'kishte përse të vonohesha.

Duke ecur nëpër rrugën ranore arrita tek një kullotë e rrethuar. Në të ishte shtrirë një lopë ngjyrë kafe të çelët dhe më vështronte. Dukej e lumtur. Ndalova. Lopa tundi veshët dhe u kthye nga ana tjetër duke e hequr nga unë shikimin e saj të mençur.

Pas pak, pashë në largësi ndërtesën e bukur të uzinës, të ndërtuar me tulla të kuqe. Ishte e vjetër, me siguri e ndërtuar nga vitet 1800. Parkingu ishte plot me makina. Njerëzit rrinin pranë tavolinave plastike. Hyra në ndërtesë.

Në recepsion u paraqita tek një teto gjoksmadhe, e qeshur. Pasi ma gjeti emrin në listë, më dha çelësat, kuponat për restorantin, programin e seminarit dhe një fletë me rregullat e brendshme. Më shpjegoi si ta gjeja apartamentin dhe më përshëndeti me “mirë se erdhe”.

Në oborrin, e rrethuar me shkurre dhe lule, ngrihej një skenë teatrale për fëmijë, mbi të cilën fëmijët organizonin shfaqje. Fytyrat i kishin me grim. Publiku i shikonte nga stolat. U largova shpejt.

Përballë ishte edhe një ndërtesë tjetër me tulla të kuqe, po aq e bukur sa e para. Në tabelë lexohej “Muzeu i uzinës”. Nuk e kisha idenë se çfarë prodhohej këtu, ndoshta qeramikë, qelq ose

karton, por as nuk më interesonte. Më poshtë kaltëronte liqeni.

Vazhdova nëpër rrugën e rrethuar me shkurre dhe arrita tek rreshti i kafeneve, ndërtime që ngjanin me baraka. Me siguri, ishin ndërtuar në vitet gjashtëdhjetë. U emocionova, kur mendova se ato kishin qenë konviktet e vajzave që punonin në uzinë. Që këtë niseshin në mbrëmjet e verës me biçikleta për të kërcyer, me funde linoje që fluturonin nga era.

E gjeta apartamentin dhe e hapa. Përbëhej nga një dhomë, një kuzhinë e vogël dhe banja. Dyshemeja ishte e mbuluar me linoleum. Përmes dritares së vetme hapej pamja e zabelit me shkurre. Fryma e vajzave të uzinës ishte avulluar. Frigoriferi në kuzhinë ishte në punë. Vura aty vodkën dhe verën e bardhë, që kisha sjellë. Hapa dritaren e vogël, pastaj zbraza çantën mbi tavolinë e lyer me bojë të bardhë.

Menjëherë vura ré diçka të çuditshme. Kish marrë me vete dy palë mbathje të Inës. E pakuptueshme. Përdorja bokserët dhe s'kishte arsye që ndërresat e Inës të ishin midis tyre. Po mendoja, mos vallë i kishte vënë që të më kujtonin diçka. Por unë e përgatita vetë bagazhin.

Mora birrën e fundit dhe u shemba mbi krevat. Lexova programin e seminarit treditör. Për sot, të premtën, ishin parashikuar muzikë, teatër, lexim poezish, biseda dhe hedhje çekiçi. Dhe mbrëmje vallëzimi pranë bregut të liqenit.

Qesha, kur pashë titullin e panelit të diskutimeve. Dikush ishte zbavitur: “Veprimtaria mendore – përkthim, marginalizim ose mospërfillje”. Biseda do të zgjaste një orë e gjysmë. Pastaj autorët vendas të lirikës së dashurisë do të lexonin vargjet e tyre, po ashtu, dhe poetët që shkruajnë në dialekt. E kuptova se grupi ynë ishte përcaktuar si qengji kurban i romantikëve provincialë, që do të na mërzhiteshin për vdekje.

Kisha ndërmend ta mendoja mirë referatin tim, por pasi pashë titullin, kuptova se do të ishte vetëm humbje kohe.

Pija birrë dhe mendoja për një shok fëmijërie. Si fizionomi i ngjante molës, por ishte bërë shkencëtar ndërkombëtar i njohur,

i cili punonte për problemet e kancerit. Thoshte që ishte tërësisht i përkushtuar në punën e vet.

Studionte, studionte, studionte, i vinte përqark botës, qëndronte në hotele luksoze dhe mbante kumtesa në kongrese që u kushtoheshin sëmundjeve të kancerit. Takoheshim periodikisht dhe çdo herë dukej më keq se herën e kaluar. Zvogëlohej para syve të mi. Besoja që kanceri do t'i jepte fund atij në vitet e afërta.

Një jetë e tillë, në të cilën nuk lë asgjë pas vetes, nuk ishte për mua. Isha i kënaqur nga e imja. Në hotelin e Tamperit pashë porno në stilin e realizmit magjik, pastaj pashë lopën e lumtur dhe për një çast pashë edhe shfaqjen e fëmijëve. Në frigorifer ftohej vera e bardhë dhe vodka. Askush s'priste prej meje të shfaqja talente. Merrja vendime të improvizuara, pa më shqetësuar asgjë.

Vështrova dhomën. Ishte tmerrësisht e shëmtuar.

Bukuria e peizazhit gjithmonë më ka lënë indiferent. Në Finlandë kjo cilësi të jep prioritet. Për një periudhë shumë të shkurtër kohe e kaluam rrugën nga oborri fshatar në kuzhinën moderne. Kur mbyll sytë, në vetëdijen time më rishfaqet banesa prindërve të mi, fëmijëria ime, e rrethuar me mobilie druri.

Jashtë u ndje e qeshur femre. U ngrita. Shkova tek dritarja dhe hodha sytë jashtë. Përmes shkurreve pashë se në rrugë ecte një grua me një fustan vere, bardhë e zi, të shkurtër. Kishte këmbë të gjata të hijshme dhe flokë të errët. Fliste me gjallëri në telefon. Nuk mund t'ia shikoja fytyrën, megjithatë ia pashë mirë prapnicën.

Më ra telefoni. Ishte sekretarja e seminarit, një grua në moshë mesatare. U morëm vesh që të takohemi para restorantit një gjysmë ore para fillimit të bisedës. M'u duk se ishte mjaft e entuziazmuar. Ndjeva që dera e apartamentit ngjitur u hap dhe u mbyll. Dallova një zë femre, i cili do të bënte kureshtar, madje dhe një burrë të vjetër.

Para restorantit arrita i fundit. Pjesëmarrësit e tjerë në diskutim, tashmë, ishin ulur nën mështekna pranë një tavoline, ku qëndronte dhe kryetarja me një shall shumëngjyrësh në qafë. Kishte gënjyer veten, kishte grimuar fytyrën e saj të dërmuar dhe kishte varur në veshë një palë vathë të mëdhenj, të kaltër.

U përshëndet ngrohtësisht me mua, fliste shpejt, duke lëvizur duart me gjallëri. E mora me mend që ishte mësuese e gjuhës finlandeze. U prezantova me katër pjesëmarrësit e tjerë. U gëzova, kur pashë se nga restoranti po sillnin alkool. Mora një gotë uiski dhe u ula.

Nuk e dija, e kujt kishte qenë ideja të na ftojë pikërisht ne të pestë për të marrë pjesë në atë panel diskutimesh. I vetmi, disi i njohur, ishte një shkrimtar rreth të pesëdhjetave, i cili i ngjante Teli Savalasit, tullac trashaluç.

E dija që vjeshtën e kaluar kishte publikuar një roman sado-maz pesëqind faqesh, i cili, pavarësisht nga reklama, nuk pati kurrfarë suksesi. Dukej goxha i pirë, djersinte dhe tundej në karrige me një shprehje fytyre të zymtë dhe agresive.

Pranë Koxhakut rrinte një fotografe e re feministe, me flokë të zinj, e shkurtër dhe tepër e gjerë, trupi i së cilës, i veshur me fustan shumëngjyrësh, të sillte ndërmend tualetin prej guri, ndërtuar në fund të sheshit për hedhjen e çekiçit. Pashë gruan e apartamentit ngjitur me timin. Ishte nja dyzet vjeçe, me profesion bioetike nga Helsinki dhe ishte veshur me një fustan kuq e bardhë. Kishte flokë të gjatë ngjyrë gështenjë e errët, sy të ngrohtë, fytyrë të ndjeshme pa grim. Kishte trup të hijshëm, gjoks të tendosur, të ndenjura të rrumbullakëta. Nëpër duart e saj të dobët dukeshin qimet në ngjyrë të kuqërreme. Nuk e di përse, por isha i sigurt, se ajo grua kishte një vetëdisiplinim të hekurt.

Pjesëmarrësi i katërt ishte një burrë i dobët me syze, profesionin e të cilit nuk munda ta gjej gjatë gjithë mbrëmjes. Mendoj se ishte diçka që kishte lidhje me fenë. Duhej të ishte i pranishëm edhe një drejtor i shitjeve nga agjencia e informimit të Tamperit, por ai, që në mëngjes,

kishte refuzuar të merrte pjesë nën pretextin se kishte probleme me apendicitin.

U bë e qartë se vetëm bioetikja kishte përgatitur referat. Ishte vendosur që diskutimi do të bëhej si gjithnjë – me mendime të parashtruara shkurt dhe drejtuesja mund të bënte pyetje të papritura.

-Nëse nuk do të pyesësh ndonjë gjë nga jeta ime seksuale do ngrihem e do të zhdukem – tha shkrimtari dhe i ra tavolinës me dorë.

Drejtuesja qeshi dhe preku shallin e saj. Në jakën e xhaketës kishte varur një distinktiv imazhin e Gëtes në profil. Mendova se njerëzit që organizojnë shpesh aktivitete kulturore kanë një naivitet për ta pasur zili.

Rrinim në heshtje dhe prisnim. Tavolinat e restorantit, jashtë, ishin plot, por edhe brenda kishte disa grupe.

Bioetikja shfletoi disa letra, të shkruara me të njëjtin shkrim. Kishte mbathur këpucë me taka të larta. E imagjinova atë në rini, vajzë e menduar, së cilës i pëlqejnë romanet e eksperimentale franceze, shiu dhe që shkruan në ditarin e saj: “Duhet të luftojmë për një mënyrë më të mirë jetese”. Kishte duar të bukura dhe në gishtin e unazës kishte vënë një unazë të rrafshët. E përpoqa të sajoja diçka, thjesht për të folur me të, por nuk munda. Më erdhi në mëndje vetëm ta pyesja: “A të pëlqen “Në mbrojtjen e kafshëve” nga Piter Singer?”. Ajo ishte zhytur kaq thellë në shkrimet, sa që nuk do të mund të bënim një bisedë normale. Drejtuesja vështroi orën, u ngjit në restorant, doli me hapa kërcimtareje, duke tundur duart dhe na e bëri shenjë me kokë. U ngritëm dhe hymë brenda.

U ulëm rreth një tavoline, bioetikja rrinte në krahun tim të majtë, fotografja në të djathtin, syzja pranë saj, ndërsa shkrimtari u ul në krye të tavolinës, mbi të cilën ishin radhitur gota uji bosh. Para fytyrës kisha tre mikrofoa.

Në sallë kishte së paku nja pesëdhjetë vetë – shumë më tepër nga ç’ e kisha pritur. Kuptohet që kishin ardhur për një shfaqje të përbashkët të lirikëve dhe poetëve që shkruajnë në dialekt. Pjesa më e madhe e publikut mbeti në oborr në kohën e diskutimit tonë.

Vështrova publikun. Mbizotëronin njerëz me moshë mesatare.

Shumë fshatarë, të veshur me xhaketa të shkurtra, rrinin me duart mbi gjunjë, pranë bashkëshorteve që buzëqeshin me mirësjellje. Ndoshta midis tyre kishte ndonjë tregtar të mallrave ushqimore dhe bashkëshortja sipërmarrëse, që merrej me metale.

Këtu, me siguri, ndodheshin dhe tregtarë kulturorë të komunës, redaktori i gazetës lokale, ndonjë prodhues me mjekër i qeramikës ose i verës dhe bibliotekarja e rrudhosur nga ilaçet e psikoterapisë. Një çift i ri kishte sjellë edhe fëmijët – djalin dhe vajzën. “Të paktën të kishin kursyer fëmijët” – mendova me vete unë. Megjithatë llogarita që mjedisi këtu ishte më i qetë, sesa ai i seminareve akademike të panumërta, në të cilët kisha marrë pjesë prej vitesh. Urova veten që kisha veshur kostum të zi dhe shpresoja të lija mbresa.

Kryetarja pyeti, nëse ishim gati.

-Një sekondë – tha bibliotekarja.

U ngrit dhe duke tundur vithet, sollti nga bari një kanë me ujë. Vura re se shumë fshatarë po vështronin atë. Kjo më nervozoi. Mendova se kurrë nuk do të arrija unitet shpirtëror me ndonjë fshatar, përveç se në rastin, kur ndonjë fëmijë do të shtypet nga traktori. Bibliotekarja mbushi gotat para nesh dhe u ul. Ndjeva aromën e parfumit të saj dhe e mora si ndonjë shenjë.. Mendova se kishte një mençuri shpirtërore.

Kryetarja hapi diskutimin. Kuptova se e kisha nënvleftësuar. Ajo fliste me lehtësi dhe zotëronte publikun.

Filloi të përshkruante ndryshimet që kishin ndodhur në Finlandë, duke treguar për fermën e babait të saj. Ferma e vjetër e trashëguar hoqi dorë nga prodhimi fshatar tradicional dhe filloi të ofronte shërbime të tilla si organizimin e festave dhe aktivitete të tjera.

Krijuan kushtet për turizmin fshatar dhe për marrjen e iniciativave tematike të ndryshme. Ka pasur edhe ekspozitë, në të cilën reklamoheshin arritjet më të mira në fushën e rritjes së derrit në Finlandën Perëndimore.

Kryetarja tregoi sallën. Ndërtesa e mëparshme e uzinës ishte kthyer në restorant dhe vend për koncerte dhe aktivitete kulturore. Ndryshimi ishte i pakthyesëm dhe prek thellë jetën në të gjithë Finlandën.

Të gjithë sektorët më të mëdhenj kaluan nga prodhimi material në

jomaterial. Ajo tha se ne, pjesëmarrësit në seminar, jemi shembuj të punës mendore. Secili prej nesh fiton ushqimin e vet duke arsyetuar. Por kjo nuk është pa dhimbje. Qeshi publiku, kur ajo tregoi për bezdinë e stomakut të drejtorit të shitjeve të agjencisë së mediave.

Pastaj u kthye nga ne :

-Mirë pra, shokë. I lutem secilit prej jush të prezantohet dhe të tregojë me çfarë pune mendore merret. Dhe të përshkruajë se si ndikon ajo tek njerëzit dhe shoqëria. Çfarë kërkoni t'u jepni atyre nëpërmjet punës suaj? Le të fillojë Kristina.

Kështu mësova se bibliotekarja quhej Kristina. Ajo filloi qetësisht. Tregoi për arsimimin filozofik dhe juridik, për disertacionin dhe çështjet etike, të cilat i kishte trajtuar në artikujt e saj. Përshkroi shkurtimisht punën e saj në universitetet finlandeze dhe britanike dhe la përshtypjen e një njeriu ta arsyeshëm dhe ambicioz. Tha se shpreson se mund t'u japë njerëzve argumentet dhe njohuritë e saj përmes analizës së provave në ruajtjen e shëndetit ose drejtësinë sociale.

Pastaj ktheu sytë nga unë.

Tregova se po shkruaja disertacionin, se jam punonjës arti nga Turku dhe përshkrova tiparet e interesave të mia studimore. Thashë se kam një subvencion të dhënë dhe kujtova vitet në stazhin si asistent, kur mësoja dhe shkruaja shumë gjëra të ndryshme.

-Çfarë u jep puna ime njerëzve?

Bëra një pauzë domethënëse.

-E kam të vështirë ta them. Para disa kohësh bleva me mjetet e mia financiare një karrige pune të re dhe ia dhashë të vjetrën sekretarit. Ai kishte një më të keqe se unë. Ose më saktë bleva karrigen me paratë e gruas me të cilën jetoja.

Fotografja foli gjatë. Ajo argumentoi me kujdes pozicionin e saj teorik dhe tregoi për punën mbi kompozimin e fotografive. Tha se kishte marrë pjesë në seminarët ndërdisiplinore të grave, ku vuri në dyshim rolin e autorëve të veçantë. Atje ata kanë bashkuar në një spektakël fotografitë, muzikën, kërcimet dhe poezinë. Tregoi se, në seritë e saj të fundit me fotografi, kishte si objekt gra të moshës mesatare, të veshura me fustane nusërie të vendit, karakteristika të

aktivitetit mashkullor – në kazerma, në ringun e boksit, në thertore dhe në sallën e bursës.

I krishteri, sapo filloi të tregonte diçka, nisi të ankohet, nuk munda ta dëgjoja më shumë.

-Unë jam bir ushtaraku – tha shkrimtari, pastaj bëri një pauzë të gjatë domethënëse. Vështroi publikun me vëmendje dhe unë kuptova se është absolutisht esëll. – Punë ime ka pak pika të përbashkëta me punën mendore.

Fliste me logjikë dhe në mënyrë imponuese. Tregoi se, që trembëdhjetë vjeç kishte bërë punë fizike dhe kishte filluar të shkruante, kur vendosi se duhej të shpjegonte përse vendime të ndryshme të pushtetit e shqetësonin gjithë natën. Ka shkruar dhjetëra libra. Në romanin e fundit ishte përqendruar vetëm mbi temën e nënshtimit dhe të përlësisë. Në të shfrytëzoi edhe përvojën e vet.

Megjithëse nuk i kisha lexuar librat, duke dëgjuar reagimet, e kisha kuptuar përse kishte pësuar fiasko. E para, autori ishte shumë i vjetër dhe i shëmtuar. E dyta, mbështetej në përvojën e vet dhe e analizonte. Atyre që blinin libra dhe përfaqësuesve të klasës së mesme, të tilla gjëra pa vlerë nuk u pëlqenin.

Shkrimtari ideal i sadomazit duhej të ishte më së shumti njëzet e pesë vjeç, burrë fotozhenik.

Shkrimtari heshti. Kryetarja iu drejtua panelit duke thënë se kush dëshironte, mund ta merrte fjalën. Publiku gjithashtu mund të merrte pjesë në shkëmbimin e mendimeve. Ra heshtja. Vështrova nga dritarja jashtë dhe pashë njerëz që shëtisnin. Dukeshin të padëmshëm, shpirtmirë, megjithëse brenda tyre zienin gjithfarë pasionesh dhe frikë.

E kërkova fjalën i pari.

-Kam një pyetje për Pekën. Ti tregove se në roman je përqendruar në temën mbi nënshtimi dhe përlësinë. A e ke shfrytëzuar përvojën tënde seksuale? Nëse po, atëherë si të duket?

Shkrimtari më hodhi një vështrim të gjatë e të zyrtë. Mori gotën nga tavolina dhe piu. Pastaj buzëqeshi.

-Kam përdorur një pjesë të saj. Libri nuk është i gjatë, rreth pesëqind faqe. Dhe si më duket. Më saktë çfarë? Të shkruarit apo përvoja ime

seksuale?

Publiku qeshi.

-Si të duket të përdorësh diçka kaq intime dhe ta vësh në dukje para të tjerëve?

-Unë thashë, jam bir ushtaraku. Kjo s'ka asgjë të përbashkët me veprimtarinë intelektuale.

Në bisedë ndërhyri fotografja. Ajo u ankua se kishim dalë nga tema. Teksa fliste, e nervozuar, tërhoqte cepin e fustanit të saj.

-Le të flasim më me hollësi për mekanizmat shoqërorë. Për strukturat e pushtetit, të cilat ne të gjithë i mbajmë. Këtu dhe tani. Me mendjen tonë, ndjenjat dhe trupin.

E imagjinoja si ajo, me trupin e saj, në sipërfaqen e detit, mban një strukturë dhe ndjeva pështirosje.

-Më duhet propë të të pyes, ti vetë je fotografuar si modele?

-Në fakt, jo.

-Përse?

-Sepse jam lodhur së tërhequri vështrimet e publikut. Unë, unë, unë.

-Është e vështirë, kur arti identifikohet me artistin.

-E qartë.

-Duket se këtu duhet të vë në dukje ngjashmërinë profesionale të njohur – tha bioetikja. Ne të gjithë merremi me veprimtari të përgjegjshme që kërkon përqendrim, nëpërmjet të të cilit ne synojmë t'i paraqesim shoqërisë sonë mundësitë dhe mjetet për zgjidhjen e problemeve shkencore. Përveç kësaj duke përdorur mendjet tona, ne ruajmë ndjeshmërinë tonë personale.

Ajo më vështroi në sy. Nxitova të kthehesha nga ana tjetër për të shmangur vështrimin e saj. E ndjeva që më kishte zbuluar.

-Ndjeshmëria, gjithashtu, është aq e rëndësishme sa dhe intelektin – pohoi shkrintari me zë të butë.

I krishteri tha të njëjtën gjë si bioetikja, vetëm se më turbull dhe më me ndjeshmëri.

Biseda mori një kthesë të papritur. Folëm për problemet e artit dhe kulturës finlandeze. Që atyre, shpesh, iu shërben një pozicion shoqëror

bindës dhe guximi. Njerëzit e artit nuk munden ose nuk guxojnë të jenë kritikë dhe pesimistë për të ardhmen. Vuri në dukje shpresën që ana sociale do të jetë në ngritje.

Ankohej se konkurrenca kapitaliste godet kulturën dhe shkencën. Mundësitë për punë dhe sigurimet shoqërore për shkencëtarët dhe artistët janë në gjendje të keqe e kështu me radhë. Kristina tregoi, e prekur, për vetëvrasjen e kolegut dhe mikut të saj. Shkaku kishte qenë se ai u gjend në rrugë të vdekur për drejtimin profesional, për zhvillimin e mundësive të tij krijuese.

Ndërsa fliste, sytë iu mbushën me lot. Doja t'ia hidhja krahun në sup për ta qetësuar, por nuk guxova.

Asgjë s'mund të thosha për mjetet e mia të ekzistencës dhe mbrojtjen sociale, sepse ato siguroheshin nga Ina me paratë e saj, pas vdekjes së trishtë të babait të saj dhe, pas pagesës së një takse të madhe për trashëgiminë. Ndoshta kishte detyrim të vazhdueshëm ndaj kishës ose kënaqej me atë që gëzonte nga Krishti. Po habitësja me vete - çfarë do të thoshte drejtori i shitjeve, po të ishte këtu, i cili pretendonte se kishte infeksion të apendicitit.

Në fund biseda preku çështjet e luftës. Kryetarja tha se, për mendimin e saj, problemi më i rëndësishëm i ndërgjegjes si për ata që merren me veprimtari intelektuale, ashtu dhe për të gjithë të tjerët është qëndrimi ndaj luftërave që bën Amerika. Politika e tyre e papërgjegjshme ka acaruar marrëdhëniet midis Perëndimit dhe botës islame.

Ajo kishte frikë se kishte një konflikt kulturor dhe fetar midis tyre.

I krishteri tha se shpreson në dialog besimi fetar, me një shprehje të tillë të fytyrës, sikur stafin e tij episkopal e kishte në varëse.

-A nuk është idiotizëm të shpresosh në dialogun fetar midis dy feve patriarkale monoteiste? – pastaj ajo bëri krahasim me hokeistin.

Nuk e kuptova krahasimin, por tingëlloi për të qeshur. Vura ré se po filloja ta pëlqeja fotografen. I krishteri dukej i fyer. Nuk u habita. Nga reagimet ndaj një artikullit tim kisha vënë ré që në vitin 2000, në Finlandë, çdo shaka shkaktonte shqetësim mes ushtrive të xhuxhëve të punës mendore.

Biseda kishte të bënte me luftën në Irak, dështimet në rendin botëror, rezistenca e sunitëve e filluar gjatë verës dhe vuajtjet e popullsisë civile. Shkrimtari heshtte dhe vështronte diku larg. E ndërpreu fotografja.

-Flisni vetëm për Irakun. Përse askush nuk thotë gjë për Sirinë? Mos po e nënvlerësoni atë? A keni menduar si mund të ndikojë mënjanimi i Huseinit tek presidenti konservator Bashar Al Asad dhe ushtria e tij? Kjo është një çështje e rëndësishme për rajonin.

Askush nuk foli. Vazhdova.

-Nëse islamofashistët marrin pushtetin atje, kjo do të shënonte fundin e bioetikës, të romaneve sadomazë dhe të fotografisë feministe. Dhe të krishtërit.

Bioetikja më vështroi me inat.

-Budallallëqe. Supozim shumë arbitrar. Ç'lidhje ka, sipas teje, midis BAAS dhe islamistëve ekstremistë?

Nuk arrita të përgjigjem, sepse shkrimtari kërceu nga karrigia dhe bërtiti:

-I dobëti duhet të nënshtrohet! Perëndimi është i fortë, shtetet islame janë të dobëta! Mos qani mbi varret e huaja!

Ai u ul përsëri me pamjen e një njeriu që i vinte për të vjellë. Të gjithë ia ngulën sytë atij. Në sallën e heshtur dëgjoheshin tingujt nga jashtë. Shkrimtari u lëshua – zuri barkun me një rën dorë dhe me tjetrën shtrëngoi ballin. Mendova se biseda për luftën, kishte zgjuar tek ai frymën e luftës. M'u duk sikur mërmëriste:

-Veprimtaria intelektuale. Në djall të vejë. Margjinalizimi dhe mospërfillja. Duhet vetëm ndërmjetësimi.

Ai drejtoi trupin dhe pui ujë.

Kryetarja u përpoq ta drejtojë bisedën në rrugë pozitive dhe na u lut të themi ndonjë arritje intelektuale të rëndësishme për ne dhe të tregonim përse ajo është domethënëse.

Bioetikja, pasi u mendua pak, kujtoi punimet e M. K. Esherit dhe tha se ato i kishin treguar asaj që thellësia nuk ka nevojë për mjegullën emocionale. Dhe se duhet të dyshojmë në vëzhgimet dhe intuitën tonë, sepse ato mund të na ngatërrojnë.

Mora fjalën dhe kujtova dy albume të grupit skocez Primal

Scream – i pari Screamadelica dhe i dyti Exterminator. Në vitin 1991, kur, për herë të parë dëgjova ritmet euforike të diskut të parë, isha nëntëmbëdhjetë vjeç. Bashkimi Sovjetik po shpërbëhej, e ardhmja kishte plot pritshmëri.

Kaluan nëntë vjet. U bëra njëzet e tetë dhe e pranova që duke dëgjuar ritmet agresive nga disku i tyre i fundit, brenda meje ngrihej një panik i paqartë. Shumë shpejt filloi lufta kundër terrorizmit. Thashë që kam dëgjuar disqet gjithmonë në të njëjtën renditje. Fotografja tregoi se, kur ishte vajzë e re kishte lexuar romanin e Aino Kalasit “E fejuara e ujkut” dhe ai kishte ndihmuar të kuptonte më mirë thelbin e vet. Nga ana tjetër, asaj i pëlqente videoja e trillerit të Majkl Xheksonit, sepse e kthente mbrapsht në vitet e rinisë.

I krishteri, gjithashtu, dha shembuj me muzikën pop. Ai vlerësonte krijimtarinë e U2 dhe, më shumë, albumin The Joshua tree. Tha se është kundërshtar i zjarrtë i kundërlaicizmit në art, sepse njeriu në thelbin e vet është homo religiosus.

Shkrimtari u qetësua. Zgjedhja e tij ishte Uliam L. Shirer dhe vepra e tij “Ngritja dhe rënia e rajhut të Tretë”, nga e cila kishte mësuar më shumë për njeriun si kafshë sociale, sesa nga martesja e tij e tretë.

-Faleminderit juve dhe publikut – tha kryetarja.

Duartrokitjet vazhduan pesë sekonda. U përkulëm para publikut. Njerëzit u ngritën dhe disa shkuan tek bari, të tjerët dolën në oborr. Disa pleq që mezi lëviznin, qëndruan në vend me sy të ngulur tek skena. Të ngrohur nga drita që vërshonte përmes dritareve, ata dukeshin si fantazma të lira në vendin e pritjes së përjetshme.

Kryetarja më propozoi të shkoja në fund të sallës, të ulem në një tavolinë të lirë e të hanim bashkë. Para shfaqjes së poetëve lirikë dhe atyre që shkruanin në dialekt kishte akoma edhe një gjysmë ore.

U morëm vesh. Arrita të ulem pranë bioetikes. Ajo porositi ushqim vegjetarian dhe verë brusko të bardhë. Unë mora një bërxollë dhe dy birra. E pastruan skenën nga karriget dhe tavolinat. E forcuan dritën dhe para skenës së pasme ngritën dekore të lartë prej kartoni.

-Diskutimi nuk shkoj shumë mirë – thashë unë, kur të gjithë porositën.

-Ishte jashtëzakonisht njohës dhe edukativ – m'u kthye kryetarja.

Ushqimi erdhi shpejt dhe ishte i mirë. Askush s'kishte dëshirë të veçantë për të folur. Unë, personalisht, ndihesha plotësisht i lirë dhe i hapur. Vura re se njerëzit mbushën gjysmën e dytë të sallës, vendet tashmë ishin të zëna, kishte njerëz edhe jashtë.

-Në të vërtetë, mua më pëlqen romani juaj i fundit – tha bioetikja, pasi hëngri.

Shkrimtari ngriti sytë nga pjata e zbrazur.

-Po pse?

Bioetikja e tërhoqi karrigen prapa, kryqëzoi këmbët dhe u përkul përpara. Fustani iu hap në kofshë.

-Sipas mendimit tim, në të trajtohen në mënyrë gjithëpërfshirëse dëshira dhe morali. Megjithëse të gjitha pohimet bëhen nëpërmjet të mohimit.

Shkrimtari buzëqeshi dhe i preku kyçin e dorës.

-Faleminderit – tha ai.

Atëherë poetët dolën në skenë. I buzëqeshën sallë së mbushur plot e përplot. Publiku u përfshi nga entuziazmi. Ata e filluan shfaqje me një dialog humoristik të rimuar duke flirtuar me vështtrimet.

Fshatarët flisnin me zë të lartë, duartrokisnin, madje fishkëllenin. Poetët buzëqeshnin me modesti dhe sinqeritet. Sikur u ishte dashur një mirënjohje e thellë që ata të ndiheshin në qiellin e shtatë. Me trishtim mendova se kurrë s'do të jem objekt i një entuziazmi të tillë.

-A, jo, djalli e marrtë. Duhet të iki – tha bioetikja.

-Edhe unë.

U morëm vesh të shihemi më vonë në vallëzim. Të gjithë premuan të vijnë, madje edhe kryetarja dhe i krishteri.

Ecja pas bioetikes nëpër hijet e zabelit. Rruga kishte anash vadha, mjedra të egra dhe hithra të gjata. Degët e pemëve vareshin mbi kokat tona, frutat e vadhave, tashmë, gjelbëronin. Kristina ecte me hap të 210

vendosur. Në një lëndinë rrezet e diellit të pasdites ngrohnin insektet.

U kujtova për një lojë, me të cilën argëtoheshim, kur ishim fëmijë. Futeshim brenda në pyll, hapnim krahët dhe rrotulloheshim derisa rrëzoheshim mbi myshkun dhe boronicat e zeza, aroma e të cilëve depërtonte thellë në mushkëri. Pishat e bukura mbi ne tundeshin dhe hapnin degët drejt qiellit të ndritshëm të verës.

Ndaluam në oborrin me çakëll para shtëpisë njëkatëshe. Futa dorën në xhep të xhakëtës për çelësin.

-Kur të jesh gati, eja tek unë të pimë nga një. Pastaj shkojmë bashkë për të kërcyer.

Gruaja më vështroi.

-Do të vij.

-Mirë. Atëherë mirupafshim së shpejti.

Ajo u kthye, hapi derën dhe hyri brenda.

Hapa frigoriferin dhe nxora vodkën. U ula në tavolinën e kuzhinës dhe piva një gllënjë nga një pije e ftohtë. Në dollapin e kuzhinës gjeta gota plastike dhe një tavllë duhani. Shpëlava dy gota dhe i vura në tavolinë. Ndeza dritën. Drita e zbehtë e llambës e bëri ambientin akoma më të paretshëm. E fika. Hapa telefonin. Kisha një thirrje nga Johana. Bëra numrin e Inës. Nuk u përgjigj. Ia hoqa zërin telefonit.

U zhvesha dhe bëra dush.

Jashtë po binte muzgu. Ia hoqa tapën shishes së verës së bardhë. U ula në errësirë para dritares, ndeza cigaren dhe piva vodkë. Prapa murit dëgjohej zhurma e ujit që rridhte. Shpejt dallova hapat që afroheshin. Bioetikja fliste në telefon. Zëri i tingëllonte, sikur ishte e lodhur ose e inatosur.

Dera e apartamentit fqinj u mbyll. Ra zilja e timit. Prita një sekondë dhe shkova të hapja derën.

Kristina kishte veshur një këmishë të kuqe dhe një fund të zi të ngushtë. Kishte ndërruar këpucët me një palë elegante me takë të lartë. Në dorë mbante një xhakëtë leshi dhe në sup kishte hedhur çantën. Kishte bërë grim dhe kishte lyer buzët. Mendova se kjo është shfaqje koketërie dhe i pëlqeu. Nuk i respektonte femrat që nuk ishin koketa. Në koketëri fshihet magjia e tyre, forca e tyre dhe, nëse dikush nuk e

kupton, do të thotë se vuan nga mendtë ose është tradhtuar.

-Kjo është kopja e simes – tha ajo duke vështruar dhomën, në qendër të së cilës qëndronte.

-Çfarë do të pish – verë të bardhë apo vodkë?

-Faleminderit, të dyja.

Ajo u ul në tavolinë përpara dritares. E shpëlava edhe një herë gotën dhe hodha pijen. Ia çova Kristinës dhe mora timen nga tavolina. I trokitëm gotat. Vura ré se i kisha lënë mbathjet e Inës sipër dollapit të rrobave. Nuk i futa në çantë dhe nuk shpjegova asgjë. U ulëm në krevat përballë njëri tjetrit dhe pinim në heshtje. Në veshë kisha një zhurmë, sikur dallga të kishte mbytur dhomën. Për një çast m'u duk se dyshemeja po më lëvizte nën këmbë.

-Më habiti kryetarja e seminarit – thashë unë. – Teto e qeshur dhe e ditur. Pamja e jashtme, nganjëherë, të gënjen.

-Mua nuk më çudit. Për mua ajo është teto.

E piva vodkën deri në fund dhe shkova në kuzhinë që të hidhja papë. Faqet më digjeshin e ndieja trupin të gjallëruar, plot forca.

-A e ke problem, nëse pi duhan brenda?

-Jo dhe shpresoj të më qerasësh.

I ofrova një cigare dhe ia ndeza. Dhoma u mbush me shtëllunga tymi gri në bojëqielli.

-Më preku rrëfimi yt për vdekjen e shokut tënd.

Kristina zgjati dorën dhe e tundi. Në kyçin e saj ishte një zinxhir i shkurtër. Pastaj piu një gllënjë dhe tha:

-Ishte i dashuri im.

Heshti për një çast.

-Mban unazë martese.

-Unazë fejese. Nuk ishim martuar.

-Unazë fejese?

-Po.

-Hiqe.

-Mos u bëj budalla.

U ngrita, fika cigaren dhe shkova në banjë. Mbylla derën dhe mbështeta ballin në të. U ktheva, zbërtheva pantallonat dhe urinova.

Lava duart dhe u pashë në pasqyrë.

-Hiqe – thashë me zë të ulët.

U ktheva në dhomë dhe u ula në krevat. Jashtë ishte errur dhe nuk dalloheshin qartë tiparet e fytyrës së Kristinës. Shikoja flokët e saj, krahët, këmbët dhe dorën me gotë.

-Më fol për atë, nëse dëshiron.

-Fillimisht mendova keq për ty. Por, kur fole për ato albumet vura ré se, thjesht, je fëmijë. Fëmijë i parritur. Sa vjeç je, në fakt?

-Më trego për të fejuarin. Dua ta di. Jam tridhjetë e një vjeç.

-Çfarë do?

-Verë. Dhe, a mund ta nderësh dritën?

E ndeza llambën mbi sobën e kuzhinës dhe ia mbusha gotën me verë.

Kristina fliste, por unë nuk i dëgjoja fjalët e saj. Ndieja vetëm zërin, tonin dhe intonacionin, e vështroja dhe mendoja se mënyra ime për të kaluar jetën është shumë monotone.

Isha dashuruar me qetësinë e bareve, ku pija me orë të tëra, me netët që pastaj i harroja, me femra që digjeshin nga dëshira e zjarrtë, të cilat më kafshonin me gojën e lagësht. Dhe, sado të përpiqesha t'a përshkruaja këtë, nuk do të tingëllonte mirë.

Miratova me kokë, kur ajo mbaroi.

-Faleminderit. Gëzohem që nuk ke vuajtur.

-Nuk vuaj.

E boshatisa gotën dhe e vura në dysHEME. Ekрани i telefonit tim u ndriçua. E vështrova dhe thashë:

-Nuk duhet të lejojmë që trishtimi për të vdekurit të na molisë.

-Nuk molisem, thjesht mërzitem.

I tregova Kristinës për Inën dhe Ionasin, për shkurtin e fundit të tij dhe si e përjetoi Ina. Shpresoja që të mos tingëllojë sikur e kam përjetuar njësoj si ata.

-Duhet të nisemi. Po filloj të dehem – tha ajo.

-Vetëm edhe nga një.

Shkova në kuzhinë dhe i mbusha gotat përgjysmë me vodkë. Nga frigoriferi doli një erë e pakëndshme. Diçka ishte prishur. E kisha ndier

edhe më parë, por nuk e kisha vrarë mendjen nga vinte.

Kur u ktheva në dhomë, Kristina kishte vënë dorën në gojë dhe qante. E lashë gotën e saj në tavolinë dhe u ula në krevat. Pija dhe trembesha, kur mendoja se, pasioni im për Inën ishte zhdukur prej kohësh. Kristina qante me zë, por shpejt filloi të ngashërente. U ngrita, solla letër tualeti nga banja dhe ia dhashë. Ajo fshiu sytë dhe shfryu hundët.

Rrinim në heshtje, pinim dhe ndienim se si batica e ndjenjave po na çonte në po atë rrugë, të cilën e kishin përshkuar vajzat që punonin në uzinë.

-Ke dëgjuar për ketaminën?

-Jo.

Fillova t'i tregoj për përvojën time, por, që në fillim, tingëlloja jobindës dhe nuk u besoja as vetë fjalëve të mia. E lashë përgjysmë.

-E harrova. Po filloj të dehem.

-Të lëvizim, atëherë.

-Hajde.

15

Pista e kërcimit ishte ndërtuar mbi një shesh plot me pisha, tek e cili të çonte një rrugë me çakëll. Në parking kishte disa autobusë dhe vetura. Në largësi, mbi sipërfaqen e qetë të liqenit dukej drapëri i hënës. Blemë biletat në hyrje. Kristina shkroi në biletë emrin e saj dhe e futi në kutinë e llamarinës për të marrë pjesë në lotari.

Afër pistës ishte një karrocë me hot-dog dhe dy banja. Ngjitëm shkallët e ulëta prej druri. Orkestra prej pesë vetash luante një vals. Përbëhej nga një kitarist, një xhezbassist, një kitarist bas, pianisti dhe një soliste e re. Ishin veshur njësoj – me pantallona të zeza dhe këmisha ngjyrë manushaqe. Këngëtarja thoshte vetëm fjalën “zemër”, gjë që të mërziste. Për herë të parë, frekuentoja këtë lloj argëtimi me kërcim. Nuk e kisha idenë çfarë ishte.

Qëndroja në radhë para barit dhe përpiqesha të dukesha si gjithë

të tjerët. Në një stol të gjatë, mënjanë nga skena, ishin ulur kryetarja, shkrimtari dhe i krishteri edhe Kristina shkoi tek ata. U habita përse duheshin tavolinat. Gjithçka dukej mjaft elementare.

Prisja në radhë dhe shikoja burrat. Djersinin dhe buzëqeshin në dritën e llambave. Në ajër ndiheshin aromat e parfumit të grave. Valsi mbaroi. I krishteri u ngrit dhe ftoi Kristinën për të kërcyer. Ajo la çantën në stol dhe u ngrit. Ata shkuan në pistë dhe humbën në turmën e çifteve që vallëzonin.

Bleva një birrë dhe një sajder për Kristinën. Nuk shitej vodkë. Shkova tek stoli dhe qëndrova pranë shkrimtarit.

-Banorët e Turkut janë këtu dhe mund të fillojë festa – tha ai dhe ma hodhi krahun në shpatulla.

E vështrova në sytë e skuqur. Afërsia e shfaqur m'u duk e çuditshme. E vlerësova personalitetin e tij si kavaleri e lehtë.

E vura çantën time nën stol. Shishja e vodkës kërciti në dyshemenë e drunjtë. Pija birrë dhe shikoja Kristinën dhe të krishterin që kërcenin. Ai kërcente mjeshtërisht, lëvizjet e tij ishin të sigurta dhe të hijshme. Shpatulla i kishte të tendosura dhe kokën të ngritur. Ajo kishte ulur kokën në supin e tij. Shpresoja të ndihej mirë. Sytë e mi endeshin në pistë – gra dhe burra, burra dhe gra.

Pjesa mbaroi. Shkrimtari u ngrit dhe u përkul para kryetares. U nisën drejt skenës. Kristina dhe i kavaleri i saj erdhën tek unë. Ajo mori çantën dhe zbriti shkallët. I krishteri u ul pranë meje dhe më përshëndeti. Iu përgjigja me kokë. Rrinim në heshtje dhe vështronim ata që kërcenin.

-Femër e mrekullueshme – tha i krishteri dhe buzëqeshi.

E vështrova në sy. E lashë të vazhdonte qetësia derisa të ndryshonte shprehja e fytyrës së tij dhe ai e zhvendosi shikimin.

-Kërceni mirë. Kisha kënaqësi t'ju shikoja.

-Faleminderit. Pasion i vjetër.

-Dëgjo, do t'ia japësh këtë pijen Kristinës. Do dal të pi një cigare dhe të shkoj në banjë. Zoti të bekoftë!

Nxora çantën që poshtë stolit dhe u ngrita. Alkooli më kishte rënë në kokë. Zbrita nëpër shkallë dhe hyra në rrugën që të çonte tek liqeni.

Në errësirë, mes bredhave, pashë një ndërtesë që më ngjau si sauna. Afër një skele të vogël qëndronin dy burra dhe bisedonin. Dëgjohej një krakëllimë e dobët. Nuk e di a vinte nga bretkosat apo nga ndonjë zog nate. U afrova tek burrat, i përshëndeta dhe hapa çantën. Hapa vodkën dhe ua zgjata të dy fshatarëve të shkurtër e barkmëdhenj. Njëri kishte lënë mjekrën e zezë. Ai mori shishen, piu dhe ia dha shokut të vet. Ai, gjithashtu, piu dhe u kollit. E mora shishen dhe piva. Papritur ndjeva të përzier në stomak dhe u përpoqa të gëlltitesha. Goja m'u mbush me hidhësirë.

Burrat heshtnin. Unë mundohesha të sajoja ndonjë gjë për të filluar bisedën.

-Hëna është shumë e bukur sonte. Dëgjohen krakëllima kafshësh. Këtu ka zogëza të mira?

Burrat vështruan njëri-tjetri. Mjekërosi tha:

-Nuk po pyet personat e duhur. Ne jemi këtu bashkë.

Unë ua ngula sytë të dyve.

-Vërtet? Jeni gei?

-Po. Të prish punë ty kjo?

-Jo. Thjesht nuk e prisja. Madje kjo më lehtëson. Këtu publiku është aq monotonisht heterogjen, saqë nuk u ndjeva mirë.

Burrat ishin nga Tamperi dhe punonin për ndërtimin e pistës së kërcimit. Ishin rreth njëzet vetë. Gjatë kësaj vere e rregullonin për herë të tretë. Këtu ata ndiheshin mirë.

-Kjo ndoshta ju zbavit. S'keni çfarë të bëni natën në Tamper?

-Neve na pëlqen kërcimi, natyra dhe këtu kemi takuar interpretues të njohur.

-Si mendoni, mund të gjendet këtu ndonjë zogëzë?

-Vështirë të thuash. Stili është pak i pakëndshëm, i ashpër.

-Veshja?

-Të folurit. Përpiqu ta ndryshosh.

U afrova vodkë. Pastaj ngrita shishen dhe e boshatisa. Përsëri u ndjeva keq dhe më erdhi për të vjellë. U ngrysa dhe shava. Pështyva në ujë. Desha të lija shishen, por nuk përkulesha dot. M'u mor fryma. Vështroja ujin dhe më vinte të mbytesha. Dalëngadalë filloi të më

kalonte gjendja e keqe. E vërvita shishen dhe u urova burrave mbrëmje të këndshme.

-E, ishte kënaqësi që u njohëm. Me siguri nuk do të gjej asgjë.

Shikoja pishat e ndriçuara, prapa të cilave ishte errësirë. Para tyre ishin banjat, pranë të cilave rriteshin shelgjet. Ecja nëpër të tatëpjetën. Po mendoja me kërshtëri, ku ishte Kristina. Kisha investuar shumë për të dhe nuk doja të humbisja. Orkestra mori një pjesë të re. Ngjita shkallët. Në skenë kishte shumë njerëz. Pashë fotografen e trashë dhe u gëzova. Ajo mbante kamerën dhe filmonte çiftet që kërcenin. Iu afrova nga prapa dhe e përqafova.

-Hajde ta kërcëjmë këtë fokstrot.

Ajo më tha se ishte tango. Rregulloi kamerën dhe hapi krahët. E kapa, e shtrëngova trupin e saj të madh dhe fillova të lëviz. Ajo ktheu fytyrën nga unë. Sipas meje, ajo diçka ngatërronte. Njerëzit na shtynin. Ndalua kërcimin para se të mbaronte tangoja dhe shkuam të ulemi në stol.

Kristina po bisedonte me shkrimtarin. Vështrova këmbët e saj. Edhe ajo po më vështronte. U përpoqa të kujtoja çastin, kur e pashë për herë të parë Për një çast vështrova në errësirë dhe pashë fotografen e trashë. Ajo fotografonte çiftet që kërcenin. Iu afrova nga mbrapa dhe e përqafova.

-Ta kërcëjmë këtë tango.

Ajo tha që është fostrot. E la kamerën dhe hapi krahët. Pastaj u ulëm në stol. Vështrova Kristinën dhe këmbët e saj. Fotografia më fliste në vesh me një zë të butë dhe e vuri dorën përmbi dorën time. E vështrova në sy. E dija çfarë donte, por nuk isha i aftë ta bëja.

-Më fal, më duhet...

U ngrita dhe shkova të ulesha tek Kristina. Ajo vështronte diku anash. E kapa pas mjekrës dhe ia ktheva fytyrën nga unë. Sytë i ishin errësuar nga zemërimi.

-Më thuaj çfarë ndien?

-Ti më shkakton dhimbje.

Shkrimtari më zuri pas kyçit të dorës. U çlirova. Orkestra shkoi të pushonte. Në altoparlantë u dha emri i fituesit të lotarisë. Shpërblimi

ishite një përmbledhje vargjesh të poetëve me autografin e tyre. Ndërsa orkestra pushonte, vunë një rok nga vitet tetëdhjetë. Piva ujë dhe kafe.

Pastaj i kërkova falje Kristinës. Më vonë kërcyem një kërcim të shpejtë dhe një të ngadalshëm. Pastaj dolëm jashtë të pinim cigare. Nata po fillonte. Po mendoja, ku, vallë, do të ishte çanta ime. Kristina u shtrëngua pas meje. Shkrimtari u bashkua me ne dhe filloi të fliste për kërcimet dhe vdekjen. Me të bashkë, shkuam në zabelin me bredha që të urinonim, por unë s' bëja dot asnjë gjë. Ai shpëtoi nga kjo punë, u mbërtheve dhe u nis.

Unë mbeta nën bredha duke pritur dhe, atëherë, u ngrit era, zabeli u zhduk, sikur përmes degëve të tij tek unë u lëshua mendimi i pashmangshëm për Kristinën dhe të krishterin në dritat e pistës, pikturat alegorike dhe fjalët e shkrimtarit për kërcimet e vdekjen dhe ndjeva që metafizika mbaroi, qerthulli i jetës e i vdekjes duhet të shikohet si një cikël gjigand politik, ekonomik dhe ushtarak, sikur vëzhgon dritat e një qyteti të madh nëpërmjet iluminatorëve të Erbsit.

Mbërtheva pantallonat dhe u ktheva tek bankina. Kristina dhe shkrimtari po putheshin. Dallova dy kokat e tyre të ngjitura në sfondin e errët të liqenit. U afrova dhe po i këqyrja. Buzët e Kristinës ishin të hapura. Shkrimtari i thithte dhe i lëpinte me kokën e përkulur dhe mbante me dorë qafën e saj nën flokët e zinj. Ajo e shtrëngonte mes këmbëve.

Ata e ndërprejnë dhe kthyen kokën nga unë. Shkrimtari u kthye, zgjati duart dhe më kapi fort kokën. E tërhoqi atë, më puthi mua, duke futur gjuhën e tij të trashë e të ngrohtë në gojën time. Nuk ndieja asgjë, as pasion, as pështirosje. Pyesja veten sa do të vazhdonte kjo. Shkrimtari ndaloi dhe më lëshoi. Qëndronim në bankinë në atë natë vere, nën draprin e hënës dhe shikonim njëri-tjetrin.

-Ti, thjesht, nuk di çfarë kërkon, edhe pse je bioetike – i thashë unë me zë të fortë.

Kristina, më ra në faqen e majtë. Me njëren dorë e kapa për flokësh, me tjetrën i kapa dorën e saj. Ajo nuk kundërshtoi dhe unë e çova lart pranë banjave, karrocës me hot-dog dhe skenës së mbushur me njerëz. Ngjitëm shkallët dhe arritëm tek kasa e biletave, në murin e së cilës

ishite mbështetur dhe pinte cigare përgjegjësi, i cili na uroi mbrëmje të këndshme.

E çova Kristinën nëpër rrugën e errët me çakëll. Nuk e dija çfarë do të ndodhte. Ia lëshova flokët. Ajo ecte pranë meje në heshtje, me kokën ulur dhe shtrëngonte në gjoks çantën e saj – gjest i vajzës së penduar.

Kaluam përmes një zabeli të madh bredhash. Nuk më kujtohej, nëse kisha kaluar vetë andej. Pas një kthese të rrugës, para nesh u hap një lëndinë e gjerë e rrethuar. Ndalua aty. Muzika nga pista e vallëzimit vinte shurdhër. Prapa pyllit, dëgjohej zhurmë nga trafiku i makinave. Kristina u kthye, m'u afrua dhe më vështroi në sy. Në errësirë fytyra e saj dukej fare e re, ndërsa sytë i shkëlqenin me zemërim.

-Idiot, a e di, ta paktën, ku po më çon?

Buzëqesha, ndihesha esëll dhe i sigurt. E dija që diçka do të ndodhte. Kristina më jepte shenja nxitëse. E kapa për flokësh, ia ngrita fundin lart. Kishte veshur tanga të zeza. Futa dorën brenda. Ajo hapi këmbët. Ndjeva qimet e saj të buta dhe organin e saj të ngrohtë. I futa gishtin e mesëm. Ajo i hapi këmbët dhe më vështroi në sy. E nxora dorën nga tangat dhe ia futa gishtin në gojë. Ajo mbylli sytë dhe e thithi me buzët e saj të plota.

-Ec përpara.

Ajo hapi sytë, ngriti tangat, u kthye dhe u nis. E ndoqa, duke i hedhur krahun në shpatulla.

Ecnim në rrugën, në fundin e s cilës dukeshin shkurret dhe vendet e ndriçuara nga dritat e fenerëve të oborrit të muzeut të uzinës. Kaluam përmes oborrit, pranë skenës bosh, në të cilën kishin dhënë shfaqje fëmijët e grimuar. Më erdhi në mendje ta ngjisja Kristinën në skenë dhe të shikoja çfarë do të ndodhte. Vazhdoja të ecja pas saj. Anash rrugës kishte vadha, mjedra të egra dhe boronicë të zezë.

Hapi derën e apartamentit dhe Kristina hyri brenda. E ndoqa edhe unë. Ajo u ndal në mes të dhomës së errët, e lëshoi çantën në dysheme, hoqi xhakëtën dhe e hodhi në krevat. Ndeza llambën.

-Nuk dua dritë.

-E do, e do.

Ajo mbeti për një çast pa lëvizur nën dritën e llambës me kokën ulur, pastaj u afrua tek krevati dhe qëndroi me kokë nga muri. Ngriti fundin dhe u mbështet me një dorë në mur, u përkul dhe hoqi tangat. Qëndrova pas saj. Vështrova trupin e saj, gëzimin e njohur nga pjekuria e femrës dhe e përkëdhela me dorë, e putha në qafë dhe m'u kujtua libri, i shkruar nga bashkëshortja e kryeministrit të mëparshëm me titullin "Si ndodh mrekullia".

-Qëndro kështu.

E hoqa xhakëtën dhe e hodha në krevat. Përvesha ngadalë mëngën e këmishës dhe vështrova Kristinën. Mbështetej në mur me kokën ulur, me fundin e ngritur lart me tangat e lëshuara poshtë, me shpinën e përkulur dhe nuk lëvizte. Merrte frymë thellë dhe ngadalë. Mendova se i kishte mbyllur sytë dhe shpresova të ishte mirë.

Dola në paradhomë, hapa dollapin e vogël dhe mora një varëse të kuqërreme. U ktheva në dhomë.

Vështrova përmes dritares së errët dhe pashë hënën që ndriçonte kurorat dhe fytyrat. Shkrimtari qëndronte në zabel dhe vështronte nga dhoma. Pastaj rrëmoi në xhepin e xhakëtës së shkurtër dhe vuri syzet me skelet të trashë. U afrua tek dritarja dhe i nguli sytë tek ne. Ngrita varësen. Ai miratoi me kokë. U ktheva dhe shkova pas Kristinës. Qëndroja në heshtje, merrja frymë thellë, mundohesha të kuptoja këtë moment, këtë dhomë, ne vetë dhe mendova se Kristina e kuptonte më mirë atë që po ndodhte dhe si dukeshim. E godita dhe ajo bërtiti. Prita, prapë e godita dhe pashë se në mollaqe e saj të djathtë u shfaq një trekëndësh i kuq.

16

Zbardhi një mëngjes i ngrohtë me diell. Zogjtë këndonin në kurorat e pemëve dhe organi i Kristinës binte erë molle.

U zgjuam ngadalë, dremisnim në krevatin e ngushtë, të dy gjinj të mëdhenj të Kristinës mbështeteshin në gjoksin tim, e kisha përqafuar me sytë gjysmë të hapur; dëgjonim frymëmarrjen tonë, rrinim shtrirë

të përgjumur, si kafshët në një vend të qetë.

I hapa sytë plotësisht. Këqyra irisët ngjyrë kafë të syve të saj. Zgjata dorën, ia ktheva kokën nga unë dhe e putha. Thitha aromën e saj. Buzët i kishte të lagështa. Ajo u shtrëngua pas meje dhe e hodhi këmbën mbi timen. E kapi organin tim dhe e drejtoi nga vetja. E dija se, në atë çast, për atë s'kishte rëndësi, cili jam unë. Do të kishte vepruar kështu me cilindo burrë, sepse i pëlqente seksi i mëngjesit. Penetrova thellë brenda saj, teksa vazhdoja ta puthja, e shtyja lehtë, sepse kështu më pëlqente, e doja atë dhe dëshiroja të ndihej mirë.

M'u kujtua vajza zeshkane e menduar, së cilës i pëlqenin romanet eksperimentale dhe shiu, shkruante kujtime me fjali të shkurtra. Dëgjova bisedën e një grupi të vogël që kalonte pranë ndërtesës njëkatëshe.

U ngrita në bërryl dhe e hodha batanijen. Doja të shikoja Kristinën. Ajo kishte kthyer kokën mënjanë, buzëqeshte me sytë mbyllur, largoi flokët nga fytyra dhe ngriti dorën mbi kokë, duke hapur gjinjtë dhe sqetullat e depiluara. Pashë buzët e saj, mollëzat, rrudhat përreth syve dhe më pëlqyen, i dashurova, sepse ato tregonin përjetimet e saj. U përkula dhe i lëpiva sqetullën. Ishte e kripur. Kristina hapi sytë, më ktheu në shpinë, hipi sipër meje, mbështeti duart në gjoksin tim dhe filloi të ma bënte me lëvizje të matura. Rrija shtrirë poshtë saj. Vura gishtin në kërthizën e Kristinës. Shikoja qartë gjithçka – gjinjtë që tundeshin, venën e fryrë në qafën e saj, qimet e duarve dhe lëvizjet e hijshme të klavikulave të saj.

E ndjeva se shpejt do kaloja në orgazëm. Ktheva sytë dhe pashë pluhur në sergjenin e tavolinës së bardhë. Ishte pluhur lulesh, i mbledhur me muaj, i përzier me pluhurin që ngrinin këmbët e kalimtarëve, pluhuri i trishtë, i cili mund të shikohet në gjithet e gjelbra të errëta të bimëve të verës.

Ky pluhur zgjoi tek unë pamjet e erës që fishkëllente nëpër degët e drurëve të pyllit, që vinte nga qielli i errësuar, nga retë lajmëtare të shtrëngatës, të cilat barteshin nëpër të. E kapa pas mesit, e largova prej meje dhe e ktheva të shtrihej në bark. Largova flokët nga qafa e saj dhe e putha. Lëkura ishte e lagësht nga sforcimet. Ngadalë lëvizja gjuhën

nëpër shpinën e saj, nga një brinjë tek tjetra, gjatë në mes dhe në të ndenjurat e saj.

U ngrita pak dhe vështrova shenjat e mavijosura në të ndenjurat e saj. I putha. U kujtova çfarë më kishte zbuluar nga vetja dhe çfarë unë i kisha treguar për veten. Asnjëri nga ne nuk u habit nga ato që dëgjoji. E ktheva në shpinë dhe ia hapa këmbët. Futa dy gishta në organin e saj. Pastaj bashkova buzët dhe lëpiva klitorin e saj të fryrë. Ndjeva shijen e mollës.

Ndoshta kjo ishte aroma e shamos së saj, por s'kishte asnjë rëndësi, sepse shumë gjatë do ta kujtoja, i ulur në kabinetin tim të punës para dosjes së mbyllur dhe pamja e parkingut nga dritarja. E afrova, e thitha, e përkëdhela.

Ajo i ngriti vithet pak dhe i lëvizi më shpejt, me frymëmarrje të shpeshtuar, me kapi mua për flokësh dhe rënkoj. Dy herë m'u duk se e arriti ereksionin, por, siç duket, diçka e pengonte. Ngrita fytyrën. Ajo vazhdonte të më shtrëngonte flokët.

-Dua të të them diçka që ti nuk e di, sonte.

-Më thuaj.

-Peka qëndronte jashtë në errësirë dhe na vëzhgonte nga dritarja. Ti e eksiton.

Vithet e saj nuk lëviznin më dhe ajo e ngriti zërin:

-Gënjen.

-Ndoshta. Vazhdova ta afroja dhe ta përkëdhelja. Për një çast mbeta pa lëvizur dhe po mendoja si paraqitet sonte skena midis nesh dhe një të treti, i cili sodiste dhe gëzohej, kur trupi i saj tundej fuqishëm. Ejakulacioni ishte i furishëm dhe i bukur, ajo bërtiste, shkulte flokët dhe aq fort ma shtrëngonte kokën pas vetes, sa që kishte rrezik të më thyente nofullën.

Kur u qetësua pak, unë qesha. Ajo vazhdonte të rënkonte. Të ndenjurat i tundeshin. U kthye me shpinë nga unë dhe u mbështoll në pozën e lindjes. Mendova se ishte fyer nga e qeshura ime dhe fillova t'ia përkëdhelja mollaqet dhe kofshët. Kjo vazhdoi gjatë. Pastaj u ngrit dhe u ul në gjunjë pranë krevatit. Më tha të ulem në fund të tij dhe kapi në gojë penisin tim. Shikoja gjinjtë e saj që tundeshin, lëkurën

e lëmuar, muskujt e tendosur. Mbarova çuditërisht shpejt, shtrëngoja çarçafin në grusht dhe shikoja si derdhej sperma ime...

Mbylla sytë. Më rrihte zemra fort. Kristina vazhdonte të thithte organin tim, e shtrëngonte me gojë kokën e tij dhe prekte me gishta testikujt e mi. Hapa sytë. Na u takuan vështrimet, e lëshoi penisin tim dhe nga cepi i gojës i rrodhi një curril i vogël sperme. Fytyra e saj shprehte krenari.

Pasi u vesh, Kristina premtoi të më çojë me makinën e saj deri tek stacioni i autobusëve. U morëm vesh që të hanim bukë para se të ndaheshim. U përpoqa ta puthja, por ajo u kthye, mori çantën, xhaketën dhe doli nga dera.

Nxora nga frigoriferi shishen e vodkës pothuaj bosh. Qëndroja lakuriq në mes të dhomës dhe vështroja jashtë. E mbarova shishen e vodkës dhe mendova për ngjarjet e kësaj nate. Shkova në banjë. Mblodha bagazhin në çantë. Çanta e shpinës më kishte mbetur në pistën e kërcimit. Kostumi ishte rrudhosur e pluhurosur.

Dielli përvëlonte pa mëshirë, frynte vetëm një erë e lehtë vere. Pylli shushurinte. Në skenë, në oborr të muzeut të uzinës, disa gra rumbullake, të veshura me kostum popullor, po jepnin koncert. Britmat e tyre ishin të padurueshme. Kalova me hap të shpejtë.

Kristina ishte ulur në restorantin e zbrazët. Kishte porositur ujë dhe sallatë. Mora një birrë, bukën dhe u ula përballë saj. Pija birrë dhe shikoja si hante ajo. Flisnim qetësisht dhe të shkujdesur. Nuk dukeshin të tjerë pjesëmarrës të seminarit. U ndjeva i zhgënjyer. Do të doja që shkrimtari të shikonte sa e rinuar dukej Kristina pas natës së kaluar me mua dhe me çfarë oreksi hante sallatë me salmon.

U ndava me të përmes dritares së makinës së saj. Mbi faturën e parkimit kishte shkruar numrin e saj të telefonit dhe ma dha.

-Nëse më telefonon, shiko të kesh një arsye të fortë.

U përkula dhe e putha në faqe. Ndërsa pyesja veten si t'i përgjigjesha, ajo, tashmë, ishte larguar. E pata të lehtë t'i lija lamtumirën, sepse e ndieja se, çfarë ndodhi midis nesh, nuk kishte shumë rëndësi për të.

E lashë çantën në trotuar dhe ndoqa me sy makinën e saj. Ajo arriti deri në kryqëzim, ndaloi, vështroi pasqyrën e pasme, shikoi djathtas,

majtas dhe u nis. E hodha faturën dhe mendova për dashnoret, të cilat një ditë, të verbuara, ndahen dhe, për një kohë të gjatë, gjenden në një rrugë qorre. Ndjeva që më pushtoi malli, por, prapë nuk isha i sinqertë me veten. Megjithatë arrija t'i nderzja ndjenjat e mia dhe t'i shuaja përsëri.

U ktheva në fund të kishës dhe hyra në oborrin e stacionit. Ishte pothuajse bosh. Vetëm një vajzë flokëzezë ishte ulur mbi një valixhe të madhe dhe kishte mbështetur fytyrën mbi duar. Ishte veshur me këmishë të zezë, fund të zi të shkurtër, çorape me vija të bardha e të zeza dhe i kishte mbledhur flokët bisht kali. Mendova se vajza kishte qenë mysafire në provincë tek prindërit dhe tani kthehej në punën e saj, në qytet.

Erdhi autobusi. E vura çantën në bagazh. Pagova biletën dhe po kërkoja një vend për t'u ulur. Vajza rrinte në anën tjetër.

Vështrova peizazhin. Ishte mesi i verës. Pylli pranë rrugës kalonte si një shirit i gjelbër. Në shtëpitë e rregulluara jetonin njerëz që paguanin me kënaqësi taksat dhe fshinin shkallët në tarracë me fshesat e bëra me dorë nga degët e mështeknës. Një reklamë me ngjyra e shoqatës së sigurimit tregonte lopët dhe kuajt në kullotë.

Dielli ulej pas reve të fryra. Mbi fushat e zverdhura vërtiteshin pulëbardhat. Testikujt e mi ishin strukur këndshëm dhe bota m'u duk një vend i mirë.

Vajza fliste në telefon, pastaj nxori nga çanta një libër dhe filloi të lexonte.

Mbylla sytë. Solla ndërmend disa muaj të shkuar, të cilët i kisha kaluar nëpër rrugët e Turkut. Shikoja pamjet e nxehta, nëpër të cilat kisha ecur vetë. Humbisja kohë nëpër trotuaret me fizionominë time të lumtur. Kisha shumë punë, por nuk e zija me dorë.

Në mëngjes shkoja në universitet plot me mendime ambicioze, kthehesha në mbremje i pakënaqur, duke fshirë ballin me dorë nëpër shkallë. Nëpër urën Aurasilta vajzat ktheheshin nga pishina me flokët e lagura. Ina rrinte në breg dhe vështronte lumin.

Në mëngjes, në 3:30 rrija shtrirë zgjuar pranë Inës. Lajmet e asaj vere nuk ishin as të mira, as të këqija dhe harroheshin shpejt si një

ëndërr gjumi. Në CNN vetëtimat godisnin fort qiejt mbi Mesopotami dhe ushtarët amerikanë shkruanin me tush grupin e gjakut në kaskat e tyre.

Dalëngadalë vetëbesimi m'u kthye. E dija se mund ta bëja. Ndjeva edhe optimizëm dhe se jam në rrugë të drejtë, në paqe me vetveten. Duhet të shpëtonim marrëdhëniet tona. E dija ose, më saktë, e ndieja çfarë duhej të bëja.

Vështrova vajzën që lexonte. Mendova se, pas njëzet vjetësh, mund të jetë Kristina. Mund të jetë Ina pas dhjetë vjetësh.

-Hej, më fal. Çfarë po lexon?

Vajza më vështroi pa ndrojtje. Ishte më e re nga sa mendova më parë, më së shumti – tetëmbëdhjetë vjeçe. Kishte një fytyrë të këndshme, të mirë. Nuk ishte e bukur, por simpatike.

Ajo ma tregoi kopertinën e librit. Ishte romani “Platforma” i Mishel Uellbek.

-Aha, e kam lexuar edhe unë. Si të duket? T pëlqen?

Vajza vështroi numrin e faqes dhe ngriti supet.

-Kam arritur vetëm deri në faqen e pesëmbëdhjetë.

-Lexo qetësisht. Më fal që të pengova.

Vështrova jashtë. Burrat, si dhe gratë nuk dalloheshin sa dinte njëri për tjetrin. Të gjithë jemi rritur, duke gëzuar e duke vuajtur dhe kishim nevojë për dikë tjetër, para se të plakemi dhe ta lëmë këtë botë.

E nxora çantën, që poshtë ndenjësës.

-Hej, të kërkoj ndjesë. Dua të të dhuroj diçka.

Që poshtë rrobave nxora varësen prej druri.

-Kjo është për ty. E kam trashëgim.

Ja zgjati vajzës dorën me varësen. Ajo e këqyri dhe e mori. Pastaj unë e vështrova me vëmendje.

-Kur të shkosh diku për të festuar, vare fustanin në të, një ditë para. Do të ndodhë një çudi.

-Po kjo është një varëse e zakonshme.

-Besomë, nuk është e zakonshme, ajo ka forcë.

I buzëqesha në mënyrën më miqësore, për të cilën isha i aftë.

-Faleminderit. Pikërisht tani po sistemohem në shtëpinë time dhe

do të më duhen varëset. Edhe një herë, faleminderit. Tani, do të më lësh të lexoj?

-Sigurisht. Kur të ndodh çudia, kujtohu çfarë të kam thënë. Rrugë të mbarë.

-Gjithashtu.

17

Zbrita nga autobusi në Tamper dhe i telefonova Inës. Ishte në tarracë në breg të lumit në shoqërinë e Johanës dhe Aarnes. U habita. Ina dhe motra ime nuk mbanin lidhje fare me njëra-tjetrën. E kisha të qartë se nuk e kuptojnë kush dhe sa di. I thashë Inës që më kishte marrë malli për të dhe dëshiroja ta takoja sa më parë. Ajo më tha se pas gjysmë ore do të kthehej në shtëpi. Dallova belbëzimin fëmënor të nipit tim.

U nisa në këmbë për në shtëpi. Vapa, tashmë, vazhdonte prej dy javësh. Çiftet familjare shëtisnin në mbrëmjen e së dielës nëpër rrugët me pluhur, merrnin videokaseta me qira dhe blinin bonbone. Prapa vitrinave të një salloni bukurie, në vazo rritej një pemë portokalli e trishtuar. Nga porta e picerisë fqinjë vinte një melodi nga lindja e afërt. Zbrita ngadalë nëpër rrugë dhe ndjeva se kam nevojë për gjumë.

Shtëpia ishte e qetë dhe e zbrazët. Zbatha këpucët dhe vara xhaketën në gardërobë, në paradhomë. Hyra në dhomën e gjumit. Krevati ishte i rregulluar. Shkova në dhomën e ndenjjes. E ndriçonte dielli dhe mobilet bënin hije. U përpoqa ta shikoja mjedisin me sytë e një vëzhguesi anësor, por ndjeva se kisha nevojë për Inën. Këqyra dhe kuzhinën dhe u ktheva në paradhomë. Mora çantën dhe lashë në banjë rrobat e pista në koshin e rrobave të palara.

Hapa dollapin dhe e vura çantën në një raft. Mora një çantë të kuqe udhëtimi, një çarçaf të pastër dhe i çova në dhomën e ndenjjes. E lashë çantën në dysheme. E zhvendosa tavolinën e bardhë në mes dhe e shtrova çarçafin. Ai shkëlqente nga bardhësia. E këqyra. U

përpoqa të mendoja për gjëra të këndshme si pastërtia, shpresa dhe shëndeti. E lashë kohën të rrjedhë dhe bardhësinë të vijë.

18

Të dielën në mëngjes, Ina rrinte me krehrin në dorë në dhomën e saj. Dhoma ishte e vogël dhe e mobiluar në mënyrë spartane. Muret e saj të bardha ishin të zhveshura.

Mërzitej pa Niklasin dhe kjo i dukej gjë e mirë. Lagu një fletë letre dhe e ngjyroi me kafe në të verdhë. E palosi dhe e futin në çantë.

I nisi koordinatorit një mesazh, në të cilin i kërkonte ndjesë dhe i shpjegonte se, për arsye personale, nuk do të merrte pjesë në mbledhjet e grupit. I uroi atij punë të frytshme dhe suksese.

Në mbrëmje i telefonoi motra e Niklasit - Johana dhe, siç e kishte zakon, kaloi drejt e në temë. Ishte e shqetësuar për të vëllain që nuk u ishte përgjigjur thirrjeve, as mesazheve të saj. Donte të dinte mos i kishte ndodhur gjë. Ina iu përgjigj që, mesa dinte ajo, jo. Motra e pyeti, ku ishte ai. Ina ia shpjegoi se ndodhet diku afër Tamperit. Johana iu lut që të takoheshin. Ina propozoi të takoheshin pak më vonë.

Ina doli nga shtëpia një orë para takimit. Donte ishte vetëm, të rendiste mendimet dhe të qetësohej para se të vinte Johana. Para derës së hyrjes u kujtua që kishte harruar syzet e diellit, por vendosi të mos kthehej.

U ul në tarracën me diell të një restoranti italian në breg. Kishte edhe të tjerë klientë. Sodiste gratë dhe burrat të veshur me rroba vere, të cilët hanin e pinin.

Pa Johanën, e cila u shfaq që nga Teatersilta, duke shtyrë karrocën e fëmijës. Ishte grua e mrekullueshme. Ina i zgjati kamerierit që kalonte pranë gotën e verës dhe porositi një tjetër.

Johana erdhi e qeshur. Flokët i kishte lidhur bisht kali, kishte veshur një fustan dyngjyrësh – të verdhë nga mesi e lart dhe gri të hapur – nga mesi e poshtë. Ina u ngrit dhe e përqafoi. Johana ishte e gjatë, gjoksin e kishte të madh dhe dukej gjithmonë, sikur sapo kishte dalë nga dushi

i sallës së fitnesit. Aarne flinte në karrocë. Në gjumë dukej më i vogël se ç' ishte në të vërtetë. Ina mendoi se ishte e pabesueshme që Johana të kishte lindur një fëmijë kaq të këndshëm.

-Përshëndetje, Aarne!

-Ti je nxirë goxha, s'jemi parë prej kohësh - tha Johana me një ton, që tregonte si do të rridhte biseda.

Johana donte të hante, Ina tha se nuk kishte uri. Tjetra shfletoi menyne dhe pyeti, nëse Ina ishte dobësuar pak.

-Po, pak – u përgjigj Ina.

Johana porositi fileto peshku ton dhe ujë. Kërkoj që balsami të ndërrohet me limon. Ina u habit që Johana vuri ré vogëlsira të tilla. Ajo kurrë nuk vinte ré, nëse kishte salcë në pjatë apo jo. Johana kërkoj diçka në kuletën e saj, e mbylli, e la në tavolinë dhe vështroi Inën.

-Si mendon, përse Niklas nuk më përgjigjet në telefon, tashmë, prej një muaji e gjysmë? i kam telefonuar njëqind herë? i kam dërguar mesazhe.

-Ka qenë i zënë.

-Po tani është verë, nuk është e mundur të ketë kaq shumë punë. Në universitet s'ka ndodhur ndonjë gjë.

-Ai po shkruan disertacionin dhe kjo gjë e nervozon. Kalon shumë kohë në kabinetin e vet.

-Nga ai disertacion do të dalë një asgjë e madhe.

-Mos thuaj kështu. Vëllain e ke të zgjuar.

-Pa dyshim, por njëkohësisht është dhe njeriu më budalla që njoh.

-Ju jeni vëlla e motër dhe asnjëri nuk e merr seriozisht çfarë mendoni për njëri-tjetrin.

-Ndoshta. Si shkojnë marrëdhëniet tuaja?

-Mirë.

-Të përshtatet ai ty?

-Sigurisht.

Johana e vështroi Inën në sy seriozisht dhe ulin kokën. Ina e urrente atë vështrim. Johana e shikonte në një mënyrë që ajo të ndihej e detyruar të përgjigjej. Ina i uli sytë. Pastaj u inatos, ngriti kokën dhe ia nguli sytë Johanës.

-Na shikon në mënyrë sipërfaqësore.

-Në asnjë rast.

-Ti ke familje. E di mirë sa nevojë kisha për Niklasin gjatë verës, kur rashë poshtë. Ai më ndihmoi të vija në vete. S'ke asnjë të drejtë të nxjerrësh përfundime për marrëdhëniet tona.

Johana ia shtrëngoi dorën fort.

-Ina, e dashur, qetësohu. Nuk gjykoj dhe nuk akuzoj askënd. Thjesht jam e shqetësuar. E njoh tim vëlla dhe di se, kur i shmanget lidhjes me mua – ka diçka që nuk shkon si duhet.

-Mirë është ai.

-Bukur. Të besoj. E di më mirë se unë çfarë ndodh, kur ai e humb ekuilibrin. E kam parë vetë shumë herë.

Ina vështronte njerëzit që shëtisnin në bregun tjetër të lumit pranë rrugës së errët të teatrit të qytetit.

-Djali ta marrë. Kam nevojë për të. Jam fare vetëm.

-Ai ka më shumë nevojë për ty. Përndryshe do të humbasë. A pi shumë?

-Jo.

-Po ti?

-Jo. Nuk më vjen mirë, sepse trishtohem.

-Çfarë pune bën, nëse mund të pyes?

-Asgjë.

-Është mirë kështu?

-Po.

Johana tundi kokën, vështroi fëmijën që flinte në karrocë dhe psherëtiu. Ina kuptoi se biseda ishte mbyllur. Porosia e Johanës erdhi dhe ajo filloi të hante. Ina i shmangej shikimit të saj. Folën për tema të parëndësishme e të parrezikshme – për idenë e re të biznesit të Johanës dhe për librat e lexuar gjatë verës. Djali u zgjua dhe buzëqeshi. Johana e mori në duar dhe shkëlqeu nga lumturia.

Ra telefoni i Inës. Ishte Niklas. Ajo u kthye dhe foli me zë të ulët, që të mos e dëgjonte tjetra. Ai kishte arritur dhe donte ta takonte sa më parë. Ajo i premtoi se do të kthehej pas gjysmë ore.

Pagoi llogarinë dhe u ngrit. Johana e vuri djalin në karrocë dhe u

kthye nga Ina.

-Mos krijove përshtypjen se gabohem në lidhje me marrëdhëniet tuaja?

Ina e mohoi me kokë.

-Thjesht isha e shqetësuar. Ju jeni të afërmit e mi. Jam mësuar të kujdesem për njerëzit e mi. Jo gjithmonë jam e kënaqur, por e tillë jam dhe nuk ndryshoj dot.

-Me mua s'ke probleme. Por, për sa i përket Niklasit, mund ta pyesësh vetë.

-Thuaji atij pederastit të më përgjigjet, kur i telefonoj.

-Do t'i them. Mirupafshim, Aarne.

Johana e përqafoi Inën, u kthye dhe shtyu karrocën drejt urës. Ina e ndoqi me sy dhe mendoi se disa njerëz kanë një vetëbesim të tepruar. Por, papritur, ajo ndjeu dëshirën të nxitonte pas saj, t'i hidhte krahët në shpatulla e t'i lutej t'i ndihmonte të rregullonin marrëdhëniet e saj me Niklasin. Dhe kjo duhej bërë shpejt, sepse e ndiente, se po të ndaheshin përfundimisht, ajo do të shkatërrohej e do të vdiste.

19

Ina ecte mes turmës së njerëzve para bibliotekës dhe, pas pak, u ul në hijen e gjelbër të pemëve në parkun Lonrot. Mendoi për kohën, kur ishte e vetmuar. Pastaj u kthye në shtëpi, hapi portën e jashtme, u ngjit nëpër shkallë. Dëgjonte jehonën e hapave dhe shikonte pasqyrimin e mureve në dyshemenë e ndritshme.

Në korridor vari xhaketën e zezë. Hoqi këpucët, u kthye, hyri në dhomën e ndenjjes dhe ndaloi. Në vetëdijen e saj të shqetësuar kalonin si xixëllonja imazhe të reja – nga xhaketa e zezë tek përparësja e bardhë, nga korridori i errët tek kabineti i ndritshëm dhe ajo qëndroi para një mjeku me përparëse të bardhë dhe maskë, i cili i tha qetësisht:

-Të lutem ulu.

Ina u ul në karrigen me mbështetësen e drejtë dhe këqyrte qoshen e dhomës, ku dukej një bimë e gjatë, e gjelbër. Mjeku u ul afër saj, shfletoi dokumentet, pastaj i la mbi tavolinën e punës. Ajo e ndiqte me sy. Edhe ai e vështronte.

MJEKU: Mirë, do ta ul perden.

Ai shkoi tek dera dhe ndezi llambën halogjene. Nga rruga vinte zhurma e një motoçiklete të sforcuar.

MJEKU: Do të kishe dashur të filloje mjekim?

INA: Nuk e di. Ndoshta.

MJEKU: Mirë. Shumë rrallë ndodh që ndonjëri ta dijë vërtet.

Ai fshiu duart me një shami, e palosi dhe e vuri prapë mbi tavolinë.

MJEKU: Sa vjeç je?

INA: Tridhjetë e një. Në dhjetor i mbush.

MJEKU: Nuk do të të jepja kaq nga pamja.

Ai e vështroi për njëfarë kohe në heshtje.

MJEKU: Si e ndien veten?

INA : Si gjithmonë, shumë e sëmurë.

MJEKU: Ke problem me zemrën?

INA: Jo.

MJEKU: Kriza zemre?

INA: Kriza zemre?

INA: Jo.

MJEKU: Dhimbje në grykë?

INA: Jo.

Mjeku mori stetoskopin nga tavolina.

MJEKU: Si shkon grupi yt i legjendave.

INA: Grupi është për mitet.

MJEKU: Epo mirë. Si është atje? Pyes për kuriozitet.

INA: Tani nuk marr më pjesë në të.

MJEKU: Pse?

INA: Nuk kam besim në të.

MJEKU: Bukur. T' i kthehem zemrës tënde. Si e ke pulsën?

INA: Normal, të njëtrajtshëm dhe të qetë.

MJEKU: Hiqe bluzën.

Ina zbërtheu kopsat dhe u zhvesh. Doktori zgjati dorën.

MJEKU: Do ta marr unë.

Doktori e mori bluzën dhe e vuri në karrige. Futi kufjet e stetoskopit në veshë, u përkul mbi Inën dhe e vuri membranën në gjoks mbi sutjena. Dëgjoi. Qeshi.

MJEKU: A do ta dëgjosh?

INA: Jo.

MJEKU: Është një tingull i jashtëzakonshëm. Nga brendësia jote. Megjithë praktikën time për vite të tëra, po habitem.

INA: Mirë.

Ai e hoqi stetoskopin dhe e vuri në tavolinë.

MJEKU: Zemrën e ke në rregull, nuk qëndron aty problemi.

INA: Shumë mirë.

MJEKU: Të lutem hiqi dhe rrobat e tjera.

INA: Tani?

MJEKU: Perdet janë të ulura, këtu jemi vetëm.

INA: Të gjitha.

MJEKU: Po.

Ina u ngrit nga karrigia, hoqi sutjenat dhe i vari në mbështetësen e karriges. Zbërtheu fundin dhe e tërhoqi, pastaj e vuri mbi sutjenat. Hoqi dhe mbathjet dhe i lëshoi në dysheme. I rrëshqiti maska deri në mjekër dhe ai e ngriti.

MJEKU: Ulu në karrigen tjetër. Jo në këtë, por në atë më të madhen.

Doktori u afrua dhe kaloi rreth Inës.

MJEKU: Mirë, ulu tani. Do të të ndihmoj. Edhe pak më poshtë. Akoma. Edhe pak. Kështu. Tani hapi këmbët. Mirë. Qëndro ashtu.

Doktori shkoi tek tavolina, veshi dorezat lateks. Dukej ogurzi. U kthye të shikonte Inën.

MJEKU: Ke trup të bukur. Të dobët, por të shëndetshëm.

INA: Faleminderit.

Doktori iu afrua Inës dhe ia futi gishtat në vulvë.

MJEKU: Akoma merresh me vrap? Luan basketboll?

INA: Jo. Vetëm, kur isha fëmijë.

MJEKU: Kurrë s'të kam parë të vraposh e të luash basketboll. Pas lojës. Kur ishe e vogël, djersije shumë. Madje edhe në janar, kur jashtë ishte ftohtë. Nuk të kam parë, por e imagjinoj.

Doktri i nxori gishtat. Shkoi tek rafti dhe mori diçka. Metali shkëlqeu. Ai u kthye nga ajo dhe u ul në gjunjë. Fytyra e tij është në nivelin e organit gjenital të Inës. Ai ngriti dorën dhe ajo pa që mbante në dorë një spatul metalike.

MJEKU: A e mban mend vizitën tënde të fundit tek unë?

INA: Jo.

MJEKU: Mund të ta tregoj.

INA: Mirë.

MJEKU: Nuk ishe mirë dhe më the: “Kam një rast vdekjeje në familje dhe duhet të iki.”

INA: Vërtet, kështu kam thënë?

MJEKU: Po. Ishte natë. U nise e frikësuar.

INA: Nuk e mbaj mend.

MJEKU: Unë po. Dashuria është shërim. Tani mund të të dhembë pak.

INA: Oh!

MJEKU: Mos e prek.

INA: Më dhemb.

MJEKU: Nuk do të vazhdojë gjatë. Duhej ta bëja. Që të shërohesh. Si e ndien këtë?

INA: Si diçka të fortë.

MJEKU: Vërtet? Sa të fortë? Të shtrengon?

INA: Jo. Ndjesia është e veçantë. Madje është e këndshme.

MJEKU: Rast interesant.

Doktroi drejtoi trupin, u kthye dhe e la spatulën në raft. U kthye tek Ina dhe e këqyri në fytyrë. I vuri dorën mbi bark dhe e shtypi shpejt. Ina lëvizi. Doktorin buzëqeshi prapa maskës.

INA: Oho!

MJEKU: Mitra shikon dhe dëgjon.

INA: Jo. Tashmë, jam lodhur.

MJEKU: E kuptoj.

INA: M'u lodhën këmbët.

Ina u përpoq të ulë këmbët. Doktorin e kapi pas kyçeve dhe ia ngriti përsëri. Në zërin e tij ndihej acarim.

MJEKU: Kam për të bërë edhe një studim, prandaj rri ashtu, pastaj mund të vishesh.

INA: Nuk dua.

MJEKU: Çfarë?

INA: Nuk dua pra.

MJEKU: Pse jo?

INA: Nuk duroj dot më.

PJESA E TRETË

Festa e Shoqatës për amputimin iu duk Rejçëll Feërçajlld përrallore. Ishte nga ato ngjarje të gëzueshme, të cilat ndodhin rrallë dhe, të cilat mbarojnë shumë shpejt, sipas pjesëmarrësve në të. Ishte një mbrëmje që njeriu e kujton përgjithmonë.

Rejçëll e kuptoi shumë shpejt, se për të kjo është shumë e rëndësishme, për arsye të pjesëmarrjes së Nikolasit.

Njerëzit u mblodhën në sallën e ndriçuar me dritë blu. Në mes ishte një tryezë e madhe, në të cilën ishin ulur Ali, Lajla, xhaxhai i Aliut, kryetarja e Shoqatës Eliza Miler, Ksanadu Kan dhe miqtë më të lartë. Tryezat e tjera ishin për katër vetë. Në një të tillë rrinte Rejçëll, Nikolas në shoqërinë e Peni Pendëlltën dhe Xhek D. Uodräf. Ksanadu u ngjiti në podium dhe mbajti një fjalim përsëritës të shkurtër. Pastaj orkestra filloi të luajë xhaz. Njerëzit bisedonin dhe qeshnin.

Fillimisht Rejçëll u përpoq të qëndronte ftohtë me Nikolasin, nuk i kushtonte vëmendje dhe përpiquej t'i tregonte gjenit të lindur në Kaliforni se mund të ekzistonte edhe pa të. Megjithatë duhej ta pranonte që, edhe pse ishte i përkorë dhe vegjetarian, ai ishte njeri mondan i vërtetë. Herë pas here, ndërronte temë dhe tregonte për aventurat e tij në kohën e misioneve të shumta në pikat e nxehta të planetit. Në ato çaste, sytë sikur i bëheshin akoma më jeshilë.

Rejçëll e dëgjonte si e magjepsur. Alkooli, dalëngadalë, tregonte ndikimin e vet. Papritur iu kujtua një mbrëmje që kishte kaluar në shoqërinë e Riçardit. Rejçëll, gjithmonë, kishte frikë, kur festonin të dy, sepse, në çdo moment, ai mund të zhytej në

kujtimet e fëmijërisë së tij fatkeqe dhe t'ia prishte humorin. Sonte, si shumë mbrëmje të tjera, të dy shëtisnin dorë nëpër dorë Londrën e errësuar. Dhe, si shumë net të tjera, ajo u kthye në shtëpi me sy të fryrë nga lotët dhe me grim të prishur, e sigurt se, një grua të trashë e të paditur si ajo, asnjë burrë nuk mund ta donte.

Por kjo ndodhte në të shkuarën, me të cilët ajo jetonte dhe tani festonte.

Mbrëmja vazhdonte. Kamerierët sollën pjatat me ëmbëlsira. Peni Pendëlltën i pëshpëriste Xhek D. Uodrëfit dhe të dy sikur ishin të tërhequr nga njëri-tjetri dhe nuk u kushtonin vëmendje të tjerëve.

Rejçëll i hodhi një vështrim sallës, kur ndërmjet saj dhe Nikolasit ra një heshtje e shkurtër, e vështirë. Edhe ai vështronte kamerierët dhe mysafirët e ulur nëpër tryeza. Rejçëll vuri ré se si Lajla ia fshiu mjekrën me pecetë Alit. Gjestet e vajzës shprehnin ngrohtësi dhe përkujdesje. Ajo do të martohej me ndonjë shiit dhe do të bëhej bashkëshortja e tij vetme, e bindur. Ali i buzëqeshi motrës së tij të bukur.

Në atë çast Nikolas u kthye nga ajo.

-Rejçëll, duhet të të them diçka, për të cilën kam menduar për një kohë të gjatë.

Ajo e vështroi, ndërsa ai u përkul drejt saj dhe qeshi.

-Kam më shumë se një vit që e mendoj, por, në fakt, nuk di si ta filloj. Ose, ndoshta, e di. Mirë, do të filloj kështu: Nuk e ke idenë sa e rëndësishme është për mua shoqëria jote, pikërisht, në këtë mbrëmje.

Rejçëll u habit. Nuk e priste prej tij këtë lloj solemniteti.

-Rejçëll, kur Ali të marrë medaljen dhe, kur unë të mbaj fjalimin tim të shkurtër, do të jesh akoma këtu...

Dukej sikur ai e kishte humbur aftësinë për të folur.

-Nikolas, do të qëndroj. Në shtëpi nuk më pret askush, përveç errësirës dhe qenve qimedredhur të teto Marigoldës.

Doktori buzëqeshi, pastroi fytyrën dhe filloi të fliste.

-Të kujtohet mëngjesi, kur u takuam për herë të parë në

sekretarinë e universitetit? Ishte dita e parë e punës për ty tek ne.

-Sigurisht që më kujtohet. Isha e frymëzuar në pritje të ngritjes profesionale dhe pothuajse e vdekur nga nervat.

-Të kujtohet sa i hutuar isha, kur të urova në atë dhomë me sytë nga kopshti me lisa të vjetër?

-E vura ré. E mbaj mend. Po. E vura ré dhe mendova se të bezdiste modestia ime.

-A e di çfarë më hutoi atëherë? A e di se çfarë më bën të ndruhem edhe tani?

-Ti e di mirë që jo. Më thuaj.

Ai nxori nga xhepi i smokingut portofolin, e hapi dhe i zgjati asaj një foto.

-Gruaja ime, Sindi.

Rejçëll e këqyri fotografinë, pa u besuar syve të saj. Nuk arriti të thotë asnjë fjalë, kur ai vazhdoi me zë të pasigurt.

-Aj u vra në San Diego, në vitin 1984, në aksident. Nuk mund të bëhej asgjë. Thjesht ndodhi. Për njëfarë kohe u zemërova me jetën dhe me botën.

-Nikolas, e di gjithë këtë. Kam lexuar një intervistë tënden të vjetër.

Ajo vështroi ngultas foton. Një grua e re rreth njëzetvjeçe qëndronte nën diellin e pasdites në breg të detit me rroba banje bruz, në të cilat ishin stampuar harqe dielli dhe flamingo. Prapa saj dielli hidhte rreze të kuqërreme mbi sipërfaqen e detit. Gruaja mbante në dorë një flakon me vaj plazhi. Era luante me flokët e saj. Ajo i buzëqeshte burrit që e fotografonte.

-Por Sindi duket...

-Ajo duket si kopja jote. Më saktë ti je kopja e saj.

Rejçëll e vështroi ngultas.

-Dhe shkaku nuk shteron ngjashmërinë tuaj në trup e në fytyrë. Gjestet dhe zërat tuaj janë të njëjta, të qeshurit të qarët e keni njësoj.

Rejçëll nuk dinte çfarë të thoshte. Atëherë ai vazhdoi.

-Kur humba Sindin, isha njëzet e pesë vjeç. I ri dhe i dashuruar

marrëzisht. Tashmë jam më i moshuar. Pothuajse njëzet vjet kam jetuar si në ëndërr dhe vetëm punoja. Duke përpunuar proteza për viktimat e aksidenteve dhe për fëmijët në shtetet e zhvilluara, kisha ndjesinë se bëja diçka të dobishme. Shumë energji kam harxhuar duke punuar në udhëheqjen e organizatës “Mjekët pa kufi”.

Nikolas e kapi shikimin e saj dhe vazhdoi:

-Kjo është sentimentale, por është e vërtetë. Lumturia ishte në duart e mia. Ishte. Dashuroja dhe provoja ëmbëlsi të pafund. Kujtimi për atë dashuri nuk më largohej për një kohë të gjatë. Shumë gjatë. Derisa erdhe ti në universitet dhe në jetën time.

Ai e përkëdheli Rejçëllin në faqe. Ajo u kapërdi.

-Nikolas, ti më infektove edhe mua me turbullimin tënd. Jo sonte, por para një viti. Ndjeva se ti je njeriu që kam kërkuar gjithmonë. Dhe, besomë, që kam kërkuar gjatë dhe me këmbëngulje. Isha vetëm një vajzë nga provinca. Nuk do t'ia dilja dot në këtë qytet dhe në jetë, pa një burrë të vërtetë pranë meje. Vitet kalonin. Kërkoja me ngulm, ashtu siç mund të bëjë vetëm një femër. Ndoshta jo kaq mirë sa Peni, por kërkoja.

-Rejçëll. Turbullim. Kur kjo kalon nga ai, mund të lindë diçka e vazhdueshme dhe e sigurt.

Sekondi i magjepsjes kaloi. Ksanadu Kan prapë u ngjiti në katedër dhe mermëriste diçka në anglishten e tij zbavitëse me theks Indian.

Njerëzit qeshën. Ksanadu Kan heshti, pastaj ngadalë vazhdoi: Ali, ti je fëmija i shpresës. Eja këtu para nesh, që të mund të të shikojmë më mirë. Shpresa, mishërimi i së cilës je ti.

Ali u ngrit, shkoj tek katedra dhe ngjiti shkallët. Protezat i kishte të lëshuara, pa jetë. E shoqëronte xhaxhai. Djali qëndroi para Ksanadu Kan, i cili i tha diçka. Folën pak, ndërsa xhaxhai përkthente. Ali dhe xhaxhai i tij qëndruan para mikrofonit.

Fjala e Alit ishte e shkurtër dhe novatore. Xhaxhai e përkthente në një anglishte të gjymtuar, por gabimet gramatikore nuk kishin rëndësi.

Ali tregoi se si atë natë familja po flinte. Papritur u zgjua

zhurma e avionëve. E pushtoi tmerri. Në mesnatë ai u struk në prehrin e nënës, e cila ishte shtatzënë në muajin e pestë. E ëma e përkëdhelte. Por kjo nuk e ndihmonte. Menjëherë dëgjoji një gjënim të tmerrshëm, çatia u shemb dhe shtëpia u mbush me flakë e tym. Në fillim ai mendoi se ishte në ëndërr. Shtëpia u shemb mbi të. Nuk ishte ëndërr. Dhe kështu u zhduk familja e tij, biçikleta e gjelbër dhe duart.

Rejçëll shtrëngonte gojën me dorë dhe, e prekur, u përkul përpara. Ali e zotëroi publikun. Bëri një pauzë të gjatë dhe e përkuli kokën, sikur po dëgjonte pëshpëritje nga salla. Pastaj tha një fjalë të shkurtër e të pakuptueshme. Xhaxhai përktheu me zë të dridhur:

-Përse?

Rejçëll shpërtheu në të qarë. Përmes lotësh asaj iu duk se në çdo tavolinë qanin. Fshiu lotët dhe, në atë çast, dëshironte që të gjithë diktatorët e botës të ishin të pranishëm këtu dhe ta dëgjojnë pyetjen e djalit shiit.

Njerëzit u ngritën në këmbë ose, të paktën, kush ishte në gjendje ta bëjë. Duartrokitjet ishin shurdhuese. Të tjerët, të cilët nuk mund të duartrokisnin, thërrisnin, fishkëllenin, përplasnin këmbët.

Ali i shikonte. Pastaj zbriti nga katedra pa falënderuar, u drejtua tek tavolina e tij me kokën lart. U ul dhe bëri shenjë me kokë nga gota. Lajla ia afroi tek goja dhe ai piu. Dhe, në atë çast, Rejçëll kuptoi se nga Ali do të dalë një konsulent shumë i mirë mediash, sepse zotëronte një aftësi instiktive për të zgjuar ndjenjat njerëzore. E dinte si mund t'u bënte përshtypje të tjerëve. Kur të rritet, ai mund të drejtonte fushatat mediatike në firma të mëdha. Dhe do të fitojë ca parà të mira. Për atë nuk duheshin duart, por koka, zemra dhe një anglishte e mirë. Rejçëll vendosi të fliste me të për këtë çështje.

Ishte radha e Nikolasit të thoshte disa fjalë dh Rejçëll u emocionua pak për të. Pasi fjalës prekëse të Alit, një amerikan do ta kishte të vështirë ta bënte publikun për vete.

Por ajo shqetësohej kot. Fjala e Nikolasit ishte e mrekullueshme!

Nëse ajo e Alit ishte pyetje, ajo e Nikolasit ishte përgjigja. Ai përgëzoi të pranishmit me telekomandën në dorë. Për një çast, qëndroi në katedër i heshtur, ashtu i hijshëm mrekullisht me smokingun e tij. Orkestra mori një melodi të lehtë. Nikolas ngriti dorën me telekomandën dhe shtypi butonin.

Në ekranin e bardhë u projektua një rrugë e pashtuar, plot me gropa në një vend të botës së tretë, në të djemtë shiitë të paushqyer luanin me top dhe gëzimi i tyre nga loja ishte i paparë. Këmishët e tyre të falura ishin të markave perëndimore. Mbrapa djemve dukeshin shtëpitë e tyre – katërkëndësha me mure guri pa ujë të ngrohtë dhe pa energji elektrike. Prej tyre çdo mëngjes, dilnin në rrugë që të luanin.

Nikolas e mbajti atë pamje mjaft gjatë, që të pranishmit të mund ta ndienin gëzimin e atyre fëmijëve. Pastaj shtypi një buton tjetër. Në ekran u shfaq po ajo rrugë, por e filmuar nga një tjetër kënd dhe në një kohë tjetër. Në mes nxinte një krater shumë i madh, shtëpitë ishin kthyer në gërmadha, ndërsa, në planin e pasmë, Rejçëll vuri ré një objekt të stërzgatur në ngjyrë të kuqërreme të hapur dhe i mbërtheu sytë mbi të.

Së bashku me të pranishmit e tjerë, u drodha nga tmërri.

Ishte një dorë njeriu e prerë deri në sup. Ajo këqyri më ngultas. Nga një skenë e një shtëpie të shkatërruar një këmbë e veshur me xhinse, pranë saj, këmba e dytë e veshur me sandale. Atëherë vura ré mirë se ajo rrugë ishte e mbjellë me pjesë njerëzore, duar, këmbë, trungje trupash dhe koka. Nëpër muret e shpuara nga ciflat e bombave kishte njolla gjaku.

Zëri i Nikolasit ishte serioz dhe plot keqardhje.

-Ja cilat janë pasojat nga aviobombat dyqind kilogramëshe. Më vjen keq ë ju detyrova të shikoni këto skena, por nuk duhet të mbyllim sytë para realitetit. Nuk duhet të shmangim vështrimin nga këto dhe të porosisim shishe të reja shampanje. Është e domosdoshme t'i shikojmë.

Ai u shfaqti të pranishmëve një seri fotosh të fëmijëve që qanin. E para paraqiste një vajzë nja pesëvjeçare me një fasho të gjakosur

e të pistë. Në tjetrën, një djalë nuk e kishte një sy, e treta - një fëmijë tjetër në vend të buzëve kishte një plagë të tmerrshme, ndërsa brenda shkëlqenin dhëmbët e vegjël të bardhë si bora. Kishte akoma shumë fotografi të tjera. Në njërën prej tyre – trangu i trupit të një fëmije ishte i djegur si lazanjë e nxirë, e harruar në furrë dhe i mungonin të dyja duart. Këmba e një djali ishte e prerë mbi gju, ndërsa fytyra ishte mbuluar me shenja të errëta.

Nikolas heshte, duke u dhënë mundësi fotove të ndikonin vetë. Pastaj tha me zë të ulët:

-Këto i shkaktojnë bombat. Nganjëherë bien drejt mbi shtëpi duke shkatërruar gjithçka. Herë tjetër shpërthejnë në rrugë duke shkakuar kraterë të mëdha. Fëmijët janë fëmijë, luajnë pranë gropave, bien në to dhe thyejnë duart ose këmbët. Thyerjet e hapura qelbëzohen, gjymtyrët i amputojnë në kushte primitive, që ekzistojnë në stallat tona.

Nikolas bëri një pauzë, pas së cilës foli me zë të lartë për të tërhequr vëmendjen edhe të atyre që ishin të zënë me alkoolin.

-E njihni shkrimtarin Ridiërd Kipling, i cili ka shkruar vjershën “Barra e një burri të bardhë”. Unë jam një mjek i zakonshëm, megjithëse protezist i mirë, nuk marr vesh shumë nga poezia, por e di që mbaj barrën e një burri të bardhë. Të gjithë ne e mbajmë. Në të gjitha anët e botës, tani, gjëmojnë luftërat. Ne duhet t’i ndihmojmë fëmijët-viktima të këtyre konflikteve. Duart e tyre janë dhe duart tona. Në duart e tyre është e ardhmja, si e tyre, ashtu dhe e jona.

Ai tregoi serinë e dytë të fotove. Ato tregonin të njëjtët fëmijë që buzëqeshnin me shpresë, sepse tashmë, ishin me proteza ose me operacione plastike të bëra me mjeshtëri, me sy artificialë që dukeshin si të vërtetë ose të ulur në karrocet për invalidët. Tashmë nuk dukeshin viktima të vuajtura të çmendurisë.

Nikolas tregoi foton e fundit, në të cilën fëmijët me gjymtyrë artificiale luanin me top në një park të gjelbër. Mbi ta fluturonte një çift dallëndyshesh.

Nikolas shtypi edhe një herë butonin dhe ekrani u errësua. Ai tha:

-Do të doja t'i falënderoja të gjithë ata që ndajnë barrën e burrit të bardhë. Dua të falënderoj takasapaguesit dhe sponsorët, politikanët mirënjohës, të cilët mbështesin kauzën tonë. Faleminderit ushtarëve që na mbështesin dhe na ndihmojnë. Faleminderit dhe kompanive ajrore që i transportoi falas këta fëmijë në Perëndim, që të marrin ndihmën e duhur. Falënderojmë kirurgët, përfaqësuesit e masmediave, të cilët ia bëjnë të njohur shoqërisë përpjekjet tona. Por më shumë të falënderojmë ty, Ali, që na tregove sa e rëndësishme është puna jonë dhe që mund të ndihmojmë këtë botë të bëhet një vend pak më i mirë për të jetuar. Duart tua janë duart tona, duart tona janë duart e tua. Përdori ato me mençuri, siç përpiqemi ne t'i përdorim tonat.

Nikolas mori pothuajse ato duartrokkitje të furishme si Ali, por nuk qëndroi të ngrohej në rrezet e lavdisë - u përkul para publikut dhe zbriti nga katedra. Rejçëll pa një burrë të madh me lot në sy që po afrohej. Ai u ul pranë saj dhe pui ujë.

Ajo ia kapi duart dhe i tha me emocion:

-Fjalët e tua ishin të mrekullueshme. Të dy me Alin jeni magjepsës. Jam krenare për ju.

Edhe ai e shtrëngoi dorën e vet pas të sajës, sikur ajo të ishte e vetmja femër në këtë botë!

Për Rejçëll Fejërçajlld ajo mbrëmje ishte përrallore. Pas fjalimeve orkestra luante melodi të lehta. Nikolas e ftoi atë për të kërcyer.

Ajo u shtrëngua pas trupit të tij të fuqishëm dhe ndjeu aromën magjepsëse të një koteleje të vogël. Pranë tyre njerëzit kërcenin në karrocat e invalidëve ose hidhnin hapa duke kërcitur me protezat e tyre. Rejçëll dhe Nikolas u rrëmbyen nga magjia e valsit duke sinkronizuar bukur lëvizjet e trupit të tyre.

Ajo e tërhoqi kokën mbrapa dhe e vështroi në sy.

-Nikolas, përse akoma nuk je i imi i tëri...

Nuk mundi ta përfundonte, sepse buzët e nxehta të tij u ngjitën etshëm pas të sajave, gjuha e tij preku të sajën dhe ajo, e elektrizuar ndjeu se po zgjohet për një jetë të re. Ishte një puthje e

gjatë, plot ndjenjë, nga e cila buzët e saj flakëronin në mënyrë të pakontrolluar.

Bënë pesë vallëzime. Në pushim uleshin në tavolinë dhe vështronin njëri-tjetrin në sy. Peni Pendëlltën dhe Xhek D. Uodrëf ishin zhdukur. Rejçëll e Nikolas putheshin dhe këmbenin vështrime plot pasion, si të dashur të vërtetë që kishin qenë të ndarë për një kohë të gjatë.

Festa, tashmë, po mbyllej. Tavolina e Alit dhe Lajlës ishte bosh. Rejçëll dhe Nikolas dolën në holl. Para gardërobës, Nikolas e ndali Rejçëllin dhe zuri për dore.

-Rejçëll.

-Urdhëro, Nikolas.

-Nuk dua të të lë të kthehesh në shtëpi vetëm.

-As unë nuk dua.

Ai e kishte zërin gjithë pasion.

-Hajde në dhomën time.

-Do të vij.

Rejçëll kapi dorën e Nikolasit si në gjendje transi, kaluan hollin dhe u ndalën para ashensorit. Teksa ngjiteshin, putheshin dhe preknin njëri-tjetrin si tinejxhër.

Dera e ashensorit u hap. Përkundër vullnetit, ata u shkëputën nga njëri-tjetri dhe panë një skenë të papritur. Piktura e varur në murin e korridorit kishte marrë flakë. Nga pajisja kudër zjarrit në tavan rridhte ujë. Qilimi i shtruar në dysheme ishte lagur.

Pa asnjë mëdyshje, Nikolas u sul, hoqi xhaketën e smokingut dhe e ngjeshi pas pikturës që digjej. Një ré e errët tymi e mbështolli gjithandej.

Pasi shoi flakën, ai u kthye dhe kërkoi me sy Rejçëllin. Ajo e ndiqte. E hodhi xhaketën në dysheme. Uji nga pajisja kundër zjarrit ia lagu flokët, fytyrën dhe krahët e tij të fuqishëm. Me këmishën e bardhë të lagur dhe me kollaren ai ngjante si kafshë e hijshme që posedonte një forcë shumë të madhe.

Tigër me shpirt prej koteleje.

Kotele me forcën e një kafshe të egër.

Rejçëll këqyri pikturën e rrëzuar, nuk mundi ta dallonte çfarë paraqiste. Tapeti nën të nxinte.

Rejçëll u afrua tek Nikolas dhe qëndroi pranë tij nën currilat e ujit. Rrobat iu lagën menjëherë. Nikolas e shtrëngoi pas vetes dhe e puthi në ballin e lagur. Nën rrobat e lagura, trupat e tyre dridheshin për njëri-tjetrin.

Rejçëll mendoi se kishte pasur besim tek ai burrë që nga çasti i parë, kur e kishte njohur. Dhe nën fustanin e zi të ndritshëm, çdo qelizë e trupit të saj e ftonte atë të depërtonte brenda saj, madje jo e ftonte, por e kërkonte, e kërkonte, e kërkonte. Ai merrte frymë rëndë. Ajo kishte ndjesinë se ai, tashmë, nuk e përmbante dot dëshirën dhe organi i tij, në çdo çast, do të çante pantallonat.

Zëri i tij tingëlloi i ngjirur.

-Një moment, këtu diçka nuk shkon.

Rejçëll u tërhoq prej tij, u kthye dhe pa se dera e një dhome ishte e hapur dhe, para saj, dikush ishte shtrirë i mbledhur kruspull. Llamba e thyer mbi atë trup, herë shuhej, herë ndizej dhe e ndriçonte me dritë fantazme.

Nikolas vrapoi, Rejçëll nxitoi pas tij. Ai ia vuri gishtin në venë për të kontrolluar pulsën.

-Kjo është Lajla dhe ka humbur ndjenjat.

Vajza ishte mbledhur kruspull në qilim. Pranë saj ishte një kuti shkrepësesh me logon e hotelit. Shamia i kishte rrëshqitur nga flokët e saj të zinj dhe ata ishin hapur nëpër dysheme. Vajza që kishte humbur ndjenjat ishte shumë e bukur.

-Duhet t'i bëj shpejt frymëmarrje artificiale – tha Nikolas.

Ai i futi duart me kujdes nën trupin e vajzës dhe e ngriti. Atëherë ajo hapi sytë dhe filloi të qeshte me zë të ngjirur dhe të egër. Fytyra e saj e bukur u shtrembërua. Nikolas e çoi në dhomë.

Rejçëll qëndroi në korridor, ku vezullimi i llambës ia verbonte sytë. Atëherë u kujtua që kishte harruar çantën e vogël në sallë, por kjo s'kishte ndonjë rëndësi. Që nga dhoma erdhi një zë i dobët.

Diku në qiellin e natës londineze zukaste një avion. Dhe në atë çast, Rejçëll pa diçka që e habiti atë tmerrësisht. Nuk e dinte, nëse

po e shikonte në realitet apo ishte në ëndërr. Megjithatë kuptoi se do ta mbante mend për tërë jetën.

Llamba ndriçonte dobët. Dera e dhomës filloi të hapej ngadalë. Rejçëll, e ngrirë në vend, i shikonte si e magjepsur. Dera u hap plotësisht, prej saj filluan të dilnin qenie të turbullta, tiparet e fytyrës së të cilave vështirë dalloheshin, ajri sikur dridhej.

Dolën burra, gra dhe fëmijë dhe, pas pak, korridori u mbushi me trupat e tyre të heshtur. Qeniet afroheshin, ngadalë, tek Rejçëll, por ajo s'kishte frikë prej tyre. Ata sikur i kërkonin asaj të bashkohej me grupin e tyre. Ajo zgjati duart drejt tyre, pastaj u zbraps disa hapa, u kthye dhe hyri në dhomë, në të cilën Nikolas e kishte çuar Lajlën dhe e mbylli.

Me 15 prill të vitit 1979, neurologu Kristof Palis dhe reumatologu Andri Bamzhi botojnë në British Medical Journal një artikull, i cili ngjalli interes me titullin “Makelloj ishte këtu? Apo nuk ishte?”

Në të dy, mjekët londinezë tregojnë se i kanë kushtuar katër vjet ndjekjes së historisë mbi sëmundjen e Stjuart Makellojit dhe 207 hyrjeve të tij në spitalet e Anglisë, Skocisë, Irlandës dhe Uellsit që nga viti 1934. Studiuesit ishin vështirësuar nga fakti se i sëmuri kishte përdorur 22 emra të ndryshëm dhe tetë mbiemra. Mjekët e identifikojnë sipas simptomave të sëmundjes, nga karakteristikat fizike dhe nga hollësitë e jetës së tij personale.

Të dhënat biografike për Makellojin janë mjaft të ngatërruara. Emri i tij i vërtetë mbetet i panjohur. Ai duhet të ketë lindur në vitin 1915 në kontenë irlandeze Donerall. Ai pohon se e ka humbur familjen në një atentat, të organizuar nga ushtria republikane irlandeze. Për arsye të ndryshme pranonte që motra i kishte vdekur, por përdorte tre shkaqe dhe tre vite të ndryshme për vdekjen e saj. Në shënimet e një spitali thuhej se Makelloj ishte pilot i forcave ajrore ushtarake Mbretërore, por të dy mjekët pohojnë se ky është rast tipik i personalitetit të gabuar.

Palis dhe Bamzhi nuk gjetën të dhëna për vitet e rinisë së Makellojit. E dhëna e parë për sëmundjen e tij vjen në vitin 1944. Ai kishte filluar disa herë mjekime në spitalin e qytetit të Belfastit për të mjekuar gjurin e dëmtuar. Në vitin 1947, atë e transferojnë nga burgu i Belfastit, pesë vjet, në spitalin psikiatrik në Purdysburn. Kur e nxorën, ai shkon në Londër dh fillon të shkojë nëpër spitale.

Në vitin 1954, kurohet në spitalin Çaring Kros nga pneumotraksi në gjysmën e majtë të mushkërisë së bardhë, të cilin ai pohonte se e kishte marrë në një spital tjetër të Londrës, ndërkohë që mjekonte shpatullën. Më vonë, po atë vit, shfaqen ankesat e tij neurologjike dramatike: krizet e dhimbjes së kokës, fotofobia, ngrirja e qafës dhe hemiplegjia e pjesshme. Mjekët dyshonin se kishte edhe

hemorragji subarahnoidale, por treguesit e palcës së eshtreve ishin normalë. Grafite që bëra më vonë me substancë kontrastive nuk tregonin devijime. Gjatë shtatë viteve të tjera atij i dhanë kurim psikiatrik. Disa studime u jepnin mjekëve argument për të dyshuar se ka kishte në palcën e kurrizit ose çrregullim kronik nervor. Në vitin 1961 vuante nga problem të gëlltitjes, të të folurit dhe të frymëmarrjes. Për këtë arsye iu nënshtrua operacionit në trakë, në qytetin Donkastër.

Në vitin 1961, Makelloj fillon të vuajë nga dhimbjet e forta të stomakut. Ato u bënë shkak që ai të shkonte shumë herë nëpër spitale për mjekim. Dyzina grafish me substancë kontrastive, klizma bariumi dhe katër ndërhyrje në bark nuk dhanë kurrfarë rezultati. Shumë shpejt filloi t'i dhembte gjoksi. Dyshohej për angina pectoris. Dhimbjet në gjoks e në bark u bënë shkak për të lajmëruar shumë here urgjencën. Në vitin 1975 u operua për prostatin.

Në vitin 1976 atë e mjekonin në spitalin e tij të dashur të Belfastit për thyerje të legenit, por pa rezultat, prandaj e çuan në spitalin Sen Marin, ku i vunë një protezë. Pas një shtrimi tjetër në spitalin e Belfastit, ai u zhduk nga regjistrat mjekësorë. Në artikullin e tyre, Palis dhe Bamzhi presupozojnë se ai ka vdekur.

Transferimet e Makellojit nga spitalet e shumta mund të quhet të mundimshme. Atij i janë bërë qindra, nëse jo mijëra analiza gjaku dhe radiografi, 48 punksiione në shtyllën kurrizore dhe shumë studime me substancë kontrastive.

Ai i kishte përvetësuar termat mjekësorë aq mirë, saqë ishte në gjendje t'i ndihmonte mjekët për vënien e diagnozës. Për shkak të pamundësisë për të folur, ai ka shkruar historinë e çdo sëmundjeje të vet. Sipas regjistrave mjekësorë, Makelloj ka ikur nga spitalet 133 herë.

Duke filluar nga viti 1934 ai ka kaluar më shumë se dhjetë vjet në spitale të ndryshme. Me siguri më shumë, sepse të dhënat mund të mos kenë qenë të plota.

Në 5 maj revista mjekësore Britanike publikoi letra të shumta

nga lexuesit, të cilët pohonin se kishin njohur Makellojin.

Dy mjekë-stazhierë praktikoheshin në vitin 1966 në dy spitale të ndryshme në Dublin. Në njërën kishte ardhur një burrë, i cili ankohej nga dhimbjet në gjoks. Doktorit që i bëri EKG-në, i duhej të merrte aparatën, por harroi. Burrit i bënë një elektroskok, kërceu nga barela, shau dhe u zhduk. Po atë mbrëmje, kolegu i tij i nervozuar nga spitali tjetër, i telefonoi dhe i tregoi se i njëjti njeri ishte paraqitur tek ai me të njëjtat ankesa, pa e përmendur incidentin.

Kur arriti doktori i parë, ai njeri u turpërua. Analizat nuk tregonin kurrfarë devijimesh dhe, pasi kaloi një natë në spital, burri u zhduk. Autorët e letrës mendojnë se ai kishte qenë Makelloj.

Në një letër tjetër thuhej se, në vitin 1978, ai ishte gjallë. Në 20 qershor ai u rrëzua në stacionin Vaterlo dhe e çuan në spitalin Shën Tomasi. E kuruan për hemiplegji dhe humbjen e të folurit. Në rrobat e tij u gjendën dokumente me emrin Uiliam Skot dh Zh. Stonhous. E njohën dhe ai ia mbathi.

Në letra të tjera pohohej se Makelloj shkonte në spitale të ndryshme me ankesa të ndryshme, duke përfshirë këtu dhe parazë në gjysmën e majtë të fytyrës, probleme me gjëndrat e djersës, apopleksi, dhimbje në gjoks.

Në 12 maj të vitit 1979, e njëjta revistë botoi letrën e dy mjekëve nga Birminghami, të cilët pohonin de Makelloj jeton në një shtëpi të moshuarish.

Ata e karakterizonin si pacient shembullor i interesuar vetëm për libra dhe televizion. Kur e lexoi artikullin që i kushtohej historisë së tij, ai tha: Kjo nuk më bën nder. Megjithatë teksti e gëzoi dhe pranoi që të dhënat, në përgjithësi, janë të vërteta. E pranoi se është ekzemplar i veçantë, por supozimi se ai vuante nga sindromi i Mynhauzenit, i shkaktoi nervozizëm.

Mjekët thoshin se Makelloj nuk mundej ta shpjegonte sjelljen e vet. Kur e pyetën, përse shkonte nëpër spitale vite të tëra, ai u përgjigj:

“Ma thoni ju – unë jam një njeri i gabuar.” Gjithsesi, shpjegoi

se në spital ndihej i sigurt.

Në 1 mars të vitit 1980, pothuaj një vit pas artikullit të parë, doli një i ri me titull – McIlroy, The Media, And The Macabre. Në të ata tregonin mbi jehonën dhe interesin për artikullin e parë të tyre në gjithë botën, në Europë, Kanada, SHBA dhe Azi. Ishin të interesuar si specialistët, ashtu dhe publiku i gjerë dhe ishin dërguar shumë letra nga dëshmitarët lidhur me këtë çështje.

Ata dëshmonin që, pasi kaloi njëfarë kohe në një shtëpi të moshuarish, Makelloj filloi përsëri të shkonte nëpër spitale në Invernes, Gllasgou, Belfast dhe Angli - në Kornuell ishte paraqitur si marinar çalaman. Ata shkruanin se ai njeri vazhdon të shkojë sa në një spital në tjetrin dhe është argument që tregon se mjekësia është e pafuqishme të ndihmojë të sëmurin nga sindroma e Mynhauzenit.

Palis dhe Bamzhi gjykonin kureshtjen që ka provokuar Makelloj. Kanë kënaqësi njerëzit, ngaqë një njeri amator është në gjendje të minojë misticizmin profesional të mjekësisë? A është në gjendje një lexues mesatar i gazetave të bëjë 48 punksione në shtyllën kurrizore? Palis dhe Bamzhi ngrenë pyetjen: A është sado-mazokizëm sjellja ndaj Makelloj?

Ata pranojnë se kishin frikë që, si rezultat i artikullit të parë, vëmendja ndaj Makellojit do të jetë e madhe dhe u bëjnë thirrje mjeteve për informim masiv, ta lënë rehat atë.

Revista botoi edhe dy artikuj për Makellojin, pas të cilave ra heshtja. Por në 3 dhjetor të vitit 1983 dy mjekë nga spitali Sent Brendan, botuan në gazetë artikullin: “Makelloj: In Memoriam”, në të cilin pohojnë se Makelloj i ka kaluar dy vitet e tij të fundit në spitalin e tyre, ku ka vdekur në moshën 60 vjeçare. Varrimi u bë në 15 tetor të viti 1983. Ata thonë se personeli i spitalit ishte lidhur me Makellojin dhe ai me ta. Të gjithë ishin hidhëruar për të, sepse ai u kishte mësuar shumë gjëra, jo vetëm nga fusha e mjekësisë, por edhe për natyrën njerëzore në përgjithësi dhe se si individ mund të lulëzojë, madje edhe në kushte të këqija. Ata pohonin se Makelloj prehet në paqe.

Për Makellojin më ka treguar babai. Ishte maj i vitit 1983. Atëherë e kisha zakon që të sëmuresha të hënën në mëngjes. Nganjëherë sëmundja më fillonte që të dielën në darkë dhe me afrimin e mëngjesit, kur duhej të nisesh përmes shkollë, filloja të ndihesha keq, më ngrihej temperatura, më dhembte koka dhe puls i më shpeshtohet. Nganjëherë sëmundja më theksohej në kohën e ngrënies së mëngjesit, më merreshin mendtë dhe i villja mjuslët mbi mbulesën e gjelbër.

Ulesha në tavolinë duke menduar se dukem shumë keq. Kthehesha në krevat, matja temperaturën dhe zakonisht ajo ishte e tillë që i jepte babait të drejtën të më thoshte se nuk isha fort mirë dhe ishte më mirë të rrija në shtëpi. Kthehesha mënjandë ngadalë, e fusja kokën nën batanije dhe përgjigjesha disi me zë të ulët dhe jo qartë, diçka që të mos kuptohej.

Rrija shtrirë në errësirë, në dhomë me sy mbyllur dhe dëgjoja bisedat e prindërve dhe të Johanës në korridor, kur vishnin palltot. Më thoshin “mirupafshim”, dilnin dhe thërrisnin ashensorin. Kështu fillonte kënaqësia ime.

Dremisja dhe shikojta ëndrra me ngjyra. Herë pas here zgjohesha, ngrihesha dhe pija lëngun natyral që më kishin lënë në tabakë, pranë krevatit. Rrija shtrirë në shpinë dhe dëgjoja zukatjen e frigoriferit, tiktakun e orës, e cila ishte e vetmja që më prishte qetësinë e madhe, e cila tregonte se si, ne të gjithë, jetojmë të vetmuar në familje.

Ngrihesha, mbështillesha me batanije dhe shikoja tek dritarja, ulesha aty dhe vështroja jashtë. Nëpër trotuare ecnin njerëzit, nëpër rrugë nxitonin makinat. Gjithçka sikur ishte e tejdukshme, madje edhe pemët. Ngrihesha, dilja në korridor dhe shikohesha në pasqyrë. Kthehesha tek dritarja. Nëse do të vdisja, e gjithë dhoma do t'i mbetej Johanës, ata do të shkonin ta zgjonin në mëngjes, por unë nuk do isha më. Duke menduar për këtë, ndihesha, njëkohësisht, edhe keq, edhe mirë, sikur dikush ma kishte lagur çarçafin me bojë akuareli blu dhe, sa më shumë mendoja, aq më shumë më forcohej dëshira që të

ktheheshin të tjerët në shtëpi, të ndieja zërat e njohur dhe ta dija se, shpejt do të interesoheshin si ndihem unë.

Një herë më telefonuan nga shkolla. Më pyetën, përse mungoja kaq shpesh të hënave. Dëgjova babain t'u thoshte se është pediatër dhe nuk mund të më dërgonte në shkollë me temperaturë. Unë, në atë kohë, rrija shtrirë në krevat. Babai më premtoi se do të bisedonim.

Erdhi tek krevati im dhe më përqafoi e më përkëdheli. Ishte pranverë. Më kujtohen duart e tij. Ishin absolutisht të pastra, mbanin erë dizinfektanti që mua më pëlqente. Ai ma përkëdheli fytyrën dhe më pyeti, nëse akoma nuk ndihesha mirë. Pohova me kokë. Ai nuk më fajësoi se shtiresha as atëherë, as më vonë, por më tregoi një përrallë.

Përrallë për një njeri, në një vend të largët, i cili ishte i lumtur, vetëm, kur sëmurej. Ai e la familjen dhe shoqërinë dhe filloi të endej nëpër spitale për vite me radhë, ecte qindra kilometra, binte, dobësohej, sajonte gjithnjë e më shumë sëmundje, provonte dhimbje të tmerrshme, kur e mjekonin.

Nuk e mbaj mend, nëse babai ma kishte përmendur emrin Makelloj. Burri shtirej se kishte parezë në gjysmën e trupit. Më kujtohet se fjalët e babait zgjuan tek unë figurën e Tejos, shoku i tim eti dhe fqinji ynë. Ishte i trashë dhe mbështetej në shkop, gjysma e fytyrës së tij ishte e sakatuar, sepse, në rini, e kishte goditur kali me shqelm. E imagjinoja si binte Tejo në shtëpi, gruaja fillon të endet nëpër spitale vite me radhë, duke përshkuar qindra kilometra, sepse është i lumtur vetëm, kur është i sëmurë.

-Përse nuk dëshiron të shkosh në shkollë të hënën? – më pyeti babai.

Këqyra dorën e tij që e kishte vënë mbi gju.

-Sepse më ngacmojnë.

E ndjeva që babai u tendos dhe drejtoi trupin.

-Kush të ngacmon dhe për çfarë?

Heshta. Ai priste. Po kërkoja që përgjigja ime të ishte e qartë, sepse ishte e rëndësishme.

-Të gjithë, ngaqë kemi makinë lada.

Babai qeshi me të madhe. Qeshi aq shumë, saqë unë fillova të qaja.

Pastaj më tha që të mos u kushtoj vëmendje këtyre budallallëqeve. Dhe përsëriti shpjegimin e bezdisshëm për mua, pa e kuptuar çfarë çmimi paguaj unë për shkak të zgjedhjes së tij.

-Për atë çmim, lada është makina më e mirë.

3

Por periudha e vërtetë e jetës së Makellojtit për mua filloi kështu:

Lajmi që Ina do të shkonte në Londër më shtroi në krevat. Javët e fundit të gushtit i kaloja në gjumë. Nuk dëshiroja të takohesha me shokët, sepse nuk mundesha t'i duroja. Kur nuk flija, rrija shtrirë dhe mendoja për Inën. Kujtoja natën e fundit në shtëpinë e saj, në çerdhen e sajuar me batanije, të ndriçuar nga flaka e zezë e llambës së natës, mënyra si më prekte dhe fliste për ishujt dhe pemët. E gjithë kjo më ndodhte për herë të parë në jetë. Doja që të mos mbaronte dhe të vazhdoja ta përjetoja.

Ina hodhi në kutinë time të postës një letër që më adresojë mua. Në zarf ishte një letër mjaft e madhe. E grisa pa e lexuar dhe e dogja në oxhak. Kur binte telefoni nuk e ngrija. I thashë nënës të më thoshte ditën që do të nisej për t'i lënë lamtumirën. Nisi letrën e dytë shumë më të hollë dhe i ra telefonit disa herë. Nuk erdhi të më kërkonte personalisht. Nuk mund ta besoja dot. Jetonim disa metra larg njëritjetrit, ajo do të nisej për një vit jashtë shtetit dhe nuk erdhi.

Ditën që do të nisej, u ngrita më herët dhe dola jashtë. Mëngjesi ishte i freskët. I shqetësuar shëtita nëpër qytet, shikoja rrugët e ngushta e shtëpitë e njohura dhe e dija se shumë shpejt do të ikja dhe unë. Ndiheja keq, isha tetëmbëdhjetë vjeç, i vetmuar dhe i trishtuar.

U ngjita në shkëmbinjtë pas shtëpisë së Inës. U ula nën një pishë dhe u mbështeta në një trung. E dija që nuk mund të më shikonte. Ishte akoma herët. Nuk e dija në ç'orë do të nisej makina. Qielli ishte i vrenjtur, por, herë pas here, shkëlqente dielli. Prita gjatë. Më mori uria. Në një moment Ionas doli jashtë, me dy çanta, i uli në tokë dhe hapi derën e bagazhit të Volvos. I sistemoi aty dhe u kthye mbrapsht.

Për një kohë të gjatë nuk ndodhi asgjë.

Pastaj doli Ina e veshur me xhinse dhe bluzë të bardhë, shkoi tek makina, vari çantën e vogël në pasqyrën anësore dhe e hapi. Ndezi cigaren. Dukej e dobët dhe nervoze, qëndronte në rrugën me kalldrëm dhe vështronte përreth. Flokët e saj të ndritshëm ishin të prerë shkurt. Shkoi tek flamuri dhe e preku. Preku dhe pemën e mollës. Kështu ishte dhe kështu duhej të jetë. Mendova që për sedrën e saj dhe se ajo, në asnjë mënyrë, nuk ishte e pazëvendësueshme që të mërzhitesha për të nën pishë.

Ionas doli jashtë dhe i tha diçka. Biseduan gjallërisht për njëfarë kohe. Ina e flaku bishtin e cigares në tokë dhe e shkeli. Trupi i saj is u përkul bukur ujt në shpinë. Ndihesha shumë i mërzhitur.

Për një çast m'u duk sikur Ina dhe Ionas po grindeshin. Imagjinova se Ionas po e qortonte për qëndrimin ndaj meje. Ai u afrua fare afër saj dhe i hodhi duart në qafë. Babë e bijë u përqaftuan gjatë.

Ionas hyri në makinë. Ina mori çantën e vet, hapi derën, u ul dhe e mbylli. E pashë tek vinte rripin e sigurimit dhe tek largonte flokët nga fytyra. Ionas ndezi motorin dhe ata u nisën. Pashë mëngën e saj të bardhë. Makina u drejtua nga qendra, duke u larguar ngadalë pranë shtëpive, gardheve dhe portave. U kthyen pas qoshes dhe u zhdukën.

“Mori fund” – mendova unë.

Kështu ndodhi.

U ngrita. Ndieja erën të luante me degët e pishave të ulëta. Zbrita nga shkallët me gjunjët që më dridheshin. Isha i uritur dhe i turbulluar. Për mjaft kohë nuk dija nga t'ia mbaja.

Mësimet në universitet filluan. U njoha me Korpinenin në kohën e një mbrëmjeje në lagjen Port Artur. Kishte veshur bluzën me emrin e stampuar të grupit No Means No dhe luante me shishen e birrës në ritmin e kitarës. Iu luta të ndalonte. Ai ishte ulur në tavolinë dhe u kthye me inat. Ishte një djalë i dobët, flokëkaçurrel nga Tamperi. Prindërit e tij paguanin qiranë për një apartament me tri dhoma, ku jetonte ai. Pas dy javësh u vendosa tek ai. Ai peshonte pesëdhjetë kile, jetonte duke ngrënë çokollata dhe portokalle, u besonte citateve të mësuara përmendësh nga libra anarkistësh. Më pëlqente kjo përzierje

dhe ndihesha mirë në shoqërinë e tij. Me kalimin e kohës ishim lodhur. Dhe, tani, ishim shoqëri e mirë për njëri-tjetrin. Ai dërdëlliste pa pushim dhe hidhte ngado hirin e cigares. Me rastin e shpërnguljes tek ai, pimë verë shtëpie me gotë njëpërdorimëshe. Pastaj shkuam në bar dhe, pasi u nisëm, unë rrëshqita dhe përmes kangjellave, rashë në katin poshtë. Erdha në vete, pasi më hipën në autoambulancë. Më çuan në spital. Të nesërmen më nxorën dhe u ktheva të dgjoja aktet seksuale të Korpinenit.

Fillova të humbja ekuilibrin. Mungesa e Inës ishte e padurueshme. Nuk mësoja. Asgjë s'më interesonte. Gjatë natës endesha nëpër pijetore. Më pëlqente si rezonojnë zërat bas në gjoksin tim. Gjithçka bëhej natyrshëm. Ina ishte larg dhe, në gjoks, më rrihte një zemër e re naive. Leena jetonte në lagjen Terasrautela dhe imagjinonte që djaloshi i saj ishte një piktor i madh.

I ndërpreme marrëdhëniet, pas kësaj i thashë se sakura e pikturuar prej tij, ishte diçka e çmendur. Theva kërcirin e këmbës në një rrëshqitëse. Teksa e vinin në gips thithja gaz ngazëllues. Isha në një dhomë me një prift që kishte thyer këmbën.

Më vonë takova Tuulin, e cila ishte e dashuruar me një futbollist vendas dhe në krevat bërtiste si në stadium. Nga Saja më mbeti vetëm kujtimi i aromës së këndshme dhe flokët e saj të dendur. Në një pijetore një fallxhore e vjetër më këqyri dorën dhe parashikoi se do të sëmuresha, por, pastaj, do të shërohesha.

Filloi të binte borë. Fjeta me një vajzë, e cila pohonte se kishte luajtur bilardo me Nik Kejvin. Tjetra ishte një çifute nga Helsinki, e cila thoshte se ishte telekinetike dhe më theu dy kriklla birre në kokë. Më çuan në spital. Pastaj më treguan se, po atë natë i kishte thyer dhëmbët një burri me tavllë.

Përndryshe ishte punonjëse sociale. Susana pesëdhjetë vjeçare kishte punuar si parukiere dhe vizatonte diej. Nëpër muret e apartamentit të saj ishin varur dhjetra vizatime të diellit. Ndërsa bënim dashuri, ajo më pyeste me zërin e një vaje të vogël: “A dëshiron ta bësh me mua?” “A të pëlqen ta bësh me mua?”. Susana. Të paktën tri herë, jam betuar, të mos kthehesha tek ajo.

Natën e vitit të ri rrëshqita në sheshin Puutori dhe godita kokën në shkallët prej betoni. Mendova se do të vdisja nga hemorragjia. Pastaj erdhi pranvera, pas saj erdhi vera. Vlera ime shoqërore anonte nga zeroja. Ditën e mesit të verës e kalova në një vilë në breg të liqenit Kakskerta. Në të gdhirë, zjarri po mbaronte, ndërsa unë u pengova në bankinë, rashë në ujë dhe godita kokën në një varkë. Nga liqeni më nxori Sami. Rrija shtrirë në bankinë në errësirë, i mbledhur kruspull. Isha i qetë si asnjëherë më parë. Mora bronkopneumoni.

Nga Sallo u nisa për në Turku me ekspres bashkë me Katerinën. Mendoja se femrat janë qenie të pashpresa. Ato janë të bukura dh kanë aromë të këndshme, por udhëhiqen prej rregullave të çmendura. Duan së tepërmi kënaqësi. Kërkojnë të ndryshojnë, por mbeten, po ato.

Kam pasur vuajtje të shkurtra dhe çaste ambicieje. Synoja për më lart. Kërkoja një jetë tjetër. Doja të isha i bukur. Doja dikë që të më sillte pije. Doja të isha i lumtur me një grua të vetme.

Viti i dytë i studimit për mua ishte më i vështirë se i mëparshmi. Merrja nga Ina letra të shkurtra dhe i përgjigjesha thatë. Punonte në një dyqan muzikor në Londër. Kishte një të dashur me emrin Pol. Ionas e shiti shtëpinë dhe jetonte në qendër afër meje.

Nganjëherë takoheshim në rrugë dhe bisedonim. Nuk i ankohesha, sepse nuk doja që të kuptonte çfarë më kishte bërë vajza e tij.

Për Krishtlindje, Ina u kthye në Finlandë. U takuam. Binte borë. Unë pija çaj agrumesh. Ina tregonte për jetën e saj në Kensington dhe në Londër. E vështroja dhe prapa krahëve të saj të dobët vëzhgoja një botë plotësisht të panjohur për mua. Gjithsesi besoja, se brenda vetes ka ruajtur qytetin e vogël verior, përmes të cilit kalonte një lumë i ngrirë dhe, në të cilin, natën, më ka përqaftuar. Në një moment Ina i kapi gishtat e mi dhe tha se i kujtonte gjestet që bëja me duar. Tha se shpreson që unë t'i kem ruajtur.

Fatkeqësitë e mia vazhdonin. Theva kyçin dhe gjurin e djathtë.

Prindërit e mi ndiheshin të shqetësuar. Madje edhe Johana më pyeti çfarë po ndodhte me mua. Iu përgjigja se nuk e di, por do të më kalojë së shpejti. Kam parë edhe të tjerë burra të rinj që e përjetonin

periudha të tilla. Isha i sëmurë nga vetmia dhe ndjenja e inferioritetit.

Iu luta babait të gjente material për atë burrin që është endur spitaleve, për të cilin më kishte folur, kur isha i vogël. Ai më dha artikujt e fotokopjuar të revistës mjekësore Britanike. I lexova e i rilexova dhe nuk e kuptova përse historia e Makellojtit më interesonte aq shumë.

Më emocionoi vraga e tij në bark. Po përse vallë? E kisha të vështirë të përgjigjesha. Ky është Perëndimi. Kjo është përgjigja. Çfarë ndodh, kur e kthen shëndetin në një qëllim të lartë? Verdikti ishte shkruar në vrangën e Makellojtit: Sëmundja është gjithmonë jashtë dyshimit.

4

Vapa mbaroi në gjysmën e dytë të gushtit. Fillova të fle më mirë. Ditë të tëra rrija në kabinetin tim.

U mërzita, mbylla kompjuterin dhe fika dritat. Hapa deri në fund dritaren e vogël dhe sodisja shiun që binte jashtë dhe i bënte kalimtarët në rrugën “Henrikikatu” të mbështjellin kokën. S’kishte erë dhe nuk lëvizin gjethet në pemë. Pas shiut qielli u kthjellua. Ajri ishte pastruar. Dielli pasqyrohej në çatitë e lagura prej llamarine. Thithja ajrin thellë. Nuk mendoja për disertacionin. Pikërisht tani nuk ia kisha ngenë mbrojtjes. U nisa në këmbë për në shtëpi, ku do të kaloja një mbrëmje të vetmuar.

Më telefonoi Timo në mes të muajit dhe më tha se e kishte gjetur atë që kisha porositur. U morëm vesh që të takoheshim në shtëpi të Sallës.

Timo kishte rruar kokën dhe dukej akoma më i dobët nga herë e fundit, kur ishim parë. Salla nuk ishte. Garsoniera ishte e ngushtë, por e rehatshme. Afër dritares ishte një tavolinë e vogël me dy karrige. Në parvazin e dritares, në vazo, rriteshin kaktuse.

Në mur varej një fotografi bardhë e zi e Klint Istvudit me pistoletë në dorë. Biblioteka e vogël ishte plot me sidi, botime xhepi dhe gazeta

muzikore. Sami i ri buzëqeshte nga një foto Polaroid, me rroba banje dhe me gotën e pijes në dorë.

Mbi një mbajtëse ishte një akuarium i kujdesur mirë, në të cilin notonin peshq të vegjël shumëngjyrësh. U afrova t’i shikoja. Kompresori zukaste qetë. Peshqit e vunë ré lëvizjen time dhe u drejtuan nga sipërfaqja. Një peshk i kuq mbeti në fund i palëvizur.

-Çfarë ka ky?

-Nga ta di unë. Peshqit janë të Sallës. Ia ngula sytë peshkut. Pastaj u ktheva dhe u ula në divanin e kuq, me siguri, i blerë në “Ikea”. Papritur u ndjeva keq që përdor shtëpinë e Sallës për këtë takim. Timo shkoi në kuzhinë dhe dëgjiova që hapi dollapin. U kthye dhe më dha një qese najloni.

E hodha përmbajtjen e saj në divan.

Kishte shishe të vogla me klorid natriumi, shiringa gjilpëra, garza farmacie dhe një paketë ketaminë. E mora kutinë dhe e hapa. Flakoni ishte i vogël dhe lëngu pa ngjyrë. Përmbajtja – pesëqind miligram. Nuk e kisha idenë ishte pak apo shumë.

-Kam nevojë për shpjegim.

Timo u ul në divan pranë meje. Binte erë të mirë.

-Ke bërë ndonjë injeksion në muskul?

-Kurrë.

-Po gruaja, për të cilën e kërkoi ketaminën?

-Hoqi dorë nga kjo ide. Do t’ia injektoj vetes.

Timo ishte një mësues i shkëlqyer. Fliste kuptueshëm dhe u përgjigjej me durim pyetjeve të mia. Më tregoi si hapet ampula dhe si peshohet përmbajtja e saj. Më shpjegoi që njëqind miligramë janë një dozë e përshtatshme. Dhe se në rastin që, nuk do kem kujtime nga përjetimi, duhet ta pakësoj dozën në shtatëdhjetë e pesë miligramë. Më tregoi si përzihet ketamina me lëngun. E hoqi bluzën dhe më tregoi si ta injektoj në muskulin e gjoksit. Vështrova krahët dhe gjoksin e tij dhe i imagjinova të dy me Sallën: ajo përkul kokën në errësirë mbi gjoksin e tij.

Dëgjioja zërin e tij, vëzhgoja gjestet dhe mendova që, një ditë, prej tij do të dalë një njeri i vërtetë.

-Përjetimi është magjepsës.

-Mund të blesh në farmaci fasho antiseptike dhe me to të pastrosh vendin e injeksionit.

Timo mblodhi diçka në çantë dhe ma dha mua.

-Mendon se do t'ia dalësh?

-Po.

-Kush do të të ndjekë në kohën e seancës?

-Akoma nuk e di. Nuk e kam menduar.

-Po të duash, vij unë. Do të jetë kënaqësi të vëzhgoj, ndërkohë që njeriu përjeton. Kjo më qetëson. Nganjëherë sytë i mbeten hapur dhe, në ta, mund të shikosh shumëçka.

-Faleminderit, do të gjej dikë.

E futa zarfin në çantën e lëkurës, të cilën e kisha blerë, pasi e harrova çantën e shpinës në pistën e kërcimit. Ishte një çantë e bukur që i shkonte një burri të moshuar. Lëkura e saj e zezë ishte zbukuruar me ornamente tunxhi dhe kishte rripa për ta mbajtur në sup, gjë që unë nuk e përdorja.

I dhashë paratë Timos. Në korridor ai më zgjati dorën dhe ma shtrëngoi timen fort.

-Të uroj ëndrra të këndshme.

-Faleminderit. Do të shihemi prapë.

Dola nga shtëpia e Sallës dhe u nisa drejt universitetit. Në qiellin gjysmë të vrenjtur dëgjohej zhurmë, si fillim, nuk po e shikoja çfarë e shkaktonte. Pastaj vura ré pjesën e parë të një avioni reaktiv.

Përballë meje vinin tri nëna që shtynin karrocet e fëmijëve dhe flisnin në telefon. Me kë flisnin, kush i dëgjonte? Para një restoranti, ziheshin dy burra. Vështrova përmes vitrinës. Nëpër tavolina rrinin figura pa fytyra. Mendova për plakjen. Kush beson në dashurinë e një burri në moshë mesatare, i cili shpreson të gjejë dritën dhe lirinë? Ëndrra e një mesoburri është një pijetore e errët, në të cilën gratë e bukura e kthejnë kokën mënjanë dhe ikin. Pas shuarjes paralajmëruese të dritave në pijetore, e vetmja portë e hapur që të pret është ajo e lumit.

Nëpërmjet xhamit të kioskës, lexova titujt e gazetave. Mendova

që një titull stereotipik duhej të dukej kështu: “E therën me thikë në gjoks një mesoburrë.” Ose “Burri ther të atin dhe ushqen me të derrat”.

Auditori në fakultet ishte i zbarzët. Ndalova, vështrova përreth dhe mbajta vesh. Ishte pasdite herët. Deri në fillimin e mësimeve mbeteshin dy javë. Kondicioneri punonte.

Më kaploi lumturia.

Ngjita shkallët, duke i kapërcyer shkallaret. E sapo kthyer nga pushimet, sekretarja rrinte në dhomën e saj para kompjuterit. Hyra dhe e përshëndeta. Ajo ishte simpatike, një grua rreth pesëdhjetë vjeçe zeshkane, e cila rrezatonte ndjenjë mëmësie. Nuk e preknin pasionet akademike. E pyeta si i kishte kaluar pushimet dhe ajo më tregoi që kishte shkuar në liqenin Sajma me burrin dhe me dy vajzat e saj të rritura. U gëzova që në botë ka një vend, ku e dinin emrin tim dhe më tregonin si i kishin kaluar pushimet.

Trokita në derën e Korpinenit. Brenda ishte qetësi. Provova dorezën, por dera ishte e mbyllur.

U ktheva në kabinetin tim, por dëgjova zhurmë nga dera e hapur pas meje. Doli Korpinen me një pamje të zemëruar.

-A ke një minut kohë?

-Hajde hyr.

Në dhomë kishte rrëmujë. Leksionet e tij do të fillonin pas tri javësh. Mbi tavolinën e punës ishin shpërndarë një grumbull librash, harta, dokumente dhe dosje plastike. Figura e Budës ishte spostuar mbi sergjenin e bibliotekës. U afrova, preka me dorë kokën e statujës dhe u përpoqa të kujtoja çfarë do të thotë fjala samsara.

-Nuk jemi parë prej kohësh – tha dhe u ul.

-Dy javë kam qenë së bashku me familjen, tek prindërit e mi. Po ti çfarë bën?

-Asgjë. Mora pjesë në një diskutim. Punë e çmendur. Asgjë tjetër s’kam bërë.

-E lexova artikullin tënd për Amerikën. Edhe ai i çmendur. Ç’bën Ina?

-Nuk e di. Ka ikur tek gjyshi në Karelien e Veriut. Nuk kam marrë vesh gjë prej disa ditësh. Po ti si i ke punët?

-Kam akoma mjaft punë dhe së shpejti fillojnë mësimet.

-Sigurisht që do të arrish. Kam besim tek ti.

-Ti po ecën mirë? – pyeti Korpinen.

Mora çantën dhe u ngrita.

-Kam nevojë për ndihmën tënde, por të mbetet midis nesh.

E vura çantën në tavolinë dhe e hapa. Nxora kompletin e ketaminës dhe e vura në vendin, në të cilin më parë qëndronte statuja e vogël e Budës. U ula.

Ia shpjegova si është puna dhe i tregova çfarë më kishte ndodhur gjatë korrikut. Ia përshkrova ndershmërisht vegimet e mia, ndërsa rrija shtrirë në pishinën e fëmijëve. Ndava me të përshtypjen se ishte përjetimi më i bukur në jetën time. I thashë se desha që ta provonte edhe Ina, sepse isha i sigurt se kështu do t'i ndihmoja të mposhte frikën nga vdekja. I thashë se kam marrë instruksione të sakta mbi përdorimin e ketaminës. Dëshiroja të përjetoja përsëri të njëjtën gjë - ja përse kam nevojë për ndihmën e Korpinenit.

Heshta. Korpinen m'i nguli sytë.

-Niklas, në djall të vesh.

-Si?

-Nuk kam kohë për budallallëqe të tilla. As dëshirë.

-Kjo do të të marrë vetëm disa orë. Do të më vëzhgosh që të mos humb ndjenjat.

-Në shtëpi kam dy fëmijë. Më ka ardhur në majë të hundës vëzhgimi.

-Nuk mund t'i drejtohem çdo njeriu me një lutje të tillë. Ti je shoku im më i ngushtë, kemi përjetuar bashkë shumë gjëra. Kjo substancë është krejtësisht e parrezikshme. Është përdorur edhe për fëmijë, mace dhe kuaj.

-Po ti mendon për kalin?

-Mos më kundërshto. Kjo është e rëndësishme për mua.

-Më duket se është më mirë të të thërë Ina.

-Mos fol kështu.

-A i jep llogari vetes çfarë po kërkon?

-Edhe unë të kam parë ty duke bërë budallallëqe më të mëdha.

-Ajo ka ndodhur para shumë vitesh, në një jetë tjetër. Tani jemi në vitin 2003, dreqi ta hajë.

I ngrita. E mora paketën dhe e futa në çantë.

-Nuk do të të pengoj më, të kuptoj.

Kështu përfundoi miqësia jonë. S'kam më nevojë për të. Nuk më interesojnë as fëmijët e tij, as gruaja, as logjika e tij. Ndjeva vetëm lehtësim.

Hapa dritaren e vogël dhe u ula para kompjuterit. Mora telefonin dhe i telefonova Samit, i cili u përgjigj menjëherë. Këmbyem përshëndetjet rutinë. I shpjegova çfarë doja të bëja dhe i kërkoja ndihmë.

-Nuk mund të bëhet. Leena nuk do të jetë dakord.

-Nuk duhet t'ia thuash asaj.

-Ne ndajmë gjithçka me njëri-tjetrin.

-Vafsh në djall, Sami.

E mbylla telefonin, e shtrëngova fort në dorë dhe vështrova nga dritarja. Nëpër qiell notonin retë. Po mendoja kujt mund t'i telefonoja, kur ra telefoni. Ishte Sami.

-U mendove?

-Jo, sigurisht që jo. Harrova të të them diçka. Kam marrë me qira për fundjavën e fundit të gushtit një vilë. Të ftoj të vish tek unë. Do të pijmë dhe do të lahemi në sauna. Do të jetë një festë beqari për mua.

U mendova dhe, pas një çasti, iu përgjigja:

-Nëse ke ftuar Korpinenin, nuk do të vij.

-Nuk e kam ftuar. Vetëm shoqërinë tonë të vjetër dhe disa kolegë. Do të vijë dhe vëllai im. Me siguri do të vijë edhe tregtari yt i ri.

-Mirë, do të vij, faleminderit, Sami.

Kontrollova numrat e telefonit të të njohurve të mi. S'munda të gjeja asnjërin, të cilit mund t'i besoja një gjë të tillë. Humori m'u shkatërrua. Nëse nuk të mbeten shokë për të bërë një aventurë, do të thotë që po plakesh. Mendova t'i telefonoja Timos, por hoqa dorë. Nuk do të më pëlqente që ai të vëzhgonte sytë e mi të hapur, kur unë

të jem në gjendje transi. Kushedi çfarë do të shikonte ai aty. Vendosa ta bëj vetëm.

Hapa postën. Një e-mail më tërhoqi vëmendjen.

Nga: seilo.ahola@vs-sisu.org

Marrësi: Jussi Korpinen s.berluskoni@hotmail.com

Në lidhje me: Mendimet e tua.

I nderuar, Jussi Korpinen,

Me kureshtje dhe me kënaqësi ndoqa shkëmbimin e mendimeve ndërmjet teje dhe anëtarit tonë Esa Taberman. Ai m'i përtheu letrat e tua, si dhe përgjigjet e veta. Duhet të them se, javët e fundit, jam argëtuar shumë me shkrimet e tua. Duhet ta pranoj që Esa ka shumë cilësi të veçanta, por, për fat të keq, mendja e shpejtë nuk është midis tyre. Kështu që, të lutem, mos e vër të gjithë grupin tonë nën një emërues.

Shkaku që po të shkruaj janë mendimet e tua mbi nacionalizmin, në të cilat kishte shumë ironi dhe sharje. Mprehtësia e shprehjeve të tua më pëlqen, Jusi – përderisa ky është emri yt i vërtetë.

Prandaj dua të të propozoj diçka.

A do të doje të bisedonim sy më sy të dy për këto gjëra të rëndësishme? Nga letrat e tua kuptova se punon në fakultetin humanitar të universitetit në Turku. Për disa kohë unë kam studiuar aty historinë. Mendoj se je relativisht i ri dhe sikur dalloj në fjalët e tua, pasionin tim të dikurshëm, kur isha i ri.

Jam pronar i restorantit “Kaski” në rrugën “Stolarmin”. Ndoshta ti e di. Është përmendur shumë herë në lajmet e vendit, si nën këndvështrimin pozitiv, ashtu dhe në atë negativ. Le ta bëjmë kështu: Propozo një kohë të përshtatshme për ty për një takim, këtë javë dhe eja në restorant. Do të të qeras me ushqim fantastik dhe do të flasim për çështjet tona. Nëse do të më telefonosh, do ta gjesh në internet faqen e restorantit.

Disa fjalë për veten. Unë jam person komunikues, mund të jem shoqëri e mirë për ty, nuk jam ndonjë llafazan i çmendur – jam hedonist social. Në ditët e sotme është budallallëk të luftosh me grushte kundër rrymave moderne. Besoj në gjithçka finlandeze dhe në mënyrën

finlandeze për të biseduar në një shoqëri gazmore finlandeze.

Shpresoj të takohemi shpejt.

Përshendetje miqësore,

Sejlo Aholla,

Amator restoranti dhe patriot.

E vura emrin tek kërkuesi dhe u shfaq faqja e uebit dhe dy artikuj gazete. I pari i kushtohej hapjes së restorantit, ndërsa tjetri programeve fillestare nacionaliste. Në të dytin, me ton kritik, tregohej se, gjatë viteve tetëdhjetë, pronari ishte dënuar për dhunë dhe pohohej që ka qenë në udhëheqjen e grupit, të përcaktuar si nacionalsocialist. Në vitin 2002 ka kandiduar në zgjedhjet vendore, por nuk fitoi.

Në faqen e internetit, të restorantit pashë foton e tij. Burrë i gjatë, me mjekër të zezë qëndronte midis njerëzve të personelit. Pas tij dukej një dre i madh i balsamosur. E pashë me vëmendje fytyrën e atij burri karizmatik nga pamja e jashtme me pak rrudha rreth syve. Dukej si njeri, fjalëve të të cilit mund t'u besojë.

U ula dhe vështroja retë, të cilat barteshin nëpër qiell. Ngadalë u zhyta në mendime. U ktheva tek kompjuteri dhe shkrova përgjigjen. Kur e mbarova, e lexova dhe e nisa.

“Përshendetje, Sejlo.

Faleminderit për letrën dhe për qerasjen që më ofron. Me kënaqësi do të takohem me ty, por shpresoj që kjo të bëhet në një teren neutral. Ja cili është propozimi im: Hajde nesër në orën shtatëmbëdhjetë në pijetoren “Tri birrat” në kampusin universitar, në rrugën “Inspektorët”. Nuk e mbaj mend numrin. Është një vend i dashur për studentët, por, tani, në fund të verës, me siguri do të gjejmë një tavolinë të qetë, në të cilën mund të bisedojmë. Shpresoj të të njoh, sepse kam parë foton tënde në internet. Unë jam një finlandez tridhjetëvjeçar, me flokë ngjyrë lajthi, i shkurtër dhe i dobët.

E, do të takohemi nesër?

Jusi Korpinen,

Asistent në universitet, në Turku.

-Unë nuk e di.

-Unë akoma më pak.

-Këtu bie shi i rrëmbyeshëm. Lumi mbante erë të mirë.

-Sot, këtu, ka diell. U lava në saunë dhe notova pak. Me gjyshin mblodhëm boronicë.

-Ndihem i vetmuar.

-Kam pastruar gjithë shtëpinë. Plehrat i derdha me makinë.

-Si është gjyshi?

-Pret.

-Çfarë?

-Ti si mendon?

-Mirë.

-Më thuaj ndonjë gjë.

-Më thuaj ti.

-Gjyshi më tregon shumë histori. I kam regjistruar në kasetë. Ai është një tregimtar i mirë.

-Të vjetrit kështu janë, kur ka se kush t’i dëgjojë. Të kujtohet çfarë do të thotë samsara?

-Po ishte diçka për jetën dhe vdekjen.

-Aha. Faleminderit. Sot bleva një çantë të re, të bukur. Ina çfarë bëhet me ne?

-Nuk e di.

-As unë.

-Çfarë do të bësh sonte?

-Do të jetoj me kujtimet. Para dymbëdhjetë vjetësh ti u nise për në Londër dhe atëherë të urreva.

-Çfarë ishte ky sinjal?

-Nuk dëgjoj asgjë.

-Ja përsëri. Mjaft, më fishkëllejnë veshët.

-Ndoshta, pa dashje, shtypa ndonjë buton.

-Tani është qetë.

- Madje tepër qetë.
 -Do shkëputemi?
 -Po. Ndoshta është më mirë që këtë mbrëmje.
 -Më telefono nesër.
 -Do të të telefonoj.
 -Mos e mbyll edhe pak.
 -Jo.
 -Përse më pyete për samsarën?
 -Nuk e di. Thjesht e kisha harruar përse bënte fjalë.
 - Sa kushton çanta?
 -Nuk është e shtrenjtë.
 -Ti për gjithçka thua kështu. Për ty asgjë nuk është e shtrenjtë.
 -Shumë rrallë ndodh kështu.
 -Kjo, sepse s'ke para. A dëgjon njëfarë zhurme këtu? Luajnë fëmijët para stacionit të autobusave.
 -Dëgjoj diçka.
 -A fle mirë tani që je vetëm? Më mirë është kështu?

6

Vapa mbaroi dhe Ina u nis për në Lindje. Të hënën, në fund të verës, në atë rrugë udhëtojnë pak njerëz. Ajo fjete deri në stacionin Pieksamaki, ku do të kalonte në trenin tjetër. Moti ishte i vrenjtur dhe filloi të binte shi.

Për pak kohë, treni e pakësoi shpejtësinë. Konduktorët njoftuan se rufeja kishte goditur një ndërtesë mbrojtëse të linjës. Ina u përpoq t'i telefononte gjyshit se do të vonohej, por ai nuk u përgjigj.

Vështroi pyllin përmes dritares, nëpër xhamat e së cilës rridhnin rrëke shiu. Hante dhe mendonte për gjyshin.

Herën e fundit ishin takuar para dy vjetësh në varrimin e gjyshes. Bënte vapë dhe ishte vështirë. Në varrimin e babait, gjyshi nuk mundi të vinte. Në atë kohë ishte i shtruar në spital në Joensu me këmbën e thyer, pasi kishte rrëshqitur në një vend të ngrirë.

Fqinji e kishte gjetur në borë. Pas një jave në spital, gjyshhi kishte ikur me këmbën në gips. Pastaj e çuan në poliklinikën vendore, por ai ia mbathi edhe që andej, që ditën e parë. E gjetën në kuzhinë duke bërë kafën. Ai u bërtiti të ardhurve për ta kërkuar dhe nuk pranoi të kthehet.

Ina zbriti nga treni në stacionin Viniijarvi. Gjyshhi i kishte premtuar ta priste, por ai nuk ishte, as makina e tij Volvo nuk dukej askund. Ajo i ra telefonit, por ai nuk e ngriti.

Përgjegjësi i stacionit thirri një taksì, e cila erdhi shpejt. Shoferi ia hapi derën dhe pyeti për adresën. Ina ia shpjegoi. Ai i tha se e njihnte gjyshin e saj – veteran me një dorë nga lufta, për të cilin thuhej se ishte një bashkëbisedues i këndshëm.

Arritën në fshat dhe e kaluan kishën prej druri. Ina shikonte pllakat e varreve dhe bredhat e errët. Në rrugën kryesore kishte gjallëri. Kaluan pranë shkollës dhe stacionit. Pas gardhit dhe gjethnajës dukej shtëpia dykatëshe e gjyshit. Taksia parkoi në oborr. Dera e hyrjes ishte e hapur. Ina pagoi, mori bagazhin dhe ngjiti shkallët prej betoni tek hyrja.

Brenda binte erë thartire. Në korridor kishte shumë miza. Në dysheme kishte njolla të mëdha.

Kaloi nëpër dhomat e katit të sipërm. Në dhomën e ndenjjes dhe në kabinet kishte më shumë pluhur se më parë. Lulet ishin tharë. Në kuzhinë kishte rrëmujë. Gjithandej ishin hedhur kuti plastike kosi bosh dhe të tjera kuti ushqimesh, zukasnin mizat kudo. Edhe mbi tavolinë kishte mbeturina ushqimesh të mykura.

Vuri xhaketën në varëse dhe çoi çantën në dhomën e mysafirëve. Ishte e mobiluar me krevat dopio, një tavolinë druri, rafte për libra, dyshemeja e mbuluar me qilim shumëngjyrësh. Kjo kishte qenë dikur dhoma e hallës Ulla.

Ina u shtri me bark në krevat dhe thithi erën e tij. Mendonte që kjo shtëpi, për zërat dhe aromat e dhomave – ishte shumë e dashur për të.

Në kornizën e derës ishin shkruar me stilolaps emrat e fëmijëve dhe shenjat e gjatësisë së tyre. U ngrit dhe preku emrin e saj. Shënimi ishte nga viti 1978.

U afrua tek dritarja. Pà mështeknën që rritej para saj. E hapi dritaren për ajrosje. Nga jashtë vërshoi aroma e barit të lagur. Kopshti ishte lënë pas dore. Bari i gjatë ua merrte frymën luleshtrydheve. Rrushi francez ishte mbuluar me një lloj bime. Dikur gjyshja aty rriste domate. Tani mbulesa e najlonit, në të cilën i mbillte, ishte grisur. Edhe pusi, gjithashtu, ishte mbuluar nga barërat.

Ina hyri në dhomën e gjumit të gjyshit dhe gjyshes. Krevati ishte i rregulluar. Gjyshi, prej kohësh, nuk flinte në të. Rrobat e gjyshes ishin nxjerrë nga dollapi dhe ishin hedhur grumbull në dysheme, sikur i kishte kontrolluar njeri. U ul në dhomën e ndenjies që të priste, shikoi albumet me fotografi dhe shfletoi ca gazeta të vjetra. Gjyshi erdhi pas dy orësh, duke u kollitur duke trokitur nëpër tarracë. Pinte duhan, i ulur në një stol të vogël. Ina doli në korridor dhe hapi derën e jashtme.

-Përshëndetje.

Me cigaren e shtrënguar në dorë gjyshi dukej i habitur. Nga fizionomia të krijohej përshtypja se ai kishte harruar se ajo do të vinte. Ai e hodhi bishtin e cigares, u mbështet në mur dhe u ngrit që ta përqafonte. Qeshi me zë ngjirur. Këmishën e kishte të pistë dhe binte erë të pakëndshme. Mjekra e bardhë ia mbulonte fytyrën. Ishte kërrusur akoma më shumë dhe krahu me dorën e prerë varej akoma më poshtë se i djathti.

Folën pak dhe shkuan të hanë darkë në klubin e fshatit. Gjyshi i bëri me vështirësi dyqind metra deri atje. Kur hynë, ai drejtoi trupin dhe përshëndeti të njohurit. Ishte krenar që t'u prezantonte atyre, mbesën e vet.

Në mëngjes Ina, u zgjua dhe ndjeu cicërimat e trumcakëve jashtë. Gjyshe me diçka merrej në kuzhinë. Ajo vazhdoi të rrinte shtrirë, duke soditur diellin që binte mbi mur dhe ndjeu se ishte zgjuar, në atë mënyrë, mijëra vera.

Në banjën e katit të poshtëm nga sifoni binte erë urine. Ina hoqi ndërresat e saj, mori dizinfektanin dhe ia hodhi sifonit. S'kishte ujë të nxehtë. Nga dushi rridhte uji i ftohtë, nga i cili qimet e krahëve iu ngritën përpjetë, por ajo u la.

U vesh, i lidhi flokët e lagura bisht dhe shkoi në kuzhinë. Kafja në

xhezve mbante erë të mirë. Gjyshi dëgjonte radion. Në tavolinë ishte një kuti plot me gurabija kareliane. Ina u mori erë.

-Këto nuk hahen, janë të prishura.

-Nuk duhej të ishin prishur, i kam mbajtur në të ftohtë.

-Përse këtu është një rrëmujë kaq e madhe? Nuk vjen punëtorja?

Gjyshi ngjau një gurabije në kafe.

-Nuk pata besim tek ajo grua që ditën e parë.

-Por ke nevojë për ndihmë.

Gjyshi turfullloi, kafshoi gurabijen dhe u kthye të dëgjonte radion.

Pasi hëngri mëngjes, ai ngjeshi në kokë një kapele nga ato te reklamave dhe shkoi në barin e stacionit të bënte muhabet me pleqtë e tjerë.

Ina bleu ushqim në dyqan, qese për plehra dhe detergjentë për larje. Ajo mblodhi plehrat në kuzhinë dhe e lau gjithandej. Frigoriferi mbante erë ushqimesh të prishura. Ajo i hodhi poshtë.

Pastroi dyshemetë me fshesë korenti dhe e lau. Nën tavolinën e kabinetit gjeti akoma kuti ushqimesh të thartuara. I hodhi të gjitha kutitë të digjeshin në sobën e saunës.

Palosi rrobat e gjyshes dhe i vendosi në qese. Një pjesë ishin shumë të vjetruara, hapi një fustan të gjelbër mbi krevat dhe mendoi për gjyshen e vet.

Në mbrëmjen e vdekjes së saj, gruaja e moshuar, kishte bërë kafen, e kishte servitur në tavolinë dhe i tha burrit se do të shkonte në tualet. Pas pak, ai ndjeu një goditje dhe u ngrit të shikonte si ishte puna. Dera e tualetit ishte e hapur, ndërsa gjyshja ishte shtrirë në dysheme. Rrugës për në spital ajo vdiq nga hemorragjia cerebrale.

Gjyshi i saj u kthye në muzg dhe, kur e pà, që i kishte ndryshuar të gjitha, kishte hedhur enët e vjetra të thyera, gjyshi u zemërua.

-Mirë ishte më parë. Në ato mblidhja luleshtrydhe.

-E kur ka qenë hera e fundit që ke shkuar për luleshtrydhe?

Plaku u nxeh, por jo për gjatë. Humori i ndryshoi, sikur të ishte fëmijë i vogël. Shumë shpejt u zbut dhe i propozoi të shkonin të

laheshin në sauna dhe të notojnë.

Ina përgatiti sanduiçe dhe kafe dhe i vuri në një shportë. Ai e priste në makinë i paduruar, duke goditur me gishta timonin. Ajo u ul në ndenjësen e përparme. Gjyshi doli nga oborri në rrugën kryesore pa i vështruar makinat që kalonin.

Makina gumëzhinte nëpër rrugën e drejtë dhe binte erë benzinë. Filloi shiu. Duke qenë vetëm me një dorë, gjyshi e ngiste shumë mirë makinën. Kur kalonin pranë shtëpive, ai i tregonte gjatë për banorët e tyre.

Ina habitej si ia kishin dhënë autoritetet patentën, nëse, në të vërtetë, ai e kishte një të tillë. Pak para se të arrinin tek sauna, ai ndaloi makinën. I tregoi asaj një histori, të cilën ajo e kishte dëgjuar shumë herë. Kishte ndodhur në vitet tetëdhjetë. Me fqinjin e tij Tanskanen u grindën për shkak të rrugës.

Ai kishte vënë një barrierë bllokuese. Gjyshi e shembi atë. Kur po kalonte herën tjetër, pa se Tanskanen e kishte parkuar makinën në atë mënyrë që gjyshi nuk mundi të kalonte. Shkoi tek sauna, mori një lopatë, gërmoi anën e kanalit nën goma dhe makina ra në kanal in e thellë. Kur e pa Tanskanen kruajti kokën dhe mendoi: “Eh, e kam parkuar shumë afër kanalit”. Gjyshi e ndihmoi ta nxirrte makinën me traktor dhe kjo u dha fund konflikteve të tyre.

Në sauna gjithçka ishte ashtu, siç e mbante mend ajo. Ajo vështroi dy ambientet e saj të vogla. Gjyshi u ul në një stol dhe ndezi sobën. Në varëse ishin dy jelekë shpëtimi për fëmijë dhe një bilbil plastik. Ina e mori dhe i fryu. Tingulli i mprehtë e shqetësoi plakun.

-Mos i fryj.

Ina zbriti nëpër shkallët e gurta deri në bregun e liqenit. Plepat e egër nuk ishin më. Bredhat ishin në vend, por liqeni iu duk më i madh nga ç’e kujtonte. Ina shikonte si i tundte era kallamat në breg. Kishte veshur xhupin ma kapuç të Niklasit.

U shtri me bark në dërrasat e lagura të bankinës dhe shikonte ujën, ku notonin peshqit. Kujtoi verën, gjatë së cilës ishte mahnitur me kushërirën e vet Satu. Pranë bankinës gjendej një stom prej

guri, ku gjyshi, një herë vrau një nepërkë. Trupi i saj gjarpëronte me orë të tëra mbi gurët, derisa pulëbardhat e çukitën.

Ina kujtonte javët që kishin kaluar këtu. Natën rrinin shtrirë të përqaftuar dhe s'bënin dot pa njëri-tjetrin. U përpoq të mos kujtonte raste të tjera nga koha, kur ishin bashkë.

Gjatë disa ditëve shiu nuk pushoi. Ajo pastroi shtëpinë, lau dritaret. Duke qëndruar në shkallë vuri re merimangat nën strehën e çatisë dhe u habit si nuk ndiente pështirosje prej tyre.

I paktoi plehrat nëpër thasë plastikë. Një pjesë të tyre e hodhi në gropën e plehrave në oborr, pjesën tjetër e ngarkoi në makinë dhe e çoi në vendgrumbullimin e plehrave të tregut, në Outokumpu. Iu lut gjyshit t'i jepte tri gjëra, të cilat ishin të shtrenjta për të: një dosje të babait nga koha, kur ai ka qenë nxënës, medaljonin e argjendtë me gur kuarci të gjyshes dhe protezën e tij, të cilën ia kishin përgatitur pas luftës. Ina nuk e kishte parë kurrë ta përdorte.

Ai, i qeshur, vështroi protezën.

-Ku e gjete? Për çfarë të duhet?

-Ta kem kujtim.

-Merre, mere, mua nuk më duhet.

Në mbrëmje u zunë, pasi Ina i tha se ai nuk duhej ta ngiste më makinën. Gjyshi u inatos shumë, e vuri kapelën shtrembër dhe bërtiti. Pastaj e fiku radion dhe, tepër i kërrusur, doli jashtë. Ina hyri në dhomën e mysafirëve duke përplasur fort derën. U shtri në krevat dhe mendoi sa e frikshme është pleqëria dhe se njeriu do të donte të vdiste në kohën e duhur.

Pas dhjetë minutash ndjeu trokitje në derë. Gjyshi u shfaq në dhomë dhe i zgjati asaj një akulllore.

-Mos u zemëro.

U ngrit dhe mori akulloren. Gjyshi doli. Ajo u shtri prapë dhe filloi të hante akulloren. Në të njëjtën mënyrë, ai gjithmonë kërkonte falje, pasi shpërthente edhe kur ajo ishte fëmijë – ose me akulllore ose me karamelle me mente. Nga punishtja në katin e poshtëm dëgjoheshin goditje. Ina u përpoq të lidhej me Niklasin. Telefoni i tij dilte i zënë. Dontë të fliste me të dhe e dinte se, kështu ai do të merrte forca.

Ina,
Të përqafoj dhe të puth fort.
Unë e dija çfarë do të ndodhte me ju. Vetëm unë e dija.
Babai i yt.

7

Unë akoma jam i bindur që s'kam bërë një plan. Jam i sigurt se asgjë nuk është ravijëzuar paraprakisht. Endesha në errësirë, pa një shteg, megjithatë ngjarjet janë akoma më të qarta në vetëdijen time.

Ishte pasdite herët. Jashtë binte shi dhe ndihesha i tensionuar. Telefoni më ishte fikur. Rrija në kuzhinë, pija kafe dhe vështroja nga dritarja se si pikat e shiut bien mbi lumin e gjelbër, përplasen në xham dhe lagin pemët në breg, gjethet e të cilave do të binin shumë shpejt. Dëgjoja. Çfarë thonë pemët? S'ka mëshirë për ty. Shkaku kryesor që jeta të jep është i ndyrë, është i gabuar.

Hyra në dhomën e Inës, duke vështruar muret e bardha, karriget prej druri të veshura me lëkurë me mbështetëse të drejtë dhe tavolinën në ngjyrë të errët, mbi të cilën ishte fotoja e Ionasit në kornizë. Më parë, kur njeriu vështronte nga dritarja e vogël, shikonte një pemë. Tani e kishin prerë e copëtuar dhe e kishin çuar diku.

Mori çantën e lënë pranë tavolinës, u ul në dysheme dhe e hapi. Brenda ishte një tufë e madhe me akuarele. I vuri në dysheme dhe i filloi t'i shikonte, këqyri vizatimet dhe u përpoq të kuptonte autorin e tyre.

Hapi dollapin dhe nxori një kuti kartoni ngjyrë kafe dhe e hapi. Ishte plot me letra. I këqyri. Ishin letra të shkruara në materiale të ndryshme për nga cilësia - nga Ionasi për Inën. Më duhej të shkoja në banjë dhe i futa prapë në kuti, të cilën e vendosa përsëri në dollap.

Për herë të parë mendova se Ionasi kishte ruajtur të sajat së bashku me të vetat. Ajo kishte trashëguar gjithçka pas vdekjes së tij dhe, pas gjithë gjasave, i kishte fshehur në ndonjë sirtar, në ndonjë nga dhoma.

Kërkoi në gjithë vendet e mundshme në dhomën e saj, në bibliotekë dhe në dollap. Hapi sirtarë, çanta, kutia kartoni dhe dosje. Rrëmoi për orë të tëra, por më kot. E dua këtë femër.

Shkova në kuzhinë, qërova një portokall dhe e hëngra me vështtrimin nga lumi. Jashtë vazhdonte të binte shi. Paketa me ketaminë ishte mbi tavolinën e kuzhinës. Shkova në dhomën e gjumit dhe veshja pantallonat e shkurtra, këmishën dhe atletet.

Mora matësin e pulsit, të Inës. Para portës së jashtme bëra një nxehe të shkurtër? Nga mesi i pranverës s'kisha vrapuar asnjëherë.

Rruga pranë bregut ishte e qetë. U laga menjëherë, pikat e shiut më hynin në jakën e këmishës dhe rridhnin nëpër shpinë. Makinat ngrinin shatërvanë stërkalash. Nën retë gri të shiut fluturonin pulëbardhat.

Nxitova për tek kështjella dhe ndalova në park nën një pemë, që të rregulloja frymëmarrjen. Trupi m'u ngroh dhe vrapit filloi të më jepte kënaqësi, megjithëse, në fillim, e kisha të vështirë. Kalova pranë shtëpisë sime, pranë pemëve pranë rrugës "Helsinkikatu", era sillte aromën e barit të thatë të lagur, të tokës dhe të kalbësirës.

Vazhdova nëpër rrugën që kalonte nëpër një lëndinë. Nëpër bregun e lumit kalonte një grua shumë e kërrusur, e cila shëtiste qenin. M'u kujtua një mëngjes në muzgun e Krishtlindjes, kur vrapoja po në këtë rrugë, i veshur ngrohtë për shkak të të ftohtit të madh.

Më kujtohet si e ngrohte dielli borën, poshtë së cilës dukeshin barërat, shkurret ishin mbuluar me brymë, ndërsa unë mendoja për festën që do të kalonim me familjen time, me Inën dhe Ionasin.

Vazhdova të vrapoj dhe pranë garsonierës, në të cilën kisha banuar dy vjet.

Ndalova para "Tre birrave", pastaj vazhdova në drejtim të pllakave përkujtimore të varrezës. Ishte shtrëngatë shiu, e cila vinte duke u forcuar. Ora në matësin e pulsit tregonte pesë pa një çerek. U afrova pranë një kabine telefoni dhe hyra brenda.

Pas disa minutash, para barit kaloi një makinë amerikane, e madhe, e bardhë. Ngrita dorezën e telefonit. Dëgjoja sinjalin "i lirë", zhurmën e motorit të makinës dhe kërcitjen e pikave të shiut. Nuk e di çfarë marke ishte makina, por njoha shoferin.

Ai e fiku motorin, zbërtheu rripin e sigurimit, doli jashtë dhe hodhi sytë përreth. Pastaj hyri prapë brenda dhe u nis në drejtim të qendrës së qytetit. Pas njëzet metrash parkoi aty afër.

Prisja në kabinën e telefonit. Aholla u afrua shpejt, duke mbrojtur kokën nga shiu me gazetë. Lëvizte me një lehtësi të papritur për një burrë të tillë të madh. Pashë shpatullat e tij të lagura, kur u kthye me shpinë prej meje dhe hyri në bar.

E vara receptorin, dola nga kabina dhe eca për nga bari. Hapa derën. Nga brenda vinte kënga “Live forever” e “Oejzis”, vinin zëra dhe përplasja e topave të bilardos me njëri-tjetrin. Asgjë s’kishte ndryshuar nga koha, kur e frekuentoja këtë bar si student. Menjëherë ndjeva dëshirë të pija.

Mbylla derën dhe shkova në parking.

Ai ishte i vogël, por makina ishte e madhe. U afrova dhe vështrova brenda. Kupeja prej lëkure dhe pulti ishin të bukur. U habita çfarë ere binte. U ktheva dhe ika, më ishin lodhur këmbët, shpina më dhembte.

Parkingu kishte një barrierë verdhë e zi dhe ishte i shtruar. Në një vend pllakat ishin hequr dhe dukej rëra e zverdhur. Ndalova, mora dy dhe u ktheva në makinë. Me të parën theva xhamin e parë. Kapa të dytën me të dy duart, e ngrita dhe godita mbulesën e makinës. Vrapova menjëherë dhe mora dy të tjera. Me të gjitha forcat e gjuajta një në derën e shoferit, ndërsa me të dytën shkatërrova stopat.

Ika me vrap nga parking dhe sprintova nëpër rrugën me çakëll pranë bregut të lumit. Qeshja me vete. Nëpër linjën hekurudhore fluturonte Pendolino për në Helsinki.

U ktheva në shtëpi dhe hapa kompjuterin. Ashtu siç isha, me pikat e djersës që rridhnin nëpër fytyrë e trup, e shkrova letrën dhe e nisa. Pastaj shkova në banjë që të bëja dush.

Dërgon: Jusi Korpinonen s.berluskoni@hotmail.com

Për: seilo.ahola@vs.sisu.org

Lidhur me: Imperialistët.

E kuptova gënjeshtren, para se të takohemi. Jam lodhur nga gënjeshttra dhe gjysmë e vërteta. Një shofer i trashë me shevrolet nuk

mund të jetë patriot i vërtetë. Ti lëpin prapanicat amerikane, prandaj kij mirësinë dhe mos më shkruaj më, sepse nga kjo histori mund të dalë diçka e frikshme.

Riparim të mbarë.

Jusi

8

Qëndrova gjatë nën dush, pastaj u fshiva me peshqir dhe u ndjeva mirë. Lyeva duart, gjoksin dhe fytyrën me krem hidratant të Inës. Preva thonjtë e duarve dhe këmbëve. U pashë në pasqyrë. Isha i kënaqur nga vetja.

Vesha bokserat e pastër dhe piva pothuaj një litër ujë. E çova paketën me ketaminë në dhomën e gjumit dhe e zbraza mbi komodinë. Me ndihmën e matëses së ilaçit për kollën, mata dy milimetra e gjysmë ketaminë, shtova dy milimetra klorid natriumi. Vura gjilpërën në shiringë. E tunda përzierjen dhe mbusha shiringën. Nxora ajrin prej saj dhe nëpër gjilpërë rrodhën disa pika, të cilat shkëlqenin në dritën e abazhurit.

Shkova tek dera me pasqyrë e dollapit. Frymëmarrja m'u shpeshtua. E mbaja shiringën me dorën e djathtë. Ngadalë e me kujdes e futa gjilpërën në muskulin e majtë të gjoksit përballë zemrës. Shtypa pistonin e shiringës.

Ndjeva një dhimbje si nga goditja e rrymës elektrike dhe mendova mos kisha prekur ndonjë nerv. Prita pak dhe shtypa prapë ngadalë pistonin. Dhimbja u shtua. U ula në cep të krevatit. Mendoja çfarë duhej të bëja. Me kujdes e nxora gjilpërën, shiringa më rrëshqiti nga gishtat dhe ra në dysheme.

E ngrita dhe pashë se, në të, kishte mbetur rreth një e treta e përzierjes. U afrova para pasqyra dhe e preka muskulin e majtë me gisht. Zgjodha një vend të ri dhe e injektova, përsëri, përzierjen. Mbajta vesh. Zhurma në veshë po më rritej dhe shumë shpejt vala më përfshiu të tërin.

U shemba në krevat me bark. U mendova – më kishte filluar një dhimbje e fortë koke. Muskuli i majtë më dhembte. U ngrita. Shiringa e zbrazët më varej në gjoks, në lëkurën e të cilit kishte pak gjak. Nuk mbaja mend nëse e kisha shtyrë pistonin deri në fund apo, kur rashë në krevat, ajo vetë ishte zbrazur.

E nxora shiringën dhe e lashë në komodinë. U shtriva dhe po shikoja tavanin. Nuk e kuptova çfarë ka ndodhur. Nga përvoja e parë kujtoja vetëm një errësirë të plotë, pa mundur të përcaktoja sa kishte zgjatur.

Ndenja shtrirë njëzet minuta pa lëvizur, më erdhi për të vjellë dhe u ngrita. Më doli një lëng, në të cilin kishte diçka si të verdhë. Në fillim u tremba, por, pastaj, u kujtova që kisha ngrënë portokall.

Gjithë mbrëmjen e kalova shtrirë në krevat. Dhimbja e kokës dalëngadalë m'u qetësua. Jashtë u errësua. U ngrita, hëngra kos dhe u ktheva në krevat. Bëra një gjumë të thellë. U zgjova, u ngrita ndenjtur në krevat dhe pashë se jashtë po binte shi. Kisha harruar t'i telefonoja Inës, i kisha premtuar. Gënjeva veten.

Vështrova në dritaren, akoma të errët, dëgjoja zhurmën e shiut dhe, pas pak, përsëri më zuri gjumi.

Në mëngjes u zgjova me një ndjesi gëzimi dhe gjallërie. Në ëndërr pashë një pulë kureshtare, ngjyrë kafe që përpiquej të hynte nga dera. Muskuli më dhembte. Kisha parë në ëndërr edhe një parking të vogël, të lagur dhe një makinë të madhe naziste.

Mora gazetën nga kutia postare dhe bëra kafën. Hëngra kos dhe dy sanduiçë me bukë me susam dhe sallo të tymosur, domate dhe kaçkavall. Lexova lajmet në gazetë. Selia e OKB-së në Bagdat ishte bombarduar. Përveç të dërguarit special, ishin vrarë edhe rreth njëzet vetë dhe më shumë se njëqind ishin plagosur. Imagjinoja si bërtisnin në oborrin e ndonjë xhamie. Piva dy filxhanë kafë dhe shumë lëng portokalli.

Shkova në dhomën e ndenjjes, vura albumin Curtains të “Tindersiks” dhe u shtriva në dysheme.

Lëshova perdet në dritare të dhomës së gjumit dhe fika telefonin. Bëra një dozë ketaminë dhe e mbusha shiringën. U ula në cep të

krevatit, e ngula gjilpërën në muskulin e majtë, pak centimetra më larg nga shenja e mëparshme. E shtyva pistonin ngadalë. Prapë ndjeva dhimbje, por më të dobët nga hera e parë. Injektova një dozë të tërë, nxora gjilpërën dhe e lashë shiringën mbi komodinë. U shtriva në krevat në shpinë. Hapa krahët dhe këmbët në një pozicion të rehatshëm. Ndjeva violinat nga dhoma e ndenjjes. Gjithçka shkante mirë. Ndjeva ca shpime të këndshme në trup, pulsi m'u shpejtua, frymëmarrja gjithashtu, errësira filloi të mbushte dhomën dhe kuptova se po humbisja ndjenjat.

Erdha në vete, u shtriva me bark, shtypa trupin me dorën e djathtë. Pëllëmbën e kisha të lagur. U ktheva anash dhe ngrita dorën që më dridhej deri tek fytyra. Ishte errësirë. Nuk e kuptoja ku jam. Dorën e kisha të gjakosur. U ktheva në shpinë. Koka më çante. Vështrova përreth. Me syrin e djathtë nuk shikoja mirë.

E njoha vendin – isha shtrirë në korridor mbi këpucët. Muzika në dhomën e ndenjjes kishte pushuar. Preka syrin. Gjysmën e fytyrës e kisha të lagur. U ngrita. U mbështeta në mur, në të cilin mbeti një njollë gjaku. Shkova në banjë dhe këqyra veten në pasqyrë. Gjysma e djathtë e fytyrës ishte me gjak. Flokët ishin ngjitur në ballë. I ngjaja një rose të plagosur. U lava me ujë të ftohtë. Syri kishte filluar të kullonte. Në vetullën e djathtë kisha një plagë dycentimetërshe. E preka me gisht – nuk ishte e thellë, por nxirrte gjak akoma. E shtypa me letër tualeti.

E lava përsëri fytyrën, pastaj u shtriva. U përpoqa të kujtoja vegimet. Isha zhytur në diçka, por nuk më dukej të kishte kushedi sa interesante, sepse aty s'kishte asgjë. Çfarë ishte ai vend? Imagjinova si isha ngritur nga krevati, dola vetë, duke u lëkundur, në korridor për të kërkuar diçka, jam penguar dhe kam goditur kokën.

Fjeta një ose dy orë dhe u zgjova i mërzitur. Syri më ishte mbyllur. Pranë kokës më vinte një tingull këmbëngulës. Pushonte dhe fillonte prapë. E kuptova çfarë ishte. Fqinji im përpiquej të shponte murin, sikur donte të më ndihmonte, të vinte e të më shpëtonte. U kujtova për minatorët kinezë të vdekur në thellësinë gjysmë kilometri, në provincën Gudejzhu, për mungesën e oksigjenit, ndërkohë që

siguronin energji për nevojat e ekonomisë botërore.

Rrija shtrirë në krevat me një gjendje shpirtërore të shpifur dhe me një sy të mbyllur. Ndieja zhurmën e turjelës së fqinjtit. Isha i uritur dhe i tërbuar nga inati. Shkova në kuzhinë dhe piva dy gota të mëdha me lëng boronice. Shtrengata kishte mbaruar. Zvogëlova dozën e ketaminës dhe e injektova për të tretën herë. Përjetimet nuk ishin ato që prisja, por nuk do të hiqja dorë deri sa të arrija rezultatin e duhur. Nëse duhej do të shkoja të blija prapë ketaminë tek Timo. Nëse do të ishte nevoja do të blija në pazar të gjithë ketaminën që ekzistonte atje.

Rashë në mendime. Vegimet nuk u ngjanin atyre në pishinën e fëmijëve. Ndoshta prania e ujit ishte një rrethanë e rëndësishme. Ndoshta uji kujton përvojën e njeriut në barkun e nënës. U zhvesha dhe me shiringën në dorë hyra në banjë. Lëshova ujin e ngrohtë dhe u ula në një karrige. Prita sa të mbushej ambienti me avull. Këtë herë e injektova në muskulin e djathtë, por nuk ndjeva kurrfarë dhimbjeje, ndoshta, sepse avulli ma digjte tmerrsisht vetullën. Pastaj hapja derën e banjës dhe e hodha shiringën jashtë.

U mbështeta në karrige. Shijoja ngrohtësinë. Shpejt ndjeva se do të ndodhte diçka e bukur dhe do të humbisja ndjenjën e realitetit. Dhimbja pushoi, por nuk u zhyta në errësi – e ruajta vetëdijen. Shikoja shtëllungat e avullit në dritën e qartë të llambave halogene dhe e kuptova menjëherë se jam brenda një shtylle të ndritshme avulli të pafund, se kam qenë gjithmonë aty dhe gjithmonë do të jem aty, i gjatë dhe i plakur, i shkrirë plotësisht në ciklonin e avullit, nga i cili formoheshin pjesë të ndryshme të gjithësisë. Fluturoja pranë tyre dhe mahnitësia prej tyre. Kisha ndjesinë se kjo vazhdoi pafundësisht gjatë, ndoshta për javë të tëra, derisa pashë para vetes një figurë të zhveshur, të errët, shumë të kërrusur. Avulli i turbullonte tiparet e tij. Kishte duar të dobëta dhe bark të fryrë. Flokët pothuajse i kishin rënë. Ai u kthye dhe më tha diçka, pastaj lau dhëmbët para pasqyrës. Shtyrdhi shkumën e rrojës dhe u rrua me kujdes. Lëvizjet i kishte të ngadalshme dhe i merrej fryma. Pastaj u ul, e shtyu veten dhe fluturoi. Ishte një pamje mahnitëse. Ndjeva lehtësim, duke e parë atë të ngrihej lart. Dhe atëherë ndodhi diçka e ankthshme. Fillova të ngrihem. Trupi

i kalbur më mbeti në banjë. Bëja sehir si një vëzhgues anësor. Në mes rrinte midis avullit një figurë e shtypur. I hoqa sytë prej andej. Hapa derën e banjës, kalova fluturim pragun, pastaj përmes korridorit të errët, pranë palltove dhe këpucëve. Në dhomën e ndenjjes fluturova mbi divan dhe tavolinë, mbi sergjenet dhe televizorin. Nën vete vura re Inën dhe Niklasin, të ulur në divan, të cilët shikonin televizorin, të ndriçuar nga drita e kaltër e ekranit. Pastaj pashë Niklasin në bibliotekë, të veshur me bluzë sportive, të ulur me shpinë nga dera para kompjuterit. E shikoja me mospërfillje. Zbrita më poshtë, e kalova aneksin dhe kuzhinën. Ina qëndronte para dritares dhe vështronte nga lumi. Pastaj u ul në dysheme dhe lexonte diçka, vazhdoj fluturimin nga dhoma e gjumit. Ina dhe Niklasi ishin në krevat dhe po bënin dashuri, kishin gërshtuar duart, këmbët dhe buzët. U afrova. Shikoja jashtëzakonisht qartë çdo pjesë të trupit të tyre duke bërë dashuri. Isha varur mbi jastëk dhe në atë moment, Niklas ktheu kokën dhe buzëqeshi – në fytyrën e tij pashë se e kishte humbur shpresën për të kuptuar dashurinë. U trondita. Fluturova përmes korridorit në banjë. E pashë veten të shtrirë në dysheme. Pashë trupin tim blu të palëvizur. Njërën sy e kisha të hapur. Nuk shikoja asgjë me të. Dija vetëm që e dua marrëzisht Inën. Më pushtoi trishtimi. Fillova ta ndiej trupin tim. Këqyra këmbët. Gjoksi më dhembte. U kollita. U përpoqa të lëvizja krahët. E kuptova që kish rënë në dyshemenë e banjës. Isha bërë mavi, i palëvizshëm dhe i mbështjellë nga një shtëllungë avulli. Mora frymë thellë. U përpoqa të pulisja syrin e shëndoshë. Në gojë kisha një shije të hidhur.

U ngrita pak a shumë. Preka gjoksin, barkun dhe kofshët. Hapa dritaren e banjës dhe, mekanikisht, qëndrova para pasqyrës. Një sy e kisha të mbyllur dhe të mavijosur. Mjekrën dhe qafën gjithashtu. E kuptova dhe u lehtësova. Kisha derdhur supën mbi vete. Mbete i palëvizur për një çast, duke mbledhur forcat dhe u ktheva në banjë që të lahem.

Javën e dytë të bujtjes së Inës, vapa u kthye për dy ditë, të cilat ata i kaluan në shtëpizën e vogël me sauna dhe shullëhej në diell, në bankinë. Gjatë asaj kohe, gjyshi i saj rrinte në hije nën pemë dhe merrte frymë thellë. Vapën nuk e duronte fare. Herë pas here e thërriste Inën – Ulla. Tashmë ngatërronte vendet dhe emrat.

Plaku u vllaçit deri tek bankina, u ul dhe futi këmbët e tij të bardha e të holla, në ujë. Ina ia lau kokën dhe shpinën. Nga e djathta e shtyllës kurrizore kishte një vragë të zbehtë, të ngjashme me një vrimë. Ina e dinte, se në kofshën e majtë kishte një të njëjtë si kjo. Lufta ishte diçka shumë e egër. Tridhjetë vjet më parë para lindjes së saj, gjyshi e kishte provuar dhe e kishte kuptuar. Kur Ina ishte e vogël mendonte, se dora që i mungonte gjyshit, ka mbetur në ndonjë zabel pishash të largët.

Gjyshi e falënderoi për larjen dhe u zhyt në liqen. Ai notonte në një anë si një peshk, që i ishin dëmtuar luspat notuese. Pastaj doli nga uji dhe u nis lart nëpër shkallë.

Ina u shtri në bankinë që të marrë rreze dielli me sytë mbyllur. Liqeni ishte i qetë. Përmes qepallave të mbyllura, dielli dukej në ngjyrë zjarri. Ajo e ndjeu veten të përmbushur, të re dhe plot dëshira.

Para drekës, Ina mori një qese najlon dhe tha se do të shkojë të shikojë, nëse kishte boronicë të pjekur. Gjyshi mori me vete një stol të vogël të bërë me dorë dhe u nis bashkë me të. Hynë në zabel. Në fillim nuk gjetën boronicë, vetëm aty-këtu ndonjë të thatë. Por më thellë në pyll, në një lëndinë, gjetën shumë. Gjyshi u ul në stol. Ina përkulej merrte boronica dhe i fuste në torbë. Plaku zgjati dorën dhe rënko. Gishtat i kishte si prej druri. Një pjesë e boronicave ra në tokë. Ai u inatos.

-Kishte të drejtë. Nuk mundem më.

Ai u ngrit, mori karrigen dhe iku, duke tërhequr çizmet e prej llastiku.

Ina e mbushi deri në gjysmë qesen. Pylli binte erë të këndshme. Ajo ndezi cigaren, të cilën ia kishte marrë gjyshit dhe dëgjonte

fëshfërimën e gjethnajës. Nga rruga vinte zhurma e makinave që kalonin. Ina ndjeu se është në një vend, nga i cili mund të shkonte larg vetë.

Hëngrën bukë, Ina bëri një ëmbëlsirë me boronica. Gjyshi hante si me zor dhe heshte. U kthyen në fshat në darkë. Ai pranoi që ta ngiste ajo makinën. Rrinte me sy të mbyllur dhe në cep të buzëve, i kishte rrijedhur lëngu i ëmbëlsirës. Teksa ngiste makinën, herë pas here, ia hidhte sytë. E dinte se do të ishte e pafuqishme, nëse gjyshi do të pësonte krizë.

Afër kishës, Ina mbushi ujë. Në shtëpi ai u lëshua rëndë në divan dhe murmuriste. Ajo u ul në tarracë dhe, teksa e dëgjonte, i vinte për të qeshur.

Mendoi se babai i saj kishte trashëguar karakterin e qetë të së ëmës, ndërsa ato gjërat e çuditshme nga babai.

Në mbrëmje, plaku ishte i gjallëruar, shikonte lajmet në televizor. Pastaj Ina mori radiokasetofonin, i cili e kishte gjetur në bufë në dhomën e ndenjjes. Në të, gjyshja kishte regjistruar, para shumë kohësh, këngë krishtlindjeje dhe himne. E vuri kasetën me shpresën se do ta kuptonte e do ta falte.

Hapi mikrofonin dhe iu lut gjyshit t'i tregonte përrallën për shën Pjetrin. I shpjegoi se e donte shumë, kur ishte e vogël. Një vëmendje e tillë i pëlqeu plakut. Ai buzëqeshi, ia përkëdheli flokët me dorë dhe filloi të tregonte.

Kur shpërtheu Lufta e Dimrit, gjyshi i saj ishte toger i ri. Kishte marrë pjesë në front, thellë në prapavijën e armikut. Pranë Murmanskut, grupi i tij hodhi në erë një tren ushtarak. Kishin asgjësuar edhe një aeroport ushtarak dhe me ski u kthyen në Finlandë, të ndjekur nga rusët. Në shkurt, një copë predhe ia preu atij dorën deri në sup. E menduan të vdekur. Pastori ushtarak që mblidhte dekoratat, vuri ré dridhje e qepallave të tij. Ndërkohë që po e transportonin me kamion në spitalin fushor, një gjuajtës rus e sulmoi kolonën. Një plumb ia përshkoi mushkërinë e bardhë dhe një tjetër i depërtoi në këmbën e majtë.

Ndërsa tregonte, plaku e shtyu karrigen mbrapa, u përkul me zor,

hoqi çorapen dhe e vuri gishtin tek këmba. Gishti i madh ishte prerë në mes, gishti i vogël i mungonte.

Për një kohë të gjatë ishte në gjendje kome dhe qëndroi në spital për disa muaj. Javët vinin e shkonin, por ai ishte pa vetëdije dhe s' dinte asgjë, as për ardhjen e pranverës, as për nënshkrimin e marrëveshjes së paqes. Ishte nisur për në qiell. E takoi atë shën Pjetri, burri më i rëndësishëm atje. Ai u lut që ta linin të hynte. Por ai u përgjigj se mund të bënte gjë për gjyshin, vetëm, nëse ai ishte i vdekur, ndërsa ai ishte akoma i gjallë. Gjyshi u habit dhe nuk e besoi. Shën Pjetri i tha se do t' i tregonte diçka.

E çoi në një sallë me kubë të lartë, në dyshemenë e së cilës ishin formuar radhë me llamba me gaz. Një pjesë e tyre digjej me një flakë të qartë, të tjerët ishin djegur deri në fund. Gjyshi iu lut shën Pjetrit t' i tregonte llambën e tij. Ai e çoi tek njëra, gjyshi u përkul që ta shikonte. Në fillim nuk pa asgjë, por, pastaj vuri ré një flakë të dobët. U drejtua dhe vështroi shenjtorin, në rripin e të cilit varej shishja e gazit. Iu lut atij t' ia jepte. U përkul dhe e mbushi llambën deri lart. Pastaj vështroi në sytë e shën Pjetrit dhe pa se ai e miratonte djegien.

Në spitalin fushor, gjyshi u zgjua pa një dorë. Mjeku i tha se nga trupi i kishin nxjerrë tridhjetë e dy copë shrapneli, megjithatë plagët po shëroheshin çdo ditë që kalonte. E dinte se e kishte mbushur llambën dhe nuk kishte frikë nga asgjë.

Njëra anë e kasetës u mbush. Ai tregonte për fëmijërinë e vet dhe vendlindjen, për babain që kishte qenë druvar dhe për vëllezërit e vet. E përshkroi si ishte ndier, kur, pak para se ta plagosnin, mori vesh se vëllai i tij më i madh, Olavi, ishte vrarë në prapavijën e armikut, pesë kilometra larg nga vija e frontit. Në një natë me hënë shkoi të merrte kufomën e tij dhe e gjeti lehtësisht. Rregulloi me ski një barelë dhe çoi në territorin e vet.

Ina e ktheu kasetën. Gjyshi i tregonte për kuajt e tij, për makinat dhe për qentë, për krushqinë që i bënë me gjyshen, si babai ishte kundër dasmës, sepse nuk besonte që një burrë me një dorë, ishte në gjendje të ushqejë familjen e vet. Gjyshi e kapi me dorën e vetme dhe i tha: “Sigurisht që do t' ia dal.”

Kaseta u mbush, por burri i moshuar donte të tregonte akoma. Vështrimi i ishte thelluar, një gju i dridhej.

-Shkojmë të flemë tani – i tha Ina.

-Unë do të shkoj pas pak. Natën e mirë, Ulla.

-Natën e mirë.

Në të gdhirë Ina u zgjua nga zhurma. Veshi xhinset, bluzën dhe shkoi të shikonte çfarë kishte. Gjyshi rrinte në tarracë në një stol. Mbante cigaren e pa nderur dhe vështronte në rrugë. Ina u ul në shkallë pranë tij. Nata ishte pa hënë dhe e ftohtë, rruga e zbrazët. Ajo ia vuri dorën mbi rrip. Ai u drodh dhe filloi të murmuriste ngadalë.

10

Më zgjoi zilja e derës së jashtme. Flija i zhveshur. Syrin e djathtë vazhdoja ta kisha të mbyllur. U kujtova përse. Jashtë ngrohte dielli, cicëronin trumcakët dhe dukej të ishte pasdite vonë.

Prapë ra zilja. U ngrita, veshja xhinset dhe dola në korridor. U zvarrita deri tek dera dhe mbajta vesh. Dëgjova zërin e Aarnes dhe e hapa.

Ishte Johana me fëmijën në krahë. Më shikonin në pritje të reagimit tim. Nipi mbante në dorë një pupël zogu. Ai, me krenari, ma drejtoi mua.

-Përshëndetje. Pupël e bukur. Hyni, gëzohem që ju shoh.

-Edhe ne gjithashtu. Megjithëse nuk e meriton.

Motra e uli fëmijën në stol në aneks dhe ia hoqi atletet.

Aaren dukej i lodhur dhe i hutuar. Flokët ngjyrë lajthi i ishin rritur dhe ai ngjante si vajzë. I pashë këpucët tij të vogla bashkë me të miat dhe më vinte t'ia plasja të qeshurit.

-Ishin në park këtu afër. Këtë verë të kam telefonuar vazhdimisht, por telefoni yt dilte i fikur ose nuk përgjigjeshe.

-Kam pasur punë.

Johana edhe më parë kishte ardhur para portës sime, kur kishim humbur lidhjet për një kohë të gjatë. Më pëlqente ai zakon i saj. Ishte

si kompensim i sjelljes së saj, kur ishim të vegjël – dhe unë kërkoja afërsi prej saj, por ajo më shmangej.

Aarne e la puplën në stol dhe vrapoi shpejt në dhomën e ndenijes. Johana pa gjurmët e gjakut në mur të aneksit.

-Çfarë të ka ndodhur?

-Do të të tregoj më vonë.

-Ku është Ina?

-Ka shkuar tek gjyshi.

Motra u kthye nga unë. Gëzohesha që ishte këtu. Dukej shumë mirë. I kishte lidhur bisht kali flokët e saj të gjatë, ngjyrë gështenjë të hapur. Kishte shpatulla të drejta dhe fytyrë të këndshme. Duart i kishte të lodhura nga mbajtja e fëmijës. Ishte një grua, së cilës burrat mund t'i drejtoheshin me kënaqësi. E përqafoi ngrohtësisht. Ajo ma preku syrin e mbyllur.

-A doni të pini ose të hani diçka? Pak më parë u zgjova.

-Në çantë kam ushqim për Aarnen që dua ta ngroh. Dua dhe një gotë ujë. Po të duash më vonë dalim bashkë të hamë jashtë. Aarne duhet të flejë.

U ula në divan dhe shikoja se si motra më ndihmonte që të ushqenim djalin. Karrigia dhe tavolina ishin të larta për atë, por ai arrinte të hante, i përqendruar, me lugën në dorë, me kokën e ulur, sikur mendonte anën filozofike të teorisë së të ngrënit. Herë pas here e vinte lugën në tavolinë, tërhiqej mbrapa dhe qeshte duke zbuluar dhëmbët e vegjël. Dukej zbavitës me fytyrën e lyer me qumësht. Ishte thjesht një djalë i vogël që hante mëngjes, por kjo sikur e ndriçonte dhomën.

Teksa e vëzhgoja si hante, më pushtuan ndjenja kontradiktore. Fëmijët janë mjeshtër për të manipuluar ndjenjat, për të fituar ëmbëlsi e miqësi, arrijnë që, me pamjen e jashtme dhe gjestet e tyre, të na thonë: “Më ushqe, luaj me mua, më bëj me krahë dhe më dëgjo. Mos më fyej.” E, pavarësisht nga gjithçka, në pjesë të ndryshme të botës, ata vdesin si miza.

U vërtit pak dhe pastaj u shtri në prehrin tim dhe fjeti. Për mendimin tim, Aarne fliste në mënyrë pak të çuditshme, por unë nuk e dija sa dhe

si flasin fëmijët që s'kanë mbushur akoma dy vjet. Ai u kthye në anë, kapi rripin e pantallonave të mi, e ngriti dhe vuri faqen në barkun tim lakuriq. Vura ré që lëkura ime kishte një aromë të çuditshme, por kjo nuk e pengoi nipin tim të mbyllte sytë dhe të flinte.

Unë dhe motra heshtëm gjatë. Ajo shfletonte një revistë të Inës, Aarne merrte frymë qetësisht dhe dukej se flinte për mrekulli. Bukurinë, ndoshta, e kishte trashëguar nga babai i vet Riku - një bjond shumë simpatik, inxhinier, me të cilin motra jetonte pa celebrim. Ai kishte ndjenjë humori, por nuk kishte fantazi. Njeri i mirë dhe fisnik. Kishte luajtur hokej dhe ishte oficer në rezervë. Pantallonat i mbante në mënyrë qesharake, kur i ngrinte, ndërsa kur pinte, fillonte të këndonte një version të vetin të “Heart Of Goldista” të Nijl Jëng dhe ëndërronte të krijonte një bandë të vetën.

Disa herë kemi shkuar bashkë në pijetore. Isha i kënaqur që Johana kishte zgjedhur atë si bashkëshort në jetë dhe jo ndonjë kopil me probleme, me të cilët bridhte nëpër bare dhe i ndërronte femrat çdo natë. Vetëm një gjë nuk kuptoja – çfarë temash bisede gjente ajo me të.

Motra m'i kishte ngulur sytë nga unë. I pëlqente që i biri më ndiente si të afërt, megjithëse nuk takoheshim shpesh. Kurrë nuk i kisha zbuluar ndjenjat e mia, kur e kuptova që ishte shtatzënë. Ndihesha i zhgënjyer. Më bezdiste fakti që i jepte vetes të drejtë të më quante dajë. Dajë.

Johana u ngrit, shkoi në banjë, por u kthye menjëherë. Foli qetë, por e vendosur:

-Niklas çfarë bën me këtë?

E vështrova – në dorë mbante shiringën. E ngrita me kujdes Aarnen dhe pëshpërita:

-Më ka filluar diabeti.

-Mos më thuaj budallallëqe. Isha në banjë.

Ajo shkoi në kuzhinë, pas pak u kthye duke mbajtur në dorë shishen e vogël bosh. E vuri shiringën në të.

-Ke akoma si kjo?

-Në dhomën e gjumit duhet të ketë.

Johana shkoi në dhomën e gjumit, u kthye dhe u ul pranë meje.

E rrotulloi kapakun e shishes, e shtrëngoi.

-Më thuaj çfarë ka në kutinë mbi komodinë?

I përkëdhela flokët nipit, ngrita kokën dhe vështrova motrën me gjithë dinjitetin, për të cilin isha i aftë.

-Bëhet fjalë për Inën. Dhe për Ionasin. Dua të kuptoj Inën, të ndihmoj e ta ngushëlloj.

Qetësisht i tregova gjithçka, përveç përpjekjes sime për ta bërë Inën të merrte Ketaminë. Motra më dëgjonte me shikimin e ngulur në sytë e mi. Nga shprehja e fytyrës së saj, kuptova se më dënon. Ajo kishte bërë jo pak budallallëqe, ishte futur në krevate të papërshtatshme, kishte bërë fatkeqë njerëz të mirë dhe nuk ishte e denjë të tregonte prioritet moral para meje.

Kur mbarova, ajo uli sytë, heshti për pak minuta dhe më vështroi përsëri.

-Ti je kllouni më i madh mjeran që njoh.

Unë jam vëllai yt i vogël dhe çfarëdo që të ndodhë në jetë, gjithmonë, për ty, do të jem klloun.

-Ke uri?

-Shumë.

-Vishu që të shkojmë të hamë.

-Më duhet të bëj dush, mbaj erë të keqe.

-Epo mirë. Do të presim.

Johana e mori djalin nga prehri im. E pashë se si ai, instinktivisht, e ngjeshi kokën në gjoksin e saj dhe ia hodhi duart në qafë me sy mbyllur, pa u zgjuar dhe mendova se, pikërisht, kështu duhet të kemi besim tek njëri-tjetri.

Motra e vuri djalin në karrocë. Ai kishte fjetur mjaftueshëm dhe donte të luante. E hodhi puplën në trotuar dhe më tha mua ta merrja. U përkula, e mora dhe ia dhashë. Ai e hodhi prapë. E ngrita. E hodhi. Ia dhashë prapë. Kështu luajtëm për ca minuta.

Në rrugën “Aninkajstekatu” hymë në një piceri të lirë, pronari i së cilës ishte emigrant. Johana e la karrocën jashtë dhe e mori djalin në krahë.

Restoranti ishte plot. Në burimin artificial gurgullonte uji dhe dëgjohej muzikë arabe. Motra zgjodhi një tavolinë të lirë pranë dritares. Shkova tek bari. Prapa kasës ishte ulur një burrë i dobët, me mjekër, të cilit i mungonte syri i majtë. Në vendin e saj, nxinte një gropë e errët e shëmtuar. Ai më vështroi me syrin e vetëm. Vështroim ngultas njëri – tjetrin. Mendova se të dy kemi dy sy normalë. Ai ngriti gishtin drejtuar nga unë.

-You motherfucker – tha ai me zë artistik.

E vështrova i çuditur.

-Yes. Mean motherfucker – vazhdoi ai.

Buzëqeshi. Nuk e kuptova fare çfarë ka parasysh. Zgjata drejt tij dorën me gishtin e shtrirë dhe shava njësoj si ai.

-You too, motherfucker.

Ishte një ndeshje e civilizuar në mënyrë të çuditshme. Ai u mbështet dhe u zgërdhi aq fort, sa që u tremba se do t'i dilte nga orbita syri i tij i vetëm. Dridhej i tëri. “Ai nuk është normal” – mendova unë. Burri ngriti kokën.

-Abu Gharaiib motherfucker – bëriti ai duke më treguar mua me gisht dhe vazhdonte të qeshte.

Dera e kuzhinës u hap dhe tre burra zeshkanë u afruan të më shikojnë. Që nga kuzhina u shfaq një djalë i ri me sy të zinj katran dhe një plak me mustaqe të bardha. Atje duhej të kishte dhjetëra njerëz të tjerë. Më thoshin diçka në gjuhë të huaj. Ai me një sy, dalëngadalë, u qetësua, u drejtua, preku me dorë zgavrën e syrit bosh, mori frymë, e nxori atë me zhurmë dhe pyeti seriozisht:

-Çfarë do të doje?

Burrat e tjerë zeshkanë u kthyen në kuzhinë. Porosita dhe pagova. Duke zgjatur paratë, më erdhi turp nga situata e jashtëzakonshme dhe fjalët që më thanë mua. Kur më ktheu kusurin e falënderova në finlandisht.

Mora kanën me ujë që kisha porositur, e çova në tavolinën tonë dhe e hodha në gota. Me syrin e hapur vështroja lëvizjen e gjallë nëpër rrugë. Incidenti ishte revoltues. Nuk dija çfarë të mendoja.

Vështrova Johanën – kishte marrë djalin në gjoks dhe të dy shikonin

jashtë nga dritarja e madhe. Midis zhurmës së bisedave të klientëve, vegimeve të dritave shumëngjyrëshe dhe muzikës, dukeshin të qetë, sikur përgatiteshin të merrnin një vendim të rëndësishëm.

-Johana, prej kohësh dua të të pyes diçka. A të kujtohet loja fëmijët e familjes Darling?

-Çfarë?

-Loja jonë e vjetër.

-Për çfarë e ke fjalën?

Ia thashë fjalët qartë e me solemnitet:

-Ne jemi këtu... Jo, ishte kështu: Ata janë fëmijët e familjes Darling, të cilët udhëtojnë vetëm.

-Mos bërtit kaq shumë. Kurrë nuk e kam luajtur këtë lojë.

-Nuk është e vërtetë. Kemi luajtur vazhdimisht. Ti e sajove, kur kemi vizituar Italinë. S'ka mundësi të mos e mbash mend.

U përpoqa prapë, pasi tërhoqa karrigen mbrapa dhe drejtova shpatullat. Sajova një fizionomi mendjemadhe, megjithëse e kisha të vështirë me një sy të rregullt dhe thashë akoma më me zë të lartë dhe domethënës:

-Këta janë fëmijët e familjes Darling, të cilët udhëtojnë vetëm.

Johana më shikonte. Pastaj më preku me dorë:

-Niklas, çfarë po të ndodh kështu? Po më bën të shqetësohem.

i përcolla deri tek ndërtesa e teatrit të qytetit, u ndava me ta dhe u nisa për në kompleksin sportiv. Doja të isha vetëm dhe të mendoja, duke shëtitur. Ngjita shkallët dhe eca nëpër pistën që rrethon stadiumin.

Në qiell mbi ndërtesat e rrugës "Betaniakatu" qielli kishte një kaltërsi të qartë, si zakonisht në fund të verës. Mendova rreth atyre që më tha motra në piceri dhe, pikërisht, që Ina është e vetmuar që e ka marrë malli për mua. Kur donte, gjithmonë ia arrinte të më bënte të ndihesha mjeran.

Ina ishte e vetmuar. Çfarë kuptimi kishte kjo? Në vetëdijen time u shfaq kjo pamje: Ionasi tullac rri shtrirë në krevat para dritares së hapur. Brenda tij kanceri vazhdon veprimin e vet ogurzi dhe e godet atë, ashtu si bombat e lëshuara nga skuadrilja B-52, kafshojnë shpatet

e pjerrëta në Tora-Bora.

Të tilla ishin vegimet e mia të atëhershme. Nuk kam frikë prej tyre. Isha krenar që isha perëndimor, që bëja jetë luksoze. Kalova qendrën tregtare. Vlerësoja dinamikën e jetës dhe vdekjes. Ina ishte e vetmuar. Të gjithë jemi të vetmuar.

Në prill pashë në faqen e një fotografi irakian fotografitë e fëmijëve, të cilët i çonin në spitalin al-Kinda – pa fytyra, me sy të nxjerrë nga shrapneli, me gjymtyrë të prera dhe lëkurë të djegur. Ndjeva se jam i infektuar nga virusi i dhunës, por nuk më mjaftonte ndjeshmëria për ta kuptuar. Pas gjithë gjasave, kjo vështirësonte dashurinë time për Inën, duke u përpjekur të ruaja ereksionin në shumë momente.

Shëtita gjatë. Erdhi mbrëmja, por unë pothuajse nuk e vija ré bukurinë e saj, sepse mendoja për gjendjen time.

Vetëdijen e kisha të qartë. Disa net të mëparshme kisha fjetur mirë. Isha i sinqertë me veten dhe përpiqesha të arsyetoja pa paragjykime. Isha në një rrugë të vdekur. Disertacionin nuk kisha bërë gati, u tregova jo serioz dhe jo korrekt.

Në dallim me Korpinenin, më mungonte mendja e shëndoshë. Nga ana tjetër, përvoja ime me ketaminën tregoi se jam i prirur edhe për mistikën. E çfarë më mbetej? Punë si pedagog, si gazetar ose si njeri i artit? Përkohësisht mund ta bëja të parën, por nuk e përfytyroja që në të ardhmen të merresha me këtë. Të ngrihem herët dhe të jem gjithmonë me humor të mirë, nuk është për mua.

Të merrem me art? Nuk e kam as dhuntinë e muzikës, as të pikturës. Letërsia nuk më tërhiqte. Edhe këtu duhej njëfarë aftësie e lindur. Më mbetej vetëm të jem këmbëngulës, i pacipë dhe i ndjeshëm. E dija që mund të isha tmerrësisht i pacipë. Butësi provoja ndaj Inës, Aarnes, Johanës, ndaj prindërve dhe miqve. Kthehesha dhe e mendoja gjendjen nga të gjitha anët. Vendosa se i dua njerëzit më shumë, sesa i urrej.

Ndërsa shëtisja, fillova të frymëzohem – diçka që shpesh më ka ndodhur, kur isha më i ri. Më vinin ide të mëdha. Përse të mos shkruaja një roman? E kisha menduar këtë mundësi edhe më parë, madje fillova të shkarravisja diçka, por, pas njëfarë kohe, e humba

besimin tek vetja.

Çfarë titulli t'i vija? Fëmijët e familjes Darling? Por, në fakt, cilin ishin ata? Atëherë m'u kujtuan fjalët e Ali Ismail Abas, të cilat i kisha thënë në spital. Pas plagosjes, dëshira i kishte ndryshuar dhe ai donte të bëhej mjek, kur të rritej. Një lajm i ri nga Londra ishte se kishte kërkuar t'i bënin tatuazh në protezë logon e Manchester Junajted. Ky ishte argumenti i radhës për prioritetin e mënyrës perëndimore të jetesës. Vendosa ta titulloj romanin tim “Roman Mjekësor”.

Në rrugën “Kristina” hyra në dyqanin e pijeve alkoolike dhe bleva verë të bardhë kiliane. Eca nëpër bregun e lumit drejt universitetit.

Ngjita shkallët e fakultetit. Dera e kabinetit të Korpinenit ishte gjysmë e hapur. Kalova dhe shkova të kërkoja një hapëse shishesh. Mora gotën dhe hyra në kabinetin tim. Hapa kompjuterin dhe piva dy gota me verë të ngrohtë.

M'u kujtua porosia e Heminguejit, të cilën e kisha mësuar, kur ndiqja kurset e letërsisë: Shkruaj sinqerisht. Unë shkrova dy fjali të sinqerta.

“Intelekti i gruas së bukur është tipar seksual. Por kjo është çmenduri.”

I lexova ato dhe mbeta pothuaj i kënaqur. Pastaj m'u kujtua diskutimi në kohën e seminarit mbi prirjen e pamjaftueshme sociale të letërsisë finlandeze. Dhe shtova pak prirje sociale.

“Intelekti i grave të bukura perëndimore është tipari seksual. Por kjo është marrëzi.”

Atëherë e ndjeva që po shkruaj roman dhe jo një artikull dhe ndryshova atë që kisha shkruar në ligjëratë të drejtë.

-Intelekti i femrave të bukura perëndimore është tipar seksual. Por mos u mërzit, Rejçëll, kjo është marrëzi.

Po kush ishte Rejçëll? Dhe kush e thoshte këtë?

Fillova të shkruaj shpejt, pa i zgjedhur fjalët.

Puna më rrëmbeu. Jashtë po binte mbrëmja. U afrova tek dritarja, ndeza cigare, dhe vështrova dritaret e ndriçuara të ndërtesave nëpër rrugën “Henrikinatu”, pas të cilave lëviznin njerëzit. Dukeshin të qetë e të sigurt. Piva verën dhe vazhdova punën. Prej kohësh nuk

kisha provuar gëzimin e të shkruarit. Në korridor ndjeva thirrje dhe zhurmë nga rënia e diçkaje. Përfundova fjalinë dhe dola të shkoja si ishte puna. Në fund të korridorit, nga një derë doli një njeri me rroba të errëta dhe u drejtua për tek shkallët. Mbajta vesh. Ishte qetësi. Dera e Korpinenit ishte e mbyllur. U ktheva tek kompjuteri.

Deri në mesnatë shkrova pesëdhjetë mijë karaktere. E printova tekstin dhe e lexova. Nuk më habitën cinizmat. Nuk ishte kushedi se çfarë, por ky ishte vetëm fillimi, do ta korrigjoja e do ta plotësoja më vonë. Vendosa ta paraqisja tekstin që ta lexonin e ta vlerësonin të tjerët. Hapa brauzerin Kâteenveto.net dhe e dërgova nën pseudonimin Mauno Palo.

Pashë çfarë ishte dërguar aty si gjë e fundit. Nën pseudonimin Pete-82 dikush kishte shkruar: “Unë jam heteroseksual, por ndiej në vetëdijen time që jam homo”. Ky ishte një nga mesazhet e zakonshme infantile, me të cilat mbushej interneti i natës. Por disa histori ishin çuditërisht të shkruara shumë mirë. Në lidhje me ato, kishte komente të shumta. Ishte e qartë se kishin zgjuar më shumë interes se një roman i lindur statik mesatar.

E mbarova verën dhe ndeza cigaren. E futa shishen bosh në dollap. E mbylla kompjuterin dhe fika dritat. Qëndrova për pak minuta në errësi duke vështruar dritaret e ndërtesave përballë. Njerëzit përgatiteshin për të fjetur, fiknin llambat dhe ulnin perdet. Prapa dëgjova zhurmë. Kujtova bujtjen e Inës tek gjyshi dhe pyesja me vete, nëse ata tashmë po flinin. Shpresoja se përsëri do t’i afrohesha dhe do t’ia përkëdhelja flokët.

Mbylla kabinetin dhe fika dritat e korridorit. Ndjeva një zë të ulët, të mbytur dhe i ndeza dritat përsëri. Hapa derën e sallës së studimit, por atje ishte qetësi. U afrova tek dera e Korpinenit dhe mbajta vesh pa lëvizur. Nga brenda dikush trokiste në mur. Nxora varësen me çelësa nga xhepi dhe hapa derën e sekretares. Mora nga tavolina çelësat origjinalë për të gjitha dhomat.

Prita pak para derës së Korpinenit, duke mbajtur vesh. Nuk dëgjova asgjë. Trokita në derë dhe thirra: “Jusi?”. Dikush goditi derën. E hapa. Në kabinet ishte errësi, por në dysHEME pranë derës

ishite shtrirë një njeri. E preka murin pranë derës me dorë dhe ndeza dritën. Korpineni ishte shtrirë në dysheme. Statuja e vogël e Budës ishte bërë copë-copë. U përkula dhe e vështrova në fytyrë.

-Jusi?

Ai rënkoi. Flokët ngjyrë lajthie i kishte të shpupurishur dhe ia mbulonin fytyrën, sytë i kishte të hapur. Ia largova flokët nga fytyra. Atëherë pashë plagën. Ishte në tëmthin e majtë. Ai e drejtoi shikimin nga unë, por sigurisht nuk ishte në gjendje të më fokusonte. Nga goja i rridhte pështymë.

-Çfarë ka ndodhur këtu? – pyeta unë.

Ai me vështroi me vëmendje, sikur u habit për diçka, por nuk u përgjigj.

11

Petri kurrë s’e kishte dëgjuar të fliste me zë kaq të rreptë dhe të tensionuar. Sejlllos sikur po i zihej fryma. Donte që rinia të shkonte pranë tij. Ai vështroi orën dhe pa që ishte pothuaj shtatë. I tha që sapo kishte ardhur nga puna dhe do të bënte dush.

-Luaje prapanicën. Kemi punë.

-Mirë, do vij pas njëzet minutash.

Para se të dilte hëngri një mollë. Tashmë po shkonte tek makina, hyri në oborrin e brendshëm, e nxori makinën dhe u nis nëpër bregun e lumit. Ishte i uritur. Rrobat me të cilat u kthye në shtëpi i kishte të lagura. Tani ishte bërë qull përfundimisht dhe kishte ftohtë. Mendoi se, pas vizitës në vilën e Sejlllos, kishte filluar të sillej ndaj tij në një mënyrë tjetër. E merrte në telefon dhe e pyeste si është. Madje e ftoi në restorant të hanin drekë bashkë. Sejlllo e kishte të qartë se Petri ishte gati t’i shërbente.

Ai e priste në rrugën “Bregdeti Perëndimor” në hyrjen e një kooperative, me duart në xhep dhe vështrimin nga lumi. Kur e pa Petrin të afrohej, ai uli sytë poshtë.

-Përshëndetje.

-Mbylle biçikletën. Biseda do të na marrë ca kohë.

Petri iu bind. Shkuan prapa qoshes. Sejllo hapi portën e një garazhi të madh, i cili binte erë vaji makinash. Shkuan në një cep të sallës, ku ishte parkuar makina e bardhë. Sejllo i ra rreth e rrotull.

-Cili njeri do t'ia bënte këtë makinës sime?

Xhami i parë i makinës ishte i thyer, pasqyrat të shtrembëruara. Petri kaloi më tutje dhe pa që llamarina e derës së shoferit ishte dëmtuar dhe një parafango e pasme gjithashtu.

-Çfarë ka ndodhur?

-Nga ta di unë, e rëndësishme është se e kanë bërë.

Sejllo i tregoi për marrëveshjen e takimit me një asistent në barin e kampusit universitar.

-Me atë që të dërgonte letra?

-I njëjti idiot. E prita një gjysmë ore, piva një kafe, por ai nuk erdhi. U ndjeva si budalla dhe ika. Dhe në parking gjeta këtë që shikon. Në fillim mendova se është vepër e ndonjë studenti. U ktheva në shtëpi dhe ia nxora asaj, duke i thënë gjithfarë budallallëqesh. Pastaj lexova postën. Eja.

Me ashensor u ngjitën lart. Në korridor para një dritareje të lartë që shkonte nga lumi në një vazo të bardhë prej guri rritej një shkurre e gjelbër në formë peme. Dyshemeja ishte shtruar me pllaka ngjyrë të kaltër. Në atë kat kishte dy apartamente, tek të cilët kishin dyer të errëta prej druri.

Në hyrje na u sul Jusi Kusti. Sejllo e kapi pas rripit dhe e nxori në tarracë. Në dyshemenë e dhomës së ndenjjes, Marja ishte shtrirë dhe po shikonte televizor.

-Përshëndetje, Petri, gëzohem që të shoh. A do të hash gjë?

-Nuk do ai. Na jep ndonjë gjë të pimë.

Ra telefoni i Sejllos, ai pa ekranin dhe u përgjigj.

-Përshëndetje. Hajde pak më vonë sot.

Petri hoqi këpucët e lagura në korridor dhe hyri në dhomën e ndenjjes. Nga dritarja panoramike, pas së cilës ishte një tarracë me xhama, dukej lumi. Qeni i shikonte dhe tundte bishtin. Megjithëse kishte lindur në Turku, Petri kurrë s'e kishte parë lumin nga një lartësi

e tillëMendoj si do të kishte qenë po të jetonte këtu bashkë me Marjën.

Ajo u solli gotat me shnaps. Sejllo e piu të vetën dhe e la në tavolinën e ulët. Petri e piu. Pija e ftohtë akull dhe e shijshme, por nuk ia dinte markën.

-Eja.

Sejllo e çoi në kabinetin e tij, muret e të cilit ishin veshur me rafte deri në tavan, plot me libra. I zoti i shtëpisë mbylli derën.

-Të gjitha i ke lexuar?

-Të paktën kështu përgjigjem, kur më pyesin.

Ai u ul në tavolinën e gjerë në kolltukun prej lëkure. Mbi tavolinë ishte një laptop i hapur. Sejllo klikoi, zmadhoi përmasën e tekstit dhe e ktheu nga mysafiri, i cili e mbaroi gotën e pijes. U mbështet në tavolinë dhe lexoi titullin “Imperialistët”. Pastaj vinte urimi i shkurtër: “Riparim të mbarë”.

-Kjo është punë e ndonjë të çmenduri.

-Nuk është puna aty.

Sejllo e ktheu kompjuterin nga vetja, duart e tij të mëdha rrëshqitën nëpër tastierë. Merrte frymë thellë dhe shpesh me një vështrim të akullt.

-Shikoje.

Petri vështrroi ekranin, ku ishte hapur faqja e universitetit. Nga një fotografi buzëqeshte një djalë kaçurrel, nën të ishte shkruar emri i tij: Jusi Korpinen. Më poshtë ishte shënuar numri i kabinetit të tij, orari i pritjes, numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike. Por ajo nuk korrespondonte me adresën, nga e cila Sejllo kishte marrë mesazhet. Në fund fare kishte disa rrjeshta mbi teorinë postkoloniale dhe teorinë e tregimit.

Sejllo e printoi faqen, pastaj hapi kërkuesin dhe shkroi emrin e Jusi Korpinenit.

-Jeton këtu, në Turku. E kemi adresën.

Printoi dhe rezultatet e kërkimit. Petri u ngrit dhe u largua prej tij. Kërkonte tonin e duhur.

-Sejllo, nga e di ti se është ai? Dërguesi i letrave mund të jetë kushdo. Universiteti ka adresën e vet, nga e cila kushdo mund të

dërgojë mesazhe. Siç e shikon, adresat nuk përputhen.

-Ai është. Ti e di mirë çfarë thuhet për nuhatjen time.

Petri ra në mendime. Nuk e dinte se çfarë pikërisht kishte parasysh Sejlllo. Por në atë çast, kuptoi diçka për atë dhe thelbin e tij – si i merr ai vendimet, kur dëshiron diçka. Dukej qartë që ai nuk lëkundej shumë. Sejlllo u mbështet mbrapa dhe barku iu var mbi rrip. Petrit i erdhi keq për të, sepse kjo ishte shenjë plakjeje dhe dobësie.

Sejlllo rrotulloi karrigen dhe mori fletët nga printeri.

-Kjo është për ty. Detyra.

Ia zgjati Petrit, i cili vetëm e vështronte. I tundi ato pa durim dhe Petri i mori. Ia nguli sytë fotografisë bardhë e zi të burrit, lëkura e të cilit ishte më e errët se në ekran.

Sejlllo u ngrit, shkoi në mes të dhomës, futi duart në xhepa dhe vështroi mysafirin e tij.

-E di se çfarë mendoj për luajalitetin. Por ky nuk duhet lënë të largohet. A do të të japë Marja ndonjë gjë?

-Jo, faleminderit. Dua të bëj një dush dhe të pushoj.

-Mirë. Faleminderit që erdhe, pavarësisht shiut dhe lodhjes.

Sejlllo hapi derën e kabinetit. Kur mysafiri doli në korridor, i zoti i shtëpisë i vuri dorën në sup. Petri u përkul, mbathi këpucët dhe lidhi lidhëset. Vështroi nga dhoma e ndenjjes dhe pa se Marja vazhdonte të rrinte shtrirë në dysheme.

-Çiao Marja.

-Çiao, çiao. Herën e fundit më le përshtypje të mirë. Të shpresojmë që do shihemi së shpejti.

Sejlllo e përcolli deri tek ashensori dhe të dy prisnin kabinën që të ngjitej, qëndronin shumë afër njëri-tjetrit. Djaloshit i dukej se me këtë afërsi, i zoti i shtëpisë donte ta impresiononte. Dera u hap dhe Sejlllo e vështroi në sy.

-Për mua ti do bëhesh një njeri akoma më i rëndësishëm. Çiao, natën e mirë.

Dera u mbyll dhe kabina u nis poshtë ngadalë. Petri u kthye nga pasqyra dhe buzëqeshi.

Të nesërmen në mëngjes, Petri u zgjua më herët se zakonisht. Bëri kafën, u ul në tavolinë dhe vështronte përmes dritares. Në ajër silleshin pulëbardhat ose laraskat – nga larg nuk i dallonte dot. E piu kafën ngadalë dhe skuqi vezë për mëngjes. Shkoi për të bërë dush, kujtimi për Marjën e bëri të masturbohej.

Eci me biçikletë në mëngjesin e freskët. E mbylli pranë një kabine në rrugën për Tamper. Priti shitësin që të hapë kioskën dhe bleu gazetën, pastaj u nis në adresën e Korpinenit.

Shtëpia e fundit e një radhe, pothuajse të njëjta, pas saj ishte një kopësht i vogël, nëpër të cilin kalonte një rrugicë me çakëll. Para shtëpisë ishin mbjellur shkurre. Petri u ul në një stol në kopsht dhe lexoi gjithçka në gazetë, madje edhe programin televiziv.

Në nëntë e gjysmë dera e banesës u hap dhe doli një djalë i vogël që vrapoi tek rëra. Pas tij doli një burrë me flokë të gjata ngjyrë lajthi, i cili e la portën të hapur. Petri e njohu nga fotografia. Burri i thirri dikujt brenda. Që andej u duk një grua e dobët flokëgështenjë me një bebe në krahë. Ajo e vuri në karrocë, u ul në shkallë dhe filloi ta tundë para mbrapa.

Korpineni luante me djalin në rërë. Dukeshin të përqendruar dhe të qetë. Petri nuk e kuptonte se si një burrë i moshuar mund të sillej kështu.

Pas njëzet minutash, babai u ngrit dhe shkoi të fliste me gruan. Pastaj hyri brenda dhe, kur doli mbante një çantë pazari. Shkoi tek djali, i tha diçka dhe fëmija e zuri për dore. U nisën për diku.

Petri priti pak dhe i ndoqi, pasi fiku telefonin.

Ata ecnin shumë ngadalë. Në fund të rrugës u ndalën që të prisnin momentin e përshtatshëm për të kaluar. Djaloshi qëndroi pranë tyre dhe këqyri me vëmendje Korpinenin. I erdhi keq për djalin për trashëgiminë që do të merrte nga i ati, i cili kishte flokë kaçurrela dhe gjoks pule. Pantallonat i vareshin përreth prapanicës së tij të dobët. Mbante dorën e djalit në dorën e vet të hollë e të zbehtë. Petrit nuk i

besohej që një dorë e tillë ta kishte dëmtuar makinën ashtu.

-Babi – tha fëmija i gëzuar dhe vështroi të atin.

-Tani nisemi.

Petri qëndroi në vendin e vet. I ndoqi me sy, teksa prisnin rrugën. U kthye, shkoi tek kabina dhe hapi biçikletën. U nis drejt qendrës, mendonte për Marjën dhe për çfarë ndien një fëmijë, kur shëtiti me të atin për dore.

Në mbrëmje, para se të fillonte turnin, ai iu lut shefit që të bënte një telefonatë nga telefoni i shërbimit, sepse iu mbyll telefoni i vet duke folur për një çështje të rëndësishme.

Telefonoi në fakultetin e Korpinenit. Iu përgjigj një zë i gjallë femre. Petri u prezantua me emrin e shefit të vet dhe gënjeu që është student i kursit të tretë.

-Më duhet t'i kthej një libër që ia kam marrë Juri Korpinenit.

-Për momentin nuk është këtu. Mund të ma sjellësh mua dhe unë do të kujdesem që t'ia jap.

-Kam disa çështje, për të cilat do të doja të flisnim. Ka ca gjëra na libër që nuk i kuptoj. Kur do të jetë aty?

-Mund të provosh pasdite. Mund të komunikosh paraprakisht në postën elektronike. Tani që s'kanë filluar akoma mësimet, orari i pritjes nuk zbatohet. Jusi shpesh punon në mbrëmje, madje ndonjëherë rri deri natën vonë.

-E qartë, ashtu do të bëj. Faleminderit për ndihmën.

Gjatë natës Petri pa një ëndërr. Qëndronte në oborrin e shtëpisë së Korpinenit, pastaj ngjiti disa shkallë dhe hyri brenda. Në korridor pa rroba dhe lodra, pastaj hyri në një dhomë të madhe. Aty vërtiteshin njerëz dhe ai s'e dinte cilët ishin ata dhe për ku do të niseshin. Ata mbanin bagazh me vete. Një grua tha se familja e ka braktisur apartamentin. Petri vuri ré se dhoma e ndenjjes ishte e papastruar, në dysheme kishte rërë dhe vërtiteshin gjethe të thata.

Mobiljet ishin të vjetra, të prishura dhe sipër tyre kishte plehra. Me sa dukej këtu s'kishte jetuar njeri prej kohësh.

Ai u ngjit në katin e dytë, hyri në dhomën e errët të gjumit dhe pa se në krevat ishte shtrirë Sejlo me sytë mbyllur. Në qoshe rrinte një

djalë i vogël me pantallona të shkurtra. U afrua tek Sejlo. Mjekrën e kishte të lagur, fytyra e zbehtë dhe e shtrembëruar. E preku.

Ai hapi sytë dhe u ul në cep të krevatit.

-Bëre mirë që erdhe. Këtu njerëzit presin prijësin tjetër – tha Sejlo dhe vështrroi djaloshin.

Atëherë Petri u zgjua. U ul në fund të krevatit dhe u kujtua se përsëriti lëvizjet e Sejllos në ëndërr. Shkoi në kuzhinë dhe mbushi ujë në një gotë të pistë që e piu para dritares. Vështronte kullën e ndriçuar në kodrën Vartiovuori, që nga hapej pamja deri larg. Mendoi t'i telefononte Sejllos. Përpiqej të arsyetonte çfarë roli ka filluar të luajë ai në jetën e tij.

Në gjashtë e gjysmë, Petri u nis për në universitet duke mbajtur librin me kopertinë të butë me titullin “Udhëzime për publikime në rrjetet e komunikimit”.

Ndërtesa katërkatëshe ishte e shëmtuar dhe e ngushtë. Porta e jashtme ishte e hapur. Kontrolloi në tabelën e auditoreve vendndodhjen e kabinetit të Korpinenit. U ngjit lart – kati ishte bosh dhe i qetë. Njëra nga dyert ishte pak e hapur. Në tabelë shkruhej “asistent Jusi Korpinen”. Një zë burri brenda bisedonte në telefon.

U kthye në auditor u ul dhe filloi të lexonte librin që mori me vete. Teksti nuk i interesonte fare. Mendonte, nëse roja i kontrollon periodikisht katet dhe, nëse ka kamera të montuara.

Nga automati bleu një çokollatë dhe një shishe ujë mineral “Vishi”. Pa mbi pemët e oborrit një tufë pulëbardhash dhe dëgjoji krakëllimën tyre. Universiteti ishte i qetë dhe i zbrazët.

Pak para orës tetë në auditor hyri një burrë, i cili mbante një qese najloni me logon e rrjetit të dyqaneve të pijeve alkoolike “Alko”. U ngjit lart nëpër shkallë. Petri mendoi se ky do të ishte ndonjë doktor i alkoolizuar, i cili në kabinetin e tij të vogël studion historinë e revolucioneve dhe planifikon gjëra të mëdha.

Në orën nëntë e gjysmë Petri u mërzi të prituri. Jashtë tashmë ishte errësirë dhe ishte i uritur.

Mbylli telefonin, la librin mbi tavolinë dhe u nis lart nëpër shkallë. Dera e kabinetit të Korpinenit akoma ishte pak e hapur, por të tjerat

ishin të mbyllura.

Në korridor ishte një kamare, në të cilën ishin hedhur një grumbull topash prej letre. Ai mori një dhe pa që janë studime të vjetra të studentëve. Ngjeshi kapuçin e xhupit në kokë. Qëndroi para derës pak të hapur dhe trokiti.

-Hyr.

Petri e hapi derën dhe futi kokën brenda. Burri që rrinte para kompjuterit ktheu kokën. Djaloshi, duke buzëqeshur, i tha me zë të lëkundur.

-Përsëndetje, më falni për shqetësimin. Më janë lutur që t'ju jap këtë.

Ia zgjati topin.

-A. E çfarë është ky? Ma jep de.

Petri hapi plotësisht derën, hyri në kabinet dhe u drejtua tek ai. Ia zgjati letrat me dorën e majtë. Korpinen rrotulloi karrigen, u ngrit dhe i zgjati dorën. Sapo ai do të merrte letrat, Petri i tërhoqi mbrapsht dhe e goditi me grushtin e djathtë. Korpinen ra në karrige dhe mbuloi fytyrën me duar. Bërtiti si një vajzë e pickuar. Petri i hodhi dokumentet përsipër tij. Mbi një raft të vogël ishte një statujë prej balte në lartësinë e gjoksit të tij. Djaloshi e mori dhe e goditi burrin në tëmth. Statuja kërceu në mur, ra në dysheme dh u thye copë-copë.

Asistenti ra në gjunjë, pastaj u shtri me bark, goditi ballin dhe mbeti ashtu i shtrirë pa lëvizur. Petri e shikonte, zemra i rrihte uniformisht. U kthye, fiku dritën, mbylli derën dhe eci nëpër korridor – ndiente si po i ngrihej niveli i adrenalines. Zbriti nëpër shkallë dhe doli jashtë.

U nis nëpër rrugën që të çonte tek katedralja. Mendoi të shkonte në “Kaski”. Kockat e gishtit të djathtë i dhembnin, por kjo nuk e bezdiste.

Në breg të lumit ai ndaloi në tarracën e galerisë së qytetit. Njerëzit rrinin në natën e freskët nën drita dhe bisedonin. Bleva një birrë dhe u ula në një tavolinë të lirë.

E vuri birrën mbi kockat e dorës. E ktheu shiritin pas që nga çasti, kur kishte lënë librin në tavolinë në auditor. Kujtonte gjithçka shumë qartë dhe ndihej i kënaqur. E ndjeu se një vajzë me flokët ngjyrë lajthi

nga tavolina fqinjë po e shikonte.

E piu shpejt birrën dhe mori një tjetër. Vajza flokëlajthi, mori çantën dh u afrua tek tavolina e tij.

-Mirëmbërëma. Rrallë e bëj këtë, por a mund të ulem e të flas me ty?

-Po, sigurisht?

Ajo ishte e gjatë, kishte mbathur një palë këpucë të rehatshme. U ul dhe u prezantua si Nina. Petri ia tha emrin dhe e vështroi. Ajo tha se kishte një takim, por ai nuk erdhi. Ishte mbrëmja e fundit e pushimeve verore dhe akoma nuk kishte dëshirë të kthehej në shtëpi. Petri kishte ndërmend të pinte birrën, të fliste pak dhe të ikte. Pastaj vendosi të rrinte më shumë, nëse Nina donte të fliste.

13

Ditën që do të udhëtonte, Ina fjeti deri vonë. Më parë shkoi tek varri i gjyshes, pastaj filloi të bënte gati bagazhin. Proteza e gjyshit nuk hynte në çantë.

Gjyshi e përcolli deri në stacion. U përqaftuan, ajo hypi në autobus dhe u ul në një vend pranë dritares. Ai mbeti aty me dorën në xhep. Ina i tha mirupafshim duke tundur protezën. Ai buzëqeshi dhe i ktheu shpinën. Ajo shikonte sa me zor ecte drejt kopshtit të tij të dashur.

Deri në Joensu rruga ishte dyzet kilometra. Autobusi ndalej në stacione të ndryshme dhe rruga dukej më e gjatë. Po mendonte përse gjyshi nuk thoshte asgjë për babain e saj. Sikur po të fliste do të shkelte ndonjë rregull të vendosur.

Në Joensu njerëzit vështronin me kureshtje, nga që mbante çantën dhe protezën. Bleu një uokmen dhe bateri për të. Hyri në një restorant që të hante. Ishte e premte dhe kishte shumë njerëz. Hëngri dhe u kujtua se herën e fundit kishin ardhur këtu me Niklasin pas një koncerti rok, kur shiu ua lagu çadrën që kishin ngrehur.

Po binte muzgu. Në stacion bleu biletën për trenin e natës dhe u ul në sallën e pritjes që të dremiste pak. Erdhi treni dhe ajo hipi. Gjeti një

kabinë me krevate dhe po shpresonte që të mos vijnë udhëtarë të tjerë.

Treni u nis, ajo lau dhëmbët dhe fytyrën në lavamanin e vogël ngjyrë portokalli.

U shtri në krevatin e poshtëm pa i hequr mbathjet. E vuri protezën pranë vetes, vuri kasetën në uokmen, pastaj vuri kufjet.

Në errësirë preku protezën. Përmes kërcitjes së rrotave dhe zhurmave të tjera dëgjonte zërin e gjyshit, në të cilin dalloheshin nota të veçanta, kur ai tregonte për se si iu lut shën Pjetrit t'i jepte gaz.

Përsëritje, Ina, Edinburg

11.07.2001

Jam ulur në një pijetore, e cila quhet “The World End” në rrugën “Kanongaten”. Jashtë bën vapë dhe shëtisin njerëz të veshur lehtë, pas gjithë gjasave – turistë si unë. E bind veten se erdha këtu, kryesisht, për shkak të riparimit të banjës. Dje u kujtova se këto ishin pushimet e para gjatë dhjetë vjetëve të fundit. Pashë në ëndërr mbrëmë rezultatet e ekografisë. Në mëngjes i telefonova Turtias. Gjithçka është në rregull. Për sot kjo është gota e dytë. Ne nuk kemi frikë apo jo?

Jetë dhe shëndet, babi.

14

Sami kishte marrë me qira, për fundjavën e fundit të gushtit, një vilë në Parasilta. Erdhi të më ftojë që të shkoja edhe unë të premtën pasdreke.

Kisha një përgjumje të tmerrshme dhe nuk e dija në ç’botë jam. Në vetëdijen time kalonin me radhë vegime surrealistike. Dukësia si figura nga litografia e Salvador Dali, trupi i të cilit është i ndarë në sirtarët e nxjerrë përgjysmë. U shemba në divan dhe thashë se nuk jam në gjendje të shkoj atje.

-Sigurisht që mundesh - më bindi ai dhe u ul pranë meje. – Atje do të jetë shumë këndshëm.

I mendova të gjitha alternativat. Ina do të udhëtonte nga Joensu me trenin e natës dhe do të arrinte në mëngjes. Imagjinova si do të ecja lart e poshtë gjithë natën nëpër tarracë duke pirë cigare njëra pas tjetrës dhe duke vuajtur.

I thashë Samit të më priste. Shkova në kuzhinë, nxora nga frigoriferi një gjysmë litri birrë, e hapa dhe e hodha në gotë. E piva me sy mbyllur. Hapa të dytën dhe e piva deri në gjysmë. U mbështeta në tavolinë, u gëlltita dhe po prisja. Pija e ftohtë filloi të veprojë.

Mora një qese najloni dhe shkova në dhomën e gjumit. Në qese futa rrobat. U ktheva në kuzhinë dhe përfundova birrën. Mora një tablet nga qetësuesit e Inës dhe e piva. Në një qese futa të gjithë birrën që kisha në frigorifer. U ktheva në dhomën e ndenjjes.

-Hajde ikim.

Moti ishte i kthjellët dhe i ngrohtë, dielli shkëlqente në xhamin e parë. Sami ngiste makinën dhe dëgjonte një pjesë të vjetër të Ramstejnit. Habitesha me aftësinë e tij për të mbajtur rrobat më të zakonshme me stil. Hapa një birrë dhe ia dhashë atij. Ai piu pak dhe pyeti cilat janë planet për javët e ardhme.

-Do të marr dy kurse të Korpinenit me urgjencë dhe ato fillojnë javën tjetër.

-Atëherë duhet të mobilizohesh fort.

-Do ta bëj që nga e hëna.

-Si është Jusi?

-Nuk di shumë gjëra për të. Kam folur me të shoqen nja dy herë. Por nuk e mbaj mend mirë se çfarë më ka thënë. Vështirë është të parashikohet çfarë do të bëhet. Nga sa kuptoj unë, ka një problem të madh neurologjik.

-Eh, në djall!

-Po.

-Kush mund të ketë vënë dorë mbi atë njeri? Ndonjë student i pakënaqur nga vlerësimi, ndoshta?

-Nuk mund ta di.

E piva birrën dhe e hodha kanoçen në ndenjësën e fundit.

-Të thashë që kam folur prapë me policët?

-Jo. Po përse?

-Ata më kërkuan. Për shkak të syrit tim të mavijosur atë natë.

-Meqë ra fjala si ishte puna atë natë?

-Nuk mund të shpjegohet dot. Herën e fundit policët me pyetën për marrëdhëniet në punë. Më pyeti një djalë i ri, m'u duk goxha i zgjuar i thashë: "Ti me të vërtetë je me humanizmin tonë? Këtu vrasja është diçka e zakonshme".

-Idiotizëm.

-Dakord.

-Duke pasur parasysh atë që ndodhi me Korpinenin.

-Po. Por unë jam bastard i fortë, duroj gjithçka, me përjashtim të pakënaqësisë në sy të femrave.

Hapa një birrë tjetër dhe ia zgjata Samit. U nisëm për në jug, dielli na verbonte. Në anë të rrugës pamë një ekskavator me mbishkrimin "Komatsu".

-Nëse dikur do të kem një djalë do ta pagëzoj komatsu – thashë unë.

-Për kënaqësinë time, kjo është pak e besueshme.

-Ti dhe Leena planifikoni të bëni fëmijë?

-Natyrisht. Bota ka nevojë për gjak të freskët.

Mbi ne shtrihej qielli i pafund. Audi i argjendtë i merrte kthesat butë në rrugën e rrethuar me fusha dhe livadhe midis bollëkut të dritës dhe jetës dhe midis këtij peizazhi madhështor, unë pija birrë, vështroja qiellin dhe ndieja se mendimet dhe veprimet e mia s'kanë rëndësi, sepse ndryshojnë vazhdimisht.

U ktheva nga Sami dhe thashë:

-Mos i thuaj askujt çfarë i ka ndodhur Korpinenit.

-Jo. Në fund të fundit, kjo i përket vetëm gruas dhe fëmijëve të tij.

-Korpineni do ta marrë veten. E njoh prej kohësh. Dhe betohem se do të hakmerrem për të.

-E qartë.

Heshtëm për pak minuta, pastaj Sami tha:

-Tani do ta shkel etiketën. Po ecën me disertacionin?

-Hiç fare. Nuk më mbetet kohë nga pija dhe kurvat.

-Po të më pyesësh mua, ka kohë për gjithçka.

-Po ti çfarë gjëje të mirë ke arritur? Punon me çfarë të bije në dorë.

-Eh, shiko kolegun tim, akademik.

Hapa një birrë tjetër dhe e piva gjatë. Dalëngadalë gjendja ime po përmirësohej.

15

Vendi është motel, Suvi është njëzet.

Janë njëmbëdhjetë ndërtesa njëkatëshe – bungalo, që ndodhen në breg të detit midis pyllit të pishave, mështeknave dhe bredhave.

Suvi rrinte në recepsion në ndërtesën, e cila ishte njëkohësisht edhe kafene dhe që andej dëgjohet pllaquritja e valëve. Shikon hijet e pulëbardhave në rërë dhe dëgjon krakëllimën e tyre. Pak më larg në gji notojnë, si çdo mëngjes, mjellmat. Fillojnë orët e nxehta. Në rërë dhe në bankinë fëmijët bëjnë atë që bëjnë të gjithë fëmijët në breg të detit: bërtasin, hidhen në ujë dhe spërkasin njëri-tjetrin.

Suvi rri në recepsion dhe u përgjigjet thirrjeve telefonike. Merr paratë e klientëve dhe u jep çelësat. Në ato ndërtesa njëkatëshe rrinin me javë familje të reja dhe vajza të moshuara, turistë gjermanë, suedezë – vijnë për ditë pushimesh. Kundrejt një pagese shtesë, Suvi i furnizon me ndërresa dhe peshqirë.

Gjithashtu u jep, me qira, biçikleta të motelit, sauna të pastra, ngre flamurin në kullë, tendos rrjetat e volejbollit dhe shërben në kafenenë e qetë. Një herë në javë bën pesëmbëdhjetë orë dezurn dhe, pastaj, fle gjatë në ndërtesën e saj të vogël. Mbi breg është ndërtuar linja e energjisë elektrike dhe, kur fryn erë e fortë nga deti, telat e saj japin tinguj muzikorë.

Nganjëherë Suvi zgjoherë herët, para orës pesë. Del jashtë dhe ulet në shkallë. Gjiri i detit është zhytur në errësirë. Afrohet lindja e diellit, vajza vështron dhe shikon se si, nga drita fillojnë të lindin hijet e pemëve. Në gusht fillojnë shirat, në mbrëmje errësohet dhe era forcohet, deti ftohet dhe merr ngjyrë zinku, në bregun, tashmë

të boshatisur, bie shi me gjyma. Suvi radhit e rregullon tavolinat e karriget pranë mureve.

Ajo mbështetet në banakun e recepsionit dhe pi çaj. Radio jep muzikë. Vetëm në dy bungalo ka mysafirë. Suvi vështron detin dhe sheh se si pranë bankinës ngrihet një mjellmë. Zogu fluturon me vështirësi përballë erës, prek ujin me krahë, bën një rrotullim mbi gji dhe drejtohet nga bregu. Prek telat e linjës elektrike dhe dritat në kafene vezullojnë, pastaj zogu i madh kthehet, bie me krahët e hapur në tokë, dëgjohej një zhurmë, sikur dikush të kishte goditur në mur me jastëk. Suvi lë filxhanin në banak dhe hap derën.

Mjellma shkëlqente si njollë e bardhë mbi rërën e lagur, u kthye në shpinë me krahët e hapura. Mbi sqepin e saj të kuqërremë u ngjitën kokrra rëre. Era ia hapi pendët në gjoks. Sytë e saj, si kopsa të zeza, u ngulitën në qiell.

Mbrëmja errësohet gjithnjë e më herët dhe, pak para orës nëntë, tashmë është errësirë e plotë. Suvi bën dezurnin në recepsion, dëgjon radion dhe zhurmën e valëve.

Dritat në ndërtesat njëkatëshe fiken dhe në kafene vijnë vetëm klientë meshkuj që porosisin birra. I kanë gratë dhe fëmijët në gjumë. Zakonisht janë të qetë, mbërthejnë sytë tek deti i errët, shprehje e fytyrës dhe gjuha e trupit të tyre tregojnë se kanë frikë nga diçka. Bisedat e tyre nuk i interesojnë Suvit.

Ata janë si insektet, të cilat tërhiqen nga dritat e kafenesë. Ky është njëfarë refleksi frike. Bisedat e tyre e nervozojnë. Tregojnë për frikën e tyre, pavendosmërinë dhe planet për të ikur. Suvi nuk i kupton. Mos është tek ajo shkaku? Apo tek errësira dhe deti? Dhe, në përgjithësi, a ka ndonjë shkak?

Njëri nga burrat thotë se është sipërmarrës në fushën e energjetikës. Ka një grua të bukur, një djalë të vogël dhe një vajzë të rritur nga martesë e parë. Në vështrim të parë, gjithçka është në rregull. Por ai ka në llogarinë bankare tridhjetë mijë euro, për të cilat bashkëshortja s'ka dijeni. Ai i ka ato për çdo rast, nëse i ndodh ndonjë gjë e keqe. “E kupton” – pyet ai. “Jo, nuk mund t’i përdorësh ato para, vetëm për diçka të keqe që mund të ndodhë” – i përgjigjet Suvi. “Eh, një ditë,

kur të rritesh, do të më kuptosh” – thotë burri.

Një burrë tjetër tregon gjerë e gjatë për punët që ka bërë, për arritjet e tij sportive në të shkuarën, për udhëtimet dhe për miqtë e tij. “Nuk e kuptoj” – thotë ai. “Çfarë?” – pyet Suvi. Ai bën me dorë nga bungalot dhe thotë: “Atë nuk e kuptoj. Ose të paktën jo si më parë.” “Ju punoni bashkë?”- pyet Suvi. “Kemi ardhur këtu së bashku” – i përgjigjet ai. “Po ti tani rri këtu vetëm” – thotë Suvi. Burri vështron nga deti. Në zërin e tij dallohen nota të buta ëndërrimi, kur thotë: “Ajo është femra, për shkak të së cilës para shumë vitesh qaja në një taksì.”

Burri i tretë tha se po bëhet gjithnjë e më cinik. Tashmë gjithçka është në rregull. Gruaja e tij akoma është e bukur. Fëmijët pas disa vitesh do ta lënë shtëpinë e prindërve. Por ai bëhet akoma më cinik. Shkaku është tek femrat e reja. “Mos më keqkupto. Nuk do të të pres” – thotë ai.

E pranon se, në fakt, nuk dëshiron gra të reja, sepse çfarë mund të flasë me to, çfarë mund të bënte me to, kur gjymtyrët i dridhen dhe tashmë nuk mund të funksionojë më? Atij i mjafton gruaja e vet. Por e di se ka humbur shumë mundësi që kishte pasur kur ishte i ri.

Kurrë nuk do të bëjë diçka që ka bërë, kur ka qenë i ri. Ai e kujton si dukej fytyra e tij, kur ishte djalë i ri dhe e urrente veten. Ja prandaj tani rri në tavolinën plastike dhe flet për vete.

Ata vijnë nga shtëpizat -bungalot tek dritat në kafene. Suvi mbushi gotën njëpërdorimshe me birrë. Nëse ata janë burra, nëse kur të rriten djemtë bëhen të tillë, ku është atëherë shpresa për një grua?

16

Bungalot ishin ndërtuar në zabel prej lloje drurësh të ndryshëm në breg të gjirit të gjerë. Parkuam në parkingun pothuaj bosh. Dielli i pasdites ndriçonte plazhin me rërë, në të cilin kishte disa njerëz. Zbrita nga makina dhe e kuptova se vera ka mbaruar. Në bankinën e gjatë ishin lidhur vetëm dy varka. Në kullë valëvitej flamuri i I dalë boje.

Sami shkoi në receptionin e motelit. Prapa xhamit pashë që po buzëqeshte një bionde e re. Pranë murit kishte diçka të ngjashme me një bar – një strehë me tendë. Shkova të shikoja çfarë ofrojnë atje.

Në një tavolinë plastike ishte ulur një çift të moshuarish dhe pinte kafe. I përshëndeta, por ata s' mu përgjigjen. Kishte birrë, verë molle dhe alkool të fortë. Mbi raftë ishin radhitur ëmbëlsira dhe çipse dhe në vitrinë bukë të thatë dhe pite. Çifti nuk fliste. Gruaja shikonte kamerën dixhitale, ndërsa burri vështronte përmes syzeve të diellit nga deti dhe tundte këmbët me venat e fryra. I vështrova dhe kalova.

Sami pagoi dhe mori çelësat. Me makinë shkuam deri tek bungalot dhe futëm bagazhin brenda. Në ndërtesën dykatëshe kishte vend fjetjeje për dhjetë vetë. Sami kishte marrë, për çdo rast, tre dyshekë kampingu. Në katin e parë ishte kuzhina, banja dhe sauna. Bungalot ishte e banueshme edhe në dimër. Mendova se, në rast nevoje, mund të fshihesh këtu dhe të kalosh mbrëmjen në bar.

Sami kishte kursyer me pijet – kishte mjaft vodkë, birrë, konjak, uiski dhe verë. E respektonte shumë këtë tipar të karakterit të tij. Kur dehej, donte që të gjithë ata që ishin pranë tij të binin nga tavolina.

E mbushëm frigoriferin me pije dhe ushqim. Sami e çoi makinën në parking. U kthye dhe zhveshi bluzën me logon e Lejkërsit. U ulëm në tavolinë jashtë dhe po prisnim.

-Domethënë ky është Koh Samui?

-Po. Në një farë mase, është emocionuese. Me Leenën kurrë s'kishim udhëtuar bashkë.

-Do të keni jetë të bukur bashkë. Gëzuar!

I pari erdhi Timo. E solli Salla me Mitsubishin e saj, ia dorëzoi Samit dhe e porositi t'i telefononte për të nesërmen në mëngjes. E puthi dhe u nis. Timo hoqi çantën e shpinës dhe u ul. Dukej i ri, i hutuar dhe si budalla. I hapa një birrë. Ai u ul në diell dhe vështronte përreth me njëfarë dyshimi. Nuk ishte nga njerëzit që u pëlqen natyra.

Sami kishte ftuar njëzet vetë, por u mblodhëm vetëm shtatë. Disa telefonuan se nuk mund të vinin. Nga shoqëria e vjetër erdhi Tini dhe Laksonen. Në rini Tini ishte një futbollist premtues, shkolla nuk i jepej, por edhe si futbollist nuk shkëlqente. Tani punonte në një biznes

sigurimesh, ku falë babait, ishte ngritur mjaft lart, megjithëse kishte vetëm institute biznesi. Nuk e kisha parë prej vitesh, por Sami mbante lidhje me të. Tini dhe unë nuk ishim kushedi sesa miq, por m'u bë qejfi që i pashë fytyrën si i moshuar pas kaq vitesh dhe e krahasova me tiparet e njohura të djalërisë.

Laksonen ishte dobësuar. Rrinte pranë meje i kërrusur dhe flegmatik. Për shumë vite kishte studiuar fizikë, por s'e kishte përfunduar. Mora vesh që kishte përjetuar periudha depresioni, por nuk e dija, nëse punonte në këtë kohë dhe nuk desha ta pyesja. Për njëfarë kohe vinte shpesh në apartamentin tim dhe të Korpinenit. I pëlqente shoqëria.

Erdhën dhe dy kolegë të Samit. Njëri ishte një dyzvetvjeçar truplidhur, i cili i kishte sytë si të qenit. Menjëherë ndjeva antipati ndaj tij, por ai doli të ishte një tip i përzemërt. I dyti ishte më i ri, një individ i dobët, i cili kishte tuberkuloz në gjoks dhe dhëmbë të prishur. Nënqeshte pa pushim.

Samit dukej pak si i mërzitur. Ai ishte mësuar që me shoqërinë e vet të mblidheshin me qejf. Pak pas orës pesë telefonoi i vëllai dhe tha se nuk do të vijë. Sami u nxehtë dhe e vërviti telefonin tek barbekyja, pjesët e tij u shpërndanë nëpër tokë. Ai u largua në drejtim të pyllit. Për të tretën herë e shikoja të prishte telefonin. Nuk e di përse e bënte.

-Merre SIM kartën, palaço – i thirra unë nga mbrapa.

Timo filloi të mblidhte pjesët e telefonit.

-Lëri. Pas pak do të kthehet e do t'i mbledhë vetë. E kam parë këtë cirk edhe më parë.

Fola me Laksonenin, i cili kishte dëgjuar çfarë i kishte ndodhur Korpinenit. I tregova çfarë kisha parë, që atë mbrëmje unë isha në punë në universitet, dëgjova diçka në korridor, pashë një njeri me kapuç të zi që zbriste poshtë në korridor dhe vazhdova të punoja.

Më vonë, gjatë natës, e gjeta Jusin në kabinetin e tij, por, tashmë, ishte vonë për ta ndihmuar. Pas disa ditësh, kur ishte në gjendje të fliste, Jusi më tha se në kabinetin e tij kishte hyrë një djalë i ri, i cili i sollti ca dokumente. Tha që plaga nuk ishte diçka serioze se ai do ta marrë veten plotësisht.

Iu luta Lakonsenit të mos fliste para të tjerëve për këtë ngjarje. Ai pohoi me kokë, pastaj tundi kokën me sy të mbyllur dhe psherëtiu thellë. Vështrova figurën e tij të kërrusur dhe mendova se, pas pak, do të bjerë në gjunjë e do të bëjë kryq. Më vinte t'ia përkëdhelja flokët e ti.

Sami u kthye pas pesëmbëdhjetë minutash dhe mblodhi pjesët e telefonit të vet, i këqyri dhe i montoi.

-Në djall! i njëjti budalla jam edhe unë si ju.

Tini u përpoq ta shkarkojë atmosferën e zymtë.

-Epo mirë de, hajde tani të shohim çfarë do të bëjmë sonte. Ta ndezim saunën? Apo të thyejmë xhamat e bungalos?

i pritëm fjalët e tij me buzëqeshje të lodhura. U ulëm dhe po bisedonim pa qejf. Sami nxori sidiplayer-in në shkallë dhe vuri The Misfits. Dëgjoja zërin e Glen Dancig dhe fillova të mendoja se atmosfera këtu është disi artificiale dhe e tensionuar. E kuptova se nuk do të duroja deri të dielën, megjithëse e dija që Sami do të fyhej.

Nga gjendja e pakëndshme na shpëtuan një grup fëmijësh, që bënin potere para bungalos më të afërt. Dy prej tyre erdhën të na pyesin, nëse donim të luanim futboll me ta në breg. Njëri mbante topin nën sqetull. U ngritëm. Laksonen tha se do të qëndronte këtu, që të ngrohte saunën. Fytyrën e kishte të mbuluar me njolla të kuqe të çuditshme, që ngjanin me konturet e kontinentit në ndonjë hartë.

Ishin pesë djem rreth dhjetë vjeç. Shtrënguam duart me ta dhe thamë emrat secili. Vumë portat mbi rërë me degë dhe kutia boshe, u mbathëm dhe loja filloi. Timo rrinte mënjanë pranë stekave me birra dhe shikonte.

Djemtë ishin shumë të shkathtë dhe të etur për fitore. Shumë shpejt e kuptuan se Tini ishte lojtari, nga i cili duhet të ruhen. Ne të tjerët luanim pa entuziazëm, shpesh ngrinim nga një kanoçe me birrë, duke vështruar nga qiell, duke u mbështetur në dëshirën e tij për fitoren dhe shkathtësinë që i donim jo më pak se fëmijët.

Pas nja dhjetë minutash unë u mërzita, ika dhe u ula pranë Timos. Vesha këmishën dhe hapa një birrë. Pinim të dy dhe ndiqnim lojën. Në një moment u kthye nga unë dhe më tha:

-Më trego pak, si shkoi me ketaminën.

-Nuk pata sukses. Mos ma kërko më këtë. Përvoja e dytë më trembi.

-Më vjen keq.

-Kështu ishte. Në fillim funksionoi, por, shpejt, mbaroi ndikimi i saj.

Trokitëm gotat dhe heshtëm.

Dielli u fsheh prapa kreshtave mbi breg, u errësua, hijet u zgjatën, djemtë vraponin shpejt dhe me entuziazëm, duke bërëtitur me urdhra dhe këshilla. E vura kanoçen e birrës në tokë dhe pata dëshirë që, pas shumë vitesh, ata të kujtonin rërën nën këmbë, burrat e mëdhenj, kundër të cilëve kishin luajtur dhe dëshirën e tyre të sinqertë për fitore.

Të shtatë u futëm në sauna, e cila ishte elektrike, pa shpirt, por, gjithsesi, vërtet e ngrohur mirë. Pas lojës biseda rrodhi më lirshëm. U ula pranë Samit, i cili derdhte ujë mbi gurët.

Biseduam për pornografinë. Kolegu i Samit me sy qeni u shpreh se, kohët e fundit, po bën luftë kundër varësisë nga porno në internet.

-Shikoja vazhdimisht – çdo natë, në mëngjes para punës dhe, më e keqja, në kohën e ngrënies.

-Dhe?

-E ndjeva, kur fillova të vija ré gjëra të njohura shqetësuese.

-Çfarë?

-I njihja artistet, para se t'u shikoja fytyrat nga shenjat e tyre karakteristike. Duke parë vulvën e fryrë rozë dhe kofshët e forta, të bukura, e kuptoja që ishin të Silvia Santit. Nga goja e ftohtë e lagësht e turpshme që i ngjante fluturës së natës, njihja Krisi Moranin.

-Atë shiko ti.

-Nga pamjet e njohura jam lodhur. Mendoja se po të më tregonin vulvën e bashkëshortes sime, do ta njihja që është ajo. Jam i detyruar ta pranoj që jo. E ndieja se diçka tek unë ishte deformuar, se diçka nuk është në rregull.

-Po pastaj, çfarë?

-Kupa u mbush, kur një herë para se të shfaqej pamja, u dëgjua një zë gruaje. E përfytyrova që është e Vaanesa Blu.

-Po penisët? A mendon se, duke i parë ata, ti mund të njohësh aktorin, gjithsesi edhe ata janë në qendër të pamjes.

-Për ta s'mund të them asgjë.

-Gënjen. Ti je homofob. Unë prej tyre i njoh. Një herë pashë si Peter Hort u zbraz dhe kurrë s'kam për të harruar.

-Kalamaj, hajde ta ndërpresim këtë bisedë dhe të shkojmë të notojmë.

17

Pas saunës, dola për të shëtitur.

Ishte natë vjeshte, deti nuk dukej. Dritaret e dy bungalove ndriçonin, por, pas pak, u fikën. Njëfarë figure dukej në dritat e verdha të barit. Me peshqirin e lidhur në mes, u ula në një tavolinë, mbusha një gotë me vodkë dhe ndjeva se po më gëlojnë në kokë mendime paranojake, të cilat, radhë, i shkaktonte brenda meje alkooli. Po prisja me durim që të më kalojnë.

U vesha dhe vura rë se belbëzoja. Të tjerët bisedonin pranë skarës. Laksonen flinte një një shezlong. Nuk i kishte më njollat në fytyrë. Me kolegun e Samit, e çuam brenda dhe e mbuluam me batanije.

Që prapa qoshes së bungalos u afrua me nxitim një burrë i veshur me pizhame dhe ndaloi pranë nesh.

-Hej! – thirri ai.

Ishte burri nga çifti i heshtur, por pa syze. Mendova se ka mësuar të flasë dhe ka ardhur të më kthente përsëhendetjen që u bëra më parë atyre. Për pak kohë foli shumë, me zë të vuajtur.

Gruaja e tij ishte sëmurë dhe asnjëri s'mund të flinte. Edhe fqinjët e tjerë në bungalo u ankuan – kishin një fëmijë të vogël. Kemi bërë shumë zhurmë.

U ngrita dhe iu afrova.

-O njeri i mirë, ma kthe gruan time. Kujdesu për të, fol me të. Ajo duket shumë e vetmuar.

Sami me kapi nga supet, më tërhoqi dhe më detyroi të ulem.

Qëndrova ashtu disa sekonda.

-Na falni, e kuptojmë, nuk do të bëjmë zhurmë më. Nuk e kishim vënë ré sa ishte ora dhe se këtu dëgjohet gjithçka, edhe larg.

-Çfarë është ajo armë? Çfarë bëni me të?

Ai e drejtoi nga unë. Ngrita dorën nga tavolina. Sami i kapi dhe e shtypi nga vetja.

-Është pistoletë lodër, që gjuan me topa. Pak më parë, po gjuanim me të kutitë boshe.

Prapë zgjata dorën. Sami ma kapi dorën dhe e shtrëngoi. Kockat më kërcitën. Burri mbeti i kënaqur nga tingujt dhe u kthye në bungalon e tij. Piva një gllënjë vodkë dhe, përsëri, më pushtoi ajo gjendja e lodhjes.

Që nga sauna erdhi burri i dytë me një fener në dorë. Ishte i qetë dhe, me sa dukej, ai ishte pronari i motelit.

-Djema, ka ankesa nga dy bungalo. Nëse nuk mund të rrini të qetë, duhet të ikni që këtej. Në rast të kundërt, do të thërras policinë. Kjo sa për ta ditur.

-E kuptuam.

E ulëm muzikën. Burri u largua. Vështruam njëri-tjetrin. Ishte pak pas mesnate dhe hymë tek bari. Kolegu i Samit donte të na qeraste. Nga prapa banakut të barit erdhi biondja, e cila i kishte marrë paratë Samit dhe i kishte dhënë çelësat e bungalos. Ishte veshur me një pulovër të zezë, të shtrënguar pas trupit. Ajo solli në tavolinë gotat e pijes njëpërdorimshme.

Nuk e kam idenë sa kemi qëndruar aty, deti ishte i errët, u mbështeta mbrapa në karrige, vështroja tendën me shirita dhe dëgjoja bisedat, herë pas here edhe zhurmën e valëve. Vajza ishte ulur në tavolinën ngjitur dhe pinte cigare. Flisnim, por ajo na e tërhiqte vëmendjen. Timo u ngrit dhe shkoi në bungalo. E kuptoja drejt atë, ishte akoma i ri dhe kishte Sallën.

Vajza u kthye në banak dhe po dëgjonte radion. Kolegu i Samit shkoi tek ajo dhe foli me të goxha gjatë. Mendova se u miqësua me të. Tek ne erdhi pronari i motelit, i cili na trembi me policinë. U ul në tavolinën tonë me puron në dorë dhe na pyeti miqësisht kush ishim

ne, nga ishim dhe çfarë bënim.

Vajza tha se do ta mbyllë barin, por na la të hidhnim dhe nga një gotë. E ftuam të vinte tek ne. Në fillim nuk pranoi, por, pak më vonë iu mbush mendja dhe u ul me gotë në dorë para bungalos. E lashë pijen dhe fola me të. Ajo fliste me shumë dhe me gjallëri dhe lëizte shumë në karrige.

Kolegu i Samit u kollit, kërceu në këmbë, u mbështet tek mëshstekna dhe hyri në bungalo. Që andej doli Laksonen dhe u ul me ne. Flokët i ngriheshin përpjetë nga të gjitha anët? Ai kurrë nuk u kishte kushtuar vëmendje vogëlsirave të tilla. Nuk ishte i bukur, as karizmatik dhe nuk i ecte me femrat. Ato me shqisën e gjashtë, nga flokët e një burri e kuptonin a do të ishte i mirë dhe i dashur me to. Në vështrim të parë, kjo nuk është e mundur, por çdo feminist e di këtë.

Laksonen u afrua me vajzën dhe atë mbrëmje ai ishte shumë më gazmor se zakonisht. Gjumi e kishte gjallëruar dhe ai thoshte gjëra të zgjuara e bënte shaka, por unë shikoja vajzën pranë tij, e cila kishte përveshur mëngët e pulovrit dhe pinte duhan. Një atlete e saj pushonte mbi dërrasën kryq në pjesën e poshtme të tavolinës. Fillova ta kuptoja çfarë zoge është. Do të kthehej në një grua, e cila do të mashtrojë çdo burrë dhe do ta bënte këtë, sikur nuk donte. Thjesht e dija që kështu do të bëhet. Ndoshta e ndjeva nga aroma që rrezatonte prej saj, kur u përkula t'i mbushja gotën e verës ose nga shqetësimi i saj i dukshëm.

U zhveshëm dhe shkuam në sauna. Nga dritarja e ngushtë unë pashë si e hoqi pulovrin, nën të cilën nuk kishte sutjena. Hoqi xhinset dhe mbathjet e bardha, i la në karrige, ngjiti shkallët, hapi derën dhe erdhi tek ne. Ishim me Samin dhe Laksonenin.

Ai tregoi diçka që më bëri të mendoj e të shqetësohem. Tha që kishte parë një klip, që tregonte një bombë të hedhur nga sateliti që kishte shpuar çatinë e një ndërtese banimi plot njerëz dhe shtëpia ishte përfshirë nga një det zjarri.

Tha që ka menduar për këtë vazhdimisht: ndërsa lante dhëmbët në banjë, ndërsa në kuzhinë lante pjatat e pista. Çdo gjë që është e njohur, zhduket papritur, kur algoritmet e sakta drejtojnë nga lartësitë pothuaj një ton metal, lëndë shpërthyesë dhe elektronikë dhe e gjithë

kjo shpon çatinë dhe vama shpërthyesë merr gjithçka ka brenda, temperatura nga një mijë gradë verbon e përvëlon mishin e njerëzve, copat metalike dhe pjesët nga çatia depërtojnë në trupa dhe, pastaj, shkëlqimi verbues kthehet në errësirë. Fliste me hollësi, sikur e kishte përjetuar personalisht.

E ndjeva që po bëhesha esëll dhe më zuri frika për të, sepse këto ishin të njohura për mua. E ndërpreva dhe e pyeta:

-Përse do që të vdesësh?

Ai m'i nguli sytë.

-Mos mendo për gjëra të tilla – i thashë unë. – Nuk është mirë për ty.

Ai fërkoj fytyrën.

-Unë nuk dëshiroj të vdes – tha Laksonen.

-A do që ta di edhe unë përse.

-Niklas, mjaft - urdhëroi Sami.

Kishte të drejtë. Vajza ishte e re, naive dhe lahej lakuriq me ne në sauna.

-Epo mirë de, askush nuk dëshiron të vdesë – thashë unë dhe e përqafova Laksonin e brengosur.

Pastaj, të tre, të pirë e të kënaqur ecëm drejt bregut, hymë në ujin e ngrohtë, notuam, u zhytëm dhe luajtëm duke spërkatur njëri-tjetrin. Pastaj, unë dhe Sami u ulëm në buzë të molit, futëm këmbët deri në gjunjë në ujë, ndërsa na bëri nga një çaj duke buzëqeshur.

-Mjaft e kam kaq – tha Sami, u nis nga bregu dhe u zhduk në errësirë, ku e priste Koh Samui. Qesha me vete.

-Po ti do akoma? – pyeti vajza dhe u ngjesh pas meje.

E vështrova në sy. U përkula, e kapa nga qafa, e shtrëngova fytyrën e saj midis këmbëve dhe ajo e futi organin tim në gojën e saj të ngrohtë.

Më parë, në kohë të vjetra, kishte një periudhë që unë shqetësohesha natën për Inën. Atëherë ajo dilte vetëm në mbrëmje ose me shokët dhe nuk e dëshironte shoqërinë time. Nuk ishte vështirë të kuptoja përse vepronte kështu, i ndieja shkaqet.

Kisha frikë për të, kisha frikë edhe për vete. Nganjëherë dilja dhe kështu e kisha më të lehtë. Po të rrija në shtëpi, nuk mundesha të flija, rrotullohesha në krevat dhe më pushtonin mendime të trishta.

Rrija shtrirë në krevat, vështroja në errësirë dhe mendoja si do të ndihesha, nëse ajo zhduket nga jeta ime. Do të më marrë malli për gjithçka me të cilën isha mësuar, qëkur kemi qenë bashkë – tingujt në kuzhinë në mëngjes, momentet pas ndonjë feste, kur mysafirët, tashmë, kishin ikur dhe jashtë afrohej agimi. Atëherë ne përqafoheshim në karrigen lëkundëse, të lodhur e të kënaqur, flisnim për miqtë tanë dhe problemet e tyre. Do të më mungojnë çarçafët e pastër të palosur gjë që unë vetë nuk e bëja dot.

Kur, në mëngjes, e ndieja të hynte në shtëpi, të lëvizte në korridor dhe pastaj në kuzhinë, e dëshiroja me gjithë shpirt ashtu siç është. Ajo hynte në dhomë të gjumit si hije e errët, zhvishej gjatë dhe unë nuk bëja fare sikur flija. Tërhiqja batanijen, dëgjoja si zhvishet, duke zberthyer kopsat dhe duke tërhequr zinxhirët dhe prisja. Doja ta ndieja rëndesën e saj mbi mua, prekjen e lëkurës së saj.

Kishte edhe net, në të cilat ajo nuk kthehej, por nuk dua të mendoj për këtë. Megjithëse kishte kohë që s’ mendoja për këtë.

Marrëdhëniet e një çifti kurrsesi nuk janë thjesht diçka. Më vjen të besoj se, me kohë, me rritjen e nivelit të pjekurisë dhe të ekuilibrit, frika zbehet. Nuk e di, nëse zhduken ndonjëherë plotësisht. Ndoshta vetëm nëse vjen ndarja. Nganjëherë mendoja për këtë duke parë në rrugë një çift të moshuar që shëtisnin. Akoma s’kanë besim tek njëri-tjetri? Akoma përgojnë njëri-tjetrin? Nuk e them dot.

Me vajzën, gjithsesi, përfunduam bashkë në mol. Kishte zbardhur dita, qielli shkëlqente, në të fluturonin pulëbardhat duke krakëllitur. U ulën në anë të molit, përballë njëri-tjetrit dhe putheshim.

Pastaj ajo hoqi xhinset dhe unë fillova të bëja dashuri me të, duke dëgjuar vallen e valëve poshtë nesh. Vajza më kapi për flokësh, ma ngriti kokën më vështroi në sy dhe m’u lut ta forcoja tempin gjë që unë e bëra menjëherë. Shikoja irisët blu të syve të saj, kur ajo bërtiti fort dhe egërsisht.

Pastaj veshi pantallonat dhe pulovrin, u ul në gjunjët e mi dhe u

struk në gjoksin tim. Ishte e lehtë. Diku u dëgjua zhurma e motorit të një makine, oborret para bungalove, të cilët dukeshin nga porti ishin bosh, bregu gjithashtu. E përkëdhela në qafë dhe ndjeva që shpatullat po i dridheshin. Ndoshta ajo kishte ftohtë.

E pyeta a kishte frikë se pronari i motelit mund të shikonte në atë pozicion, por ajo u përgjigj se kjo, tashmë, nuk i interesonte. Kontrata e saj ishte deri në fund të gushtit. E pyeta çfarë do të bënte pastaj dhe ajo tha se nuk e dinte.

E mbështeti ballin e saj tek i imi, më preku me gisht buzët dhe më pyeti, nëse kisha ndonjë të dashur.

Iu përgjigja se kam.

-Si është?

U mendova.

Ktheva kokën dhe vështrova nga deti. Qëndrova gjatë kështu. Ajo tha që, përderisa nuk guxoja ta shikoja në sy, do të mbetemi përgjithmonë të huaj.

E vështrova dhe pashë që, me të vërtetë është e huaj për mua, megjithëse ishte në krahët e mi. Pas kësaj e kuptova qartë se e kam humbur Inën, por ky mendim nuk më shqetësoi. E dija që do të më duhej ta përballoja atë provë.

E lëshova me kujdes vajzën. U ngrita dhe i thashë se do të iki.

Ajo, gjithashtu, u ngrit dhe tha se do të shkonte në bungalon e saj e do të flinte, sikur nuk kishte nevojë për asgjë tjetër, përveç gjumit. Shkuam në breg, u përqaftuam, e vështruam njëri-tjetrin, buzëqeshëm dhe u ndamë. Atë mëngjes kuptova se parapëlqejta pikërisht të tilla marrëdhënie.

U ngjita rrugës lart. Oborri i bungalos ishte plot me kuti, shishe dhe gjithfarë plehrash të tjera. Ngjita shkallët, hapa derën dhe hyra në errësirë. Ndjeva gërhitje. U ngjita në katin e dytë, shkova në cepin më të largët të tij, sa më larg gërhitjes. Ndërtesa ishte e ulët, me çati të pjerrët. U ula në një krevat, mbi të cilin s'kishte as batanije, as jastëk. Hoqa xhakëtën, u shtriva në shpinë, u mbështolla me të dhe futa krahët në mëngë.

Kur u zgjova dielli ndriçonte perden kuq e bardhë në dritare. Kujtova ngjarjet nga nata e kaluar. Poshtë dikush flinte akoma. Nga jashtë po flisnin dhe ai njohu zërin e Laksonenit. U ngrita dhe zbrita poshtë. Fillova të gjeja bagazhin tim, por pastaj u mendova.

Në tavolinën jashtë ishte ulur Laksonen dhe ai me sy qeni. Kishin filluar të pinin dhe ishin me humor të mirë. U afrova pranë tyre, por nuk u ula. Ata heshtën dhe më hodhën një vështrim pyetës. U thashë se do shkoj në qytet, u ktheva, i përshëndeta me dorë dhe u nisa rrugës poshtë. Ecja me kokë ulur dhe mendoja çfarë do të thosha, nëse në tavolinë do të ishte ulur Korpinen. Në recepsion ishte një djalë flokëzi me syze. Iu luta të më thërriste një taksì. Ai ngriti receptorin e telefonit fiks. Ndërsa formonte numrin po mendoja a duhej t’i jepja bakshish, por ai zgjidhi dilemën duke thënë se taksia po vinte, më falënderoi dhe foli me dikë nga brenda lokalit.

Dola në parking, kalova pranë audit të Samos dhe kalova nga porta e motelit, nga e cila fillonte rruga ranore. U ula në një cep midis barit që valëzonte. Dielli ngrohte dhe pranë meje zukatnin insektet.

Nxora telefonin nga xhepi dhe i telefonova Inës. Ajo u përgjigj menjëherë me një zë të gjallëruar. Ishte në shtëpi dhe po rregullonte bagazhin e saj. I thashë ku jam, se po pres taksinë dhe do të nisem. Heshta për një çast, pastaj e pyeta nëse dëshiron të më takojë. “Po” m’u përgjigj, sikur kjo të ishte gjëja më e natyrshme. Folëm akoma edhe pak dhe unë u përpoqa të kuptoja nëse ishte e zemëruar ose indiferente.

Atëherë dëgjova diçka, ktheva kokën dhe pashë që nga kthesa u shfaqën dy kuaj ngjyrë kafë. Ecnin ngadalë njëri pas tjetrit. Kalëronin dy vajza me kilota, çizme të zeza dhe xhaketa të mbërthyera deri lart.

E mbylla telefonin dhe, nga sytë e kafshëve që afroreshin, kuptova se më kishin parë. Sigurisht, i ulur në tokë, u dukeshin i vogël. Ata u afruan dhe unë dallova qartë lëvizjet e muskujve të tyre, në diell u dukeshin venat, dëgjoja hapat e tyre të rëndë në rrugë dhe shikoja si

trupat e vajzave lëvizin me ritmin e lëvizjes së kafshëve.

Kurrë s'kisha qenë afër kafshëve kaq të mëdha. Mendova çfarë do të ndodhë, nëse unë do të kërceja dhe do të bërtisja. Më në fund mendova, nëse vajza e motelit kishte hipur ndonjëherë në kalë. Kafshët u larguan qetësisht.

Prita gjatë taksinë duke vështruar nga rruga, nëpër të cilën u larguan kuajt dhe, ku patkonjtë e tyre kishin lënë gjurmë. Mora një gur të vogël dhe fillova ta rrotulloj me gisht. Ngjante si një kokërr bizele e rrafshët. Në gojë ndjeva një shije të keqe. Teksa e thithja, pashë në rrugë, tek ngrinte pluhur, një makinë të bardhë. Para se të ndalonte, ktheva kokën dhe pështyva gurin në bar.

19

Ky që udhëtimi im më i keq me taksi. Kisha pasur edhe të tjera të këqija, por kaq të tmerrshëm sa ky – jo. Rrija në ndenjësën e pasme. Goja më ishte tharë. Megjithëse isha larë në sauna, e ndieja lëkurën të pistë.

E ngiste makinën një grua rrumbullake, bionde, afërsisht në moshën time. Ishte njeri i mirë, por afërsia e saj dhe çka tregonte më bënë të ndihem keq. Udhëtonim përmes pyjesh dhe fushash drejt qytetit tim të lindjes. Makina ishte e re dhe e pastër, shoferja e ngiste me mjeshtëri, murmuriste, megjithatë mua më dukej sikur do hapej dera dhe një dorë e padukshme dhe do të më qëllonte në tëmth dhe të fshinte nga vetëdija ime ato peizazhe dhe të gjitha gjepurat e tjera.

Dielli ngrohte përmes xhamit të pasmë dhe më digjte qafën. Mbylla sytë. Në radio jepej kënga e Jari Silanpës. Shoferja e ngriti zërin. Tha diçka për këngëtarin – kishte ndjekur tridhjetë e pesë koncerte të tij, i fundit ishte para dy javësh. Për të ai ishte këngëtar i më i madh finlandez. Kari Bensa, gjithashtu, ishte i mirë, por nuk mund të krahasohej me Jarin. Rashë dakord me të dhe i thashë se nënës sime i pëlqente shumë. Ajo tha se Jari ishte shumë karizmatik dhe kjo është dhunti nga natyra, e cila haset rrallë. Ai as nuk ka studiuar, as

nuk është stërvitur – thjesht e ka të lindur. Në koncertet e tij të gjithë të pranishmit e ndiejnë që Jari këndon pikërisht për ta. Miratova me kokë sa më arritën forcat, pastaj u përkula përpara.

-Hesht të lutem. Nuk duroj dot më – thashë unë me sa mirësjellje munda.

Arritëm në Turku në qetësi. Nëse nuk do ta kisha pështyrë atë guralecin, udhëtimi do të kishte qenë, për të dy ne, shumë më i këndshëm. I dhashë një bakshish të madh dhe i kërkova falje për sjelljen time të ashpër. Shoferja ishte e sjellshme, tha se, edhe herë të tjera, kishte parë burra të lodhur, e kuptonte se s’kisha asgjë personale me të dhe më uroi gjithë të mirat.

20

Hyra brenda, ngjita shkallët dhe dëgjoja vetëm hapat e mi.

Në tavolinën e vogël në korridor, ishte një protezë e çuditshme dore e veshur me dorezë lëkure. Zbatha këpucët, hyra në dhomën e ndenjjes dhe ngriva në vend. Shtëpia ishte e ndriçuar. Ina qëndronte në mes me sytë e ftohtë. Hapi rrobat para meje dhe më tha me zë të qetë:

-Vërju punës tani.

21

Ina rrinte në karrige me shpinë të drejtuar dhe shikonte në qoshe të dhomës, ku ishte vendosur një bimë e lartë, e gjelbër. Mjeku qëndronte para dritares dhe vështronte jashtë. Në qiell ngrohte dielli dhe retë notonin ngadalë.

INA : Fol hapur, pa mëdyshje. Dua të vërtetën.

Ina vështron doktorin – ai mua. Pastaj kthehet dhe ul perden. Në dhomë bëhet errësirë dhe ai ndez dritën.

MJEKU: Ndoshta nuk të duhet e gjitha.

INA: Nuk kam frikë.

MJEKU: Për çfarë bëhet fjalë?

INA: Çfarë seminari filozofik është ky?

MJEKU: Dhimbja të mëson.

Ai nxjerr nga xhepi një tub të bardhë me spërkatës. Heq kapakun dhe spërkat tri herë, pastaj ia tregon gruas së re.

MJEKU: Ky është i tretur në alkool anetol. Farërat e anasonit futen në vodkë një javë, tretja përzihet dhe pihet në shoqëri të mirë. Është një mrekulli!

INA: Hajde të dalim në temë.

Ai e merr flakonin, përvesh mëngët e xhaketës dhe qëndron para saj.

MJEKU: Drejtohu, nëse do.

Ajo drejtohet dhe doktori i prek nyjet limfatike në fyt.

MJEKU: Çfarë bën gjyshi yt, partizani i vjetër?

INA: Është i paparë. Kam marrë me vete protezën e tij.

MJEKU: Një i tillë mund të jetë edhe i rrezikshëm për të afërmit e tij.

INA: Të tillë nuk ka.

MJEKU: Të ka ty.

INA: Ai gjithmonë më ka dëgjuar mua.

Doktori e hoqi dorën dhe u afrua tek dritarja. Tërhoqi perden dhe vështron qiellin, në të cilin notojnë ré të bardha.

MJEKU: Problemi nuk qëndron tek gjëndrat limfatike.

INA: Dhe?

Ai hesht, duke vështruar retë.

MJEKU: Nuk e di, gjithçka mund të jetë. Problem endokrin. Zhvishu, po të duash.

Ajo ngrihet, zhvesh bluzën, e palos dhe e vë në karrige. Pastaj zbërthen sutjenat, heq fundin dhe e hedh në mbështetësen e karriges? Heq edhe mbathjet dhe del lakuriq.

MJEKU: Ré në formë veshkash. Qielli na jep një shenjë.

Ai ul perden.

MJEKU : Ulu në karrigen e madhe.

Ina shkon dhe ulet.

MJEKU : Tërhiq pak më poshtë, këmbët këtu dhe këtu. Qëndro kështu.

INA : M’i mbaj këmbët.

MJEKU: Nuk do të jesh rehat.

INA: Përndryshe do të lodhen.

Ai merr nga tavolina e punës dy rripa lëkure dhe ia lidh. Pastaj vë dorezat latekse. Njëra i krijon vështirësi. Pastaj fillon vizita gjinekologjike.

MJEKU: Çfarë rëndësie kanë për ty Jari Silanpaa dhe Kari Bensa?

INA: Nuk mund të të përgjigjem.

Doktori shkon tek tavolina e vet, merr një spatul metalike dhe vazhdon vizitën.

INA: Të kujtohet, kur erdha për herë të parë tek ti?

MJEKU: Jo.

INA: Mund të ta tregoj.

-Tregoma.

INA: Erdha këtu e sëmurë dhe thashë: “Në familjen time kemi një rast të rëndë, për vdekje. Kam nevojë për ndihmë.”

MJEKU: Vërtet kështu the?

INA: Po. Ishte natë dhe unë isha e tmerruar.

MJEKU: Nuk e mbaj mend.

INA: Ti ishe i gatshëm dhe i mrekullueshëm.

MJEKU: Natën gjërat janë më ndryshe. Të kujtohen dorashkat e nënës?

INA: Natyrisht.

Pas pak doktori i thotë se duhet të bëjë analizat diku tjetër, lë spatulën dhe ia zgjidh kyçet asaj. Hesht. Zëri i Inës tregon nervozizëm.

INA: Të bëj akoma analiza.

MJEKU: Jo.

INA: Po çfarë?

MJEKU: Jo.

INA: Po pse?

MJEKU: Nuk mundem. Unë e kisha deri këtu.

PJESA E KATËRT

ADUARI

Llamba në korridorin e hotelit vezullonte, ndriçonte dhe fikej. Qeni ngjyrë gri i afrohen psikoterapistes Rejçëll Fejërçajlld. Ajo s'ka frikë prej tyre dhe zgjat dorën. Më në fund, tërhiqet, hyn në dhomën, në të cilën Nikolas kishte sjellë Lejlën dhe mbyll derën.

Vajza ishte shtrirë në krevat. Nikolas ishte përkulur mbi të dhe po e këqyrte. Vajza qeshte e papërmbajtur dhe rrotullohej nën batanije.

Rejçëll vështron dhomën dhe e kupton çfarë ka ndodhur.

Dera e minibarit ishte e hapur. Në dysheme ishin hedhur shishe të vogla vodka, uiski dhe xhini. Mbi televizor ngriheshin dy kanoçe birre të hapura dhe një shishe vere e bardhë në gjysmë. Televizori jepte një film pornografik. Një çift me trupa të bukur ishin bërë njësh mbi një divan me lëkurë të bardhë.

Nga dritarja dukej deti i kaltër. Nga dhoma dukeshin zogji të mëdhenj, të cilët përplaseshin në xhamat e dritares dhe bënin zhurmë të madhe. Rejçëll, e lodhur, fiku televizorin.

-Asgjë interesante – tha Nikolas, duke nuhatur frymën e Lejlës.
– Diagnoza është shumë e thjeshtë - Lejla ka pirë dhe është bërë tapë.

Vajza pushoi së rrotulluari nën batanije dhe tani shikonte Nikolasin në sy. Me një dorë u kap tek flokët e tij, kurse me gishtat e tjetrës, preku buzët dhe mjekrën e tij.

-Asgjë nuk është e çuditshme, pasi gjithçka nga minibari është pirë, përveç lëngut të portokallit dhe ujit mineral.

Nikolas u përkul mbi vajzën dhe e shikonte i shqetësuar. Dhe atëherë ai bëri diçka marramendëse: ngriti lart fundin e saj të gjatë deri në kyçe dhe ia ngriti këmbën. Rejçëll e pa që ishte pa mbathje.

Nikolas, i shokuar, u drejtua.

“Kështu” – mendoi Rejçëll. “Kuçka e vogël shiite tregon moralin e saj.”

Në qiellin e natës gumëzhinte një helikopter. Rejçëll e dëgjonte.

Nikolas ia uli fundin vajzës. Lejla u zgërdhi, përkëdheli me duar gjinjtë e saj, nxori gjuhën jashtë duke vështuar Nikolasin dhe lëpiu buzët. Pastaj bërtiti fort, ngriti përsëri fundin, hapi shalët dhe vuri gishtin në vete.

Nikolas u kthye nga Rejçëll i shastisur.

-E pabesueshme – tha ai. – sociologët këtë e quajnë asimilim. Lejla gjendet në Londër vetëm prej njëzet e katër orësh, por, tashmë, përcepton vlerat dhe moralin perëndimor.

Rejçëll e vështroi – ai u skuq... Hapi krahët dhe rënkoj i dërmuar:

-Emancipimi! Çfarë do t’i them xhaxhait të Alit?

Atëherë Rejçëll e pa mirë. Pantallonat e burrit ishin fryrë dukshëm përpara. Ajo u kthye mënjanë dhe i tha me zë të ulët:

-Nikolas, ti më theve zemrën mua. E parandjeva se do të ndodhte kështu. Gjithçka ishte tepër e bukur për të qenë e vërtetë. Tepër e bukur. Një lumturi e tillë nuk është për vajza si unë.

-Rejçëll, mos dysho në ndjenjat e mia.

-I pashë ndjenjat e tua.

-Ky është reagim primitiv, i cili kalon dhe kaloi.

-Nuk është e nevojshme t’i fshehësh dëshirat e tua. Ke të drejtë të bësh çfarë të duash dhe askush s’do të të pengojë.

-Të dua ty, Rejçëll.

-Edhe unë të dua, Nikolas.

Ai, tashmë, i kishte ulur pantallonat deri tek gjunjët, hodhi tej këpucët, tërhoqi nyjen e kollaros dhe e nxori nga koka këmishën,

i pushtuar nga një eksitimi i fortë. Pas dy sekondash ishte lakuriq.

Në fillim Rejçëll mendoi se ai kishte vënë protezë. Organi i tij dukej tepër i madh për të qenë i natyrshëm. Ishte i trashë, i gjatë me vena të fryra.

Nikolas u hodh në krevat dhe penetroi në vulvën Lejlës, e cila ngriti këmbët e hijshme, mbështolli me to vithet e mjeshtrit mahnitës të protezave dhe ulëriti. Rejçëll vështronte si e goditur. Vajti dhe u ul në krevat.

I përkëdhelte mollaqet burrit pompues, testikujt e tij dhe mendonte se të tre ata mund të jetojnë në harmoni dhe mirëkuptim reciprok.

Atëherë ndjeu zhurmë nga mbrapa.

Ali qëndronte dy metra larg krevatit dhe shikonte me një fizionomi të vuajtur. Dera midis dy dhomave të hotelit ishte e hapur. Pantallonat e pizhameve të tij të bardha ishin të ulur deri në gjunjë.

Rejçëll përsëri ndjeu gumëzhimën e helikopterit, e cila përzihej me gulçimin e Nikolasit.

-Ali, ti duhej të ishe në krevat për të fjetur – i tha Rejçëll.

Djali u përpoq të ngrinte pizhamet, por protezat e tij të reja nuk iu bindën dhe ai shikonte me një shprehje fytyre të sflitur. Zemra e Rejçëllit u tkurr nga keqardhja.

-Hajde të të ndihmoj – i tha ajo.

Por nuk arriti, sepse dhoma u mbush me qenie kaltëroshe, të cilat u afruan tek krevati. Tiparet e grave, të burrave dhe fëmijëve ishin të sfumuar, sikur përreth tyre të dridhej mjegullima.

Rejçëll mendoi se ëndërronte. Atëherë ndjeu zhurmë, çatia u hap dhe brenda vërshoi era dhe errësira. Shpërtheu një dritë e qartë dhe ajo pa se si në atë ndriçim u ngrit trupi lakuriq i Nikolasit.

Këtu mbaroi dhe vegimi.

Petri priste Ninën në qendrën tregtare. Para vitrinës së dyqanit për veshje, dy vajza luanin në violinë. Në një skenë rridhte njëfarë shfaqjeje. Publiku përbëhej nga njerëz të të gjitha moshave. Deri në Krishtlindje mbeteshin katër ditë dhe njerëzit e veshur ngrohtë mbanin në duar pako me dhurata.

Petri do t'u bënte dhuratë dy vetëve – Sejllos dhe Ninës. Në telefon i kishte treguar mikut të vet për vajzën, përndryshe –dy muaj nuk e kishte takuar e nuk kishte shkuar në restorantin e tij. Shkonte në punë dhe, në kohën e lirë, Nina ia shteronte forcat.

Nina i doli përpara me një kapele të bardhë leshi dhe dorashka të kuqe. I kishte faqet të skuqura nga të ftohtit. Vajza erdhi, e puthi dhe ia futi gjuhën në gojë, siç bënte zakonisht. Petri u eksitua.

Ajo nxori nga xhepi një listë dhe i tha se duhej të shkonin në Tijmari, që të blejë ca gjëra. Ishte një vajzë e gjatë me flokë ngjyrë lajthie, së cilës i pëlqente rregulli. Petri e kalonte këndshëm me të. Para se të niseshin për në Tijmar ajo donte të shikonte shfaqjen dhe u përziën me publikun. Në skenë luanin dy qenie përrallash me këmbë e duar ngjyrë portokalli. Njëra ishte e bardhë me një sy të zi, tjetra ishte e zezë me sy bardhë. Qëndronin në dy skajet e skenës dhe vështronin. Ia kishin ngulur sytë njëra-tjetrës, rrëshqitën e ranë në dysheme.

E ndoqën shfaqjen një copë herë, pastaj u mërzitën, sepse nuk ndodhte asgjë interesante. Dy kukullat rrëshqisnin, rrëzoheshin, ngriheshin dhe gjithçka përsëritej nga e para. Petri të gjithë këtë e quante budallallëk, por fëmijët qeshnin. “Ndoshta gjejnë ndonjë kuptim në të” – mendoi ai.

U nisën të dy të zënë për dore. Ereksioni i Petrit akoma s'kishte rënë. Nina me siguri, gjithashtu, ishte e lagësht. Ai e dinte çfarë do të ndodhte dhe e priste. Në shtëpi do të zhvisheshin, do bënin dashuri, do të rrinin shtrirë të sflitur pranë njëri-tjetrit, me frymëmarrje të shpeshtuar, pastaj do të bisedonin e do të qeshnin si të çmendur. Por, fillimisht, duhej të shkonin në Tijmar.

Vendi është zyra. Suvi është njëzet e një vjeçe.

Ishte dhjetor - bora, më në fund, mbuloi çdo gjë.

Suvi është ulur para kompjuterit dhe u përgjigjet thirrjeve telefonike.

Suvi njëzet e një vjeçe mendon për dimrin me kufjet në veshë, flet në telefon dhe shkruan njoftimet, të cilat, në ditë të mira, arrijnë deri në dyqind.

Puna e kishte mësuar të kuptonte, kur njerëzit i shesin gjërat e tyre nga nevoja – i dallonte nga intonacioni dhe nga shpjegimet.

Një grua nga Espo dëshiron të shesë një serë lulesh. I thotë Suvit se do ta shesë me leverdi. Suvi, tashmë, e shikon veten të ulur midis trëndafilave, kaktuseve dhe zambakëve.

Ditë dhjetori herët. Zyra akoma është e qetë. Suvi hap kutinë e postës në katin e parë. Djemtë e paketimit që pinë cigare në oborr, hynë brenda të mbuluar me flokë bore.

Suvi hap një zarf të ri, në të cilin ka një fletë me një tekst dhe një foto. Njoftimi është i shkurtër.

“Një doktor kërkon një paciente të re, për të cilën të kujdeset nga ana mjekësore.”

Nën tekst ishte shënuar adresa e kutisë postare.

Në foton e bërë me kamera dixhitale, një burrë shpatullgjerë flokëzi, i veshur me përparëse mjeku të zbërthyer shikonte objektivin. Në fytyrë kishte një maskë mbrojtëse, ndërsa në duar doreza lateksi. Ai ishte vetëm në një dhomë pak të ndriçuar. Prapa tij, në mur, dukej një tablo, në të cilën është pikturuar diçka që shpërthen në qiell. Doktorin i keq duket si i sëmurë.

Suvi e këqyr foton me vëmendje. Në qoshe faksi fillon të japë sinjal. Suvi tërheq karrigen dhe vështron. Shikon një kishë të gurtë, e fotografuar në kalendar muri. Përmes derës prej xhami shikon djemtë e paketimit të përkulur mbi tavolinën e punës. E hedh njoftimin dhe foton në koshin e plehrave. E rrotullon karrigen dhe

vështron jashtë, ku bora vazhdon të bjerë.

Përkulet dhe nxjerr nga koshi njoftimin dhe fotografinë.

3

Të shtunën, në 13 dhjetor të vitit 2003 ushtarët amerikanë arrestuan Sadam Huseinin, në afërsi të qytetit të lindjes - Tikrit, në fshatin me emrin Aduar, pas tetë muajsh hetimi. Publiku i televizionit, në gjithë botën, shikon një pijanec mjekrosh, të pistë, të paqethur, mjeran.

Shikoja televizorin në garsonierën time në rrugën “Pitkalakatu Lindor”. Jetoja aty prej dy javësh. Kisha një divan, krevat, televizor dhe pjata të thella. Në mur varej një pikturë që paraqiste një pilot që katapultonte nga avioni i goditur. Librat dhe disqet i kisha lënë tek Ina. Ishim marrë vesh që të merrja të gjithë bagazhin, kur të gjendej një banesë e përshtatshme.

E urreja këtë garsonierë. Ishte në katin e parë dhe nga dritarja shikoja kokat e kalimtarëve, të cila, nganjëherë, zgjateshin brenda. Për këtë arsye perdet i mbaja pothuaj gjithmonë, i mbaja të ulura. Nga rruga, gjatë ditës, ndihej shumë zhurma e lëvizjes rrugore. Natën ishte qetë, por kjo s’kishte rëndësi. Rrija shtrirë në errësirë, i mbledhur kruspull. Para së gjithash doja të ikja prej këtej.

Në televizor pashë se si, tri mijë kilometra larg meje, një doktor me syze, ndriçonte me një fener të hollë në gojën e diktatorit të kohëve të fundit dhe përziante në të me spatul. Kishte vënë doreza lateksi dhe kishte një orë dore. Husein rrinte para një muri të bardhë i ngrysur dhe i pistë. Kishte blerë një televizor të lirë, të përdorur, të kohës së vjetër.

Fati i Huseinit nuk më interesonte, e kisha humbur interesin dhe për vuajtjet e popullit irakian. Përpiqesha të gjallërohesha. Rrija ndenjor ose shtrirë në dyshtemënë e garsonierës ose në divan i pirë, qaraman dhe shikoja se si format e mobileve të mia të vogla ndryshojnë çdo minutë që kalonte.

Dy herë në javë shkoja në universitet, për të zhvilluar kurset e Korpinenit. Ecja nëpër rrugët me baltë, vështroja në vitrinat e dyqaneve dhe shikoja shenjat e katastrofës që më kishte goditur. Zhurma e lëvizjes në rrugë sikur më pëshpëriste: “Aduar, Aduar, tani je i vetmuar, Aduar.”

Të dy kurset zhvilloheshin në formë seminari me grupe të vogla. Nuk e kujtoj qartë si i bëja. Studentët me siguri e ndienin përgjumjen time të tmerrshme dhe vetëdijen time të ngatërruar. Mendoj se, herë pas here, ia arrija të isha i zbavitës dhe, si çdo pijanec – i sinqertë.

Më kujtohet se në mësimin e fundit me grupin e dytë ra fjala për arrestimin e Huseinit. Një pjesë e studentëve shprehën mendimin se lajmi do të forconte pozitën e Bushit në fushatën elektorale. Qëndruam pas seminarit për të diskutuar. Për mendimin tim, ata ishin të rinj shumë të mirë, antiamerikanë cinikë të habitshëm. Për problemet e planetit Tokë akuzonin presidentin e Amerikës së Veriut. Pata ndjesinë se u vinte keq për shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik.

Krishtlindjen e kalova me prindërit e mi. Nuk bleva kurrfarë dhuratash, pa dhuratë mbeti, madje edhe mbesa ime. I dërgova dhuratë vetëm Inës. Në kohën e bisedave në tavolinë heshtja dhe i kushtoja vëmendje vetëm verës së kuqe. Shqetësohesha që Ina në Krishtlindje është vetëm, s’kishte të afërm në Turku dhe nuk donte të shkonte tek shokët. Nuk deshi të vinte as tek prindërit e mi. Ishte vetëm.

Aq shumë piva, saqë mbeta në shtëpinë e prindërve një javë. Rrija në krevat në dhomën time të dikurshme të fëmijërisë, flija dhe ëndërroja. Haja gjellët e nënës dhe shëtisja në rrugët pa njerëz, duke menduar që, tashmë, jam tridhjetë e një vjeç, që jam vetëm, që ditët janë me diell, netët e errëta, që një të tretën e jetës kam genë me Inën.

Gjatë pranverës së vitit 1994, Ina u kthye nga Londra. Mori me qira një apartament me dy dhoma në rrugën “Hameenkatu”. Atëherë unë shërbeja në ushtri si sanitar, ishim shokë, megjithëse,

nganjëherë, e kisha të vështirë ta takoja.

U lirova në korrik. Shërbimi në ushtri që i dobishëm për mua, isha në formë fizike të shkëlqyer. Nuk kisha pasur incidente, jeta në ushtri ishte çuditërisht liberale. Qeveria më ushqente, më paguante një shumë të vogël çdo muaj, unë e mbaja me krenari uniformën dhe, në përgjithësi, jetoja mirë.

Ishin ditë plotësisht të shkujdesura. Femrat më vështronin dhe unë ecja i tendosur si tel kitare. Isha i ri dhe pa asnjë problem.

Pasi u lirova e humba menjëherë vetëbesimin. Gjatë një jave isha tek Ina. Flija në divan. Nga koha e nxituar nuk kisha shkuar në shtëpi. Kur më bëheshin pis rrobat, i hidhja dhe blija të reja.

Në një pasdite të vonë hëngrëm pica dhe folëm për aventurat e mia me femrat. Inës iu mërzhit kjo temë dhe shfaqti dëshirën të shikonte apartamentin tim. I thashë se e kam lënë garsonierën në kampusin studentor dhe s'ka asgjë për të parë. Megjithatë ajo nguli këmbë që të shkojmë.

Ishte një pasdite e ngrohtë gushti. Me kujtohet mirë data – 28 08 1994. Shkonim për tek pjesa lindore e kampusit. Ina tha se unë jam thjesht një kokëderr dhe kam pasur të bëj me femra të papërshtatshme. E pranova që jam budalla, sepse jam burrë dhe qenie morale. Ia shpjegova që çdo burrë ka të drejtë të zgjedhë me cilën do të shtrihet në krevat. Nganjëherë ndodh edhe me femra të papërshtatshme.

Filozofoja me vetëbesim. Ina heshtte, heshta dhe unë.

Hapa derën e garsonierës. Ajo ziente nga zukatja e mushicave, s'kisha parë kurrë diçka të tillë. Pamja ishte vërtet e shpifur, pështirosëse. Ishin miliarda prej atyre mizave aq të vogla që vërtiteshin kudo. Shkova në kuzhinë dhe hapa koshin e plehrave. Një re qelbësire më goditi në fytyrë, më depërtoi në hundë, në veshë...

Mora një gazetë, e mbështolla në formë ruloni dhe fillova të nxirrja jashtë insektet. Më vinte turp që Ina shikonte këtë mynxyrë në shtëpinë time. Qëndronte në mes të dhomës, vështronte stuhinë e mushicave të pështira. Më pyeti ku është fshesa me korent. I

thashë se nuk kisha. Ajo doli dhe, pas njëzet minutash, u kthye me një fshesë korenti të kuqe. E vuri në prizë dhe filloi të sillej, ngadalë, nëpër shtëpi. Ecte përmes resë së atyre fëlliqësirave, si ndonjë Moisi femëror, i cili ndan detin nga ndyrësirat. Shpejt dhoma dukej në një mënyrë tjetër. Hapa gardërobën, nga e cila fluturoi një ré e dendur mushicash. Ina ua doli edhe atyre.

Ajo pastroi gjithçka. Ndenji me mua atë natë. Ndenji si pothuaj njëzet vjet. Rrinim shtrirë në krevatin tim të ngushtë, nën të vetmen mbulesë timen, të ngjitur pas njëri-tjetrit me trup e fytyrë. “Po fle?” - më pyeti ajo. Nuk u përgjigja, vështroja natën jashtë përtej dritares. Ajo më kapi nga mollaqet. Dy sekonda më mjaftuan që të eksitohesha. U përpoqa të tërhiqesha prej saj, por ajo më përqafonte, fuste fytyrën në qafën time dhe më puthte fort.

Pastaj m’i hoqi bokserat, i shtrëngua pas meje dhe flokët e saj më mbuluan fytyrën.

Në garsonierë ishte errët dhe ngrohtë. Ina flinte e kthyer nga muri, me shpinë prej meje. U ula dhe po e vështroja. Gjykova që, po të më kishte mbetur një pikë dinjiteti, duhej ta zgjoja dhe t’i thosha të ikte.

E shikoja dhe nuk më vinte gjumë aspak. Kalova tek karrigia lëkundëse në mes të dhomës. E hapa televizorin pa zë.

Jepej programi i natës “Teleshop”. Reklamonin gjithfarë detergjentësh, pajisje sportive dhe karrema artificialë peshkimi. Për mua të gjitha ato shpikje ishin shembull i gjenisë njerëzore për të lehtësuar jetën e njerëzve të tjerë që jetojnë në këtë planet të tmerrshëm.

Në ekran ishin ngjitur disa mushica, të cilat ishin shpërndarë nëpër fytyrën e qeshur të reklamueses.

Vështroja nga Ina, e cila me siguri ëndërronte, sepse kohë pas kohe, dridhej, sikur shikonte diçka të frikshme. U ula qetësisht dhe nuk doja ta zgjoja. Ajo u kthye, ngriti kokën, më vështroi me sy të pulitur, por nga drita e ekranit nuk më pa. Nuk u thashë kush jam. Thjesht e shikoja.

Atë natë e dija që Ina është pranë meje dhe se duhet të përpiqemi

të jemi të guximshëm, të mençur dhe të bindur. Pas nëntë vitesh, nuk kishte mbetur asgjë nga guximi im.

Nuk u besoj parandjenjave. Por, gjashtë muaj para se të vdiste Ionas, e dija se shumë shpejt do të ikte. Po pinim kafë dhe verë të kuqe. Ishim të tre – ai, unë dhe Ina. Doktorët thoshin gjëra të kundërta për gjendjen e tij. Ionas tregonte, i hutuar, tregonte për kolegun e vet që ishte i sëmurë. Nuk di përse, por e ndjeva që do të vdiste. Shpejt do të fillonte të humbte vetëdijen, herë pas here, dhe ne do të zhvendoseshim të jetonim pranë tij.

Nganjëherë mendoja për veten dhe Korpinenin. Për disa çështje kishim mendime të ndryshme. Ai akoma nuk ishte në gjendje të punonte. Një herë shkova për vizitë tek ai. Që andej u nisa i kënaqur.

Në shtëpinë e tyre mbretëronte një atmosferë e nderë. Pimë kafë në dhomën e ndenjjes. Korpineni dridhej, derdhte kafën dhe fyente gruan. Këqyra fytyrën e saj dhe mendova se ajo grua e sflitur ishte moshatarja ime. Megjithëse Korpinenin e kisha shok të vjetër, më vinte ta merrja mënjane në kuzhinë gruan e tij e t'i thosha: “Merr djalin dhe ik, lëre atë. Përndryshe ti do marrësh fund fare”.

Në fillim isha kënaqur, që lidhjet e reja të Inës nuk zgjasnin shumë. E urova për të parën dhe, kur më tha se ishte kuzhinier, ia plasa të qeshurit. Lidhja e tanishme është diçka tjetër. E shikoj që Ina, me të, ndihet e qetë dhe e gëzuar – dhe e miratova këtë. Më ftoi të kalonim së bashku vitin e Ri. Ishte e çuditshme të rrija aty, të kujtoja të kaluarën dhe të ndiej se nuk është e shkuar e pakthyeshme. Në korridor i mbajta pallton Inës. Kur u kthye, e përkëdhela në qafë, sikur të ishte akoma e imja. Isha i pirë dhe, për të dy, ky ishte një çast i tmerrshëm.

Johana më tha se jam një zekth bezdisës. Sipas meje, të gjithë njerëzit kështu janë. Kur shikojmë ose ndiejmë diçka që na pëlqen, duam ta shikojmë e ta ndiejmë përsëri. Nipit tim i pëlqejnë trenat. E çova në stacion që t'i shikonte. I entuziazmuar qëndronte në platformë dhe i përshëndeste duke tundur dorën trena që vinin e që

iknin dhe donte të shikonte më shumë, e më shumë. Ia shpjegova Johanës, çfarë do të thotë kjo, sipas meje – Aarne do të bëhet feminist kur të rritet.

Pas Inës, kisha femra, të cilat vinin, iknin dhe më hutonin. Nuk zhvisheshin si burrat. I vinin rrobat mbi karrige, sikur donin të linin një kujtim të vogël prej tyre. Pastaj ktheheshin dhe ndiheshin të turpëruara. Ishin magjepsëse. Unë jam i gjatë dhe duart i kam të bukura. E dija pse. Jam krijuar që të jem i dashur me femrat – kur i përkëdhel, mos të tremben. Kur ta gjej dashurinë tjetër, do të të bëj të pamundurën ta ruaj atë.

Ina 2.11.2002

Fund shtirjeve. Nuk e di si është për ty, por unë ndihem i lehtësuar. Kam përjetuar një vjeshtë të zezë. Kjo që ndodh me mua nuk është në dorën e askujt. Më kanë thënë drejtpërdrejt çfarë më pret dhe, megjithëse kjo më mbush me zemërim dhe frikë – u jam mirënjohës. Shpejt do ta lë veten në duart e mjekëve dhe e di se ata do të bëjnë gjithçka si duhet.

Është ora dymbëdhjetë e gjysmë pas mesnate. Shpresoja t'i hidhja mendimet e mia në një letër më të mirë, por ti dhe Niklas po flinit në dyshemenë e kabinetit tim. Qëndrova në derë dhe dëgjoja frymëmarrjen tuaj në errësirë. Me siguri po bënit gjumë të thellë. Por cilësia e letrës nuk ka rëndësi, në qoftë se ke çfarë të thuash.

Dy gjëra të rëndësishme.

E para: Ajo biseda jonë e tmerrshme, në fund të së cilës ti më pyete për çfarë krenohesha. Thashë të mos flisja për familjen, sepse ty nuk të pëlqen t'i dëgjosh këto. Vetëm tani e di si duhej të përgjigjesha. Do të mund të thosha që në det ka anije, të cilat çojnë ngarkesën e tyre në porte të sigurta. Për mendimin tim, kjo është e rëndësishme. Nëpër kuvertat dhe kajutat e tyre ka shumë njerëz. Ngarkesa e anijes s'ka rëndësi.

E dyta: Niklas dhe ti. E di si ndihesh, kur të ikën njeriu i dashur. Edhe ti e di. Duhet ta përjetoni dhe kjo të mos ju ndajë. Ju duheni

prej shumë kohësh dhe besoj se kështu do të jetë. Unë të dua pa masë, më duaj dhe ti, por mos humb për shkakun tim.

Babai yt i lodhur, Ioanas.

4

Për Inën më e rëndë ishte nata. U zgjua dhe ndjeu se dikush ishte në shtëpi. U kujtua që kjo nuk ishte e mundur. Vuri ujë për çajin dhe ndjeu hapa të matura të një njeriu të sëmurë, të mbetura në të kaluarën...

Për Krishtlindje kishte bredhin e zbukuruar dhe gatime me peshk. Erdhi Niklas dhe i solli një dhuratë. Në pako ishte e njëjta frutierë që Ina, tashmë, e kishte. Ina u ul, vështronte pemën, ushqimet dhe frutierën. Pas tri ditësh kishte ditëlindjen. Niklas erdhi me dhuratën në dorë. Në kokë kishte vënë një kapele qesharake. Ajo mendoi se ky ishte dhjetori i fundit që Niklas i bënte dhuratë. Tamam para se të ndaheshin dhe të mbyllte derën, ajo filloi të kapet pas tij.

Ishte muaji shkurt, Ina doli jashtë. Nga vdekja e babait kishte kaluar një vit. Jashtë kishte rënë errësira. Pa një tufë pulëbardhash. Shkoi dhe u ul në shkallët e gurta të katedrales. Dielli po kthjellohej, bora shkrinte, njerëzit, tashmë, nuk visheshin aq ngrohtë. Prej diku erdhën fluturim zogjtë dhe i mbushën degët e pemëve me cicërima. Kjo ishte vendlindja e saj, përmes saj kalonte lumi Ayrajoki, këtu ishin varrosur të vdekurit dhe këtu jetonin të gjallët.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Korhonen, Riku

Roman doktori / Riku Korhonen ; përkth. Xhemile
Zykaj ; red. Rexhep Hida. – Tiranë : Fan Noli, 2018
... f. ; ... cm.

Tit. origj.: Lääkäriromaani

1.Letërsia finlandeze 2.Romane

821.511.111 -31